



KLSH

E U R O S A I

E U R O S A I

(Institucionet Supreme Europiane të Auditimit)



seria: botime KLSH- 07/2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

EUROSAI

(Institucionet Supreme Europiane të Auditimit)

Tiranë, 2012

Titulli:
EUROSAI (Institucionet Supreme Europiane të Auditimit)

Redaktor:
Dr. Adriatik Kotorri

Art design:
Brixhilda Xhaferi

Seria: Botimet KLSH
07/2012

© Mundësohet përdorimi i materialeve të këtij botimi,
kundrejt citimit të burimit, KLSH.

ISBN: 978-9928-159-04-5

Ky libër u punua, nga Grupi i Punës: Dr. Bujar Leskaj, Fatos Çoçoli, Kozma Kondakçi, Irena Islami, Dalina Demi, Xhuljeta Çela dhe Redina Karapici

Shtypur në shtypshkronjën “MIRGEERALB”
Tiranë, 2012

PËRMBAJTJA

Faqe

Hyrje	5
EUROSAI- Informacion i Përgjithshëm	7
Gjykata Evropiane e Audituesve.....	36
Gjykata Federale Gjermane e Auditimit.....	43
Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO) e Britanisë së Madhe,	55
Zyra Supreme e Auditimit (NIK) e Republikës së Polonisë,	63
Gjykata Turke e Llogarive	75
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e Kosovës.....	84
Gjykata e Auditimit e Republikës së Sllovenisë	90
Zyra Kombëtare e Auditimit e Kroacisë	97
Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë	109
Gjykata e Auditimit e Mbretërisë së Hollandës	113
Gjykata Spanjolle e Llogarive	118
Gjykata Italiane e Llogarive	127
Gjykata Franceze e Llogarive	139
Gjykata Austriake e Auditimit.....	147
Gjykata Greke e Auditimit	160
Institucioni Shtetëror i Auditimit i Malit të Zi	164
Zyra e Auditimit e Shtetit të Maqedonisë.....	168
Zyra e Auditimit të Institucioneve e Bosnjës dhe Hercegovinës	172
Gjykata Rumune e Llogarive.....	175
Institucioni i Auditimit Shtetëror i Serbisë	178
Zyra Kombëtare e Auditimit e Bullgarisë.....	183
Zyra Federale Zviceriane e Auditimit	187
Gjykata e Auditimit e Belgjikës.....	190
Gjykata e Audituesve e Luksemburgut.....	196

Gjykata e Audituesve e Portugalisë	198
Zyra Kombëtare e Auditimit e Hungarisë.....	204
Zyra e Audituesit të Përgjithshëm e Mbretërisë së Norvegjisë.....	208
Agjencia Kombëtare e Auditimit e Danimarkës.....	211
Zyra Kombëtare e Auditimit e Finlandës.....	215
Zyra e Lartë e Auditimit e Republikës Çeke.....	220
Zyra e Lartë e Auditimit e Republikës Sllovaqe	224
Zyra Kombëtare e Auditimit e Maltës	227
Zyra e Auditimit e Qipros.....	230
Kontrolli i Shtetit i Izraelit	234
Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm i Irlandës.....	239
Zyra Kombëtare e Auditimit e Islandës.....	243
Dhoma e Llogarive e Federatës Ruse	245
Zyra Kombëtare e Auditimit e Estonisë.....	251
Zyra Shtetërore e Auditimit e Letonisë	255
Zyra Kombëtare e Auditimit e Lituanisë	259
Gjykata e Llogarive e Moldavisë	261
Dhoma e Kontrollit e Republikës së Armenisë	262
Dhoma e Kontrollit e Gjeorgjisë	265
Komitetit i Kontrollit i Bjellorusisë	268
Dhoma e Llogarive e Azerbajxhanit	273
Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë.....	275



HYRJE

Ky botim, pjesë e kolanës “Botime KLSH-2012 ” jep informacion për mënyrën e organizimit dhe funksionet e institucioneve supreme të auditimit të të gjitha vendeve evropiane, si dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve, organit më të lartë auditues të Bashkimit Evropian.

*Libri prezanton organizatën EUROSAI (European Organization of the Supreme Audit Institutions - Organizata Evropiane e Institucioneve më të Larta të Auditimit), komunitetin e institucioneve supreme të auditimit (SAI), ku SAI-t zhvillojnë kongrese, konferenca dhe aktivitete të tjera trajnimi e shkëmbimi reciprok eksperiencash, nën moton e INTOSAI-t “**Experientia mutua omnibus prodest**” (nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë).*

Rezoluta e miratuar në Kongresin e 6-të të EUROSAI në Bon, Gjermani në vitin 2005, në pikën 2 të saj kërkon “...rritjen e njohjes reciproke dhe shkëmbimit profesional mes SAI-ve. Komiteti i trajnimeve të EUROSAI do të publikojë materiale njohëse dhe do të çojë më tej bashkëpunimin EUROSAI-Instituti i Zhvillimit i INTOSAI, si dhe do të lehtësojë bashkëpunimin mes SAI-ve të rajonit. Ky botim i KLSH është kontribut dhe në zbatim të kësaj kërkesë të EUROSAI.

Misioni i EUROSAI është të rrisë zhvillimin profesional dhe institucional të anëtarëve të organizatës. Vizioni i tij është kontributi në përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e auditimit në sektorin publik të rajonit.

Në bazë të standardeve INTOSAI (veçojmë nenin 15 të Deklaratës së Limës, kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit publik)

dhe motos së INTOSAI, KLSH përgjatë vitit 2012 ka vendosur kontakte intensive dhe nënshkruar marrëveshje me një numër institucionesh homologe, si Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Zyra Kombëtare e Auditimit e Polonisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë, Institucioni Shtetëror i Auditimit të Kroacisë dhe Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. KLSH synon me këtë bashkëpunim trajnime efektive të stafit auditues dhe kryerjen në të ardhmen të auditimeve të përbashkëta apo paralele në rajon, për ngritjen e kapaciteteve të audituesve dhe realizimin e integritimit evropian dhe standardeve të BE-së edhe në fushën e auditimit më të lartë publik.

Ngritja e kapaciteteve audituese shton pavarësinë tonë, sikurse shprehet z. Terence Nombembe, President i INTOSAI-t dhe Auditor i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, “Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s’do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë”, thënie të cilën e citova kur paraqita platformën e zhvillimit të KLSH në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvëndit në dhjetor 2011, si kandidat për Kryetar i nominuar nga Presidenti i Republikës.

Të vetëdijshëm për trashëgiminë e përbashkët kulturore të Evropës dhe të bindur për domosdoshmërinë në efektivitetin e auditimit publik, këtë libër e përgatitëm duke ju drejtuar jo vetëm audituesve të brendshëm dhe të jashtëm të vendit, por edhe menaxherëve publikë dhe qytetarëve të interesuar për zhvillimin e komunitetit të auditimit suprem në kontinent, si mburoja e fundit dhe tejet profesionale për mbrojtjen e interesave ekonomike dhe shoqërore të taksapaguesve në realizimin e mirëqeverisjes e të përdorimit të fondeve publike me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Bujar Leskaj
Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit





E U R O S A I

Informacion i përgjithshëm

EUROSAI (Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit) është një nga grupet rajonale, pjesë e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI). INTOSAI përmbledh 190 Institucione Supreme të Auditimit (SAI) të 190 vendeve anëtare me të drejta të plota dhe katër vendeve anëtare të asociuara. INTOSAI është një organizatë mbështetëse e Kombeve të Bashkuara. Kontributi i saj është vlerësuar kohët e fundit me Rezolutën A/66/209 të 22 dhjetorit 2011 të Kombeve të Bashkuara me titull “*Promovimi i efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit*”.

Gupet e tjera rajonale të INTOSAI-t janë OLACEFS, AFROSAI, ARABOSAI, ASOSAI, PASAI dhe CAROSAI¹.

Edhe pse EUROSAI është institucioni më i ri nga shtatë grupet rajonale të INTOSAI-t, ideja e një organizate evropiane të SAI-ve daton që nga themelimi i INTOSAI në vitin 1953. Hapat e para aktive në drejtim të krijimit të EUROSAI-t u zhvilluan në vitin 1974 gjatë Kongresit të VIII të INTOSAI-t në Madrid (1974). Ndërmjet viteve 1975 dhe 1989, SAI-t e Italisë dhe Spanjës me mbështetjen e Komiteti të Kontaktit të Kryetarëve

¹ AFROSAI – Organizata Afrikane e Institucioneve Supreme të Auditimit, ASOSAI - Organizata Aziatike e Institucioneve Supreme të Auditimit, ARABOSAI - Organizata Arabe e Institucioneve Supreme të Auditimit, OLACEFS - Organizata e Amerikës Latine dhe e Karaibeve e Institucioneve Supreme të Auditimit, CAROSAI – Organizata e Karaibeve e Institucioneve Supreme të Auditimit, SPASAI - Organizata e Paqësorit të Jugut e Institucioneve Supreme të Auditimit.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Evropiane të Auditimit

të SAI-ve të vendeve të Komunitetit Ekonomik Evropian hapën rrugën për krijimin e EUROSAI-t, duke përgatitur projektet fillestare për statutin e EUROSAI-t. Në qershor të 1989, në Kongresin e XIII-të të INTOSAI-t, mbajtur në Berlin, u miratua “Deklarata e Berlinit” për krijimin e Organizatës Evropiane të SAI-ve.

Në nëntor të vitit 1990, në Madrid u zhvillua Konferenca Themeluese dhe Kongresi i EUROSAI-t. Në këtë Kuvend u zgjodh për herë të parë Kryetari dhe Bordi Drejtues i EUROSAI-t. Statutet ishin diskutuar dhe miratuar, si dhe selia e përhershme dhe Sekretariati i Përgjithshëm, te cilet u vendosën në zyrat e Gjykatës Spanjolle të Auditimit.

EUROSAI u themelua nga 30 anëtarë (SAI-t e 29 shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e Audituesve). Tani numri i vendeve të anëtarësuar është 50 (SAI-t e 49 shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e Audituesve). Objektivat e organizatës, të përcaktuara në nenin 1 të statutit të saj, kanë të bëjnë me nxitjen e bashkëpunimit profesional midis vendeve anëtare të EUROSAI-t, për të inkurajuar shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit. Kjo gjë çoi në zhvillimin e auditimit të sektorit publik dhe stimuloi krijimin e një partneriteti me akademikët e universiteteve në lidhje me këtë temë, për të punuar në drejtim të harmonizimit të terminologjisë në fushën e auditimit publik.

Procedurat Standarde të EUROSAI-t

Procedurat standarde të përfshira në këtë dokument, kanë për qëllim të mbulojnë fushat e autoritetit dhe përgjegjësive të këtyre organeve, pavarësisht nga praktikat që organizata mund të ketë miratuar, me kusht që të mënjanojnë konfliktet me Statutin e EUROSAI-t.

Mbledhjet e zakonshme të Kongresit

1. Kongresi mban një mbledhje të zakonshme çdo tre vjet, në datën dhe vendin që vendos vetë ai.
2. Vendi organizator duhet të njoftojë pjesëmarrësit dhe vëzhguesit të paktën 4 muaj përpara organizimit të mbledhjes.
3. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës të propozuar, i cili vihet në dispozicion të të gjithë anëtarëve.

Mbledhjet e Kongresit jashtë rendit të zakonshëm.

EUROSAI udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Bordi Drejtues ka të drejtë të thërrasë takime të jashtëzakonshme në çdo kohë, me nismën e tij ose me kërkesën e gjysmës së anëtarëve të Bordit.
2. Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjithë anëtarët dhe vëzhguesit për takimin e jashtëzakonshëm, të paktën 30 ditë përpara.
3. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, i cili hartohet nga Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAI-t pas konsultimeve me Presidentin dhe miratohet nga Bordi Drejtues.

Presidenti i Kongresit

1. Kongresi drejtohet nga Kryetari i Institucionit Suprem të Auditimit të vendit organizator, ose nga përfaqësuesi i tij.
2. Pasi Presidenti i Kongresit emërohet kryetar i EUROSAI-t, ai udhëheq Bordin Drejtues dhe përfaqëson EUROSAI-n.

Funksionet e Presidentit të EUROSAI-t

Kompetencat dhe detyrat janë si më poshtë:

1. Të hapë dhe të mbyllë të gjitha mbledhjet e Kongresit dhe të Bordit Drejtues.
2. Të zhvillojë debate dhe të sigurojë respektimin e statuteve dhe standardeve të veprimit.
3. Përcakton rendin e diskutanteve dhe afatin kohor për secilin.
4. Zgjidh çështjet e rendit të ditës, duke marrë parasysh të drejtën e secilit delegat për të përfshirë çështje të ndryshme në Kongres.
5. Hedh në votim propozimet dhe informon për rezultatet.
6. Nënshkruan vendimet e miratuara në emër të Kongresit dhe Bordit Drejtues, me propozim nga Sekretariati.
7. Zbaton objektivat e organizatës gjatë intervalit midis Kongreseve.
8. Me propozimin e Sekretariatit, i rekomandon Kongresit të shqyrtojë çështje specifike.
9. Miraton propozimet e Sekretariatit, të cilat nuk janë në kompetencat e Bordit Drejtues ose të Kongresit.

10. Zbaton detyrat e përcaktuara nga Kongresi dhe Bordi Drejtues.

Kompetencat e Bordit Drejtues:

1. Vendos të organizojë seminare, takime të ekspertëve dhe aktivitete të tjera të ngjashme të përkohshme.
2. Përcakton mbështetjen financiare për seminare dhe takime të tjera analoge, brenda kuadrit buxhetor të miratuar nga Kongresi.

Agjenda e Bordit drejtues :

1. Bordi Drejtues mblidhet të paktën një herë në vit.
2. Vendimet miratohen me votim në bazë të rezolutave të paraqitura paraprakisht.

Rregulloret e zbatueshme.

Në të gjitha takimet ku marrin pjesë disa anëtarë të EUROSAI-t, përcaktimi i renditjes së pjesëmarrësve dhe çdo kërkesë tjetër e anëtarëve do të ndjekë radhën e përparësisë të përcaktuar në nenin 16. Ky rregull mund të plotësohet me rregullat procedurale të vendosura nga INTOSAI.

Përparësia në EUROSAI

Në terma të përgjithshme, përparësia e EUROSAI-t është si vijon:

1. Presidenti i EUROSAI-t.
2. SAI organizator i takimit në fjalë.
3. Zëvendës-Presidenti i parë i EUROSAI-t.
4. Zëvendës-Presidenti i dytë i EUROSAI-t.
5. Sekretariati i EUROSAI-t.
6. Anëtarët e Bordit Drejtues të EUROSAI-t renditur sipas rendit alfabetik dhe sipas emrit të vendit të tyre në gjuhën angleze.
7. Vëzhguesit në Bordin Drejtues të EUROSAI-t renditur sipas rendit alfabetik të emrit të vendit të tyre në gjuhën angleze.
8. Audituesit e EUROSAI-t renditur sipas sistemit të përshkruar më lart.
9. Anëtarët e tjerë të EUROSAI-t renditur sipas sistemit të përshkruar më lart.
10. Vëzhguesit, të cilët nuk janë anëtarë të EUROSAI, renditur sipas sistemit të përshkruar më lart.

Statuti i EUROSAT-t

Të vetëdijshëm për trashëgiminë e përbashkët kulturore të Evropës dhe të bindur për domosdoshmërinë në efektivitetin e auditimit publik për administratën, përfaqësuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit të shteteve evropiane u takuan në Berlin më 20 qershor 1989, me rastin e Kongresit Botëror të 13-të të INTOSAI-it, me qëllim:

Të përmirësojë marrëdhëniet midis shteteve të Evropës në fushën e auditimit publik, përtej kufijve të sistemeve të ndryshme politike, ekonomike dhe sociale. Kongresi theksoi nevojën e bashkëpunimit ndërmjet SAI-ve, në funksion të rritjes gjithnjë e më të ngushtë të ndërveprimit mes të gjitha shteteve Evropiane. Kjo gjë do të jepte kontribut në procedurat dhe metodat e auditimit publik, duke përmirësuar shkëmbimin e përvojave mes institucioneve të tilla, duke përvetësuar përvojën evropiane, si dhe duke iu referuar qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara. Për sa më sipër, vendet ranë dakord të krijojnë një Organizatë Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT) në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

Kapitulli I: Qëllimet dhe parimet:

Objektivat

Neni 1

Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit - EUROSAT - ka për qëllim që brenda INTOSAI-t:

1. Të nxisë mirëkuptimin profesional dhe teknik të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve anëtare të EUROSAT-t dhe grupeve të tjera rajonale të INTOSAI-t, duke shkëmbyer ide dhe eksperiencë mes tyre për auditimin e financave publike.
2. Të ruajë marrëdhëniet me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara për problemet që ndikojnë në auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve publike.
3. Të mbajë të informuara të gjitha institucionet anëtare të EUROSAT-t për ndryshimet në legjislacionin e çdo shteti në çështjet e kontrollit të financave publike dhe të organizimit, si dhe funksionimin e

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

institucioneve përkatëse.

4. Të promovojë studimin teorik dhe praktik të problemeve dhe çështjeve që lidhen me auditimin e disiplinave të ngjashme.
5. Të bashkëpunojë në shkëmbimin e teknikave dhe të njohurive që konsiderohen me interes, si dhe të inkurajojë mbajtjen e seminareve dhe kurseve të trajnimit për zyrtarët e institucioneve anëtare të EUROSAT-t, si dhe të institucioneve të tjera anëtare të INTOSAT-t.
6. Të promovojë dhe lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit ndërmjet vendeve anëtare të EUROSAT-t, si dhe shpërndarjen e publikimeve mbi çështjet që janë brenda kompetencave të tyre.
7. Të nxisë krijimin e instituteve e të qendrave të specializuara, si dhe bashkëpunimin me Universitetet në lidhje me auditimin e të ardhurave publike dhe shpenzimet.
8. Të nxisë zbatimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të miratuara nga Kongresi i EUROSAT-t.
9. Të sigurojë harmonizimin e terminologjisë teknike dhe unifikimin e termave në sferën e kontrollit të financave publike.
10. Të bëjë çdo përpjekje për të arritur mirëkuptim të problemeve dhe të çështjeve që lidhen me auditimin e financave publike.

Parimet

Neni 2

EUROSAT udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Barazi e të gjitha Institucioneve Supreme të Auditimit, të cilat janë anëtare të EUROSAT-t.
2. Të respektojë të drejtën e tyre për të qenë të pavarur.
3. Të respektojë normat juridike dhe ligjore nga të cilat udhëhiqen vendet anëtare.

Kapitulli II: Përbërja

Anëtarët

Neni 3

1. Anëtarët e EUROSAT duhet të jenë Institucionet Supreme të

Auditimit të financave publike të shteteve evropiane, që janë anëtarë të INTOSAI-t, përveç Institucionit Suprem të Auditimit të Komunitetit Evropian.

2. Anëtarësimi i një institucioni i nënshtrohet Statuteve aktuale dhe miratimit të Bordit Drejtues.
3. Tërheqja nga EUROSAI bëhet e vlefshme, kur njoftimin e jep Bordi Drejtues.

Kapitulli III: Organizimi

Organet

Neni 4

Struktura e EUROSAI do të jetë:

1. Kongresi
2. Bordi Drejtues
3. Sekretariati.

Kapitulli IV: Kongresi

Përbërja

Neni 5

Kongresi duhet të përbëhet nga kryetarët e Institucioneve Supreme të Auditimit, të cilët janë anëtarë të EUROSAI-t ose përfaqësuesit e tyre zyrtarë të autorizuar. Mbledhja e Kongresit është e vlefshme kur është e pranishme shumica absolute e anëtarëve.

Vëzhguesit

Neni 6

1. Kryetari i Bordit drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t duhet të marrin pjesë, sipas detyrës, në takimet e Kongresit.
2. Përfaqësues nga institucione dhe organizata të tjera mund të pranohen si vëzhgues në vendimin e Bordit Drejtues, i cili duhet të komunikohet në Kongres.
3. Një vëzhgues nuk mund të votojë në Kongres.

Takimet

Neni 7

1. Kongresi duhet të mbliidhet në sesionet e tij të zakonshme të paktën çdo tre vjet.
2. Një seancë e jashtëzakonshme e Kongresit mund të thirret nga Bordi Drejtues me iniciativën e tij, ose me kërkesën e gjysmës së anëtarëve.
3. Kongresi kryesohet nga Kryetari i Institucionit Suprem të Auditimit të vendit organizator.

Votimi

Neni 8

1. Për miratimin e marrëveshjeve nga ana e Kongresit, është e nevojshme shumica absolute e votave të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të dispozitave të neneve 9.8, 10.1.b dhe 19.
2. Secili anëtar ka një votë.

Kompetencat dhe përgjegjësitë

Neni 9.

Kongresi është autoriteti më i lartë i i EUROSAI-t dhe ka këto kompetenca dhe detyra:

1. Të krijojë udhëzimet e nevojshme për të arritur objektivat e EUROSAI-t.
2. Të miratojë raportet e organeve të tjera të EUROSAI-t mbi aktivitetet e tyre përkatëse.
3. Të miratojë propozimet e paraqitura nga një ose më shumë prej anëtarëve të tij ose nga Bordi Drejtues.
4. Të miratojë:
 - a. Buxhetin për periudhën midis dy Kongreseve të zakonshëm.
 - b. Kontributet e anëtarëve, në përputhje me dispozitat e nenit 16.
 - c. Llogaritë e EUROSAI-t.
5. Të krijojë komisione teknike dhe grupe studimore, si dhe të përcaktojë funksionet e tyre.

6. Të zgjedhë katër anëtarët e Bordit Drejtues.
7. Të zgjedhë vendin ku do të mbahet takimi i radhës i Kongresit.
8. Të ndryshojë Statutin e EUROSAT-t, me propozimin e Bordit Drejtues ose të një të tretës së anëtarëve të EUROSAT-t, duke miratuar një rezolutë të Kongresit me një shumicë të cilësuar. Në secilin rast, ndryshimi i propozuar duhet t'u dërgohet vendeve anëtare të EUROSAT-t 30 ditë më parë.
9. Të hartojë rregullat e veta dhe ligjshmërinë.
10. Të emërojë audituesit e EUROSAT-t, në përputhje me nenin 15.

Kapitulli V: Bordi Drejtues

Përbërja

Neni 10

1. Bordi drejtues duhet të përbëhet nga 8 anëtarë, të përcaktuar si më poshtë:
 - a. Katër anëtarë të përhershëm të përcaktuar si më poshtë:
 - Krerët e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve ku janë mbajtur dy sesionet e fundit të Kongresit.
 - Kryetari i Institucionit Suprem të Auditimit të vendit ku do të zhvillohet Sesioni i radhës i Kongresit.
 - Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAT-t.
 - b. Katër anëtarë nga Kryetarët përkatës të Institucionit Suprem të Auditimit të EUROSAT-t, të zgjedhur nga Kongresi për një kohëzgjatje prej gjashtë vjetësh; dy anëtarë do të zgjidhen çdo tre vjet. Anëtarët nuk mund të rizgjidhen menjëherë pas përfundimit të mandatit të tyre.

Në mënyrë që të sigurohet një përfaqësim i balancuar i të gjithë anëtarëve, duhet bërë çdo përpjekje për të siguruar shpërndarjen e vendeve në një mënyrë të tillë që:

- Të jenë respektuar ndryshimet gjeografike në Evropë, duke marrë parasysh anëtarët e përhershëm.
- Llojet kryesore të auditimit të financave publike, të miratuara nga Institucionet Supreme të Auditimit, që përfaqësohen në Bordin Drejtues.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Nëse numri i kandidatëve tejkalon numrin e posteve, duhet të mbahet një votim i fshehtë.

Nëqoftëse, në përfundim të raundit të parë, nuk ka kandidatë të mjaftueshëm me një shumicë absolute votash të anëtarëve përfaqësues në Kongres, duhet të zhvillohet një raund i dytë dhe në përfundim do të zgjidhen kandidatët, që kanë numrin më të madh të votave.

Kryetari i Institucionit Suprem të Auditimit, ku u mbajt sesiioni i fundit, do të jetë Kryetari i Bordit Drejtues.

Kryetari i Institucionit Suprem të Auditimit të vendit, ku do të mbahet sesiioni i radhës, duhet të jetë nënkryetari i Bordit Drejtues. Këshilli Drejtues emëron një Zëvendës-kryetar të dytë midis anëtarëve të zgjedhur. Mandati i Bordit Drejtues nis me përfundimin e çdo sesiioni të radhës të Kongresit.

Së paku katër anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të jenë të pranishëm në mbledhje për të formuar një kuorum.

Bordi Drejtues mblidhet të paktën një herë në vit.

Bordi Drejtues merr vendime me shumicë votash. Çdo anëtar i Bordit Drejtues ka të drejtën e një vote. Kryetari ka votën vendimtare në rastet kur anëtarët e Bordit Drejtues kanë dështuar në arritjen e një vendimi me shumicë votash.

Kryetarët e Institucionit Suprem të Auditimit, të cilët janë anëtarë të Bordit Drejtues të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t mund të përfaqësohen si vëzhgues në takimet e Bordit Drejtues të EUROSAI-t.

Kompetencat dhe përgjegjësitë

Neni 11

Bordi Drejtues ka përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Të mbikëqyrë përmbushjen e statutit të EUROSAI-t.
2. Të përvetësojë vendimet e nevojshme për funksionimin e EUROSAI-t, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Kongresi.
3. Të miratojë projekt-buxhetin dhe ta paraqesë atë në Kongres.
4. Të hartojë udhëzime për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare nga ana e Sekretariatit dhe për auditimin e tyre.
5. Të paraqesë për miratim tek Kongresi llogaritë së bashku me raportin e audituesve dhe komentet e tyre.

6. Të paraqesë një raport mbi veprimtarinë e EUROSAT-t në çdo sesion të radhës së Kongresit.
7. Të përmbushë detyrat që i janë besuar nga Kongresi.

Kryetari

Neni 12

Kryetari i Bordit Drejtues duhet të përfaqësojë EUROSAT-n.

Kapitulli VI: Sekretariati

Struktura

Neni 13

Selia qendrore e Institucionit Suprem të Auditimit siguron funksionimin e Sekretariatit, ku Kryetari i tij duhet të jetë Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAT-t.

Kompetencat dhe përgjegjësitë

Neni 14

Sekretariati ka përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Të përgatisë mbledhjet e Bordit Drejtues.
2. Të zbatojë vendimet e Kongresit dhe të Bordit Drejtues.
3. Të përgatisë projekt-buxhetin e EUROSAT-t dhe ta paraqesë atë në Bordin Drejtues.
4. Të paraqesë pasqyrat financiare si dhe një raport financiar vjetor të Bordit Drejtues.
5. Të zbatojë buxhetin dhe të mbajë llogaritë dhe rregjistrat e EUROSAT-t.
6. Të kryejë detyrat e caktuara nga Kongresi ose nga Bordi Drejtues.

Kapitulli VII: Audituesit

Auditimi

Neni 15

1. Dy auditues nga dy Institucione Supreme të Auditimit, anëtare të EUROSAT-t, kontrollojnë llogaritë dhe menaxhimin financiar të organizatës dhe i raportojnë Bordit Drejtues, si dhe Kongresit.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

2. Të dy audituesit caktohen për tre vjet dhe zgjidhen nga Institucionet Supreme të Auditimit, të cilët nuk janë anëtare të Bordit Drejtues.
3. Sekretariati ju ofron audituesve të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara, si dhe i ndihmon ata në përmbushjen e detyrave të tyre.

Kapitulli VIII: Rregulloret Financiare

Rregulloret Financiare

Neni 16

1. Shpenzimet e bëra nga EUROSAI përballohen:
 - a. Nga kontributet e anëtarëve të caktuar në bazë të klasifikimeve të përdorura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Anëtarët njoftohen për vlerësimet nga Sekretariati i Përgjithshëm dhe pagesa bëhet në fillim të çdo viti kalendarik.
 - b. Nga grantet, donacionet, apo ndonjë lloj tjetër kontributi dhënë nga subjektet kombëtare, ndërkombëtare ose individë.
 - c. Nga të ardhurat e shitjes së publikimeve dhe veprimtarive të tjera të EUROSAI-t
 - d. Me anë të çdo të ardhure tjetër të miratuar nga Bordi Drejtues.
2. Institucioni Suprem i Auditimit të vendit siguron dhe paguan për personelin e nevojshëm, si edhe për hapësirat për funksionimin e Sekretariatit.
3. Kostot, që rezultojnë nga çdo mbledhje e Kongresit, përballohen nga Institucioni Suprem i Auditimit, ku do të zhvillohet takimi. Kongresi mund të vendosë të kontribuojë për Institucionin e Lartë të Auditimit në fjalë.

Kapitulli IX: Dispozitat Përfundimtare

Zyrat qendrore dhe statusi ligjor

Neni 17

1. Selia e EUROSAI-t është Gjykata e Llogarive të Spanjës.
2. EUROSAI funksionon në bazë të rregullave dhe ligjeve të shtetit ku ndodhet selia. Ajo rregullohet me Statutet e veta dhe dispozitat rregulluese për ekzekutimin e tyre, ose nga legjislacioni i shtetit në fjalë.

Klauzola për gjuhën

Neni 18

Gjuhët zyrtare të EUROSAT-t janë: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe rusisht.

Shpërbërja e EUROSAT-t

Neni 19

Në rast të shpërbërjes, e cila duhet të arrihet me një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të EUROSAT-t, procedurat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e shtetit ku ndodhet selia.

Roli i ekipeve të EUROSAT-t

Kongresi i EUROSAT-t është autoriteti suprem i organizatës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e tij. Roli i tij më i rëndësishëm është që të diskutojë dhe të miratojë rekomandimet për çështjet me interes të përbashkët profesional dhe teknik. Një herë në çdo tre vjet, EUROSAT organizon takime të rregullta, secili prej të cilëve kryesohet dhe thirret nga kreu i SAT-t anëtar që organizon Kongresin.

Ndërmjetkongreseve, Bordi Drejtues i EUROSAT-t ndërmerr të gjitha hapat që i konsideron të nevojshme për të arritur qëllimet e EUROSAT-t, duke përfshirë edhe kryerjen e detyrave të caktuara nga Kongresi për Bordin Drejtues. Sekretariati mban kontakte me anëtarët, mbështet Bordin Drejtues dhe organet në misionin e tyre.

Organet e tjera të EUROSAT-t janë të rëndësishme në avancimin e punës së EUROSAT-t në periudhën ndërmjet Kongreseve. Pjesa më e madhe e punës së tyre lind nga shqyrtimi i çështjeve në kongrese. Që nga krijimi i Ekipeve të Orientuara në Kongresin e tetë të EUROSAT-t dhe në bazë të nenit 9.5 të statutit të EUROSAT-t, organet e EUROSAT-t ekzistojnë në formë të ndryshme:

- Katër Ekipet janë krijuar për të çuar përpara punën e EUROSAT-t drejt arritjes së qëllimeve strategjike të tij, duke kontribuar edhe në zbatimin e strategjisë së INTOSAT-t në Evropë. Ekipet veprojnë, në një mjedis bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës, duke iu nënshtuar rishikimit të Planit Strategjik të EUROSAT-t. Ekipet janë një pjesë e përhershme e strukturës së EUROSAT-t.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- Grupet e punës janë ngritur nga Kongresi, që të merren me një sërë çështjesh, që janë me interes të ndërsjellë për SAI-t anëtare, si dhe me çështjet profesionale, të cilat lidhen me një praktikë më të gjerë të auditimit. Mandatat e grupeve të punës mund të zgjaten, por nuk duhet të konsiderohen si të përhershme.
- “Task Forcat” janë ngritur nga Kongresi ose Bordi Drejtues, për një periudhë të kufizuar kohore, për t’u marrë me detyra të veçanta, të një natyre teknike ose organizative.
- Projekti dhe Grupet e Studimit mund të themelohen nga një ekip, grup pune ose “task forca” për një periudhë të kufizuar, për të lehtësuar punën e këtij organi.

1.1 ROLI I EKIPEVE

Janë katër ekipe të krijuara nga Kongresi për të arritur qëllimet strategjike të EUROSAI-t:

Ekipi 1: Ndërtimi i kapaciteteve.

Ekipi 2: Standardet profesionale.

Ekipi 3: Shkëmbimin e njohurive.

Ekipi 4: Qeverisja dhe komunikimi.

Qëllimi i Ekipeve është të arrijnë qëllimet strategjike brenda periudhës së vlefshmërisë së planit strategjik të EUROSAI-t. Ekipeve janë të ngritura dhe detyrat e secilit përcaktohen në planin strategjik.

Ndërsa tre Ekipeve e para janë përgjegjëse për zbatimin e zonave të veçanta të planit strategjik, Ekipi i katërt duhet të sigurohet që çështjet e ndërprera, përfshirë bilancin, koherencën dhe pajtueshmërinë me planin strategjik, janë trajtuar në mënyrën e duhur.

Grupet e punës / “Task Forca”

Në përputhje me nenet 9.5 të statutit të EUROSAI-t dhe 13 të Procedurave Standarde, Kongresi i EUROSAI-t është kompetent për krijimin e komisioneve teknike, grupeve studimore dhe për përcaktimin e funksioneve të tyre.

Këto organe janë krijuar për të mbështetur Kongresin në nivel teknik, në

veprimet dhe iniciativat konkrete, duke i besuar mandate të veçanta. Këto organe mund të krijohen nën një bazë të përhershme ose me afat konkret për zhvillimin e detyrës “ad hoc”. Themelimi, dhënia e mandateve të reja dhe shpërbërja e këtyre organeve janë nën përgjegjësinë e Kongresit.

Gjithashtu Bordi Drejtues i EUROSAT-t mund të ngrëjë grupe pune, komitete dhe projekte / grupe studimi për ta mbështetur atë në zbatimin e kompetencave të tij.

Anëtarët e EUROSAT-t mund të marrin pjesë në këto organe vullnetarisht. Çdo grup pune, “task force” ose komitet teknik duhet të zgjedhë kryetarin e vet. Të gjithë anëtarët, që marrin pjesë në komitetet teknike ose grupet e studimit duhet të përfaqësohen nga delegatët apo përfaqësuesit e tyre, të cilët mund të ndihmohen nga ekspertë ose këshilltarë.

Grupet e punës, “Task Forcat” dhe Komisionet, që aktualisht janë duke operuar në kuadër të EUROSAT-t:

- **Grupi i punës për Auditimin e Mjedisit** (themeluar në vitin 1999 - Kongresi IV). Drejtuar nga SAI i Norvegjisë.
- **Grupi i punës për Teknologjinë e Informacionit** (themeluar në vitin 2002 - Kongresi V). Drejtuar nga SAI i Zvicrës.
- **Task Force për Auditimin e Fondeve të Caktuara për Katastrofat dhe Fatkeqësitë** (themeluar në vitin 2008 - Kongresi VII). Drejtuar nga SAI i Ukrainës.
- **Komiteti i Monitorimit për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave elektronike për praktikën, në cilësinë e auditimit** (themeluar në vitin 2001- Kongresi VIII, për zhvillimin dhe mbajtjen e përditësuar të punës së bërë nga ana e Grupit të Punës së EUROSAT-t për hartimin e një Udhëzuesi mbi Praktikën më të mira në cilësinë e auditimit, krijuar në vitin 2008). Drejtuar nga SAI i Hungarisë.
- **Task Forca e Auditimit dhe Etikës** (themeluar në vitin 2011- Bordi Drejtues). Drejtuar nga SAI i Portugalisë.

Komisioni i Trajnimit të EUROSAT-t

Krijimi i një Komisioni të Trajnimit të EUROSAT-t (KTE) u miratua nga Bordi Drejtues në mbledhjen e XXI-të, të mbajtur në Madrid (Spanjë) në

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

vitin 2000, pas një takimi të jashtëzakonshëm (XIX) në Paris, në nëntor të vitit 1999 dhe një takimi përgatitor në Frankfurt në fillim të vitit 2000. KTE-ja ishte e përbërë nga tetë vende anëtarë: SAI i Republikës Çeke, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Polonisë, Portugalisë, Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar. SAI i Francës dhe i Spanjës bashkëkryesojnë Komitetin.

Në takimin e XXXI të Bordit Drejtues të EUROSAT-t (Reikjavik, 11 shtator 2006) u ra dakord që të përfshiheshin në Komisionin e Trajnimit si anëtarë të rinj, SAI i Lituanisë dhe Hungarisë, që kishin qenë vëzhgues respektivisht në Komisionin e vitit 2002 dhe 2005. Në takimin e XXXII të Bordit Drejtues (Bernë, 13 shtator 2007), SAI i Federatës Ruse u bë anëtar i Komitetit të Trajnimit të EUROSAT-t, pasi kishte marrë pjesë në këtë Komitet si vëzhgues.

Disa subjekte të tjera kanë marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e KTE-së: Gjykata Evropiane e Audituesve, Komiteti për Ngritjen e Kapaciteteve të INTOSAT-t, Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAT-t dhe SIGMA.

KTE-ja, nën autoritetin e Bordit Drejtues, ishte në krye të çështjeve që lidheshin me trajnimin brenda rajonit të EUROSAT-t.

Misioni i EUROSAT-t në lidhje me trajnimet është:

“Të rrisë zhvillimin profesional dhe institucional të anëtarëve të EUROSAT-t”.

Misioni përcakton qëllimin kryesor të aktiviteteve trajnuese të EUROSAT-t. Ai gjithashtu pasqyron edhe zhvillimet e pritshme të EUROSAT-t, në mënyrë që kapaciteti profesional i individit të jetë i ndërvarur me zhvillimin institucional të SAI-t. Për këtë arsye, këto dy nivele duhet të jenë njëkohësisht në qendër të vëmendjes për aktivitetet e trajnimit të EUROSAT-t. EUROSAT i kushton vëmendje të veçantë SAI-ve që e kanë më të nevojshme gritjen e kapaciteteve.

Vizioni i EUROSAT-t në lidhje me trajnimet është:

“EUROSAT kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e auditimit të sektorit publik të rajonit”.

Vizioni shpreh qëllimin e EUROSAT-t në lidhje me trajnimin. Duke respektuar dhe vlerësuar diversitetin e rajonit, mendimi i tij është se ka gjithmonë hapësirë për zhvillim dhe përmirësim. Duke lehtësuar shkëmbimin e përvojës dhe mundësitë për të mësuar nga njëri-tjetri, si dhe ekspertët e jashtëm, EUROSAT duhet të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e auditimit të sektorit publik të kryer në rajon.

Kongresi i EUROSAT-t

Kongresi i EUROSAT-t është organi më i lartë i Organizatës. Sipas neneve 5-9 të Statutit, Kongresi është i përbërë nga të gjithë anëtarët e Organizatës. Ai organizon seanca të zakonshme çdo tre vjet.

Kongresi Kushtetues i EUROSAT-t u mbajt në Madrid (Spanjë) në vitin 1990. Kongreset në vijim u zhvillua në:

- 1993, Stokholm (Suedi);
- 1996, Pragë (Republika Çeke);
- 1999, Paris (Francë);
- 2002, Moskë (Rusi);
- 2005, Bon (Gjermani);
- 2008, Krakov (Poloni);
- 2011, Lisbonë (Portugali).

Kongresi ka funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

- Të krijojë udhëzimet e nevojshme për të arritur objektivat e EUROSAT-t.
- Të miratojë raportet e organeve të tjera kushtetuese të EUROSAT-t mbi aktivitetet e tyre përkatëse.
- Të miratojë propozimet e paraqitura nga një ose më shumë anëtarë të saj ose nga Bordi Drejtues.
- Të miratojë:
 - Buxhetin për periudhën midis dy Kongreseve të zakonshëm.
 - Kontributet financiare të anëtarëve.
 - Llogaritë e EUROSAT-t.
- Të krijojë komisione teknike dhe grupe pune për të përcaktuar funksionet e tyre.
- Të zgjedhë katër anëtarë të Bordit Drejtues.
- Të zgjedhë vendin ku do të mbahet takimi tjetër i Kongresit.
- Të ndryshojë Statutin e EUROSAT-t, me propozimin e Bordit drejtues ose me një të tretën e anëtarëve të EUROSAT-t, duke e miratuar rezolutën e Kongresit me një shumicë prej dy të tretave

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

të të pranishmëve. Në këtë rast ndryshimi i propozuar duhet t'u dërgohet anëtarëve të EUROSAI-t 30 ditë përpara.

- Të hartojë rregullat dhe rregulloret e veta.
- Të caktojë audituesit e EUROSAI-t.



Revista EUROSAI

Që nga Kongresi i tetë (Lisbonë), Kryesia e EUROSAT-t është mbajtur nga Presidenti i SAI-t të Portugalisë. Kongresi i nëntë do të zhvillohet në Hollandë në vitin 2014.

Bordi Drejtues i EUROSAT-t

Sipas neneve 10-12 të Statutit, Bordi Drejtues i EUROSAT-t është i përbërë nga tetë anëtarë:

- Katër anëtarë me të drejta të plota (Krerët e SAI-ve, vendet e të cilëve organizuan dy seancat e fundit të zakonshme të Kongresit, kreu i SAI-t, që do të organizojë seancën e radhës së Kongresit, si dhe Sekretari i EUROSAT-t).
- Katër anëtarë të tjerë të zgjedhur nga Kongresi për një mandat gjashtë vjeçar (dy anëtarë që zëvendësohen çdo tre vjet).

Për të siguruar një përfaqësim sa më dinjitoz të anëtarëve në Bordin Drejtues, në procesin e përzgjedhjes, duhet të merret parasysh edhe larmia gjeografike dhe sistemet e ndryshme të organizimit të auditimit të sektorit publik.

Kryetarët e SAI-ve që janë pjesë e Bordit Drejtues të INTOSAT-t dhe janë Anëtarë të EUROSAT-t, gjithashtu, marrin pjesë në Bordin Drejtues, si vëzhgues.

Të ftuarit mund të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit drejtues për paraqitjen e artikujve të veçantë të rendit të ditës.

Që nga Kongresi VIII (EUROSAT në Lisbonë, Maj-Qershor 2011) Bordi Drejtues përbëhet nga SAI-t e mëposhtëm:

- Anëtarët: Portugali, Poloni, Spanjë, Turqi, Ukrainë, Hollandë, Belgjikë dhe Gjykata Evropiane e Audituesve.
- Vëzhguesit: Austria, Hungaria, Norvegjia, Federata Ruse dhe Mbretëria e Bashkuar

Bordi Drejtues drejtohet nga Presidenti i EUROSAT-t (SAI i Portugalisë), i cili përfaqëson Organizatën. Dy zëvendës – presidentë (që nga qershori 2011 zëvendës- presidenti i parë, SAI i Hollandës dhe zëvendës – presidenti i dytë, SAI i Turqisë) dhe Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAT-t, i cili mbështet Presidentin në përmbushjen e detyrave.

Bordi Drejtues mbledhet të paktën një herë në vit, mbledhja e fundit ka qenë në Lisbonë (Portugali), më 2 qershor 2011. Mbledhja e radhës e Bordit Drejtues u mbajt në Ankara (Turqi), më 28 Maj 2012.

Bordi drejtues ka këto përgjegjësi:

- Të mbikqyrë plotësimin e statuteve të EUROSAI-t.
- Të miratojë vendimet e nevojshme për funksionimin e EUROSAI-t, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Kongresi.
- Të miratojë projekt-buxhetin dhe ta paraqesë atë në Kongres.
- Të hartojë udhëzime për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare nga ana e Sekretariatit dhe më pas për auditimin e tyre.
- Ti paraqesë Kongresit për miratim llogaritë, së bashku me raportin e audituesit.
- Të paraqesë një raport mbi veprimtarinë e EUROSAI-t në çdo seancë të zakonshme të Kongresit.
- Të përmbushë detyrat e besuara nga Kongresi.

Sekretariati i EUROSAI-t

Sipas neneve 13-14 të Statutit të EUROSAI-t, Sekretariati i Organizatës është mbajtur përherë nga Gjykata e Llogarive e Spanjës, e cila është edhe selia e EUROSAI-t. *Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAI-t është kryetari i Gjykatës Spanjolle të Auditimit.*

Sekretariati i mban vendet anëtare të EUROSAI-t në kontakt dhe promovon marrëdhëniet mes tyre gjatë intervalit midis Kongreseve. Sekretariati është gjithashtu përgjegjës për hartimin e një plani të propozimeve të paraqitura në organet qeverisëse, me kërkesë të anëtarëve. Sekretariati publikon revistën vjetore “Revista EUROSAI” dhe një buletin tremujor “Buletini i EUROSAI-t”, të cilat gjenden në faqen e internetit të EUROSAI-t.

Sekretariati ka *përgjegjësitë* e mëposhtme:

- Të përgatisë mbledhjet e Bordit Drejtues.
- Të zbatojë vendimet e Kongresit dhe të Bordit Drejtues.
- Të përgatisë projekt-buxhetin e EUROSAI-t dhe ta paraqesë atë në Bordin Drejtues.
- Të paraqesë pasqyrat financiare, përveç një raporti financiar vjetor të Bordit Drejtues.
- Të realizojë buxhetin dhe të mirëmbajë llogaritë dhe regjistrat e EUROSAI-t.
- Të kryejë detyrat e caktuara nga Kongresi ose nga Bordi Drejtues.

Bashkëpunime me Institucione dhe Organizata të tjera

EUROSAI gjithashtu zhvillon aktivitetin e tij në bashkëpunim me organizata të tjera dhe institucione ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me organizatat e tjera ndërkombëtare të institucioneve të Auditimit.



17-18, shtator 2012.

Një delegacion i KLSH-së, kryesuar nga Kryetari, z. Bujar Leskaj, mori pjesë në konferencën e EUROSAI – OLACEFS në Tbilisi, Georgji

EUROSAI mban rregullisht Konferenca bashkërisht me OLACEFS. Deri më sot janë zhvilluar gjashtë Konferenca (Spanjë, Kolumbi, Mbretëria e Bashkuar, Peru, Portugali dhe Venezuelë). Konferenca e shtatë e përbashkët e EUROSAI dhe OLACEFS u zhvillua në Tbilisi, Gjeorgji në datat 17-18 Shtator 2012, me temë “*Roli i institucioneve supreme të auditimit në mirëqeverisjen e sektorit publik*“. Në të mori pjesë një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kryesuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj. Kryetari i delegacionit të KLSH z. Leskaj zhvilloi një sërë takimesh me homologët e SAI-ve pjesëmarrës në këtë konferencë, si me Presidentin e

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, Dr. Igor Šoltes, me Presidentin e Zyrës së Auditimit Suprem (NIK) të Polonisë, z. Jacek Jezierski, me Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Turqisë Dr. Recai Akyel, etj.

Konferenca u fokusua në dy drejtime kryesore, në rritjen e besueshmërisë së palëve të interesuara, nëpërmjet auditimit të integritetit dhe përgjegjshmërisë menaxheriale e filozofisë dhe sjelljes së titullarit, si dhe në reformën e menaxhimit financiar publik, me tendencat dhe mësimet e nxjerra.

Në përfundim të këtij takimi, u formulua dhe Deklarata e Tbilisit, si më poshtë:

DEKLARATA E TBILISIT

EUROSAI dhe OLACEFS u mbledhën në Konferencën e VII-të të përbashkët, të mbajtur në Tbilisi (Gjeorgji), më 17-18 shtator 2012,

Njohin:

- Nisur nga mjedisi ekonomik e social, si dhe kërkesat e qytetarëve duhet të kryhen reforma nga shtetet, të cilët synojnë menaxhimin e burimeve publike në mënyrë efikase, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë fiskale.*
- Ashtu siç theksohet në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara A/66/209, më datë 22 dhjetor 2011, SAI-t luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të lartpërmendura. Në mënyrë që SAI-t të kontribuojnë për të pasur një përgjegjshmëri sa më të madhe në institucionet publike, është thelbësore të sigurohet pavarësia dhe cilësia e lartë e punës së tyre, duke rritur kështu besimin e palëve të interesit.*
- Strategjitë e shëndosha, komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm, kërkesat etike, cilësia dhe monitorimi i mekanizmave të kontrollit janë elementë kryesor që SAI-t të arrijnë të kenë një veprimtari të shkëlqyer në menaxhim. Zhvillimi i IT-së dhe vlerësimi i punës nga homologët janë instrumenta të vlefshme për rritjen e kapaciteteve të SAI-t, si dhe përgjegjshmërinë dhe transparencën, duke rritur kështu besimin e qytetarëve.*
- SAI-t kontribuojnë ndjeshëm për arritjen e një qeverisje të mire, në ruajtjen dhe mbajtjen e funksionit efikas të kontrolleve të zhvilluara, që lëshojnë rekomandime me qëllim përforcimin e menaxhimit*

publik, si dhe të transparencës së informacionit mbi këto çështje për shoqërinë.

- *Praktikat dhe përvojat e secilit SAI përfaqësojnë një burim të vlefshëm informacioni për të tjerët, kështu bashkëpunimi shërben më së miri për përmirësimin e marrëdhënieve me publikun, për menaxhimin dhe auditimin e jashtëm në nivel global, duke përfitur nga sinergjitë ndërkombëtare.*

Inkurajojmë:

Të dyja organizatat t'i përhapin këto parime brenda komuniteteve të tyre rajonale dhe të punojnë së bashku në mënyrë që të auditojnë dhe promovojnë më shumë efikasitet, më shumë përgjegjshmëri, efektivitet, integritet dhe transparencë në menaxhimin publik për të mirën e qytetarëve.

Anëtarët e tyre duhet të udhëhiqen nga shembuj për përmirësimin e cilësisë së punës së tyre dhe për të rritur ndërgjegjësimin e vlerave dhe përfitimeve të SAI-t në arritjen e qeverisjes së mire.

Të dyja organizatat, për të intensifikuar bashkëpunimin në kuadër të komunitetit INTOSAI, përmes niveleve të ndryshme të vendim-marrjes së tyre dhe strukturave të punës, nxisin përfitimin e sinergjive maksimale nga njëra-tjetra, si dhe rritjen e ndikimit të veprimeve të tyre të përbashkëta Kryetarët dhe Sekretarët e Përgjithshëm të EUROSAT-t dhe OLACEFS-it ia përcjellin këtë Deklaratë Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Presidentëve dhe Sekretariateve të Përgjithshme të Grupeve të tjera Rajonale të Punës së INTOSAI-t, si dhe të palëve të tjera të interesit.

Deklarata e Pavarësisë së SAI-ve

Miratur në Kongresin e katërt të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT), më 4 Qershor 1999.

Në Deklaratën e Limës (1977), SAI-t ripohuan angazhimin e tyre për pavarësi, kusht ky i domosdoshëm për auditimin efikas të menaxhimit të llogarive publike.

Që atëherë kanë ndodhur ndryshime të shumta sociale, teknologjike dhe politike. Në veçanti, hapja e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore ka përtërirë kërkesat për pavarësi dhe transparencë. Decentralizimi, privatizimet dhe liberalizimi kanë ndryshuar të gjithë menaxhimin e sektorit publik.

Për këtë arsye anëtarët e EUROSAT-t u takuan në Seminarin e Lisbonës (1998) dhe më pas në Kongresin e Parisit (1999), ku ripohuan se sot pavarësia mbështetet në parimet e mëposhtme:

1. SAI-t duhet të kenë burimet e nevojshme për të qenë plotësisht të pavarura.

Pavarësia e SAI-ve duhet të bazohet në dispozitat kushtetuese ose legislative që përcaktojnë natyrën e tyre institucionale në kuadër të kompetencave publike. Pavarësia varet edhe nga garancitë e dhëna kryetarëve të SAI-ve, kështu që ata mund të kryejnë detyrat e tyre në një mjedis mjaft të qëndrueshëm. Mbrojtja është e nevojshme kundër presionit të jashtëm së bashku me kompetencat e përcaktuara qartë të hetimit, kur bëhet fjalë për ruajtjen e pavarësisë së audituesve.

SAI-t duhet të kenë burime të mjaftueshme në dispozicion, në mënyrë që të mund të kryejnë detyrat e tyre. Autonomia buxhetore përbën një tjetër faktor që mund të nxisë pavarësinë e vërtetë.

Së fundi, në mënyrë që të jenë plotësisht të pavarura, SAI-t duhet të jenë të lira kur bëhet fjalë për planifikimin dhe kryerjen e auditimeve, në mënyrën se si ata e gjykojnë të arsyeshme.

2. Pavarësia shkon dorë për dorë me përgjegjësinë, e cila manifestohet në mënyra të ndryshme, në varësi të kuadrit institucional të vendit.

SAI-t duhet t'u nënshtrohen të njëjtave rregulla, të cilat u rekomandohen të tjerëve për të ndjekur.

Ata duhet të vendosin procedura të auditimit të brendshëm për të siguruar efikasitetin e punës së tyre. Auditimet e brendshme duhet të strukturohen në mënyrë të tillë që ata të kenë mjetet për të pajisur presidentët dhe drejtuesit me një imazh të vërtetë dhe të besueshëm të performancës së institucionit. Ky auditim i brendshëm duhet të sigurojë një monitorim të rregullt të treguesve të tyre operacionale dhe të bëjë vlerësime për rezultatet e kontroleve të auditimit që institucioni zhvillon.

SAI-t janë të prirura gjithmonë e më shumë drejt kërkesës për t'u ushtruar mbi to auditime të jashtme. Kjo procedurë i ofron publikut garanci, që SAI-t përdorin metoda të përshtatshme pune dhe kjo nuk duhet të përbëjë ndonjë sfidë për pavarësinë e tyre.

Me anë të publikimit të raporteve buxhetorë të performancës dhe raporteve mbi aktivitetet e auditimit dhe duke i dërguar ato në Parlament, SAI-t duhet të paraqesin shkallën më të lartë të transparencës në çështjet lidhur me mënyrën se si ata përdorin burimet në dispozicion dhe rezultatet që kanë arritur.

3. Marrëdhëniet me median si një tjetër tregues i pavarësisë së SAI-ve.

Liria e SAI-ve për të përcaktuar politikën e tyre të komunikimit me median dhe me publikun brenda kornizave ligjore ekzistuese është një komponent thelbësor i pavarësisë dhe efikasitetit të tyre. Duhet të sigurohemi se procesi i tyre i komunikimit ofron një pamje të drejtë dhe të paanshme dhe që nuk krijon mundësi për kundërshtime të pakuptimta. Me përjashtim të atyre rasteve ku shpërndarja e informacionit është e detyrueshme në përputhje me dispozitat ligjore ose kushtetuese, kjo liri përfshin mundësinë e publikimit ose jo të një raporti të veçantë për publikun. E njëjta filozofi mund të zbatohet për përmbajtjen, mjedisin, formën, datën dhe mjetet e shpërndarjes.

Transparenca në lidhje me organin që është duke u audituar është thelbësore. Kjo duhet të transmetohet me anë të një procesi ku faktet bien dakord me këto organe dhe / ose nëpërmjet këtyre pohimeve, duke u botuar së bashku me raportet e SAI-ve, në mënyrë që publiku të marrë informacion të plotë, të balancuar dhe të drejtë. Publiku gjithmonë duhet të ketë qasje të drejtpërdrejta në raportet që SAI ka vendosur të publikojë, duke iu vënë në dispozicion kopje. Këto raporte duhet të sigurohen nëpërmjet mediave të ndryshme të informimit, duke përfshirë këtu edhe një faqe Eëb-i.

DEKLARATA E EUROSAT-t

Përforcimi i pavarësisë së Institucioneve të Larta të Auditimit.

Duke kujtuar Deklaratën e Limës me Udhëzimet për Rregullat e Auditimit të vitit 1977 dhe Deklaratën e Meksikës për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit të vitit 2007 të lëshuar nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), ku përcaktohen parimet e pavarësisë në auditimin e qeverisë.

Duke pranuar kontributin thelbësor të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) për një qeverisje të mirë në mbrojtje dhe ruajtje të funksioneve të kontrollit efikas të zhvilluara nga parlamentet, lëshimin e rekomandimeve që synojnë forcimin e menaxhimit publik, si dhe sigurimin e informacionit në lidhje me këto çështje për organet publike dhe për shoqërinë.

Duke theksuar se pavarësia e funksionit të auditimit publik është e një rëndësie primare për garantimin e transparencës dhe integritetit të administratës publike, duke forcuar besimin publik në institucionet qeveritare.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Duke nënvizuar se pavarësia e SAI-ve nga organet e audituara, bën të mundur mbrojtjen nga presionet e jashtme, lirinë deri në rezultatet e auditimeve të tyre, sigurimin e objektivitetit të gjetjeve të tyre, besueshmërinë dhe transparencën. Kjo gjithashtu bën të mundur që këto auditime të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes publike.

Duke theksuar faktin se disa anëtarë të EUROSAI-t, gjatë mandatit të tyre kanë hasur në kërcënime, duke mos marrë në konsideratë fuqitë e tyre, duke u përpjekur për të ndikuar në rezultatet e tyre, duke kufizuar burimet, duke dëmtuar reputacionin e tyre ose duke vënë në dyshim neutralitetin e tyre politik.

Anëtarët e EUROSAI-t, u mbledhën në Kongresin e VIII-të, të mbajtur në Lisbonë më 30 maj – 2 qershor 2011:

Për të njohur dhe mbështetur iniciativat për zhvillimin e INTOSAI-t, në nivel të brendshëm dhe të jashtëm, në promovimin e një niveli më të lartë të transparencës, përgjegjshmërisë dhe përdorimit sa më efektiv dhe efikas të burimeve publike për të mirën e qytetarëve.

Për të manifestuar angazhimin e plotë të EUROSAI-t në forcimin dhe mbështetjen e pavarësisë së SAI-ve, duke ndërmarrë hapa aktivë në këtë drejtim, si një element kyç i strategjisë së saj, duke inkurajuar një përhapje të gjerë të këtyre parimeve dhe duke kontribuar për të zgjeruar dhe zbatuar rezultatet e përpjekjeve të INTOSAI-t në Rajonin Evropian.

Për të shprehur hapur vullnetin e tyre për të mbajtur linja komunikimi me parlamentin, pushtetin publik, mediat dhe qytetarët në mënyrë që sfidat të përballohen në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.

Për të inkurajuar anëtarët e EUROSAI-t ta përcjellin këtë Deklaratë në Parlamentet e tyre dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme:

- Për të rritur ndërgjegjësimin rreth vlerave, përfitimeve, rolit dhe rëndësisë së pavarësisë së SAI-ve, duke ndërmarrë një veprim aktiv në ruajtjen e tyre.
- Duke kërkuar mbështetje për aktivitetet aktuale që zhvillohen në nivel të OKB-së, veçanërisht përpjekjet në bazë të rezolutës ECOSOC të 26 prillit 2011, në lidhje me miratimin e një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së duke njohur rëndësinë e parimit të pavarësisë së SAI-ve siç është përcaktuar në Deklaratat e Limës dhe atë të Meksikos.

Për të inkurajuar anëtarët e EUROSAI-t të informojnë pushtetin publik, mediat dhe qytetarët, mbi rëndësinë e ruajtjes dhe sigurimin e funksionimit

të pavarur të SAI-ve të tyre, sipas Deklaratës së Limës dhe Meksikës.

Kongresi VIII i EUROSAT-t miraton:

Deklaratën drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian, Komisionit Evropian dhe parlamenteve dhe qeverive të shteteve anëtare të BE.

1. Komiteti i Kontaktit i Krerëve të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) të shteteve anëtare të BE-së dhe ai i Gjykatës Evropiane të Auditorëve (ECA-së), umblodhën në Luksemburg më 13-14 tetor 2011. Një pjesë e mirë e takimit iu përkushtua diskutimit për ndikimin e SAI-ve të BE-së dhe ECA-së në Semestrin Evropian. Zhvillimet e tjera të kohëve të fundit në BE, që kanë të bëjnë me qeverisjen ekonomike përfshijnë rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve financiare, institucionet, ndihmën shtetërore për sektorin financiar dhe auditimin e mekanizmave për menaxhimin e krizës së euros.

2. Komiteti i Kontaktit vlerëson se kriza globale financiare dhe ekonomike ka zbuluar lidhjen e ngushtë midis ekonomive të vendeve të BE-së, si për ato që janë pjesë e eurozonës ashtu edhe për vendet jashtë saj dhe theksoi interesat e përbashkëta dhe prioritetet, të cilat shkojnë përtej dimensionit kombëtar. Përgjigja në nivel të BE-së ka përfshirë një sërë masash, që konsistojnë në:

1. Në përpjekjet për të nxitur rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike.
2. Mekanizma të reja për të nxitur koordinimin e politikës fiskale dhe ekonomike.
3. Legjislacioni i ri për qeverisjen ekonomike.
4. Ndryshimet në mbikëqyrjen e sektorit financiar, ndihma financiare për shtetet anëtare në nevojë.

Auditim i përshtatshëm i fondeve publike.

3. Komiteti i Kontaktit thekson se marrëveshjet dhe instrumentet e reja, të krijuara në nivele kombëtare, të BE-së dhe ato ndërqeveritare (sidomos midis vendeve të eurozonës) mund të jenë përfshirë konsiderueshëm në shfaqje korruptive në përdorimin e fondeve publike. Kjo çon në rritjen e rrezikut të mungesës së përgjegjshmërisë në veprimtarinë e auditimit publik.

4. Komiteti i Kontaktit beson që parimet e mëposhtme (duke ndihmuar promovimin e qeverisjes së mirë dhe ruajtjen e asetëve) duhet të respektohen kur fondet publike janë në rrezik:

- Transparencë e mjaftueshme, në formën e informacionit të besueshëm dhe në kohë (duke përfshirë statistikat kombëtare)

mbi shfrytëzimin aktual ose të menduar të fondeve publike, si dhe rreziqet ndaj të cilave ata janë të ekspozuar.

- Përgjegjësia për të dhënë llogari para vendim-marrësve dhe personave përgjegjës për menaxhimin e proceseve, duke përfshirë vëzhgimin e operacioneve publike.
- Auditimi i efektshëm i fondeve publike, për të mundësuar sigurinë dhe informacionin se si po përdoren fondet publike dhe përballë cilave rreziqe janë ekspozuar fondet publike. Kjo i kontribuon transparencës së procesit dhe siguron bazë të mirë përgjegjësie në punë.

5. Komiteti i Kontaktit thekson rëndësinë e sigurimit të një përgjigje efektive në auditimin publik të krizës financiare dhe ekonomike dhe pasojat e saj. Marrëveshjet dhe instrumentet e reja kanë krijuar përgjegjësi të reja, mundësi dhe sfida për SAI-te BE-së dhe atë të ECA-s. Këto institucione duhet të marrin në konsideratë, në kuadër të mandateve të tyre përkatëse, si të përshtatin punën e tyre të auditimit në kontekstin e ri. Në disa raste ky proces ka filluar tashmë përmes zbatimit të detyrave të reja dhe të përditësuara të auditimit.

6. Komiteti i Kontaktit pranon thirrjen e SAI-ve të zonës së euros për marrëveshjet mbi auditimin publik të jashtëm të Mekanizmit për Stabilitetin Evropian (ESM-në) në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Komiteti i Kontaktit ka miratuar rezolutë të veçantë për këtë çështje.

Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit midis SAI-ve të BE-së dhe ECA-së.

7. Komiteti i Kontaktit thekson rëndësinë e të mësuarit dhe të përfituarit nga përvojat e njërit dhe tjetrit vend. Ndërvarësia e rritur e ekonomive të vendeve të BE-së përforcon vlerat e përbashkëta dhe perspektivën e përbashkët që fiton secili vend nga ky bashkëpunim i ngushtë. Kjo përfshin:

- Evidentimin e **mësimeve të nxjerra** nga rezultatet e auditimeve të fundit, si dhe ndikimin e këtyre mësimeve për të mbledhur dhe shkëmbyer njohuritë e duhura në fushën e auditimit.
- Identifikimin e përhapjen e **praktikave më të mira** aktuale në auditimin e marrëveshjeve të reja dhe atyre ekzistuese.
- Identifikimin e **hapësirave publike të auditimit** dhe detyrat e reja potenciale të auditimit dhe të partneritetit, duke i trajtuar saktë ato.
- Bashkëpunimi në fushën e auditimit ka parasysh zhvillimin e **metodave dhe teknikave të veçanta të auditimit**, që përdoren nga SAI-t, ka parasysh mjetet dhe udhëzimet për zbatimin e metodave dhe teknikave më të mira, që identifikohen.

Informacion i përgjithshëm

8. Komiteti i Kontaktit do të zhvillojë këto veprime brenda **rrjeteve** të tij ekzistuese që mbulojnë auditimin e strategjisë Evropa 2020 dhe politika fiskale, nëpërmjet **auditimeve paralele apo të koordinuara** dhe nga **aktivitet e tjera bashkëpunuese** të përcaktuara për këtë qëllim.

Luksemburg, më 14 tetor 2011



GJYKATA EVROPIANE E AUDITUESVE

Historiku i Gjykatës Evropiane të Audituesve

Gjykata Evropiane e Audituesve u krijua nga Traktati i Brukselit në 22 korrik 1975. Gjykata filloi të veprojë si një organ i auditimit të jashtëm të Komunitetit Evropian në tetor 1977 dhe e ka selinë në Luksemburg.

Gjykata Evropiane e Audituesve është njohur si një nga pesë institucionet e Komunitetit Evropian, pas nënshkrimit të Traktatit të Mاستrihtit, më 1 nëntor 1993. Institucionet e tjera janë: Parlamenti Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian dhe Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit Evropian.

Roli i kësaj Gjykate u konfirmua dhe forcua më 1 maj 1999, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, i cili autorizoi Gjykatën të kryejë auditime të menaxhimit financiar dhe theksoi rolin e saj në luftën kundër mashtrimit. Traktati i Nisës (Nice) më 1 shkurt 2003, konfirmoi parimin se Gjykata duhet të ketë një anëtar nga secili shtet anëtar dhe t'i lejohej mundësia për tu organizuar në dhoma, si dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të Gjykatës me organet e auditimit kombëtar.

Gjykata Evropiane e Audituesve

Gjykata Evropiane e Audituesve përbëhet nga 27 anëtarë, nga një për secilin shtet të Bashkimit Evropian, të cilët zgjedhin Presidentin e Gjykatës.

Presidenti, i cili zgjidhet për një mandat tre vjeçar, është "i pari ndër të barabartët" dhe luan një rol koordinues. Ai bën propozime për shpërndarjen e paketave financiare tek anëtarët, planifikon agjendën e seancave të Gjykatës dhe kryeson diskutimet e Gjykatës. Në marrëdhëniet me jashtë, Presidenti përfaqëson dhe kryeson Gjykatën Evropiane të Audituesve.

Anëtarët e Gjykatës propozohen nga çdo shtet anëtar dhe emërohen nga Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian me shumicë të cilësuar.

Anëtarët e Gjykatës :

- zgjidhen për një mandat gjashtë vjeçar, me të drejtë rizgjedhje
- zgjidhen nga radhët e personave që janë ose kanë qenë pjesë e auditimeve të jashtme në vendin e tyre dhe janë të kualifikuar posaçërisht për këtë detyrë
- janë plotësisht të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre, gjithmonë në funksion të interesit të përgjithshëm të BE-së dhe pavarësia e tyre duhet të jetë jashtë çdo dyshimi
- gjatë mandatit të tyre, nuk mund të angazhohen në profesione të tjera, qoftë fitimprurës apo jo
- u përfundon mandati në rast të vdekjes, kur japin dorëheqjen, ose të detyruar nga një vendim i Gjykatës së Drejtësisë

Funksionimi i Gjykatës Evropiane të Audituesve

Gjykata funksionon si një trup gjykues kolegjal me anëtarë që janë kolektivisht përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e të gjitha deklaratave zyrtare të Gjykatës.

Gjykata ndahet në pesë grupe auditimi, nga të cilat katër janë grupe vertikale auditimi, secili i përbërë nga gjashtë anëtarë. Gjykata ka gjithashtu një grup Koordinimi, Komunikimi, Vlerësimi, Sigurimi, dhe Zhvillimi (KKVSZ), i përbërë nga tre anëtarë të përhershëm plus një anëtar nga secili grup auditimi vertikal. Anëtarët ndahen në grupe auditimi nga Gjykata, me propozim nga Presidenti. Secili grup zgjedh drejtuesin dhe përfaqësuesin në grupin e Koordinimit, Vlerësimit, Sigurimit, Zhvillimit dhe në Komitetin Administrativ.

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Evropiane të Auditimit



Selia e Gjykatës Evropiane të Audituesve

Auditimi i llogarive të BE-së kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), të cilat janë aplikuar si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat. Gjykata merr pjesë aktive në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare, me anë të organeve të saj, bashkë me institucionet kombëtare të auditimit (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit - INTOSAI, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve - IFAC).

Për të siguruar që transaksionet kryhen në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullat e miratuara, Gjykata bazohet në rezultatet e dy ekzaminimeve të sistemeve mbikqyrëse dhe të kontrollit, të destinuara për të zbuluar, parandaluar dhe korigjuar gabimet e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë. Kur sistemet janë testuar dhe gjetjet janë të besueshme, Gjykata auditon më pak transaksione, për të ardhur në një përfundim të vlefshëm për ligjshmërinë dhe rregullsinë e tyre. Për të mbështetur konkluzionet e Gjykatës përdoren edhe burime të tjera, si p.sh ato të ekspertëve të ndryshëm.

Në auditimin e performancës, Gjykata përdor një shumëllojshmëri metodologjish auditimi për të vlerësuar sistemet e menaxhimit, të monitorimit dhe të informacionit. Gjatë përzgjedhjes së auditimeve të performancës, Gjykata ka për qëllim të identifikojë subjektet, të cilat kanë

gjasa të japin një impakt më të lartë në identifikimin dhe përmirësimin e mundshëm të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve të BE-së.

Gjykata ushtron funksionin e saj brenda një kornize ndërinstitucionale bazuar kryesisht në:

- Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, nenet 310-325, të cilat përmbajnë dispozita që rregullojnë të ardhurat financiare dhe shpenzimet e BE-së.
- Rregullorja e Këshillit (KE, Euratom) Nr 1605/2002, datë 25 qershor 2002, mbi rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komunitetit Evropian.

Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian i jep Gjykatës Evropiane të Llogarive (Nenet 285 - 287) detyrat kryesore për kryerjen e auditimit të BE-së, për të përmirësuar menaxhimin e financave dhe për të informuar qytetarët e Evropës mbi përdorimin e fondeve publike nga ana e autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Kështu, sipas Traktatit, Gjykata e Audituesve shqyrton llogaritë për të gjithë të ardhurat dhe shpenzimet e BE-së, gjithashtu shqyrton llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të organeve, agjencive apo zyrave të caktuara nga BE-ja, për aq kohë sa instrumente të ngjashme të rëndësishme nuk përjashtojnë auditime të tilla.

Me një deklaratë, Gjykata e Auditimit informon Parlamentin dhe Këshillin mbi besueshmërinë e llogarive, për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë, të cilat janë të botuara në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian. Kjo deklaratë mund të plotësohet me vlerësime të veçanta për secilën fushë të veprimtarisë së BE-së.

Gjykata shqyrton nëse të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet janë bërë në mënyrë të ligjshme dhe të rregullt dhe nëse menaxhimi financiar ka qenë eficient. Në këtë mënyrë Gjykata raporton në çdo rast, që evidenton parregullsi.

Nëse është e nevojshme, auditimi përfshin edhe institucione të tjera të BE-së, të cilat menaxhojnë të ardhura apo shpenzime nga buxheti i BE-së, duke përfshirë çdo person fizik apo juridik. Në Shtetet Anëtare, auditimi duhet të kryhet në bashkëpunim me organet kombëtare të auditimit, ose nëse këto nuk kanë kompetencat e duhura, me departamentet kombëtare kompetente. Gjykata e Audituesve dhe organet kombëtare të auditimit të vendeve anëtare, duhet të bashkëpunojnë nën frymën e besimit, por duke

ruajtur pavarësinë e tyre.

Çdo institucion tjetër i Bashkimit Evropian, çdo organ, agjenci apo zyrë menaxhimi e të ardhurave dhe shpenzimeve, çdo person fizik ose juridik, si dhe organet kombëtare të auditimit duhet t'i përcjellin Gjykatës së Audituesve, me kërkesën e saj, çdo dokument apo informacion të nevojshëm për të kryer detyrën e saj. Gjithashtu, Gjykata duhet të ketë një marrëveshje me Bankën Evropiane të Investimeve, lidhur me qasjen në informacione që kanë të bëjnë me menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të BE-së. Në mungesë të saj, ajo gjithsesi duhet të ketë qasje në informacionet e Bankës për sa i përket menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të BE-së.

Pas mbylljes së çdo viti financiar, Gjykata Evropiane e Audituesve përpilon **një raport vjetor** që i përcillet institucioneve të tjera të BE-së dhe botohet në Fletoren Zyrtare të Bashkimi Evropian, bashkë me përgjigjet e këtyre institucioneve për vëzhgimet e Gjykatës. Gjykata gjithashtu, mund të paraqesë vërejtjet në çdo kohë, veçanërisht në formën e raporteve të veçanta, pyetjeve specifike dhe dhënies së mendimeve me kërkesën e njërit prej institucioneve të tjera të BE-së. Gjykata Evropiane e Audituesve gjithashtu ndihmon Parlamentin Evropian dhe Këshillin Evropian në ushtrimin e kompetencave të tyre të kontrollit mbi zbatimin e buxhetit.

Misioni i Gjykatës Evropiane të Audituesve

Gjykata Evropiane e Audituesve është një institucion evropian, i cili u krijua me qëllim kryerjen e auditimit të financave evropiane. Si një audituese e jashtme e Bashkimit Evropian, Gjykata kontribuon në përmirësimin e financave evropiane dhe vepron si kujdestar i pavarur i interesave financiare të qytetarëve të Bashkimit Evropian.

Gjykata jep shërbime auditimi, nëpërmjet të cilave ajo vlerëson mbledhjen dhe shpenzimin e fondeve të BE-së. Ajo shqyrton nëse veprimet financiare janë regjistruar dhe publikuar ashtu siç duhet, nëse janë menaxhuar dhe ekzekutuar rregullisht dhe sipas ligjit, në mënyrë që të garantohet ekonomikiteti, efikasiteti dhe efektiviteti. Gjykata komunikon përfundimet e auditimeve të saj në raporte të qarta dhe objektive.

Gjykata përkrah përgjegjshmërinë dhe transparencën dhe ndihmon Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian në mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit të BE-së, në veçanti gjatë procedurës së zbatimit.

Vlerat e Gjykatës Evropiane të Audituesve

Për kryerjen e misionit të saj, Gjykata bazohet në këto vlera :

Pavarësi, Integritet, Paanshmëri dhe Profesionalizëm

Gjykata duhet :

- te ruajë dhe te forcojë pavarësinë dhe integritetin e saj në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Institucionin, anëtarët e tij dhe stafin; objektiviteti dhe paanshmëria e saj të jenë të padiskutueshme
- te kryejë detyrat pa u ndikuar politikisht, nga çështjet kombëtare ose ndonjë ndikim tjetër i jashtëm dhe duke shmangur çdo konflikt interesi
- te caktojë një skemë lëvizshmërie të audituesve në mënyrë që të mos auditohet e njëjta fushë për një kohë shumë të gjatë nga të njëjtët persona
- te përmbushë misionin e saj të paanshëm duke zgjedhur mirë temat e auditimit, duke kryer auditime cilësore, duke bërë rekomandime dhe ofruar këshilla mbi çështjet e menaxhimit financiar, duke marrë parasysh pikëpamjet e aktorëve të tjerë, por pa kërkuar udhëzime dhe pa rënë pre e presionit nga ndonjë burim i jashtëm
- te ruajë një standard shembullor të profesionalizmit në të gjitha aspektet e punës së tij
- të përfshihet aktivisht në zhvillimin e vazhdueshëm të profesionit të audituesit publik në BE dhe në mbarë botën.

Kodi Etik i Gjykatës Evropiane të Audituesve

Për të realizuar misionin e saj, Gjykata duhet të jetë dhe të perceptohet si një institucion i pavarur dhe profesional, në të cilën palët e interesit mund të kenë besim të plotë.

Për këtë qëllim, Gjykata ka adoptuar kushtet e vendosura nga Kodi Etik i INTOSAI-t (ISSAI 30) dhe është duke publikuar një sërë Udhëzimesh Etike.

Udhëzimet Etike synojnë të ndihmojnë që vendimet e saj të përditshme, si në auditim dhe në drejtimin e institucionit, të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara nga Kodi i INTOSAI-t.

Besim, Siguri dhe Kredibilitet

Rrënjësia e besimit, sigurisë dhe kredibilitetit tek palët e interesit të Gjykatës, tek të audituarit dhe qytetarët e Bashkimit Evropian. Për këtë

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Evropiane të Auditimit

qëllim, i gjithë stafi i Gjykatës duhet të silllet në mënyrë etike dhe të shmangë çdo rrethanë që mund të dëmtojë Gjykatën. Ky parim është i vlefshëm edhe kur dikush largohet nga Gjykata.

Ndershmëri

Burimet ekonomike të Gjykatës duhet të përdoren në mënyrë të ligjshme, të rregullt dhe financiarisht të shëndoshë. Gjykata duhet të veprojë si një model në menaxhimin financiar: burimet e saj ekonomike duhet të menaxhohen në përputhshmëri të plotë me Rregullat Financiare dhe me çdo rregull tjetër të zbatueshëm; objektivat e saj duhen arritur në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Fshehtësia Profesionale

Duhet të shmangen zbulimet e informacionit, i cili është përfituar gjatë punës, për palët e treta, përveçse në kuadrin e procedurave të Gjykatës ose në përputhje me rregulloret përkatëse.

Detyra e konfidencialitetit vazhdon të jetë në fuqi edhe mbasi dikush largohet nga Gjykata.

Kompetencë dhe Trajnim i Vazhdueshëm Profesional

Për të kryer detyrat në mënyrë kompetente dhe të paanshme, stafi i Gjykatës duhet të njohë dhe të zbatojë procedurat ligjore dhe operative përkatëse. Në veçanti, nëse bëhet fjalë për audituesit, atëherë duhet të zbatohen Standardet dhe Linjat e Veprimit të Gjykatës; standardet profesionale të INTOSAI-t dhe IFAC si edhe metoda të përshtatshme auditimi.

Një Organizim i Shkëlqyer dhe Efikas

Një ambient pune i mirë është i rëndësishëm si për arritjen e objektivave të Gjykatës ashtu si edhe për të siguruar komoditetin në punë të stafit. Për këtë qëllim, në Gjykatën Evropiane të Llogarive nxitet bashkëpunimin nga ana profesionale dhe personale dhe zbatohen politikat e mundësive të barabarta për të gjithë stafin.

Sjellja e mirë administrative

Stafi i Gjykatës angazhohet për t'i shërbyer interesave të qytetarëve të Bashkimit Evropian, të cilët presin shërbime auditimi cilësore, duke treguar përkushtim, aftësi dhe mirësjellje në marrëdhëniet me publikun.

Kodi etik zbatohet nga i gjithë personeli i Gjykatës: anëtarë të Gjykatës, drejtues, auditues dhe stafi në funksione administrative.

B u n d e s
rechnungshof



Gjykata Federale Gjermane e Auditimit

Institucioni më i Lartë Gjerman i Auditimit - Bundesrechnungshof

Paraardhësi i Gjykatës Federale të Auditimit (Bundesrechnungshof) u themelua në Prusi në vitin 1714 dhe i përgjigjej mbretit.

Kur në vitin 1848 Prusia bëhet monarki kushtetuese, mbikëqyrjet vjetore të institucionit i drejtoheshin parlamentit.

Kur në vitin 1871, me vullnet të vetë Prusisë, u kompletua bashkimi i Gjermanisë, ky organ u bë Institucioni më i Lartë i Auditimit në Gjermani. Në vitin 1950, mbas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit Themelor 1949, Gjykata Federale e Llogarive u quajt si pasardhësja e institucionit të parë duke pasur të njëjtin status dhe të njëjtat funksione të specifikuar në kushtetutë.

Në vitin 1969 reforma e Ligjit Buxhetor forcoi më shumë mandatin auditues të Gjykatës dhe e bëri atë organ këshillues të Bundestagut, Bundesratit dhe qeverisë federale duke i siguruar edhe hyrje të drejtpërdrejtë në Bundestag. Në 1985 Ligji mbi Gjykatën Federale të Auditimit e njohu atë si gjykatë, duke i dhënë kështu edhe pavarësi kushtetuese. Qenia e saj një “Gjykatë” reflekton më shumë natyrën e saj kolegjinale në procesin vendim-marrës, se sa natyrën e saj gjyqësore.

Në vitin 1998 u krijuan 9 zyra rajonale auditimi me detyra ndihmëse kundrejt Gjykatës në misionin e saj auditues të financave federale. Zyrat rajonale të auditimit i përgjigjen Gjykatës dhe ndjekin drejtimet e saj në kryerjen e detyrave audituese.

Organizimi dhe Struktura e Gjykatës

Ligji mbi Gjykatën Federale të Auditimit përcakton statusin kushtetues të Gjykatës, aspektet operative, si dhe caktimin e detyrave dhe procesin e brendshëm vendim marrës. Zyra e Gjykatës është e organizuar në 9 divizione auditimi, të cilat janë po ashtu të ndara në 46 njësi audituese. Gjykata ka 63 anëtarë: Presidenti, Zëvendës Presidenti, 9 Drejtorë të Lartë Auditimi dhe 52 Drejtorë Auditimi të thjeshtë. Ata kanë pavarësi gjyqësore dhe status kushtetues të ngjashëm me atë të gjykatësve. Ata nuk mund të shkarkohen nga puna dhe i nënshtrohen vetëm ligjit. Që nga viti 1985 Presidenti dhe Zëvendës Presidenti i Gjykatës janë zgjedhur me shumicë absolute dhe me ndërthurjen e përbashkët të qeverisë federale (me të drejtë aprovimi), të Bundestagut dhe Bundesratit (me të drejtë zgjedhjeje) dhe të Presidentit të Republikës që bën emërimin. Emërimet për të dy postet bëhen për një periudhë 12 vjeçare ose deri me arritjen e moshës së pensionit (65 vjeç).

Anëtarët e tjerë të Gjykatës zgjidhen nga Presidenti i Republikës me propozimin e Presidentit të Gjykatës, zakonisht mbas një konsultimi me Komitetin e Përhershëm të Senatit.

Sipas ligjit, si Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe 1/3 e anëtarëve të Gjykatës, duhet të jenë avokatë me eksperiencë. Anëtarët e Gjykatës kanë një liri veprimi të konsiderueshme dhe nuk kanë një metodë auditimi të përcaktuar të cilën duhet ta ndjekin. Informacioni përfundimtar mbi auditimet individuale, vendoset praktikisht nga organi kolegjal përkatës. Pra vendimet mbi auditimet individuale merren brenda kornizës së disa komisioneve kolegjalë, anëtarët e të cilëve janë një Drejtor i Lartë Auditues dhe një Drejtor Auditues i të njëjtit divizion auditimi. Dy anëtarëve kolegjalë mund tu shtohen edhe Presidenti ose zëvendës Presidenti. Vendimet merren me unanimitet.

Gjykata është përgjegjëse për auditimin e Ministrive të veçanta. Ajo mund të ndërmarrë edhe punë audituese ndër-dikasteriale si për shembull në programet mbi burimet njerëzore dhe shpenzimet, në trajtimin dhe përpunimin e të dhënave, në fushën e pensioneve dhe punëve publike.

Për më tepër grupe auditimi *ad hoc* mund të krijohen nga Gjykata për të vënë në punë projekte auditimi specifike.

Gjykata ka liri të plotë për sa i përket natyrës dhe shtrirjes së punës audituese, rekrutimin, pagës dhe kualifikimeve të stafit të saj, si dhe burimeve të tjera. Anëtarët e Gjykatës mbështeten nga audituesit. Stafi rekrutohet nga

departamente të tjerë të administratës dhe zakonisht caktohet në divizione audituese që përgjigjen për ministrinë nga e cila personi është rekrutuar. Në stafin e Gjykatës ka alternim konstant, sidomos të atyre organikëve të brendshëm që kanë diploma universitare. Stafi i Gjykatës bën pjesë në shërbimin civil kombëtar dhe trajtohet në mënyre ekuivalente.

Pavarësia e funksionit auditues nga pushteti ekzekutiv përforcohet akoma më shumë nga metoda e përcaktimit të buxhetit të Gjykatës, i cili aprovohet në parlament çdo vit, së bashku me grante shkarkimi.

Objektivat, Roli dhe e Drejta e Aksesit e Gjykatës

Në kushtetutën e vitit 1949 – amenduar nga reforma e ligjit buxhetor – i kërkohet Gjykatës të auditojë kontabilitetin dhe të ekzaminojë performancën, rregullsinë dhe konformitetin e menaxhimit financiar. Kontabiliteti të cilit i referohet kushtetuta, është ai shtetëror. Kodi Buxhetor Federal i vitit 1969 thotë se funksionet e Gjykatës përfshijnë gjithë menaxhimin financiar të të gjithë qeverisë federale duke futur këtu edhe fonde imobiliarë të veçuar. Gjykata gjithashtu ekzaminon pjesëmarrjen e qeverisë federale në kompani private në të cilat qeveria ka një interes direkt ose indirekt dhe në kooperativa industriale në të cilat qeveria është pjesëtare. Gjykata auditon edhe në ato raste kur qeveria ka pjesë në ndërmarrje publike të cilat ndodhen në fazën e parë të privatizimit.

Gjykata ekzaminon gjithashtu edhe subjekte private që marrin grante apo garanci: ato që drejtohen nga qeveria federale ose nga një individ i emëruar nga ajo dhe ato ku ekziston një marrëveshje ose statuti i subjektit lejon një ekzaminim të tillë.

Këto lloj auditimesh verifikojnë edhe përdorimin korrekt dhe të shëndoshë të fondeve. Së fundi këtij auditimi mund ti nënshtrohen edhe palët e treta, të cilave u janë kaluar këto fonde nga subjekti i audituar.

Për shkak të numrit të madh të operacioneve financiare, Kodi Federal Buxhetor i ka lënë Gjykatës të vendosë zërat e kontabiliteti publik që ajo do të auditoj dhe cilat jo.

Marrëdhëniet me Parlamentin dhe me Qeverinë

Historikisht ka patur tensione në marrëdhënien midis organit auditues, pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit legjislativ. Me reformën e Ligjit Buxhetor 1969, ju lejua Gjykatës Federale dhe Gjykatave në Land-e të kishin akses direkt në parlamentet përkatës.

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Me Ligjin e 1985 u shtua edhe funksioni ndihmës i Gjykatës kundrejt dy dhomave të parlamentit dhe të qeverisë federale. Gjykata në këto raste nuk ekzaminon linjën e veprimit të organeve, por ajo merr në konsideratë vetëm supozimet faktike mbi të cilat janë marrë vendimet dhe shikon nëse objektivat e linjës së veprimit janë arritur. Këto detyra të Gjykatës duhen kryer në mënyrë konstruktive.

Detyra kryesore e Gjykatë është të ekzaminojë menaxhimin financiar të Republikës Federale. Rezultatet i raportohen ministrive dhe qeverisë; përfundimet e Gjykatës shoqërohen nga analiza të detajuara të çështjeve më të rëndësishme që janë raportuar më parë në parlament.

Për më tepër Gjykata mund të përdorë informacionet e mbledhura për të këshilluar si qeverinë dhe parlamentin mbi vendimet e ardhshme buxhetore. Jo gjithmonë raportet e Gjykatës janë të disponueshme për parlamentin ose për qeverinë, ose edhe për opinionin publik në përgjithësi. Kjo ndodh sepse Gjykata ka një rol bashkëpunues me qeverinë dhe për këtë arsye ajo e informon atë mbi mënyrat me të cilat administrata publike mund të përmirësohet. Qëllimi i saj pra nuk është të vërë thjesht në dukje shembuj të një menaxhimi të keq. Gjykata harton edhe raporte qortuese drejtuar qeverisë, në ato raste kur ministria përkatëse heziton të pranojë dhe zbatojë rekomandimet e saj.

Institucione të tjera të Auditimit Publik

Lander-at gjithashtu, kanë fuqi vendim-marrëse dhe përgjegjësi administrative të rëndësishme. Çdo land ka organin e tij auditues (Landesrechnungshof), i cili mban lidhje dhe punon në kushte të barabarta me Gjykatën, në çështjet ku kanë përgjegjësi të përbashkët për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve publike. Në rastet kur Gjykata punon me një ose më shumë organe auditues lokal, ata mund të vendosin të punojnë bashkë, ose të ndajnë përgjegjësitë midis tyre. Në rast se Gjykata dhe organet audituese lokale kanë interes të përbashkët në ndonjë çështje, atëherë ata punojnë si palë bashkëpunuese.

Proçesi i Auditimit

Këshillimi mbi Buxhetin e Shtetit

Që prej reformës së Ligjit mbi Buxhetin të vitit 1969, Gjykata është përfshirë në zhvillimin e buxheteve të departamenteve dhe në veçanti në takimet midis departamentet shpenzuese dhe Ministrisë së Financës, të cilët mbahen përpara nënshkrimit të buxhetit në Parlament.

Auditimi Financiar

Përqaşja e Gjykatës mbi auditimin në përgjithësi është e përcaktuar në Kodin Buxhetor Federal, i cili kërkon që të ekzaminohet nëse janë respektuar parimet e financimit dhe menaxhimit të saktë, duke përfshirë këtu pajtueshmërinë me Ligjin mbi Buxhetin, vlerësimet dhe dokumentet mbështetës. Kodi kërkon gjithashtu që të kryhen kontrole për të verifikuar nëse fondet janë administruar me efikasitet dhe ekonomicitet dhe nëse funksionet mund të zbatoheshin duke vënë në përdorim më pak fonde. Përgjegjësia më madhore e Gjykatës është të sigurojë që marrja dhe shpenzimi i fondeve qendrorë, përputhet me kriteret ligjorë. Fokusi i veçantë mbi ligjshmërinë e shpenzimeve federale shpjegon arsyen pse 1/3 e personelit të Gjykatës duhet të këtë kualifikim universitar ligjor. Gjatë viteve tetëdhjetë, fokusimi i Gjykatës u zhvendos drejt auditimit të performancës dhe për këtë arsye ajo filloi të punësonte personel me një varietet më të gjerë aftësish dhe arsimit, duke përfshirë këtu ekonominë, biznesin dhe inxhinierinë.

Gjatë zbatimit të detyrave të saj, Gjykata nuk bën një dallim midis auditimit financiar dhe temave të tjera më të gjera të menaxhimit.

Zyra Rajonale Auditimi që plotësojnë punën e saj në menaxhimin financiar, pajtueshmërinë dhe vlerën e monedhës janë ngritur në Berlin, Koblençë, Këln, Frankfurt, Hamburg, Hanover, Madgeburg, Munik, Shtutgard dhe zëvendësojnë sistemin pre-auditues të mëparshëm në Gjermani.

Sistemi i ri është projektuar për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin. Gjykata dhe Zyrat e saj Rajonale të Auditimit kanë të drejtë të vëzhgojnë çdo dokument dhe dosje të nevojshme për të kryer një auditim efektiv. Përveç auditimit *ex post* të projekteve dhe llogarive, Gjykata ka të drejtë të inspektojë edhe projektet dhe llogaritë, zhvillimi i të cilëve është në vazhdim. Gjithsesi në këto raste ajo merr në konsideratë vetëm ato vendime që janë marrë në momentin e auditimit. Këto programe auditimi bashkëveprues mund të identifikojnë hapësira të mundshme zhvillimi dhe kursimi. Për kontratat mbi ndërtimet, Gjykata ka të drejtë të shqyrtojë të gjithë dokumentet dhe të auditojë si fazën e tenderit ashtu dhe fazën e planifikimit.

Gjykata përmbledh rezultatet e ekzaminimeve individuale dhe jep këshilla për përmirësim në letra menaxheriale të drejtuara departamenteve.

Në ndihmë të këtij procesi është dhe Parlamenti, i cili nëpërmjet Komisionit

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

të Ndarjeve Buxhetore, nen-komisioneve dhe Komisionit të Llogarive Publike, mundohet të sigurojë që nga raportet e Gjykatës të nxirren përfundimet e duhura.

Sanksionimi

Gjykata mund t'i sugjerojë Parlamentit nëpërmjet letrave menaxheriale ose raporteve speciale, çështjet ku vihet në dyshim përgjegjësia personale e punëtorëve publikë. Departamentet individuale të qeverisë janë përgjegjës të ndërmarrin hapat e duhura dhe ti raportojnë Gjykatës dhe/ose Parlamentit.

Në rastet kur dyshohet një shkelje e Kodit Disiplinor ose Penal, Gjykata njofton Prokurorin Federal për Çështjet Disiplinore dhe/ose Prokurorin Publik dhe çështja mund të shkojë për gjykim përpara një gjykate disiplinore ose penale. Në çështjet disiplinore sanksionet mund të jenë pagim i një dëmshpërblimi ose shkarkimi nga puna. Për veprat penale dënimi mund të jetë pagesa e një dëmshpërblimi ose heqje lirie.

Para vitit 1910, nocioni i efikasitetit përmbliidhej në verifikimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë të shpenzimeve. Kodi Buxhetor i vitit 1922 përfshiu efikasitetin si një kriter të ri auditimi, dha sqarime të mëtejshme mbi marrjen e kampioneve dhe bëri një përmendje të veçantë për punën në terren. Përcaktimi i punës në terren si një kriter auditimi, kishte për qëllim kryesisht reduktimin e punës klerikale dhe administrative, duke premtuar ndryshimin e rolit dhe fushëveprimin në punën e një auditori në mënyrë që ai të mund të formojnë mendimin e tij mbi efikasitetin dhe përshtatshmërinë e transaksioneve të qeverisë.

Auditimi i performancës është tani kryesor për punën e Gjykatës.

Që prej vitit 1952, Presidenti i Gjykatës ka një përgjegjësi shtesë si i Ngarkuari Federal i Performancës, i cili vlerëson efikasitetin e administratës dhe bën rekomandime në lidhje me përmirësimin e çështjeve dikasteriale ose ndër-dikasteriale. Në ushtrimin e fuqive të tij Presidenti, mund të këshillojë Parlamentin mbi efikasitetin struktural dhe operativ të administratës publike.

Në 2003 i Ngarkuari Federal themeloi një zyrë qendrore shërbimesh, me qëllim informimin e departamenteve të qeverisë federale në impaktin e mundshëm që legjislacioni i ri mund të shkaktojë në menaxhimin e financave federale dhe në performancën e sektorit publik.

Raportimi

Raporti Vjetor i Gjykatës, i ashtu quajtur Vëzhgimet, luan një rol të rëndësishëm në procesin gjatë të cilit Parlamenti aprovon llogaritë e Qeverisë. Raporti i paraqitet Parlamentit vjeshtën e dytë pas mbylljes së vitit financiar. Raporti përmban shembuj të detajuar, çështje të rëndësishme që kanë nevojë për aksione të mëtejshme dhe çështje të tjera në lidhje me të cilat Gjykata nuk është e kënaqur nga përgjigjja e departamenteve mbi vërejtjet e saj.

Organet e audituar mund të komentojnë përfundimet e Gjykatës dhe opinionet e tyre përfshihen në raport. Komentet mbi menaxhimin financiar nuk i kufizohen vetëm vitit financiar për të cilin kërkohet shkarkimi parlamentar, por paraqesin gjetjet deri në datën e publikimit të raportit.

Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike diskuton Vëzhgimet bashkë me Gjykatën dhe departamentet e saj. Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike i kalon raportin Komisionit mbi Ndarjet Buxhetore, i cili i rekomandon Parlamentit të konsiderojë Qeverinë të lirë në lidhje me shqyrtimet e vitit financiar në diskutim.

Komisioni mbi Ndarjet Buxhetore përpilon një draft rekomandimesh mbi një rezolutë shumë të detajuar. Zbatimi i të cilave monitorohet nga Gjykata. Raporti vëzhgimor publikohet nga Parlamenti dhe i prezantohet në të njëjtën kohë shtypit. Raporti Vjetor është vetëm një pjesë e punës së Gjykatës. Gjykata përgatit edhe rreth 600 letra menaxheriale në vit.

Për më tepër, Gjykata mund të përpilojë raporte të tjerë në çdo kohë mbi fusha interesi aktuale dhe çështje ndër-sektoriale. Këto raporte janë më të përditësuar dhe shtyjnë parlamentin të fokusohet në çështjet më shqetësuese financiare.

Që nga viti 1997 Gjykata ka paraqitur një raport shtesë informativ kundrejt opinionit publik për të vënë në dukje efektivitetin e punës së saj. Raporti mbi Impaktin e Auditimit ka qëllime parandaluese dhe vë në dukje përfundimet e arritura në Raportin Vjetor dy vite më parë, duke përfshirë këtu aksionet e ndërmarra nga departamentet federalë dhe agjencitë mbi mangësitë e gjetura nga Gjykata. Raporti i paraqitet opinionit publik çdo Qershor.

Zgjedhja e Anëtarëve të Gjykatës

Presidenti dhe Zëvendës Presidenti zgjidhen nga legjislatura e momentit në bazë të rekomandimeve të ekzekutivit për një periudhë të caktuar.

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Anëtarët e rinj zgjidhen nga Presidenti i Republikës Federale mbi propozimin e Presidencës së Gjykatës. Ky i fundit mund të konsultohet me Komitetin e Përhershëm të Senatit para paraqitjes së kandidaturave. Të gjithë anëtarët gëzojnë pavarësi gjyqësore dhe kanë status kushtetues të ngjashëm me atë të gjykatësve.

Kontrolli mbi Anëtarët

Anëtarët e Gjykatës kanë liri veprimi në përjasjen e detyrave të tyre. Vendimet mbi auditimet ndërmerren në mënyrë të pavarur por kolektivisht.

Aftësitë e Anëtarëve dhe të Stafit

Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe 1/3 e stafit duhet të jenë juristë. Anëtarët ndihmohen nga auditorët të cilët i janë bashkuar Gjykatës mbasi kanë përfituar eksperiencë profesionale.

Buxheti

Buxheti i Gjykatës përcaktohet nga legjislacioni.

Përgjegjësia e Auditimit

Përgjegjësitë statusore të Gjykatës përfshijnë auditim financiar, të rregullsisë dhe shqyrtimi i vlerës së parasë. Gjykata ka një përgjegjësi auditimi të gjerë. Ajo përfshin të gjithë menaxhimin financiar të Qeverisë Federale. Përveçse Ministrive kryesore përfshihen edhe ndërmarrje private dhe publike në të cilat qeveria është palë e interesuar dhe ndërmarrjet private që marrin grante shtetërorë.

Gjykata ka liri të plotë në vendosjen e prioriteteve të saj të auditimit dhe mund të lerë llogari të pa ekzaminuara. Ekzekutivi dhe Parlamenti nuk mund t'i kërkojnë Gjykatës të ndërmarrë ekzaminime specifike, edhe pse praktikisht i kërkohet asaj t'i përshtatet sugjerimeve të Parlamentit.

Gjykata nuk ekzaminon vlefshmërinë e linjave të veprimit. Gjithsesi, ajo mund të ndërmarrë ekzaminime të këshillave mbi të cilat linjat e veprimit janë zbatuar dhe nëse këto kanë arritur objektivat e tyre.

Gjykata mbështetet tek puna e 9 Zyrave Rajonale të Auditimit, të themeluar në 1 Janar 1998.

E Drejta për të Audituar.

Gjykata vendos kohën dhe natyrën e auditimit. Ajo mund të bëjë edhe auditime të momentit. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha të dhënat dhe faturat dhe të kërkojë shpjegime mbi to.

Ajo luan edhe një rol të rëndësishëm në procesin buxhetor sepse mbart përfitimet e eksperiencën audituese mbi propozimet e shpenzimeve të parashtruara nga ministritë.

Gjykata konsultohet gjithashtu mbi çdo ndryshim me pasoja financiare i bërë nga ministritë në rregulloret e tyre.

Raportimi

Gjykata ka për detyrë t'i raportojë Parlamentit dhe ekzekutivit. Raporti i saj vjetor, Raporti mbi Impaktin e Auditimit, Raportet Speciale dhe Raportet e hartuar nga Komisioni Federal i Performancës publikohen dhe janë të disponueshëm publikisht. Gjetje të tjera mbi auditimin i raportohen direkt ekzekutivit dhe nuk bëhen publike. Po ashtu edhe disa auditime të veçanta të ndërmarra për komisionet parlamentare nuk publikohen.

Ministritë mund të komentojnë raportet e Gjykatës dhe komentet e tyre futen në vetë raportet.

Legjislacioni Kryesor

Mandati i raportimit direkt të Gjykatës në Parlament u miratua në vitin 1969. Legjislacioni i vitit 1985 e vendosi Gjykatën midis degëve legjislative dhe ekzekutive të Qeverisë, duke sjellë kështu përgjegjësi akoma më specifike për Parlamentin.



GJYKATA E AUDITIMIT E LANDIT TE BAVARISE

Gjykata Bavareze e Auditimit (ORH) është një autoritetit suprem i pavarur shtetëror i Landit të Bavarisë. Ajo ka selinë e saj në Mynih. Gjykata është e ndarë në struktura ekzekutive dhe në departamente auditimi.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

ORH siguron mandatin e saj nga përgjegjësia dhe kompetencat e dhëna nga Kushtetuta e Landit Bavarez. Ajo auditon realizimin e buxhetit të Landit dhe performancën e drejtimit ekonomik të shtetit, duke përfshirë investimet dhe fondet publike.

Gjykata është një institucion me një histori të gjatë. Ajo është themeluar në vitin 1812.

Mandati i auditimit

Auditimit të ORH i nënshtrohet i gjithë buxheti i shtetit i landit të Bavarisë, administrata e tij, gjykatat, kompanitë shtetërore dhe fondet e investimeve. Koncepti i menaxhimit financiar përfshin zbatimin e ligjit të buxhetit dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Bavarisë në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve.

Objekt auditimi i ORH janë edhe organizimi administrativ dhe menaxhimi i personelit publik.

Neni 89 i Kushtetutës së Landit Bavarez numëron fushat dhe subjektet e auditimit për OHR. Në to futentë ardhurat dhe shpenzimet e Shtetit, detyrimet e tij, pasuritë e tij dhe obligacionet. Gjithashtu përfshihen edhe të gjitha masat e marranga Shteti dhe më parë, por që kanë vetëm pasojat financiare në të ardhmen. ORH auditon edhe në subjekte jashtë administratës shtetërore, nëse këto subjekte kanë marrë nga shteti rimbursim shpenzimesh apo ndihmat (Neni 91 paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës dhe ligjit të Gjykatës). Grantet qeveritare ose kreditë të cilat garantojnë nga Shteti, si dhe garanci të tjera shtetërore po ashtu auditohen nga ORH (Neni 91 paragrafi 3). Kur Shteti është i përfshirë si aksioner në firma private, ORH auditon funksionimin e Shtetit në bazë të parimeve tregtare (Neni 92). OHR auditon edhe njësitë lokale (komunat, qarqet, rrethet, dhe korporatat tjera komunale, institucionet dhe organizatat të tilla si kompanitë e shërbimeve), me përjashtim të atyre rasteve kur këto struktura dhe shërbime që ato kryejnë bien nën juridiksionin federal. OHR është përgjegjëse për sigurinë sociale në shtetin e Bavarisë.

Planifikimi

Para fillimit të vitit fiskal, OHR përgatit një plan pune për të gjithë inspektorët e saj dhe zyrat e auditimit. Ajo mbulon me auditime të rregullta organet dhe autoritete të caktuara, si dhe të përqëndrohet dhe në sektorë prove.

Plani i punës diskutohet me audituesit me të përgatitur dhe të përparuar. Ky

diskutim vlen për të koordinuar me projekte dhe për të testuar fusha të reja auditimi. OHR diskuton me ta qëllimin dhe objektivat e auditimit. Plani i auditimit në këtë mënyrë nuk është i ngurtë, por mund të përshtatet me kërkesat e veçanta, p.sh. në dritën e ngjarjeve gjatë këtij viti për mbajtjen e një disipline të fortë financiare dhe fiskale.

Raportimi vjetor në Parlament

Vetëm kur diskutimi i mesazhit auditimit është i plotë, janë të qarta dhe rezultatet dhe gjetjet e tij. Vetëm në këtë kohë gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi mund të raportohen.

Në raportin e saj vjetor mbi llogaritë e Shtetit në Parlament, OHR merr rastet që mund të jenë të rëndësishme për lehtësimin e Qeverisë dhe të Shtetit nga shpenzimet e tepërta ose problemet me performancën e dobët (neni 97 i Ligjit organik). Raporti përmban përzgjedhjen e rezultateve të auditimit në një formë koncize. Ai ka hyrjen, rezultatet e auditimit mbi rregullsinë e llogarive dhe të dhëna të tjera ekonomikisht të rëndësishme për t'u treguar. Raporti i OHR për auditimin e financave shtetërore shkon për një opinion të Kancelarisë së Shtetit dhe ministrive, dhe nëse është e nevojshme, konsultohet përsëri. Vetëm pas një diskutimi të plotë dhe marrjes në konsideratë të mendimit të menaxherëve të njësitë e audituara, kontributet vijnë në Kolegjin e Madh të Gjykatës, i cili më në fund vendos për përfshirjen e tyre në raportin vjetor. Në raportin vjetor përfshihen jo vetëm gjetjet dhe vlerësimet e ORH, por edhe thelbi i komenteve të drejtuesve të njësitë të audituara. Marrësi i raportit vjetor është Parlamenti i Bavarisë, si dhe opinioni publik nëpërmjet botimit të tij.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit

Pas kësaj, Raportin Vjetor i kalon Komisionit për Buxhetin dhe Financat e Shtetit të Parlamentit bavarez. Komisioni për Buxhetin pastaj propozon vendimet (inspektime vëzhgimi, kërkesa apo mosmiratime fondesh) mbi kontributet individuale të raportit dhe masat ndaj pushtetit shtetëror, për shkak të pasqyrave financiare të deklaruara dhe raportit vjetor. Parlamenti i kërkoi qeverisë që të raportojnë kontributet për masat e marra. Ky raportim bëhet zakonisht një herë në vit. Parlamenti, në bashkëpunim me ORH kontrollon rekomandimet nëse ata janë zbatuar nga qeveria dhe Shteti dhe si janë zbatuar. ORH merr vendim për hetimet e rasteve të papërfunduara nga raportet e mëparshme vjetore - në qoftë se këto vijnë për vendim dhe raportojnë

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

se datat kanë skaduar - dhe jep sygjerrime për shqyrtim të mëtejshëm të materialeve nga Parlamenti, edhe nëpërmjet nismave ligjore për ndjekjen e rasteve më të rëndësishme.

Bashkëpunimi (i mundshëm) me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë

KLSH është në proces negocimesh për të vendosur bashkëpunimin me SAI-n bavarez. Profesori i shquar i Financave Publike pranë Universitetit të Bambergut në Gjermani dhe një sërë Universitetesh të tjera Europiane, Prof.Dr Heinz-Dieter Wenzel, i cili mban dhe titullin Doctor Honoris Causa nga Universiteti Publik i Tiranës dhe nga shumë universitete të tjera prestigjioze, po ndihmon KLSH për të mundësuar një bashkëpunim të frytshëm.



Prof.Dr. Heinz-Dieter Wenzel në zyrën e Kryetarit të KLSH-së. Dr.Bujar Leskaj
në janar 2012



Britania e Madhe, Zyra Kombëtare e Auditimit NAO

Historiku dhe informacion i përgjithshëm

1. Zyra e Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm (C&AG) është krijuar në bazë të Aktit të Ministrisë së Thesarit të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë të vitit 1866. Kontrollori i Përgjithshëm emërohet nga Mbretëresha, me propozimin e Kryeministrit, aprovimin e Kryetarit të Komitetit të Llogarive Publike dhe miratimin e Dhomës së Komunave si dhe konsiderohet anëtar i Dhomës së Komunave.
2. Audituesi i Përgjithshëm është kreu i Zyrës së Auditimit Kombëtar (NAO), e cila u themelua më 1 janar 1984, nga Akti Kombëtar i Auditimit të vitit 1983. Zyra Kombëtare e Auditimit kontrollon shpenzimet publike në emër të Parlamentit dhe ka një staf prej 880 vetash. Audituesi i Përgjithshëm verifikon llogaritë e të gjitha departamenteve dhe organeve qeveritare të sektorit publik dhe ka autoritet ligjor për të raportuar në Parlament mbi ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin, me të cilat kanë përdorur burimet e tyre. NAO kryen funksion krejtësisht të pavarur nga qeveria.

Veprimtaria

Vizioni i NAO-s është të ndihmojë kombin për të shpenzuar në mënyrë efektive.

NAO aplikon perspektivën unike të auditimit publik, për të ndihmuar Parlamentin dhe ecurinë e qeverisë në qëndrueshmërinë e shërbimeve publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO) mbikqyr shpenzimet publike në emër të Parlamentit, duke iu kërkuar llogari departamenteve të qeverisë, për të ndihmuar drejtuesit e shërbimit publik në përmirësimin e punës dhe shërbimin e ofruar.

NAO auditon pasqyrat financiare të të gjitha departamenteve qeveritare dhe një gamë të gjerë të organeve të tjera publike dhe prodhon rreth 60 raporte vlerësimi në vit.

Auditimi ka dy anë:

- Auditimi i pasqyrave financiare të të gjithë departamenteve të qeverisë qendrore, agjencive dhe organeve të tjera publike dhe raportimi i rezultateve në Parlament. (Në 2011-12, NAO ka audituar shpenzimet dhe të ardhurat me vlerë që arrin mbi 1 trilion sterlina nëpërmjet 458 llogarive).
- Për të parë se si janë zbatuar projektet e qeverisë, programet dhe iniciativat, NAO boton raporte, të cilat përmbajnë rekomandime si të përmirësohen shërbimet. Programi i punës është i fokusuar në tre fusha që ndikojnë në ecurinë e të gjitha departamenteve në arritjen e objektivave financiare: përmirësimin e menaxhimit financiar dhe raportimit; përdorimin më mirë të informacionit; dhe për të siguruar që shërbimet janë kryer me kosto-efektive.

Puna e NAO-s rrit efikasitetin e fondeve publike. Në vitin 2011, NAO i kurseu ekonomisë britanike 1 miliardë sterlina.

Vlerat

Për NAO-n, vlerat janë baza e punës dhe ato që përcaktojnë pikësynimet. Gjithashtu, vlerat përcaktojnë mënyrën e sjelljes midis kolegëve brenda institucionit dhe subjektet e jashtme të auditimit.

Pavarësia

NAO është një institucion i pavarur dhe objektiv, i cili respekton standardet më të larta profesionale dhe personale.

Autoriteti

NAO punon me cilësinë më të lartë, duke shfrytëzuar gjerësisht provat dhe praktikën.

Bashkëpunimi

Për të arritur qëllimet, NAO bashkëpunon me kolegët dhe palët e interesuara.

Paanësia

Mënyra e punës dhe trajtimi i njerëzve është i drejtë dhe i paanshëm.

Strategjia e NAO-s

Strategjia e NAO-s për vitet 2012 – 2015, tregon zbatimin në perspektivë të një strategjie unike në auditimin publik, për të ndihmuar Parlamentin dhe ecurinë e qeverisë në përmirësimin e shërbimeve publike.

Sfidat e hasura momentalisht nga sektori publik janë të rëndësishme për organet publike, të cilat janë nën presion për të ofruar shërbimet e tyre me sa më pak burime. Ajo që tani është më e rëndësishme se kurrë për këto organizata, është të kontrollojnë shpenzimet e tyre, për të menaxhuar riskun, të kenë informacion të mjaftueshëm në lidhje me performancën e tyre dhe për të kuptuar se si shërbimet e tyre mund të realizohen me koston më të ulët.

Përveç sfidave në kuadrin fiskal, strategjia e NAO-s vendos prirjet në kuadrin e ndryshimit dhe kontrollit të politikave. Në shumë pjesë të sektorit publik, po ndodhin reforma të rëndësishme në kuadrin e hartimit dhe shpërndarjes së shërbimeve publike. Këto ndryshime duhet të pasqyrohen në programin e punës për vitin e ardhshëm. Ka edhe ndryshime në fushën e auditimit, me reformën në auditimin publik vendor dhe rivlerësime të mëtejshme të kontabilitetit në sektorin publik. Strategjia përcakton reagimin ndaj këtyre ndryshimeve.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Ekspertiza e gjerë në auditimin publik dhe përgjegjësia e NAO-s, e pavarur në të gjithë sektorin publik, lejon të përqendrohet vëmendja në çështjet thelbësore, të cilat janë sigurimi që shpenzimet publike janë përdorur në mënyrën e duhur. Strategjia gjithashtu bën të mundur mbështetjen në përmirësim e shërbimit të sektorit publik, ndërsa synon një ulje prej 15 për qind të burime gjatë tre viteve të strategjisë. Për të arritur këtë, NAO ka për qëllim ndërtimin e një institucioni të performancës të lartë, që zhvillon dhe zbaton njohuritë e ekspertëve për të ndikuar pozitivisht tek ata që janë përgjegjës për drejtimin e shërbimeve publike të Britanisë.

Në 2012 – 2013, NAO do të vazhdojë të përqendrohet në tre tema strategjike që ndikojnë në ecurinë e vlerës së parave: përmirësimin e menaxhimit financiar dhe raportimit, nëpërmjet përdorimit më të mirë të informacionit dhe për t'u siguruar që shërbimet janë prodhuar me kostofektive. Auditimit financiar do të mbetet në qendër të vëmendjes së Parlamentit, për të mbajtur llogaritë e qeverisë në lidhje me shpenzimin e parave publike. NAO raporton në Parlament mbi veprimet e qeverisë, për të treguar ndikimin ekonomik të krizës financiare dhe implikimet për financat e vendit. Gjithashtu, i rekomandon qeverisë reduktimin e shpenzimeve publike dhe shpenzimet e shërbimeve publike.

Kompetencat e NAO-s

Legjislacioni përforcon punën e NAO-s.

Kompetencat specifike dhe detyrat e Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm dhe të NAO-s janë të përcaktuara në ligjet e miratuara nga Parlamenti.

Kuadri ligjor konsiston në ligjet e mëposhtme:

Ligji Kombëtar i Kontrollit Financiar 1983

Në bazë të këtij ligji, u themeluan institucionet e Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm dhe Komisionit Parlamentar të Llogarive Publike, të cilët përcaktonin veprimtarinë e NAO-s me qëllim që të lejojë ekzaminimin e vlerës së parave dhe të sigurojë auditimin.

Ligji i Burimeve dhe Llogarive Qeveritare i vitit 2000

Ky ligj si dhe Instrumentet statutorë përkatës që janë miratuar pas tij, vendosin një bazë ligjore më të gjerë për shumë nga auditimet ekzistuese, duke zgjeruar numrin e institucioneve qeveritare për të audituar. Gjithashtu,

ligji ka zgjeruar të drejtat e NAO-s për të audituar edhe grupe të tilla, si konsulentët e Qeverisë.

Përveç kësaj, disa dispozita të ligjeve të mëparshme të auditimit vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot.

Auditimi i Pasqyrave Financiare

Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm (C&AG), mbështetur nga Zyra e Auditimit Kombëtar NAO), luan një rol kyç në fazën e llogaridhënies për financat e sektorit publik.

NAO ka përgjegjësi për auditimin e pasqyrave financiare të:

- Të gjithë departamenteve qendrore të qeverisë.
 - Agjencive ekzekutive.
 - Një game të gjerë të institucioneve të tjera të sektorit publik.
- NAO gjithashtu ka një numër të madh klientësh ndërkombëtarë, ku mund të përmendim Organizatën Ndërkombëtare të Punës si dhe Programin Botëror të Ushqimit.

Qasjet e Auditimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

Auditimi i pasqyrave financiare kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (të zbatuara në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë) të miratuara nga Bordi i Praktikave të Auditimit (APB). Stafii i NAO-s është i kualifikuar profesionalisht dhe vazhdimisht në trajnim, me një gamë të gjerë përvoja në kete sektor dhe është në gjendje të ofrojë cilësi dhe aftësi shumë-disiplinore.

Qasja e NAO-s për auditimin e pasqyrave financiare përdor një varg teknikash për të marrë të dhëna dhe siguri mbi auditimin dhe bazohet në kuptimin e plotë të biznesit të klientit. Ky kuptim jep mundësinë e zhvillimit të një strategjie të auditimit, e cila fokusohet në trajtimin e risqeve të veçanta duke siguruar një nivel të pranueshëm garancie të të gjithë pasqyrave financiare si një e tërë.

NAO është në gjendje të përmbushë nevojat dhe të evidentojë risqet, me të cilat përballen klientët individualë, në këtë mënyrë projektohen qasjet për të shtuar vlerë për klientin. Të kuptuarit e biznesit, vlerësimi i rrezikut dhe kontrollit të proceseve të rishikimit, ofron mundësi për reagime pozitive dhe konstruktive nëpërmjet ndarjes së analizave të riskut dhe efektivitetit

të menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të riskut. Kjo i mundëson NAO-s të kontribuojë drejt përmirësimit të raportimit financiar, menaxhimit financiar dhe proceseve qeverisëse kooperative, jo vetëm në nivel entiteti por në të gjithë sektorin publik.

Pavarësia, Objektiviteti dhe Integriteti

NAO ka procedura të brendshme strikte për të siguruar pavarësinë, objektivitetin dhe integritetin, përfshirë një deklaratë vjetore nga stafi, i cili identifikon konfliktet e mundshme të interesit ose çështje të tjera të ngjashme. Siç është rekomanduar nga Bordi i Praktikave të Auditimit, për të mënjeluar konfliktet e interesit dhe për të siguruar pavarësinë nga klientët që auditohen, NAO ka adoptuar një politikë rotacionesh çdo 5 vjet. Drejtuesit e firmave, që kryejnë kontrolle të cilësisë dhe shqyrtime të informatave historike financiare dhe të shërbimeve, ndërrohen shpesh.

Marrëdhëniet me klientët

Qëllimi i NAO-s është të ruajë marrëdhëniet e mira ekzistuese dhe të ndërtojë marrëdhënie të reja me klientët e audituar. Gjithashtu NAO u ofron klientëve mundësinë të sigurohen se pasqyrat e tyre financiare janë në përputhje me ligjet përkatëse dhe kërkesa të tjera ligjore.

Cilësia

Cilësia është e rrënjësuar thellë në kulturën e NAO-s, duke krijuar edhe procedura shqyrtimi për të siguruar që auditimi është ndërmarrë në mënyrë efektive dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Përveç auditimeve të NAO-s, Njësia e Auditimit dhe Inspektimit të Këshillit Financiar (AIU) shqyrton çdo vit edhe procedurat e firmave të mëdha. Raporti i parë i AIU-së për NAO-n, përfundoi në maj të vitit 2010.

Opinionit i Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm (C&AG) Një vështrim i vërtetë dhe i drejtë

Opinionit i C&AG-së është i rëndësishëm për të formuar një mendim nëse llogaritë e organeve të audituara janë pa gabime materiale dhe në përputhje me kërkesat për raportimet përkatëse. Me mbështetjen e NAO-s, ai ofron siguri që pasqyrat financiare paraqesin një pasqyrë të “vërtetë dhe të drejtë” të pozicionit financiar dhe performancës së subjektit në përputhje me statutin, kuadrin ligjor apo rregullator në të cilat mbështet ai. Në rrethana

të caktuara, opinioni i C&AG mund të modifikohet për t'ju përshtatur llojit të llogarive apo legjislacionit themelor.

Rregullsia

Gjatë vërtetimit të llogarive, C&AG duhet të mbajë parasysh se transaksionet e regjistruara në pasqyrat financiare duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e Parlamentit apo autoriteteve të tjera. (Ka një numër të vogël përjashtimesh për këtë, kur organet nuk kanë një funksion publik, ose nuk janë të financuara nga buxheti publik). Rregullshmëria është objektivi kryesor dhe një nga karakteristikat dalluese.

Një transaksion është i rregullt, kur është kryer në përputhje me:

- Legjislacionin autorizues.
- Rregulloret e lëshuara në bazë të legjislacionit.
- Autoritetet parlamentare.
- Autoritetet e Thesarit.

Çdo auditim përmban hapa dhe procedura specifike për të trajtuar rrezikun e parregullsisë, si dhe për të identifikuar rastet e shkeljeve materiale.

Standardet

NAO ka përgjegjësi profesionale për të raportuar nëse pasqyrat financiare nuk përputhen, në çfarëdo aspekti material, me standardet që janë lëshuar nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit dhe udhëzimet e ngjashme të lëshuara nga Thesari, të tilla si Manuali i Raportimit Financiar dhe Menaxhimi i Financave Publike. Nëse NAO identifikon një anomali, C&AG do të lëshojë një opinion të kualifikuar dhe bashkangjitur një raport me shpjegime të mëtejshme.

Raportet e Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm (C&AG)

Në rastet që nuk identifikohen gabime materiale ose parregullsi në llogari, C&AG gjithsesi duhet të përgatisë një raport për Parlamentin dhe organe të tjera qeverisëse mbi çështje të tjera, të cilat konsiderohen të rëndësishme për t'u trajtuar.

Raportet mbi organet e qeverisjes qendrore i drejtohen Parlamentit dhe mund të merren në konsideratë edhe nga ana e Komisionit të Zgjedhur të Llogarive Publike. Ky Komision, në bazë të dëshmive të C&AG, publikon zbulimet, konkluzionet dhe rekomandimet e tij.

Bashkëpunimi me KLSH

Ekspertët e NAO-s Britanike kanë qenë aktivë në projektin e Binjakëzimit të KLSH, me fonde të projektit CARDS gjatë viteve 2007-2008. Për arsye subjektive nga ana e KLSH, ky bashkëpunim u ndërpre për periudhën 2009-2011. Kryetari i KLSH gjatë vitit 2012 ka shprehur interes për të ripërtëritur bashkëpunimin në projekte të reja në të ardhmen e afërt dhe përgjigjja e Kryekontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm të NAO-s është pozitive.



19	4	P/09/003	strukturalnych na lata 200
			Realizacja przez Centralny 4 pozyskania miejsc dla osadz
Kontrola wykonania budżetu państwa			
1.	P/09/007	Wykonanie budżetu państwa w 2	Rady Ministrów
2.	P/09/006	Wykonanie budżetu państwa w 200	Sprawiedliwości i cz. 15/02-15/12 -
3.	P/09/011	Wykonanie budżetu państwa w 2000	wykonanie planu

Republika e Polonisë, Zyra e Lartë e Auditimit, NIK

Zyra e Lartë e Auditimit ose NIK (emri i mëparshëm ka qenë Dhoma e Lartë e Kontrollit) është organi më i lartë i pavarur i auditimit, misioni i të cilit është të mbrojë shpenzimet publike. Për më shumë se 90 vjet, NIK ka vlerësuar funksionimin e shtetit polak dhe menaxhimin e fondeve publike.

Misioni dhe Vizioni

Misioni i Zyrës së Lartë të Auditimit është të promovojë efikasitetin ekonomik dhe efikasitetin në shërbimin publik në dobi të Republikës së Polonisë. Vizioni i Zyrës së Lartë të Auditimit është të jetë një institucion i lartë auditimi, raportet e të cilit duhet të jenë një burim i pritur dhe i kërkuar informacioni për organet e shtetit dhe publikut në përgjithësi.

Tradita e auditimit të shtetit në Poloni

Si pasojë e evolucionit të monarkisë në Evropë gjatë dekadës së parë të viteve 1500, thesari mbretëror dhe thesari publik u ndanë, kështu që u bë e nevojshme për të kontrolluar rrjedhën e parave në mes tyre. Për këtë arsye, elitat politike në atë kohë u përpoqën të krijojnë një sistem të tillë të llogarive që do të jetë efektiv dhe njëkohësisht nuk do të dëmtonte prestigjin e monarkut. Nevoja për të kontrolluar shpenzimin e fondeve publike dhe politikat fiskale të monarkut, formuan bazën për sistemin auditues. Pra, tradita e auditimit të buxhetit të shtetit në këtë vend, ka lindur shekuj më parë. Për shkak të rolit të tij në ligj-bërje, Parlamenti e ka zhvilluar mandatin e tij në auditimin e shtetit.

Polonia ne shekujt 16-të – 18-të.

Që në shekullin e 16-të, në Poloni ekzistonin dy zyrtarë përgjegjës për kontrollin e shpenzimeve: një kontrollonte shpenzimet e fondeve mbretërore dhe një për monitorimin e shpenzimit të parave te shtetit. Ata bashkëpunonin me taksa-mbledhesit e emëruar nga Parlamenti. Në 1591 u krijua Gjykata e Thesarit (polonisht : Trybunał Skarboëy) për mbikqyrjen e fondeve publike, gjë që zgjeroi kontrollin Parlamentar mbi financat. Në shekullin e 18-të, Gjykata e Thesarit u zëvendësua me dy komitete të thesarit - një për Mbretërinë e Polonisë dhe tjetra për Dukatin e Madh të Lituanisë (te dy shtetet së bashku përbënin Komonuelthin Polak-Lituanez). Të dy komitetet ishin të varur nga dhoma e ulet e Parlamentit dhe raportonin për llogaritë publike. Në vitin 1775, u krijua Këshilli i Përhershëm (polonisht: Rada Nieustająca), si një prototip i qeverisjes moderne. Ajo kishte Departamentin e Thesarit për të menaxhuar financat shtetërore, i cili gjithsesi mbeti nën kontrollin e Parlamentit. Në këtë mënyrë, qeveria menaxhonte drejtperdrejt financat dhe Parlamenti kishte pushtetin legjislativ dhe kontrollues dhe ky model ka evoluar që atëherë. Në vitin 1791, u krijua Komisioni i Thesarit të Komunelthit, por shumë shpejt, në 1795, Polonia e pavarur ndaloi së ekzistuari, pasi shtetet fqinje e ndane territorin e saj midis tyre. Më pas, vendi u zhduk nga harta e Evropës për më shumë se njëqind vjet. Rrjedhimisht, kjo gjë shënoi fundin e të gjitha institucioneve publike të pavarura polake.

Zyra qendrore e Llogarive të Dukatit të Varshavës

Zyra qendrore e Llogarive (polonisht: Głóëna Izba Obrachunkoëa) u krijua pas themelimit të Dukatit të Varshavës, nga Napoleoni në vitin 1807. Zyra ishte përgjegjëse për kontrollin e llogarive të shtetit si dhe atyre lokale. Kreu i saj i parë ishte Franciszek Ksaëry Zboiński.

Zyra e Llogarive të Mbretërisë së Polonisë

Mbretëria e Polonisë (referuar edhe si Polonia e Kongresit) u themelua me vendim të Kongresit të Vjenës më 1815. Ajo u qeveris nga cari rus i cili, nga dekretet e 1816 dhe 1821, themeloi Zyrën e Llogarive (polonisht: Izba Obrachunkoëa). Përgjegjësia e saj kryesore ishte kontrolli i të gjitha llogarive publike dhe ishte e autorizuar edhe për të shprehur opinione mbi projekt-buxhetin. Njëkohësisht, për ndryshimet

në buxhetin e paraqitur nga sundimtari, duhej rënë dakord me Zyrën e Llogarive. Institucioni ndaloi së vepruari në vitin 1867, kur Mbretëria e Polonisë humbi krejtësisht pavarësinë pas Kryengritjes së Janarit, e cila ishte përpjekje e pasuksesshme e kombit polak për të rifituar pavarësinë e humbur në 1795. Rrjedhimisht, sistemi polak i auditimit të shtetit u absorbua nga strukturat institucionale ruse.

Zyra e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Polonia më në fund fitoi përsëri pavarësinë në vitin 1918 pas Luftës së Parë Botërore. Në shkurt 1919, Kryetari i Shtetit, Jozef Piłsudski, nënshkroi një dekret për Zyrën e Lartë të Kontrollit të Shtetit (Najwyższa Izba Kontroli Państwowej). Ky ishte një organ i pavarur, në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Shtetit, dhe përgjegjësia e tij ishte auditimi i të ardhurave shtetërore, shpenzimeve dhe menaxhimi i aseteve publike. Ai gjithashtu, monitoron punën e institucioneve dhe menaxhimin e fondeve dhe njësisë të vetë-qeverisura, duke nxjerrë raporte mbi buxhetin e shtetit. Kështu u siguria kontrolli i plotë mbi financat publike.

Zyra e Lartë e Kontrollit në Republikën e Dytë të Polonisë (1918-1939)

Kushtetuta e miratuar në mars të vitit 1921, mundësoi që Zyra e Lartë e Kontrollit të Shtetit, bazuar në parimin e përgjegjësisë kolegjiale, të ishte e autorizuar për auditimin e gjithë administratës shtetërore, sa i përket financave të saj dhe llogarisë. Çdo vit, NIK ishte i detyruar të paraqesë opinionin e tij për votën e miratimit për qeverinë, në dhomën e ulët të Parlamentit (polonisht: Sejmi). Presidenti i Nik ishte përgjegjës direkt për performancën e Nik dhe për punonjësit e saj. Më 3 qershor 1921, Akti mbi Auditimin e Shtetit u miratua dhe ishte në fuqi deri në përfundim të Republikës së Dytë të Polonisë në vitin 1939. Kjo mundësoi që NIK të ishte një organ i pavarur në bashkëpunim me Parlamentin.

Zyra e Lartë e Auditimit në Republikën Popullore të Polonisë (1945-1989)

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, pushteti më i lartë në vend ka qenë Këshilli Kombëtarë (polonisht: Krajoëa Rada Narodoëa, Shkurtimi: KRN.), i cili ka themeluar Zyrën e Auditimit (BIURO Kontroli)

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

që është menaxhuar në fakt nga Presidiumi i KRN-së. Në këtë mënyrë, auditimi i shtetit është dashur të jetë zyrtarisht i pavarur ndaj administratës. Në vitin 1949, Parlamenti krijoi Zyrën e Lartë të Auditimit (Najwyższa Izba Kontroli, Shkurt. NIK).

U përshtat gjithashtu dhe akti mbi NIK në mënyrë që Presidenti i NIK të emërohej nga SEJM dhe të ishte përgjegjës ndaj tij. Akti gjithashtu siguroi që NIK të përbëhej nga nëntë departamente, tri zyra dhe degët rajonale. Presidenti i NIK ishte anëtar i Këshillit të Shtetit. Kjo pavarësi relative e auditimit të shtetit përfundoi në vitin 1952, kur NIK u zëvendësua me Ministrinë e Kontrollit të Shtetit. Në këtë mënyrë, parimi i pavarësisë së NIK u shkel: NIK, i cili ishte një institucion suprem i auditimit, funksiononte si një nga ministritë dhe pjesë e qeverisë, veprimtaria e të cilit monitorohej. Si rezultat i ndryshimeve në politikën e brendshme polake, që u zhvilluan pas mesit të 1956, NIK u rivendos në vitin 1957 sërish në varësi të Sejm. Sejmi gjithashtu, emëronte dhe shkarkonte Presidentin e NIK. Në vitin 1976, Akti mbi NIK u ndryshua dhe NIK u shndërrua sërish në një organ qeveritar, të mbikëqyruar nga ana e Kryeministrit edhe pse emri i saj mbeti i pandryshuar. Së fundi, pavarësia e Zyrës Supreme të Auditimit u rivendos në vitin 1980 dhe auditimi i shtetit ishte përsëri në duart e Sejm-it. Në këtë mënyrë, funksioni kontrollues i Sejm-it u rrit ndjeshëm.

Zyra e Lartë e Auditimit në Poloni pas vitit 1989

Në vitin 1989 morën fund regjimet komuniste dhe Republika Popullore e Polonisë u shndërrua përsëri në Republikën e Polonisë. Edhe pse në një farë mënyre pavarësia e saj ishte e kufizuar gjatë periudhës së komunizmit, NIK mbijetoi si një strukturë e veçantë organizative. Kështu, Polonia demokratike, kishte një institucion të gatshëm që të fillonte menjëherë aktivitetin e tij të auditimit. Megjithatë, për shkak të kushteve të reja shoqërore dhe politike, pas vitit 1989 lindi nevoja për krijimin e një ligji të ri për Zyrën e Lartë të Auditimit. Ai u miratua përfundimisht nga Sejmi më 23 dhjetor 1994 dhe modernizoi auditimin shtetëror në Poloni.

Baza ligjore për të vepruar

Detyra themelore e NIK-ut është të kontrollojë veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore, Bankën Kombëtare të Polonisë (NBP), personat juridikë shtetërorë dhe subjektet e tjera shtetërore organizative. NIK mund të kontrollojë gjithashtu aktivitetet e organeve të qeverisjes vendore, për

Zyra Supreme e Auditimit (NIK) e Republikës së Polonisë

sa i përket ligjshmërisë së tyre, menaxhimit të shëndoshë, efikasitetit dhe integritetit. NIK ndërmerr auditime të urdhëruar nga Sejmi (Dhoma e Ulët e Parlamentit polak) ose nga organet e tij, me kërkesë të Presidentit, të Kryeministrit ose me iniciativën e vet. Funkcionimi dhe organizimi i NIK-ut është parashikuar në Kapitullin 9 të Kushtetutës së Republikës së Polonisë dhe në Ligjin për NIK-un, më 23 dhjetor 1994 (me amendimet e paraqitura nga Ligji i 22 janarit 201

Struktura e Organizimit të NIK-ut

Statusi i ri i Zyrës së Lartë të Auditimit u miratua nga Parlamenti, më 26 gusht 2011 dhe brenda 3 muajve, Presidenti i ri rregulloi organizimin e brendshëm institucional. Gjatë kësaj kohe, u transformuan departamentet më të rëndësishme dhe u krijuan njësi të reja organizative. Sipas ndryshimeve, Zyra e Lartë e Auditimit përbëhet nga 14 departamente auditimi në fusha të ndryshme të veprimtarive shtetërore si dhe nga 4 departamente administrative, të cilat ofrojnë shërbime të brendshme për NIK. Këto njësi janë vendosur në zyrat qendrore të NIK në Varshavë. Veç kësaj, NIK ka edhe 16 njësi rajonale në çdo rajon administrativ të Polonisë, të cilat përfshihen në auditime.

Këshilli i NIK-ut

Këshilli i Zyrës së Lartë të Auditimit është organi që zbaton parimin e kolegjalitetit të NIK-ut, si është parashikuar nga Kushtetuta polake dhe dispozitat statutoare. Këto organe kanë kompetenca të gjera, p.sh. miratimin dhe kalimin e rezolutave më të rëndësishme të NIK-ut, dokumente të cilat është i detyruar t'ia paraqesë Sejm-it. Këshilli i NIK-ut përfshin: Presidentin si Kryetar, Zëvendës-presidentin, Drejtorin e Përgjithshëm dhe 14 anëtarë.

Përbërja dhe mënyra e punës së Këshillit të NIK-ut

Shtatë ekspertë të ligjit ose të ekonomisë dhe shtatë drejtorë të njëjësive të auditimit. Këshilltarët e Presidentit të NIK-ut emërohen nga anëtarët e Këshillit të NIK-ut dhe nga Marshalli i Sejm-it, me kërkesë të Presidentit të NIK-ut pas marrjes së mendimit nga Komiteti i Sejm-it. Mandati i anëtarit të Këshillit të NIK-ut është 3 vjet.

Personat, duke qenë pjesë e këshillit, janë të pavarur në kryerjen e

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

funksioneve të tyre dhe mund të kenë mendime kundërshtuese mbi rezolutat që votohen. Garancia e pavarësisë së anëtarit, kur ata janë të emëruar në mënyrë të veçantë nga ana e NIK, është votimi i fshehtë, si dhe fakti se përfundimi i kontratës së punës në lidhje me punonjësit, duke u emëruar anëtar i Këshillit kërkon pëlqimin e Këshillit të NIK-ut.

Presidenti i NIK-ut mund të ftojë persona të tjerë përveç anëtarëve të Këshillit në mbledhjet e tij.

Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari i NIK-ut me iniciativën e vet ose me kërkesën e të paktën 1/3 së anëtarëve të Këshillit. Mbledhjet kryesohen nga kryetari i NIK-ut ose një zëvendës-president i emëruar nga kryetari. Në vitin 2010, janë mbajtur 15 Mbledhje të Këshillit, nga të cilat njëra kishte natyrën e seminarit. Takimet në formë seminari janë vendi i debatit për çështje të rëndësishme të funksionimit të shtetit dhe rolit të NIK-ut për ndërtimin e shtetit nën sundimin e ligjit.

Kompetencat e Këshillit

Këshilli i NIK-ut ka kompetenca të gjera. Ky organ miraton rezolutat, duke iu referuar planit vjetor të punës së Zyrës së Lartë të Auditimit, si dhe projekt-buxhetin e saj. Çdo vit Këshilli miraton dokumentet që NIK është i detyruar të paraqesë para Sejm-it, që do të thotë analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit, supozimet e politikës monetare dhe raportin e NIK-ut mbi aktivitetin për vitin e kaluar. Përveç kësaj, Këshilli i kalon për shqyrtim Sejm-it, opinione mbi miratimet e Këshillit të Ministrave dhe propozimet për probleme të veçanta, në lidhje me veprimtarinë e autoriteteve publike. Këshilli i NIK-ut mund të ofrojë këshilla për programin e auditimit, si dhe informacion për rezultatet e auditimeve veçanërisht të rëndësishme, drejtuar nga presidenti i NIK-ut. Çdo çështje tjetër drejtuar nga presidenti i NIK-ut apo paraqitur nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit është subjekt për këshilla. Këshilli i NIK-ut rishikon pasqyrat, që i referohen nenit 54, fraksion 3 të Ligjit për Zyrën e Lartë të Auditimit.

Detyrat e këshillit përfshijnë shqyrtimin e vlerësimeve, komentet dhe gjetjet e përfshira në pasqyrat e post-auditimit të paraqitura nga Presidenti ose nënkryetari i NIK-ut.

Në vitin 2010, Këshilli shqyrtoi rezerva për 52 pasqyra post-auditimi, nga të cilat gjashtë ishin të përfshira në total, 30 pjesërisht dhe 16 në tërësinë e tyre.

Bashkëpunimi me Parlamentin

NIK është organi më i lartë i auditimit të shtetit dhe i raporton Sejm-it (dhoma e ulët e Parlamentit). NIK i paraqet Sejm-it mbi 150 deklarata auditimesh, duke përmbushur në këtë mënyrë misionin e tij për të informuar Kuvendin mbi gjendjen e shtetit dhe të financave publike.

Në seancat plenare të Sejm-it, NIK paraqet dokumentat më të rëndësishme dhe opinionin e tij mbi çështjet më të rëndësishme që lidhen me kontrollet që kryen. Përfaqësuesit e NIK marrin pjesë edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe të nën-komiteteve.

NIK i paraqet Sejm-it dokumentet e mëposhtme:

- Analiza e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet e politikës monetare.
- Opinione mbi miratimet e qeverisë.
- Deklarimet mbi rezultatet e auditimeve të urdhëruar nga Sejmi dhe organet e tij.
- Deklarimet mbi rezultatet e auditimeve të kryera me kërkesë të Presidentit dhe Kryeministrit si dhe rezultatet e auditimeve të rëndësishme.
- Mocionet në Sejm për shqyrtimin e problemeve të caktuara në lidhje me organet që kryejnë detyra publike.
- Prononcimet mbi kundërshtimet për sa i përket veprimtarisë së Ministrave, Krerëve të Zyrave Qendrore ose Presidentit të Bankës Kombëtare që vijnë nga auditimet e kryera nga NIK.
- Raport mbi aktivitetin e vitit të shkuar.
- Informacion se si janë përdorur gjetjet e auditimit në lidhje me ligjëvënien dhe aplikimin e tij.

Gjithashtu, NIK është i detyruar të paraqesë tek Sejm edhe një plan periodik pune. Rezultatet e auditimit nuk duhet të bëhen publike pa u dorëzuar më parë tek Sejm-i. Presidenti i NIK merr pjesë në seancat plenare të Sejm dhe çdo vit i paraqet Sejm-it “Analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet mbi politikën monetare”.

Çdo vit, përfaqësues të NIK marrin pjesë në qindra mbledhje parlamentare (në 2006 - 916 mbledhje, në 2007 - 720, në 2008 - 966, në 2009 - 932, në 2010 - 719). Ata paraqesin dhe japin shpjegime mbi rezultatet e auditimeve, si dhe japin opinionet mbi nismat ligjore të deputetëve. NIK bashkëpunon rregullisht me Komitetin Shtetëror të Auditimit, i cili është

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

përgjegjës për të dhënë mendim mbi planin e punës të NIK, raportet vjetore të aktivitetit të tij, mbi buxhetin dhe raportin e ekzekutimit të tij etj. Komisioni kryen vlerësimin periodik të aktivitetit të NIK, duke përfshirë edhe analiza e deklarata mbi rezultatet e auditimit dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Komiteti gjithashtu merret me veprimtaritë ndërkombëtare të NIK, bashkëpunimet me organe të tjera të auditimit në Poloni dhe me analizimin e ankesave dhe sugjerimeve drejtuar NIK-ut.

Politika Mjedisore e NIK

NIK angazhohet për të kufizuar efektet e dëmshme që aktivitetet e saj mund të kenë në mjedisin natyror. Kjo është arritur përmes konsumit racional të energjisë elektrike dhe të burimeve natyrore (kryesisht letër) si dhe përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave. NIK gjithashtu synon të promovojë qëndrimet pro-mjedisore mes punonjësve të saj dhe të përmirësojë vazhdimisht përpjekjet e saj për sa i përket kujdesit ndaj mjedisit.

Politika mjedisore e NIK po zbatohet në kuadër të sistemit të menaxhimit të mjedisit të quajtur Zyra e Gjelbër, e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Punonjësit e NIK dhe personat e tjerë që punojnë për NIK ose në emër të tij, janë bërë të vetëdijshëm për nismën e Zyrës Gjelbër.

Presidenti i NIK, Jezierski Jacek, është përfshirë në zbatimin e politikave mjedisore duke ofruar burimet e nevojshme. Në Korrik 2011 Shoqëria Gjermane Lloyd Polen, konfirmoi se sistemi i menaxhimit të mjedisit i përdorur nga NIK, i përmbush kërkesat e standardeve ndërkombëtare. Për këtë arsye, NIK u pajis me certifikatën mjedisore përkatëse, e vlefshme deri më 17 Korrik 2014.

Veprimtaria

Zyra e Lartë e Auditimit i dorëzon Sejmi-t, analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet e politikës monetare, të opinionëve në votimin e miratimit të qeverisë, konstatimeve për rezultatet e kontrolleve dhe raportet vjetore mbi veprimtarinë e saj.

Shpenzimet publike që kërkojnë auditimin e NIK

Zyra e Lartë e Auditimit heton çdo fushë ku përfshihen shpenzimet publike dhe përdorimi i pasurive shtetërore. NIK gjithashtu kontrollon nëse

institucionet publike bëjnë punën e tyre në mënyrë efektive, efikase dhe me ekonomicitet. Çdo vit, NIK auditon mijëra subjekte, duke paraqitur kështu pamjen e përgjithshme të funksionimit të shtetit. Deklarimet mbi rezultatet e auditimit i paraqiten Sejm-it (Dhoma e ulët e Parlamentit polak) dhe institucioneve përgjegjëse për funksionimin e duhur të subjekteve të audituara.

Buxheti i shtetit në mikroskop

Auditimi më i rëndësishëm që kryen NIK, është ekzekutimi i buxhetit të shtetit. Çdo vit, NIK-u auditon rreth 400 subjekte në kuadër të kontrollit të ekzekutimit të buxhetit të shtetit. Ky auditim është detyra kryesore në planin vjetor të punës së NIK-ut. Në një seancë plenare të Parlamentit, Presidenti i NIK-ut paraqet çdo vit rezultatet e auditimit mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit. Ato përshkruhen në dokumentin e titulluar “Analiza e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzime mbi politikën monetare”.

Planifikimi vjetor

Plani i auditimeve për vitin ushtrimor, zhvillohet në bazë të drejtimeve prioritare të auditimit, të vendosura çdo 3 vjet nga Kolegji i NIK-ut. Në vitet 2009 – 2011, NIK ka vlerësuar nëse shteti ka funksionuar normalisht, nëse burimet publike janë menaxhuar në mënyrë efektive dhe se si ka qenë ecuria e Polonisë në BE. Auditimet e planifikuara për vitin 2011 ishin të përqendruara kryesisht në buxhetin e shtetit, gjendjen e financave publike, ekonominë, sigurinë e shtetit dhe qytetarëve, mbrojtjen shëndetësore, ekologjinë, arsimin, problemet sociale dhe aktivitete që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Polonisë në Bashkimin Evropian.

Standardet e auditimit të NIK

Standardet e auditimit të NIK kanë lejuar ruajtjen e nivelit profesional të auditimeve të kryera. Ato ofrojnë një platformë për planifikimin, punën dhe vlerësimet e rezultateve të auditimit. Gjithashtu, ato pasqyrojnë arritjet e NIK-ut dhe janë modifikuar në bazë të zgjidhjeve metodologjike të auditimit.

Standardet e auditimit përbëhen nga 17 grupe çështjesh që mbulojnë fazat dhe procedurat më të rëndësishme të auditimit. Ato janë zhvilluar në bazë të ligjeve polake, standardeve të auditimit të INTOSAI-t,

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Evropiane të Auditimit

udhëzimeve evropiane zbatuese të INTOSAI-t, standardeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) dhe përvojës së gjatë të NIK-ut. Standardet e auditimit të NIK-ut së bashku me udhëzimet metodologjike përbëjnë Manualin e auditimit.

Bashkëpunimet Ndërkombëtare

NIK është i përfshirë aktivisht në veprimtaritë në arenën ndërkombëtare duke bashkëpunuar me Institucionet e Larta të Auditimit në Evropë dhe në botë, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e auditimit të vendeve të tjera. Bashkëpunimi me SAI-t e tjerë, lejon që NIK të rrisë njohuritë e tij mbi praktikat më të mira të standardeve të auditimit dhe të përhapë përvojën e tij në arenën ndërkombëtare.



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis SAI-t të Polonisë përfaqësuar nga Presidenti z. Jacek Jezierski dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj
23 maj 2012, Varshavë, Poloni

Bashkëpunimi me KLSH

NIK-u polak dhe KLSH kanë patur një marrëveshje bashkëpunimi të vitit 2006, e cila për fat të keq nuk u zbatua gjatë viteve 2009-2011, për shkaqe të menaxhimit të brendshëm të KLSH.

Një marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar midis këtyre dy institucioneve nga dy drejtuesit z. Jacek Jezierski presidenti i NIK dhe z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së, në maj të vitit 2012 në Varshavë.

Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Zyra e Auditimit Suprem e Polonisë do të shkëmbejnë eksperiencë në veprimtarinë e tyre audituese. Në fillim të korrikut 2012, një grup prej 15 audituesish nga KLSH morën pjesë në trajnimin për auditimin e performancës në Qendrën e Trajnimeve të NIK në Poloni, ndërsa në dhjetor, 16 auditues të KLSH morën pjesë në një trajnim intensiv një javor për auditimin financiar po në Poloni.

Në respekt të popullit polak dhe të NIK, KLSH së shpejti do të botojë në shqip librin “Simbole polake”.

NIK si anëtare e INTOSAI-t

NIK është anëtar i INTOSAI-t që nga viti 1959.

NIK është përfshirë në mënyrë aktive në veprimtaritë e INTOSAI-t, po ashtu edhe përfaqësues të NIK-ut janë të pranishëm në strukturat e INTOSAI-t dhe marrin pjesë në nën-komitete, grupet e punës dhe kongrese.

NIK-u luan edhe rolin e audituesit të Organizatës Evropiane për Kërkimet Bërthamore.

Zyra e Lartë e Auditimit polak u caktua si auditues i jashtëm i Organizatës Evropiane për Kërkimet Bërthamore (CERN). NIK duhet ta kryejë këtë funksion nga viti 2013 deri në 2015.

Ky është një dallim për Zyrën e Lartë të Auditimit polak dhe gjithashtu hera e parë kur funksioni i audituesit të jashtëm i është dhënë një SAI “të ri” anëtar (që u bashkua me CERN pas vitit 1989).

CERN (Organizata Evropiane për Kërkime Bërthamore) u themeluar në vitin 1954. Selia e saj është vendosur në Gjenevë. Aktualisht, janë 20 vende organizatore . Buxheti i tij i tejkalon 1 miliard CHF. Afërsisht tre mijë ekspertë dhe teknologë punojnë në baza të rregullta, por numri i njerëzve që bashkëpunojnë me CERN arrin në tetë mijë.

CURRICULUM VITAE
JACEK JEZIERSKI
President i NIK



Jacek Jezierski lindi më datë 11 Prill 1958 në Gdansk. Ai u diplomua në Fakultetin e Biologjisë dhe të Shkencave të Tokës, në Universitetin e Gdansk-ut. Në vitin 1988 Jezierski mori pjesë një ekspeditë shkencore njëvjetoje të qendrës kërkimore të Akademisë Polake të Shkencave (APSH) në Arqipelagun e ishujve Spitsbergen, në Arktik.

Ai nisi karrierën e tij profesionale në vitin 1983 në qendrën ornitologjike të APSH-së në Gdansk. Gjatë viteve 1985-1990 Jezierski punoi për Klubin Malor “Trójmiasto”. Në vitet 1990-1992, ai punoi në Zyrën Ekologjike të Komitetit Kombëtar të “Solidarność”-it.

Në datën 15 Qershor të vitit 1992 Jacek Jezierski u zgjodh në Zyrën më të Lartë të Auditimit si Zëvendës Drejtori i ekipit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Infrastrukturës së Ndërtimit, e cila ndyshoi emërtimin në Departamenti i Mbrojtës së Mjedisit dhe Ndërtimit.

Në datën 1 Gusht 1998 ai u zgjodh si Zëvendës President i NIK-ut. Në 22 Gusht 2007 u zgjodh si President i NIK-ut. Nga viti 2008-2011 Jezierski ishte Kryetari i Bordit Drejtues i EUROSAT-t.

Në qershor 2012, në zyrat e NIK, Presidenti Jezierski organizoi një ceremoni festive për 16 audituesit e KLSH që ndodheshin për trajnim për auditimin financiar në Varshavë. KLSH vlerëson së tepërmi kontributin e Jezierski-t dhënë institucionit veçanërisht në ndihmën për trajnimin e audituesve shqiptarë. Jezierski është propozuar nga Kryetari i KLSH për t’u dekoruar nga Presidenti i Republikës. Ky propozim është pranuar në parim dhe në pranverë të vitit 2013 do të zhvillohet ceremonia e dhënies së dekoratës.



Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë dhe Kryetari i KLSH në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes, maj 2012, Varshavë Poloni



Gjykata Turke e Llogarive

Gjykata Turke e Llogarive u krijua nëpërmjet një dekreti perandorak të Madhërisë së tij Sulltanit Aziz, në vitin 1862. Në vitin 1876, me miratimin e Kushtetutës së parë osmane, Gjykata u kthye në një institucion kushtetues. Pas themelimit të Republikës në vitin 1923, ajo u rithemelua dhe ruajti statusin e saj përcaktuar në Kushtetutën e Republikës. Sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Gjykatën e Llogarive, ajo është përgjegjëse për auditimin e të ardhurave, të shpenzimeve dhe të pronës së administratës publike, në emër të Asamblesë së Madhe Kombëtare (Parlamentit).

Si organ auditues i jashtëm i qeverisë qendrore, lokale dhe institucioneve të sigurimeve shoqërore, ajo auditon rreth 120.000 llogari kontabël të sektorit publik. Gjykata kryen auditimim financiar mbi besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare dhe përcakton nëse transaksionet financiare të lidhura me të ardhurat, shpenzimet dhe asetet e administratës publike janë në përputhje me ligjet dhe marrëveshjet e tjera ligjore. Me ndryshimin e ligjit të vitit 1996, Gjykatës i'u dha detyra e shqyrtimit të zyrave të qeverisë nën juridiksionin e saj në lidhje me përdorimin e burimeve të tyre duke treguar vëmendje ndaj ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

Shpenzimet e saj financohen nga një buxhet i veçantë. Por pavarësia e saj financiare është më e thellë: ajo përgatit buxhetin e saj dhe e paraqet atë në

parlament pa ndërhyrjen e ekzekutivit. Presidenti i Gjykatës është i vetmi autoritet që autorizon shpenzimet nga buxheti.

Karakteristikat

Gjykata është Institucioni më i Lartë i Auditimit me natyrë kolegjiale, i pajisur me fuqi gjyqësore dhe që nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes administrative apo politike.

Duke qenë se Gjykata është e pavarur nga tre fuqitë, legislative, ekzekutive dhe gjyqësore, ajo ka liri të plotë të vendosë cilat llogari dhe subjekte do të auditojë, kur dhe si do ta kryej auditimin. Ajo gjithashtu vendos nëse për çështjen në fjalë është i nevojshëm raportimi në Parlament. Planifikimi konkret i punës bëhet në bazë të sugjerimeve të auditorëve. Në kryerjen e punës ajo mund të komunikojë drejtpërdrejt me ministrinë, bordet, zyrat qeveritare, kontabilistët dhe zyrtarë të tjerë përgjegjës. Gjykata ka gjithashtu të drejtë të ketë akses dhe të shqyrtojë çdo regjistër, regjistrim dhe dokumente mbështetëse që janë të nevojshme për punën e saj. Personeli i Gjykatës gëzon disa garanci që lidhen me pozicionin e punës. Presidenti i Gjykatës nuk mund të hiqet nga posti i tij para përfundimit të mandatit të tij shtatë vjeçar ose para se ai të ketë mbushur 65 vjeç. Në mënyrë të ngjashme, anëtarët nuk mund të shkarkohen nga detyra ose të dalin në pension para moshës 65 vjeç. Për sa i përket audituesve, me përjashtim të rasteve të parashikuara në mënyrë specifike me ligj, atyre nuk mund tu ndërpritet ose tu hiqen shpërblimet e tyre dhe të drejtat e tjera ose të punësohen në ndonjë zyrë tjetër përveç asaj në të cilën janë caktuar.

Veprimtaria

Mandati i auditimit të Gjykatës së Llogarive zhvillohet në një proces me dy faza. Faza e parë është auditimi i llogarive, ndërsa e dyta është gjykimi i llogarive të audituara. Produkt i fazës së dytë është një dokument ligjor i quajtur urdhër gjyqësor me të cilin zyrtarët përgjegjës ose shfaqësohen ose janë përgjegjës për transaksionet e tyre. Produktet e tjera janë raportet e ndryshme drejtuar Parlamentit. Këto raporte mund të klasifikohen si vijon:

1. Deklarata e Pajtuëshmërisë së Përgjithshme

Sipas Kushtetutës, Gjykata duhet të përgatisë Deklaratën e Përputhshmërisë së Përgjithshme dhe ta dërgojë atë në Parlament. Me këtë Deklaratë ajo siguron Parlamentin që shifrat dhe faktet e treguara në Projekt-ligjin

përfundimtar të llogarive, përshkruajnë rezultatet aktuale të zbatimit të buxhetit të shtetit.

2. Raporte Performance

Me amendimin e vitit 1996, Gjykatës i është dhënë kompetenca për të kryer auditime të performancës. Prandaj, ajo shqyrton nëse institucioni publik dhe organizatat brenda mandatit të saj të auditimit, kanë përdorur burimet e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

3. Raportet për Opinionin Publik

Ligji i Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar

Sipas këtij ligji, Gjykata duhet të dorëzojë në Parlament, Raportin e Aktivitetit dhe Raportin e Përgjithshme të Veprimtarisë së Administratës Publike, Raportin e Aktivitetit të Përgjithshëm të Administratës Lokale dhe Raportin mbi Vlerësimin e Përgjithshëm të Auditimit të Jashtëm.

Raporte të Tjerë

Këto raporte parashikohen nga dispozitat e ligjit që rregullon funksionimin e Gjykatës:

- a) Dispozitat ligjore dhe rregulluese të cilat rrezikojnë interesat e Thesarit (neni 25).
- b) Pyetjet financiare që përfshijnë edhe metodat e kontabilitetit, praktikat, sistemet dhe procedurat që mund të jenë shqetësuese për përlogaritjen e të ardhurave (neni 28, IV).
- c) Çështjet me interes (neni 28, V).
- d) Rezultatet e auditimit në lidhje me llogaritë e pronës (neni 87).
- e) Nëse organet qeveritare jashtë buxhetit të qeverisë qendrore kanë vepruar në kuadër të «qëllimit e themelimit të tyre» (neni 87).
- f) Raste të rëndësishme të mosplotësimit të legjislacionit (neni 88). Raportimi nën pikat (a), (b), (c) dhe (f) më sipër është në zgjedhjen e Gjykatës, ndërsa raportimi nën pikat (d) dhe (d) kërkohet nga ligji.

Organizimi dhe Stafi

Gjykata Turke e Llogarive ka dy lloje stafi:

1. Stafi Profesional

Përbëhet nga Presidenti, Anëtarët dhe Audituesit. Aktualisht, stafi

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

profesional është i përbërë nga 661 individë: 49 janë të stafit gjyqësor dhe 710 janë auditues.

2. Stafi Mbështetës

Përbëhet nga personeli që nuk i përket stafit profesional. Ata janë rreth 555 individë.

Siç u përmend më lart Gjykata është e strukturuar si institucioni më i lartë i auditimit kolegjal ku ka individë dhe borde. Individët janë:

Presidenti i Gjykatës

Ai ose ajo është zyrtari më i lartë i Gjykatës dhe është përgjegjës për funksionimin e përgjithshëm të saj. Ai kryeson mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe gjithashtu mund të kryesojë Bordin e Apelit dhe të Këshillit të Dhomave, kur e konsideron të nevojshme.

Sekretari i Përgjithshëm

Alpha

Sekretari i Përgjithshëm është asistenti administrativ i Presidentit. Sekretari i Përgjithshëm mund të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe Bordin e Dhomave. Presidenti emëron 3 krye auditues apo auditues të lartë, si ndihmës të Sekretarit të Përgjithshëm.

Alpha

Anëtarët e Gjykatës

Në thelb, ata janë anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme. Për më tepër, çdo anëtar është pjesë e një prej tetë dhomave dhe gjithashtu anëtar i Bordit të Apelit ose të Bordit të Dhomave;

Prokurori dhe zëvendësit e tij

Ata veprojnë në emër të Thesarit dhe i japin mendimin e tyre me shkrim dhomave përkatëse, mbi gjetjet e auditimit.

Audituesit

Audituesit shqyrtojnë llogaritë e përcaktuara nga Presidenti. Ata janë të organizuar në grupe auditimi, aktualisht në 21 të tilla.

Stafi

Stafi përbëhet nga zyrtarë, teknikë dhe mbikëqyrësit e tyre. Ata ofrojnë përkrahje administrative dhe teknike për funksionimin e përgjithshëm të Gjykatës.

Kolegjet janë:

1. Dhomat

Dhomat janë baza e sistemit gjyqësor. Çdo dhomë përbëhet nga një kryetar dhe gjashtë anëtarë dhe vepron si gjykatë. Detyra kryesore e saj është të kontrollojë veprimet dhe llogaritë e zyrtarëve përgjegjës. Gjykimi është i bazuar në raportet e audituesit. Kështu, dhoma vendos nëse këta zyrtarë janë të pafajshëm apo përgjegjës.

2. Asambleja e Përgjithshme

Ajo përbëhet nga Presidenti, kryetarët dhe anëtarët e dhomës. Detyrat e Asamblesë përcaktohen nga ligji i Gjykatës Turke të Llogarive.

3. Bordi i Apelimit

Bordi i ofron zyrtarëve përgjegjës, të drejtën e apelit kundër vendimeve të Dhomave.

1. Bordi i Dhomave

Ajo përcakton mendimin këshillues të TCA, mbi rregulloret financiare të departamenteve qeveritare. Anëtarët e stafit duhet të jenë të diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, të Shkencave Politike, të Ekonomisë, ose në institucione arsimore jashtë vendit, të njohur nga Këshilli i Lartë Arsimor. Është gjithashtu thelbësore që Presidenti dhe anëtarët të kenë mbajtur më parë një nga pozicionet e listuara në Ligjin e TCA. Kryetari dhe anëtarët e bordit zgjidhen nga Kuvendi, ndërsa audituesit emërohen nga Presidenti pas një konkursi. Prokurori dhe ndihmësit e tij, emërohen me propozimin e Ministrisë së Financave, me anë të një dekreti të përbashkët.

Marrëdhëniet ndërkombëtare

Gjykata Turke e Llogarive është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe e dy Grupeve Rajonale të saj, Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Auditimit (EUROSAI) dhe Organizata Aziatike e Institucioneve Supreme të Auditimit (ASOSAI). Përveç kësaj, është një nga anëtarët themeluese të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Institucioneve Supreme të Auditimit (ECOSAI). Presidenti i TCA ka qenë presidenti i parë i Bordit Drejtues të kësaj Organizate dhe ende mban kryesimin e Bordit. TCA gjithashtu, mban lidhje të ngushta me SAI të tjera në Evropë dhe Azi. Marrëdhëniet mes Institucioneve Supreme të Auditimit, kontribuojnë në përpjekjet e tyre për të përmirësuar cilësinë e auditimit. Për këtë arsye, TCA ka dërguar disa prej audituesve të saj në disa kurse të zhvilluara nga zyrtarë të tjerë të auditimit. Edhe vetë TCA ka zhvilluar një kurs për SAI-t dhe është e përgatitur për të zhvilluar të tjerët nëse kërkohet. Paralelisht me procesin e anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin Evropian (BE), TCA po vazhdon përpjekjet për harmonizimin me praktikën e BE. Në këtë kuadër, TCA në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, ka realizuar një Projekt Binjakëzimi mbi forcimin e kapacitetit të auditimit. Gjithashtu, TCA ka vizituar SAI të vendeve të ndryshme, për të diskutuar e për të shkëmbyer eksperiencën mbi çështjet me interes të përbashkët.

Bashkëpunimi me KLSH

Më datën 29 maj 2012, TCA kremtoi 150 vjetorin e themelimit të saj. Një delegacion i KLSH i përbërë kryetarin z. Bujar Leskaj dhe në përbërje ndër audituesit më me emër dhe përvojë në institucion, Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini, Drejtori i Departamentit z. Fatos Çoçoli, kontrollorët e lartë Znj. Zyra Kepi e z. Rustem Tare, mori pjesë në festimet e këtij jubileu të SAI-t turk në Ankara.

Më datë 16 nëntor 2012 në Ankara të Turqisë, Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin Prof. Asoc. Dr. Rejai Akyel.

Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata e Llogarive e Turqisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin



Delegacioni shqiptar në seancën jubileare të 150 Vjetorit të Gjykatës së Llogarive të Turqisë. Maj 2012

Gjykata Turke e Llogarive

financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në çertifikimin e deklaratave financiare.

Në dhjetor 2012, një grup prej 15 audituesish nga KLSH do të trajnohen në Ankara pranë Gjykatës turke për auditimin e performancës dhe gjatë vitit 2013 do të zhvillohen një sërë trajnimesh të tjera në Turqi.



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Gjykatës së Llogarive të Turqisë përfaqësuar nga Presidenti Prof.Dr. Recai Akyel dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari Dr. Bujar Leskaj
16 nëntor 2012 Ankara, Turqi

Një delegacion i lartë i Gjykatës së Llogarive të Turqisë i kryesuar nga z. Hiqmet Cavit Erdogan, anëtar i Dhomës së Lartë të Gjykatës vizitoi Shqipërinë me rastin e 100-vjetorit të shtetit shqiptar.



Në zyrën e Kryetarit të KLSH-së, më 29 nëntor 2012
Dr. Bujar Leskaj priti delegacionet e ardhura me rastin e festimeve
të 100-Vjetorit të Pavarësisë.

(Në foto nga e djathta: z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Dr. Igor Šoltes, President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, Dr. Bujar Leskaj, z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Kroacisë, z. Hiqmet Cavit Erdogan, Anëtar i Lartë i Dhomës së Gjykatës së Llogarive të Turqisë.)

CURRICULUM VITAE

Dr. Recai AKYEL

President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë



Dr.Recai AKYEL lindi në vitin 1965 në rrethin e Şenkaya Erzurum-së; ai përfundoi shkollimin fillor dhe të mesëm në Kirsehir.

U diplomua në vitin 1987 në Departamentin e Administratës Publike të Fakultetit të Shkencave Politike në Universitetin e Ankarasë. Menjëherë pas

diplomimit ai filloi programin Master në degën e Administratës Publike të Institutit të Shkencave Sociale të Universitetit Gazi.

Ai u emërua Guvernator i qarkut në Eskisehir dhe gjithashtu u bë një anëtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Qëndroi në Mbretërinë e Bashkuar për një vit, si pjesëmarrës i një programi profesional arsimor në gjuhën angleze. Më pas u emërua Guvernator i provincës së Qarqeve Pozanti, İscehisar, Çamoluk, Solhan, Gölkaya, İmamoğlu, Kızıltepe dhe Elbistan. Ka qenë në Japoni për gati një muaj në një trajnim në lidhje me menaxhimin e katastrofave.

Ka përfunduar një doktoraturë në degën e Studimeve të Biznesit të Universiteti Çukurova në Institutin e Studimeve Sociale. Ka një njohuri të mirë të gjuhës angleze.

Ka botuar libra me informacione mbi qarqet ku ai ishte Guvernator: Pozanti, İscehisar, Çamoluk, Solhan, Gölyaka, İmamoğlu. Përveç kësaj, ai ka botuar librin me titull “Tërmeti në Gölyaka” në lidhje me përvojën e atyre që kanë përjetuar tërmetin e 17 gushtit dhe 12 nëntorit të 1999.

Më 25 qershor të 2009 Parlamenti Turk e zgjodhi Dr Recai Akyel, i cili kishte qenë Guvernator i Provincës Tokat që nga 13 prill 2007, si Presidentin e 34 të Gjykatës Turke të Llogarive (TCA). Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Dr Akyel është gjithashtu anëtar i Bordeve Drejtues të Organizatës aziatike të Institucioneve Supreme të Auditimit (ASOSAI), Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik Institucioneve Supreme të Auditimit (ECOSAI) dhe Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).



Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Turqisë dhe Kryetari i KLSH gjatë takimit në Gjykatën e Llogarive të Turqisë, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, Ankara, nëntor 2012



REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Misioni

“Të kontribuojë për mirë menaxhimin financiar në administratën publike”. Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës kryen auditime të cilësisë, në harmoni me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe me praktikat e mira evropiane. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, krijon besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike, duke pasur si pikësynim ndërmarrjen e një roli aktiv për të siguruar interesin e tatimpaguesve dhe palëve të tjera, për rritjen e llogaridhënies publike.

Funksioni

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAPK), kryen auditime vjetore statutores të rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe Organizatave Buxhetore. ZAPK gjithashtu ka të drejtë të kryejë auditime të formave të tjera dhe ndjekjen e fondeve buxhetore që i jepen përfituesve. Kjo gjë bëhet në kuadër të fushëveprimit të këtij institucioni, por nuk është e detyrueshme me ligj që të kryhet çdo vit. Auditimi i Performancës është një nga këto lloje auditimi, i cili kryhet për të vlerësuar nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, me kosto efektive, dhe efikase dhe nëse janë vendosur sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

ZAPK raporton tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP-Komisioni i Mbikëqyrjes së Financave Publike), për auditimet e kryera. Të gjitha raportet e ZAPK-së, janë të hapura për publikun dhe publikohen në faqen e internetit të ZAPK-së. Raportet përmbajnë rekomandime, të cilat adresojnë dobësitë më serioze të identifikuar, me qëllim që t’i ofrohet Kuvendit, Qeverisë, dhe taksapaguesve një shërbim profesional dhe i integruar i auditimit.

Pikësynimi është të sigurohen taksapaguesit dhe donatorët ndërkombëtar, se fondet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive, dhe

efikase. ZAPK e arrin këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrë të matur dhe siç duhet.

ZAPK synon të ndihmojë në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe Menaxhimin e Financave Publike. ZAPK përgjithëson gjetjet nga procesi i auditimit dhe jep kontributin e tij për zhvillimin e mëtejshëm të administratës publike.

KUSHTETUTA E KOSOVËS

Baza Ligjore

Neni 136

[Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës]

1. Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar.
2. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Audituesit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj.
3. Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.
4. Kuvendi vendos për shkarkimin e Audituesit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të propozimit të Presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
5. Mandati i Audituesit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.

Neni 137

[Kompetencat e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës]

Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës auditon:

- (1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- (2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
- (3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Neni 138

[Raportimi i Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës]

1. Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, i paraqet Kuvendit:
 - (1) raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
 - (2) mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi;
 - (3) informacione për rezultatet e kontrolleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
2. Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës i paraqet Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e vet.

Neni 157

[Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, është një ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil.

Bashkëpunimi me KLSH

Ne shkurt të vitit 2012 nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.



Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj
në Konferencën vjetore të ZAP Kosovë,
Prishtinë 16.07.2012

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në tre vitet e fundit që drejtohet nga personaliteti i auditimit suprem z. Lars Lage Olofsson ka dyfishuar buxhetin e saj, ka katërfishuar numrin e auditimeve dhe ka shtuar personelin me 50 punonjës të rinj. KLSH dergoi në korrik 2012 një grup me auditues dhe drejtues, për të

marre pjese ne Konferencen Vjetore te ZAP dhe per t'u trajnuar, duke fituar eksperience ne organizimin e eventeve te tilla.

Marreveshja parashikon po ashtu pershtatjen ne gjuhen shqipe te standardeve ISSAI te auditimit financiar dhe te performances.



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis ZAP-it të Kosovës përfaqësuar nga Auditori i Përgjithshëm Mr. Lars Lage Olofsson dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj
Tiranë, 14 shkurt 2012

CURRICULUM VITAE

LARS LAGE OLOFSSON

Auditor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Kosovë.



Mbi 30 vjet përvoja të ndryshme në Auditimin e Jashtëm, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në sektorin publik, si dhe në organizatat ndërkombëtare. Specialist në menaxhimin financiar dhe auditim.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Përvojë pune në projekte që mbulojnë proceset buxhetore, zhvillimin e biznesit, hartimin dhe zhvillimin e sistemeve administrative, sistemet financiare dhe të kontabilitetit, qeverisjen e mirë, nevojat për trajnim, analiza institucionale, si dhe projekte mbi ndërtimin e kapaciteteve, vlerësimeve, etj.

Përvojë në projektimin dhe zbatimin e projekteve dypalëshe ose shumëpalëshe të zhvillimit me organizatat ndërkombëtare.

Përvoja ndërkombëtare nga puna në Rusi, shtetet baltike, Evropën Lindore, Ballkan, Afrikë etj



Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, z. Lars Lage Olofsson
dhe Kryetari i KLSH z. Bujar Leskaj, në zyrën e Kryetarit të KLSH në Tiranë,
14 shkurt 2012

Punësimi

2009 - në vazhdim Auditori i Përgjithshëm, Kosovë
2006 - 2009 Këshilltar i Lartë dhe Zhvillues Biznesi, Zhvillimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
2004 - 2006 Konsulent, Këshilla dhe Ndihmë Olofsson, partner i MAPSEC
2001 - 2003 Këshilltar i Lartë mbi Kontrollin Financiar dhe Auditimin e Jashtëm, SIGMA / OSBE.



Kryetari i KLSH-së dhe Auditori i Përgjithshëm i Kosovës,
Vlorë, 28 nëntor 2012



Republika e Sllovenisë, Gjykata e Auditimit.

Informacion i përgjithshëm mbi Gjykatën Sllovene të Auditimit.

Kushtetuta e Sllovenisë thekson se, Gjykata e Auditimit të Republikës Sllovene, është organi më i lartë për mbikëqyrjen e llogarive shtetërore, të buxhetit të shtetit dhe të të gjitha shpenzimeve publike në Slloveni. Kushtetuta më tej parashikon se, Gjykata e Auditimit është e pavarur në kryerjen e detyrave të saj dhe organizimi dhe kompetencat e Gjykatës së Auditimit janë të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, ligji i funksionimit të kësaj Gjykatë parashikon se aktet, me të cilat ajo ushtron kompetencat e saj të auditimit nuk mund të ndryshohen apo të hidhen poshtë nga gjykatat apo organe të tjera shtetërore. Misioni i Gjykatës së Auditimit është të informojë publikun mbi rezultatet e auditimit të organeve shtetërore dhe përdoruesve të tjerë të fondeve publike. Përveç kësaj, për shkak të përvojës dhe ekspertizës së saj në praktikat më të mira, Gjykata e Auditimit jep këshilla për organet shtetërore dhe përdorues të tjerë të fondeve publike, për të përmirësuar operacionet e tyre financiare.

Duke zbuluar parregullsi dhe jo efikasitet, Gjykata e auditimit bën me përgjegjësi organet shtetërore dhe bartëse të funksioneve publike, të cilët duhet të kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Sllovenisë dhe Bashkimit Evropian.

Veprimtaria e Gjykatës së Auditimit.

Audituesit e Gjykatës së Auditimit mbledhin prova për çështjet e mëposhtme: nëse të ardhurat e buxhetit të shtetit janë mbledhur si duhet, nëse shpenzimet e buxhetit të shtetit ishin në përputhje me rregullat dhe nëse operacionet financiare të përdoruesve të fondeve publike ishin të përshtatshme, pra në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit. Audituesit gjithashtu, vlerësojnë nëse fondet publike janë përdorur në përputhje me qëllimet e përcaktuara. Gjatë procedurës së auditimit, audituesit japin këshilla për përdoruesit e fondeve publike për shmangien dhe eliminimin e gabimeve, parregullsive dhe jo-efikasitetit në operacionet e tyre financiare. Gjykata e Auditimit gjithashtu, boton opinione detyruese mbi çështjet e financave publike.

Kë mund të auditojë Gjykata e Auditimit?

Gjykata e Auditimit mund të kontrollojë veprimet e çdo përdoruesi të fondeve publike. Një përdorues i fondeve publike është një entitet ligjor publik, apo njësi e tij, një subjekt privat ligjor ose një person fizik që ka marrë ndihma nga buxheti i Bashkimit Evropian, buxheti i shtetit ose buxheti i një autoriteti lokal, apo që kryen një shërbim publik, ose siguron të mira publike mbi bazën e një koncesioni. Një subjekt ligjor privat mund të auditohet nga Gjykata e Auditimit në qoftë se ai është një kompani, bankë apo kompani sigurimesh, në të cilat shteti apo një autoritet lokal ka shumicën e aksioneve. Opinione të Gjykatës së Auditimit mbi këto operacione duhet të konsiderohen nga çdo organ shtetëror, organi i autoriteteve lokale dhe përdoruesit e fondeve publike ndaj të cilit kryhet auditimi. Në bazë të kompetencave të saj, Gjykata e Auditimit gjithashtu ka disa detyrime që përcaktojnë qëllimin vjetor të punës së saj. Sipas nenit 1, Gjykata e Auditimit duhet të kryejë auditime vjetore mbi rregullsinë e zbatimit të buxhetit të shtetit (rregullsinë e veprimeve të shtetit), rregullsinë e veprimeve të institutit publik të sigurimeve shëndetësore dhe rregullsinë e operacioneve të institutit të sigurimeve të pensioneve publike. Çdo vit, Gjykata e Auditimit duhet të auditojë rregullsinë e operacioneve për një numër të caktuar të qyteteve dhe komunave, si dhe të ofruesve komercialë dhe jo-komercialë të shërbimeve publike. Numri i tyre duhet të përcaktohet në programin vjetor të punës.

Si i zbaton Gjykata e Auditimit detyrat e saj?

Detyra themelore e Gjykatës së Auditimit, është të shqyrtojë dhe të kontrollojë veprimet e përdoruesve të fondeve publike. Nga auditimi i këtyre operacioneve, ajo merr të dhënat e duhura dhe të mjaftueshme për të shprehur një opinion mbi përdorimin e tyre:

- Në auditimin e pasqyrave financiare, ajo vlerëson integritetin dhe saktësinë e pasqyrave.
- Në auditimin e rregullsisë së operacioneve, shpreh një opinion mbi përputhshmërinë e veprimeve me rregullat dhe udhëzimet që përdoruesit e fondeve publike duhet të ndjekin.
- Në auditimin e performancës, shpreh një mendim për ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve të përdoruesve të buxhetit.

Të gjitha raportet e lëshuara nga Gjykata e Auditimit paraqiten në Asamblesë Kombëtare dhe në njësinë e audituar. Gjykata e Auditimit, çdo vit, duhet ti dorëzojë Asamblesë Kombëtare një raport vjetor për punën dhe gjetjet e saj më të rëndësishme.

Si e vendos Gjykata se cilat auditime duhet të ndërmerren?

Gjykata e Auditimit i ushtron kompetencat e saj krejtësisht e pavarur dhe është përgjegjëse për miratimin e programit të saj të punës. Në hartimin e programit vjetor të punës, Gjykata e Auditimit konsideron përgjegjësitë ligjore, si dhe propozimet direkte dhe indirekte nga deputetët, Kuvendi, qeveria, ministrat, autoritetet vendore, shoqëria civile, mediat dhe qytetarët individualë, duke përfshirë dhe prioritetet dhe strategjitë e saj. Në përzgjedhjen e auditimeve për t'u përfshirë në programin vjetor të punës, Gjykata e Auditimit përpiqet t'u përgjigjet pritjeve të publikut sa më me efikasitet të jetë e mundur; megjithatë ajo duhet të mbetet e pavarur në përcaktimin dhe identifikimin e punës së saj në mënyrë që të jetë në gjendje të japë gjykime objektive, e cila vlen edhe për informimin publik.

Organizimi i Gjykatës së Auditimit.

Gjykata e Auditimit të Republikës së Sllovenisë ka tre anëtarë: një president dhe dy zëvendës presidentë. Ata propozohen nga Presidenti i Republikës dhe emërohen nga Asambleja Kombëtare për një afat prej nëntë vjetësh, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve në një votim të fshehtë. Kryetari dhe dy nënkryetarët formojnë Senatin e Gjykatës së

Auditimit. Përveç anëtarëve, Gjykata e Auditimit ka gjithashtu deri në gjashtë auditues shtetërorë të lartë, të cilëve u ka dhënë statusin e zyrtarëve publikë. Ata emërohen nga kryetari i Gjykatës së Auditimit për një afat prej nëntë vjetësh. Gjykata e Auditimit ka edhe shërbime përkrahëse përveç shërbimeve të saj të auditimit. Ajo mund ti zgjedhë të gjithë punonjësit e saj në mënyrë të pavarur. Në vitin 2004, Gjykata e Auditimit krijoi një njësi në Maribor, që zbaton kontrollin mbi përdorimin e fondeve publike në Slloveninë verilindore. Arsimiti i pjesës më të madhe të punonjësve, është në fushën e ekonomisë dhe jurisprudencës, por ka edhe auditues nga fusha të tjera akademike. Gjykata mund të ftojë edhe ekspertë nga jashtë apo grupe ekspertësh të huaj, për të marrë pjesë në auditimet e tyre.

Ndikimi i punës së Gjykatës së Auditimit.

Gjykata e Auditimit lëshon një raport mbi auditimet e ndërmarra për përdoruesit e fondeve publike. Raporti i dorëzohet Asamblesë Kombëtare dhe subjektit të audituar si dhe publikohet në faqen e internetit të Gjykatës. Në këtë mënyrë, publiku informohet vazhdimisht për punën e Gjykatës. Në raportet e saj, Gjykata e Auditimit gjithashtu ofron edhe këshilla dhe rekomandime për përdoruesit e fondeve publike, me qëllim rritjen e përmirësimeve në operacionet financiare. Nëse gjatë auditimit janë evidentuar shkelje apo parregullsi, subjekti i audituar duhet të paraqesë një dëshmi mbi masat e ndërmarra për përmirësimin e parregullsive dhe operacioneve të tyre. Objektivi i Gjykatës së Auditimit është të ndihmojë institucionet të përmirësojnë operacionet e tyre duke kryer kontrole dhe konsultime. Në këtë mënyrë, operacionet e administratës publike janë përmirësuar dhe janë dhënë garanci që paratë për funksionimin e organeve shtetërore, institucioneve publike dhe qeverisjes vendore, të cilat janë mbledhur nga qytetarët në formën e taksave ose të kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj, janë përdorur si duhet, në përputhje me qëllimet e përcaktuara dhe me efikasitet. Gjykata e Auditimit shqyrton përdorimin e fondeve publike dhe vazhdimisht i raporton konstatimet e saj për publikun.

Bashkëpunimi me KLSH

Me këtë institucion, Kontrolli i Lartë i Shtetit shqiptar ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi më 25 prill 2012 në Ljubjanë të Sllovenisë. Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

e Llogarive e Sllovenisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në çertifikimin e deklaratave financiare.



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë përfaqësuar nga Presidenti Dr. dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari Dr. Bujar Leskaj
25 prill 2012 Ljubjanë, Slloveni

Gjatë muajit tetor 2012, 14 auditues të KLSH realizuan një javë trajnim për auditimin e performancës pranë zyrave të Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë në Ljubjanë.

Të dyja palet do të eksplorojnë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta, për të forcuar kapacitetet në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.



Kryetari i KLSH-së dr. Bujar Leskaj, priti delegacionin e Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë përfaqësuar nga Presidenti Dr. Igor Šoltes (i pari djathtash) me rastin e festimeve të 100-Vjetorit të Pavarësisë, Tiranë, 29 nëntor 2012.



Ish-Presidenti Bamir Topi me Kryetarët e delegacioneve të ftuara nga KLSH (nga e majta - z. Lars Lage Olofsson, z. Hiqmet Cavit Erdogan, z. Ivan Klešić, Dr. Igor Šoltes), Vlorë, 28 nëntor 2012



Presidenti i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë dhe Kryetari i KLSH me deputetët e Kuvendit z. Ditmir Bushati dhe z. Ilir Gjoni, Vlorë, 28 nëntor 2012

CURRICULUM VITAE

DR. IGOR ŠOLTES

President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë



Dr. Igor Šoltes u lind më 22 gusht 1964 në Lubjanë dhe u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Lubjanës në vitin 1991.

Në vitin 2004, Asambleja Kombëtare e zgjodhi atë kryetarin e Gjykatës së Auditimit të Republikës së Sllovenisë, pozitë të cilin ai e mori më 1 qershor 2004. Para kësaj detyre, Dr. Šoltes ka qenë Komisioner për

Qasje në Informatat Publike.

Dr. Igor Šoltes e filloi karrierën e tij në vitin 1992, në pozicionin e anëtarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të komunës së Lubjanës dhe Shef i Departamentit të Çështjeve Ekonomike në Njësinë Administrative të Lubjanës.

Nga viti 1994 deri në mes të vitit 2001, ai ka qenë edhe kryetar i Bordit të Fondit të Strehimit i të gjitha komunave të Ljubljanaës. Që nga qershori i vitit 2002, ai është anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Fondit të Strehimit, për qytetin e Lubjanës.

Në vitin 1997, ai u emërua anëtar i Komisionit Shqyrtues, me detyrën dhënien e vendime në procedurat e prokurimit publik, ku ai punoi kryesisht në fushën e administratës publike, ankesave dhe ligjin e prokurimit.

Për shkak të zhvillimeve në fushën e legjislacionit të prokurimit publik dhe ndryshimeve institucionale, Komisioni Shqyrtues u ristrukturuar në vitin 1999 dhe u quajt Komisioni Kombëtar Shqyrtues. Dr. Igor Šoltes ishte anëtar i saj deri në vitin 2001.

Në vitin 2001, Qeveria e Republikës së Sllovenisë e emëroi atë Drejtor të Zyrës së sapokrijuar të Prokurimit Publik, i cili ishte një organ qeveritar i ngarkuar me zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në shkallë kombëtare dhe zhvillimin e standardeve për përdorim efikas dhe efektiv të financave publike.

DRŽAVNI URED
ZA REVIZIJU



**Zyra Kombëtare e Auditimit
të Kroacisë**

Zyra Kombëtare e Auditimit (SAO) e Republikës së Kroacisë u krijua në 1994, në bazë të Ligjit të Auditimit Kombëtarë, më 30 Korrik 1993, amendimet në 1995, 1999, 2001 dhe 2004. Audituesi i parë i Përgjithshëm u caktua në Prill të 1994-ës për një periudhë tetë vjeçare. Ajo u rizgjodh përsëri në 2002-in për një mandate të dytë.

SAO ka rolin e Institucionit të Lartë të Auditimit në Kroaci, si përcaktohet në Ligjin e Auditimit Kombëtar. Ai ka arritur gjatë viteve një reputacion të mirë në Kroaci, i cili ka kontribuar për pozicionin e tij si një institucion i pavarur dhe i pakundërshtueshëm. Megjithatë, ky qëndrim, duke lënë mënjanë ekzistencën e tij, nuk është siguruar ende në Kushtetutën e Republikës së Kroacisë. SAO ka bërë disa kërkesa për këtë qëllim në të kaluarën, por është dashur një kohë e gjatë para se propozimi të merrej parasysh për ndryshimin e Kushtetutës në mënyrë që të sigurojë ekzistencën dhe pavarësinë e SAO-s. Si pjesë e një pakete të amendamenteve kushtetuese të përgatitura nga një komision i gjerë politikisht, i cili përfaqësonte parlamentin dhe qeverinë, ky ndryshim do të paraqitej në një të ardhme të afërt, me qëllim që të kishte kaluar para përfundimit të vitit 2009. SAO ka qenë i përfshirë në hartimin e tekstit të amendimit dhe është i kënaqur me rezultatin.

SAO ka një staf prej 280 personash, ku 232 prej të cilëve janë auditues të certifikuar shtetërore. Në zyrën qendrore të SAO-s, në Zagreb punojnë 94 persona dhe 186 të tjerë punojnë në 20 zyrat rajonale.

Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm është përgjegjës, mes të tjerash, për Shërbimin Ligjor, një shërbim i rëndësishëm mbështetës në kulturën ligjore kroate administrative. Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjithashtu përgjegjës për sigurimin e cilësisë, i raporton drejtpërdrejt Audituesit të Përgjithshëm.

Zyrat rajonale kanë numër të ndryshëm të personelit, duke filluar nga 6 në 15. Shpërndarja e zyrave rajonale ndjek strukturën administrative të Kroacisë. SAO është në dijeni të shpërndarjes së disavantazheve

ekonomike në vend, por pret rezultatin e debatit në lidhje me ristrukturimin e administratës territoriale në Kroaci para se të modifikojë strukturën e vet. Audituesi i Përgjithshëm, Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm dhe Audituesi Asistent i Përgjithshëm mblidhen çdo javë në një takim informal “kolegium”. Të paktën dy herë në vit zhvillohet një “kolegium” më i gjerë, duke përfshirë edhe krerët e zyrave rajonale. Krerët e zyrave rajonale kanë të njëjtin pozicion si drejtorët e departamenteve në zyrën qendrore. Një këshill ekspertësh, i përbërë nga “kolegumi” i vogël dhe shtatë ekspertë të jashtëm (profesorë universiteti, ekspertë me përvojë në auditim), është themeluar për të këshilluar SAO-n, më konkretisht në fushën e zhvillimit strategjik dhe në zbatimin e Planit Strategjik të SAO-s. Këshilli i ekspertëve mblidhet një herë në muaj, sipas rregullave të veta, por në praktikë ai i plotëson tre ose katër herë në vit, me kontakte intensive informale në mes të këtyre takimeve.

Kuadri Ligjor

Ligji për Kontrollin e Shtetit përcakton mandatin e SAO-së për auditimin e shpenzimeve publike dhe të ardhurat - më konkretisht, auditimin e pasqyrave financiare, transaksioneve të njësisve të qeverisjes lokale, rajonale dhe njësisve të vetëqeverisjes, personat juridik që janë pjesërisht ose tërësisht të financuar nga buxheti i ndërmarrjeve publike, kompanitë dhe personat e tjerë juridikë me pronësi në pjesën më të madhe nga ana e Republikës së Kroacisë apo njësisve të vetëqeverisjes lokale ose rajonale. Ligji i Kontrollit të Shtetit gjithashtu përcakton mandatin e SAO-s në kontrollin e përdorimit të fondeve të BE-së dhe atë të organizatave ndërkombëtare apo institucioneve, që duhet të përmbushin nevojat publike.

SAO duhet të kërkojë zgjidhje alternative për trajtimin e detyrave të saj të auditimit të detyrueshëm, të cilat janë zgjidhje shumë të rënda që shkojnë përtej një cikli trevjeçar për komunat më të vogla. Përveç forcimit të kontrollit të brendshëm të financave publike në nivel lokal, të cilat mund të lehtësojnë detyrën për SAO-n, duhet të merren në konsideratë zgjidhjet më radikale, që do të jenë për të vendosur një kufi monetar për përdorimin e audituesve të SAO dhe për komunat nën atë prag, auditimet t’i bëjnë qarqet përgjegjës për mbikëqyrjen financiare.

Struktura organizative dhe mënyra e funksionimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë janë të ngjashme me ato të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për këtë arsye është me interes njohja me ligjin e plote të SAI-t kroat, si më poshtë :

LIGJI MBI ZYRËN E AUDITIMIT TË KROACISË

(Gazeta Zyrtare Nr. 80/11)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, juridiksionin dhe administrimin e Zyrës së Auditimit të Shtetit, veprimtarinë dhe raportimin, detyrat dhe të drejtat e audituesve të autorizuar shtetërore dhe punonjësve të tjerë dhe bashkëpunimin e Zyrës së Auditimit të Shtetit dhe të organeve të tjera.

Neni 2

- (1) Zyra e Auditimit të Shtetit është organi me i larte i inspektimit ndaj institucioneve kroate që është autonom dhe i pavarur në punën e tij.*
- (2) Zyra e Auditimit të Shtetit menaxhohet nga Audituesi i Përgjithshëm*
- (3) Zyra e Auditimit të Shtetit është një person juridik.*
- (4) Selia e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Shtetit është në Zagreb.*

Neni 3

- (1) Financimi për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Shtetit sigurohet nga buxheti i shtetit të Republikës së Kroacisë.*
- (2) Zyra e Auditimit të Shtetit planifikon burimet e nevojshme për punën e saj, siç është përcaktuar nga Parlamenti në buxhetin e shtetit.*
- (3) Zyra e Auditimit të Shtetit mund të gjenerojë të ardhurat e saj duke kryer auditime të burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe marrë pjesë në projekte dhe programe ndërkombëtare.*
- (4) Të hyrat vetiake përdoren për të përmirësuar funksionimin e Zyrës së Auditimit të Shtetit.*

II. ORGANIZIMI I ZYRËS SË AUDITIMIT KOMBËTAR

Neni 4

- (1) Zyrat qendrore të Zyrës së Auditimit të Shtetit ndodhen në Zagreb ndërsa zyrat rajonale në qendrat e qarkut.*
- (2) Zyra Qendrore në Zagreb dhe zyrat rajonale veprojnë në të gjithë territorin kroat.*

Neni 5

Struktura e detajuar dhe funksionimi i Zyrës së Auditimit të Shtetit, do të rregullohet me Kushtetutë dhe aktet e tjera të brendshme normative, të miratuara nga Audituesi i Përgjithshëm.

III. JURIDIKSIONIN E SHTETIT TË AUDITIMIT

Neni 6

(1) subjekt i rishikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të shtetit, pasqyrave financiare dhe transaksioneve financiare të qeverisë, lokale dhe territoriale (rajonale) e vetë-qeveritare, subjektet juridike të cilat financohen nga buxheti, personat juridikë të themeluar nga Republika e Kroacisë ose qeveritë lokale (rajonale), kompanitë dhe subjektet e tjera në të cilat Republika e Kroacisë apo qeveritë lokale (rajonale) kanë pronësinë e shumicës së aksioneve, dhe përdorimin e Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ose institucioneve për financimin e nevojave publike.

(2) Njësitë e qeverisjes dhe njësitë e qeverive rajonale (lokale), në kuptim të këtij ligji, përfshin të gjitha degët legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe të gjitha agjencitë, institucionet dhe subjektet e tjera në nivel qendror dhe lokal të vetë-financuara nga buxheti i shtetit ose buxheti i lokal (rajonal) i vetë-qeverisjes.

(3) Raportet e auditimit për zbatimin e buxhetit të shtetit kryhet çdo vit, dhe raporti i auditimit paraqitet në Parlamentin kroat në muajin qershor.

Neni 7

(1) Një auditim, në kuptim të këtij ligji, përbëhet nga dokumentet gjyqësore, raportet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm, procedurat e kontabilitetit dhe ato financiare, dhe të dhëna të tjera që shërbejnë për të përcaktuar nëse pasqyrat financiare janë të vërteta dhe rezultatet e operacioneve financiare janë në përputhje me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit dhe Standartet.

(2) Një Auditim, është procesi i ekzaminimit të transaksioneve financiare në drejtim të përdorimit ligjor të fondeve.

(3) Një auditim përfshin gjithashtu një vlerësim të efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarive, si dhe një vlerësim të efektivitetit në arritjen e qëllimeve të biznesit dhe objektivave të transaksioneve individuale financiare, programeve dhe projekteve.

IV. MENAXHIMI KOMBËTAR

ZYRA E AUDITIMIT

Neni 8

(1) Zyra e Auditimit të Shtetit menaxhohet nga Audituesi i Përgjithshëm.

(2) Audituesi i Përgjithshëm emërohet nga Parlamenti kroat me opinionin e Komisionit për Financa dhe Buxhetin.

(3) *Audituesi i Përgjithshëm emërohet për një periudhë prej 8 vitesh, me mundësi riemërimi.*

(4) *Audituesi i Përgjithshëm mund të emërohet një qytetar kroat i cili ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare ose studime të integruara universitare dhe pasuniversitare ose ka një diplomë profesionale të fokusuar në ekonomi apo drejtësi, me dymbëdhjetë vjet përvojë profesionale dhe reputacion personal në fushën e financave publike.*

(5) *Audituesi i Përgjithshëm ka imunitet si përfaqësuesit në Parlamentin kroat.*

(6) *Audituesi i Përgjithshëm pas përfundimit të detyrës, ka të drejtë për pension sipas rregullave që rregullojnë të drejtën të dalin në pension në Parlamentin kroat.*

Neni 9

Audituesi i Përgjithshëm:

- *Organizon punën e Zyrës së Auditimit të Shtetit,*
- *Përfaqëson Zyrën e Auditimit të Shtetit,*
- *Miraton Statutet dhe aktet e tjera normative të brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Shtetit*
- *Ofron një plan strategjik për Zyrën Kombëtare të Auditimit,*
- *Miraton programin vjetor të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit,*
- *Raporton Parlamentit kroat për punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit*
- *Sugjeron Parlamentit kroat Zëvendës Audituesin e Përgjithshëm,*
- *Vendos mbi pranimin veprimtarinë dhe përfundimin e audituesve shtetërore të autorizuar*
- *Vendos ne lidhje me provimin për auditues shtetëror të certifikuar,*
- *Emëron një komision për të marrjen ne provim për auditues shtetëror të certifikuar*
- *Monitoron zbatimin të ligjeve dhe rregulloreve,*
- *Monitoron zbatimin dhe marrjen e masave për të siguruar efektivitetin e Zyrës së Auditimit të Shtetit.*

Neni 10

(1) *Parlamenti kroat shkarkon Audituesin e Përgjithshëm para skadimit të mandatit të tij*

- *Me kërkesë të tij,*
- *Nëse jepet pëlqimi për t'u emëruar në një zyrë tjetër,*
- *Nëse konstatohet që është përgjithmonë i paaftë për kryerjen e detyrave të tij, dhe*

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- Nëse ai dënohet për një vepër penale.

(2) Në qoftë se ndaj Audituesit të Përgjithshëm nis një procedim penal për një vepër penale që ndiqet kryesisht, dhe për të cilat parashikohet një dënim me burg prej 5 vjet ose më shumë, Audituesi i Përgjithshëm nuk mund të kryejë detyrat e tij deri në përfundim të kësaj procedure. Vendimi për pezullim jepet nga Parlamenti kroat.

Neni 11

(1) Audituesi i Përgjithshëm ka një zëvendës të caktuar nga Parlamenti kroat me propozimin e Audituesit të Shtetit, për një periudhë prej tetë vitesh.

(2) Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm mund të emërohet një shtetas kroat, i cili ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare ose studimet e integruara universitare dhe pasuniversitare me orientim ekonomik apo drejtësi, me tetë vjet përvojë profesionale dhe reputacion personal në fushën e financave publike.

(3) Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm, në rastin që zëvendëson Audituesin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij dhe të kryen detyrat e ngarkuara nga Audituesi i Përgjithshëm.

V. METODAT DHE RAPORTIMI

Neni 12

(1) Zyra e Auditimit të Shtetit planifikon dhe kryen auditimin në masën e dhënë në programet vjetore dhe planet e punës, si dhe kërkesat e Parlamentit kroat, nëse Audituesi i Përgjithshëm konstaton se këto kërkesa janë të justifikuara.

(2) Fusha e programit dhe planit vjetor të punës do të bazohet në:

- përcaktimet e këtij ligji,
- vlerësimin e riskut,
- rëndësinë financiare të subjektit të audituar,
- rezultatet e auditimeve të mëparshme,
- informacionin e mbledhur për subjektet e biznesit dhe auditimit
- kriteret e tjera që janë të përcaktuara nga aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

(3) Një auditim kryhet sipas mënyrës dhe procedurave të përcaktuara të standardeve të auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Kodin e Etikës Profesionale të Zyrës së Auditimit të Shtetit.

Neni 13

(1) Përfaqësuesi ligjor i subjektit të audituar, duhet ti sigurojë audituesit të autorizuar të gjithë dokumentacionin e plote të nevojshëm, dokumentet, raportet, rekordet dhe informacionet e tjera të nevojshme për qëllimin e auditimit.

(2) Përfaqësuesi ligjor i subjektit të audituar, duhet ti deklarojë audituesit të autorizuar dhe të vere në dispozicion dokumentacionin e një biznesi apo informacione të tjera konfidenciale të nevojshme për auditim.

(3) Dokumentacioni, raportet, shënimet dhe informacionet e tjera të referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, të marra gjatë auditimit mund të përdoren për të krijuar raporte rreth auditimit.

Neni 14

(1) Një auditues shtetëror i autorizuar përgatit një projekt-raport mbi auditimin në përputhje me standardet e auditimit të referuara në nenin 12 paragrafi 3 të këtij ligji.

(2) Projekt raporti i auditimit do t'i dorëzohet përfaqësuesit ligjor të subjektit të audituar.

(3) Përfaqësuesi ligjor i subjektit të audituar, brenda 8 ditësh nga dita e pranimit të draft raportit i paraqet Zyrës Kombëtare të Auditimit një deklaratë mbi faktet e përshkruara në projekt raport.

(4) Raporti mbi auditimin do të përfshijë deklaratimet e përfaqësuesit të subjektit të audituar.

(5) Raporti mbi auditimin mund të ankimohej brenda tetë ditëve nga dita e marrjes, nga përfaqësuesi ligjor i subjektit të audituar. Audituesi i Përgjithshëm vendos në lidhje me ankimin brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së ankimit.

(6) Përfaqësuesi ligjor i subjektit të audituar, brenda 60 ditëve nga marrja e raportit, dorëzon në Zyrën Kombëtare të Auditimit një deklaratë me shkrim për veprimet e marra në lidhje me gjetjet e auditimit.

Neni 15

(1) Audituesi i Përgjithshëm raporton në Parlamentin Kroat mbi punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit deri në fund të këtij viti për periudhën raportuese fillim 1 tetor të vitit paraardhës dhe përfundon më 30 shtator të vitit aktual.

(2) Pas raportimit në Kuvend, një raport mbi punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit në paragrafin 1 këtij neni, publikohet në faqen e internetit të Zyrës së Auditimit të Shtetit.

VI. AUDITUESIT KOMBËTARE

Neni 16

- (1) Auditimi kryer nga kontabilistë publik te certifikuar.*
- (2) Audituesi duhet te autorizohet nga Audituesi i Përgjithshëm, te jete një profesionist i pavarur i cili është një auditues i certifikuar publik dhe plotëson kërkesat e tjera të këtij ligji.*
- (3) Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, zyra e Auditimit te Shtetit mundet qe gjatë auditimit, për të adresuar pyetje specifike, te punësojë një ekspert të veçantë.*

Neni 17

- (1) Audituesit kombëtarë punësohen nëpërmjet një konkurimi publik. Për marrjen ne pune veprimtarinë dhe përfundimin e marrëdhënieve te punës te audituesve shtetërore te autorizuar vendos Audituesi i Përgjithshëm.*
- (2) Kandidati qe kërkon te pranohet si auditues shtetëror i certifikuar duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:*
 - *te jete shtetas kroat,*
 - *te ketë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare ose studime te integruara universitare dhe pasuniversitare ne fushën e ekonomisë, drejtësisë ose fusha te tjera të përshtatshme, dhe*
 - *nuk është dënuar për vepra penale.*
- (3) Kandidatët të cilët janë pranuar në postin e audituesit shtetëror te certifikuar duhet te kalojnë provimin dhe të certifikohen nga audituesi publik i autorizuar, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 18 këtij ligji.*

Neni 18

- (1) Provimi për auditues shtetëror të certifikuar do të kryhet duke u bazuar ne programin e provimit te miratuar nga Audituesi i Përgjithshëm.*
- (2) Kandidatet për te hyre ne provimin për auditues shtetëror te certifikuar duhet te kenë te paktën tre vjet eksperience profesionale.*
- (3) Një person i cili ka një përvojë pune për më shumë se tre vjet në profesion jashtë Zyrës së Auditimit të Shtetit, mund të pranohet të punojë në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me kusht që brenda 12 muajve nga marrja e punës të kaloje provimin për auditues shtetëror të certifikuar.*
- (4) Një punonjës që ka fituar eksperience sipas paragrafit 2 të këtij neni, ka kaluar provimin dhe ka siguruar certifikimin si auditues shtetëror i certifikuar, dhe plotëson kërkesat e tjera të nenit 17 te këtij ligji mund të caktohet në pozicionin e duhur.*

(5) *Provimi sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të kryhet përpara një komisioni të caktuar nga Audituesi i Përgjithshëm.*

(6) *Personit i cili e kalon provimin, i lëshohet një certifikate nga Audituesi i Përgjithshëm si auditues publik i certifikuar.*

Neni 19

(1) *Audituesi i certifikuar nuk mund të jetë anëtar i këshillit mbikëqyrës apo i entiteteve të tjera juridike, subjekte të auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.*

(2) *Audituesi i Certifikuar nuk auditon:*

- *në qoftë se është përfshirë në mbajtjen e rekordeve të biznesit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit të audituar,*
- *nëse si përfaqësues ligjorë i subjektit të audituar ose anëtar i bordit mbikëqyrës është bashkëshorti, një i afërm me lidhje gjaku direkte deri në shkallën e katërt, prindi adoptues, fëmija, prindi direkt i audituesit.*

Neni 20

(1) *Paga si auditues shtetëror i certifikuar paguhet në përputhje me një ligj të veçantë për pagat e audituesit shtetëror të autorizuar.*

(2) *Ne lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tjera të audituesve shtetërorë të autorizuar, zbatohen dispozitat në lidhje me nëpunësit civilë.*

VII. BASHKËPUNIMI ME ORGANET TJERA

Neni 21

Në kryerjen e detyrave të saj, Zyra Kombëtare e Auditimit punon me organet e tjera qeveritare, në një mënyrë që nuk vë në dyshim pavarësinë dhe autonominë e tyre.

Neni 22

Zyra e Auditimit të Shtetit mund të jetë anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve përgjegjëse për auditimin e jashtëm dhe fusha të tjera në juridiksionin e saj, si dhe të marre pjesë në punën e tyre dhe punën e organeve të tjera ndërkombëtare, në të cilën ajo do të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e Kroacisë.

VIII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 23

(1) *Një gjobë në shumë prej 20,000.00 deri në 50,000.00 kuna do të caktohet mbi njësinë e qeverisjes qendrore, njësite e qeverisjes lokale dhe territoriale apo ndaj personave të tjerë juridikë të cilët dështojnë në furnizimin ndaj audituesit shtetëror të certifikuar të dokumenteve, letrave,*

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

raporteve, rekordeve dhe informacioneve të tjera për qëllime të auditimit sipas nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 këtij ligji.

(2) Në rast se aktivitetet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni do të jenë për faj të përfaqësuesit ligjor, atëherë ai mund të gjobitet në shumën nga 5,000.00 deri në 10,000.00. kuna.

Bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit

Më datë 27 Nëntor në qytetin e Vlorës, Kryetari i KLSH z. Bujar Leskaj nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Presidentin e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, z. Ivan Klešić. Marrëveshja parashikon



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, përfaqësuar nga Audituesi i Përgjithshëm z. Ivan Klešić dhe KLSH përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, Vlorë, 27 nëntor 2012

shkëmbime eksperience mes dy SAI-ve në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në çertifikimin e deklaratave financiare. Të dyja institucionet po ashtu do të eksplorojnë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta, për të forcuar kapacitetet e tyre në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kroacisë

Para Monumentit të Pavarësisë me rastin e festimeve të 100-Vjetorit (nga e djathta Dr. Bujar Leskaj, Dr. Igor Šoltes, President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë dhe z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës), Vlorë, 28 nëntor 2012.



Me delegacionet e institucioneve të larta të auditimit të ardhura me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë, në zyrën e Kryetarit të KLSH, Tiranë, 29 nëntor 2012

CURRICULUM VITAE

IVAN KLEŠIĆ

PRESIDENT I ZYRES SHTETËRORE TË AUDITIMIT TË KROACISË



Auditori i Përgjithshëm është z. Ivan Klešić, i diplomuar si ekonomist, lindur më 17 tetor 1955 në Koritinja (Karlovac). Ai përfundoi studimet universitare dhe Master në Fakultetin Ekonomik në Zagreb. Përmes projektit të binjakëzimit “Përforcimi i kontrollit të jashtëm mbi buxhetin”, i cili u zhvillua së bashku me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kroacisë, ai fitoi certifikatat: Trajnues i Trajnerëve, Auditues i performancës, ACL, BE Auditimi i Anti-Mashtrimit Financiar dhe Korrupsionit, si dhe Auditimi Financiar. Pas diplomimit, ai ka punuar në ndërmarrjen “Automekanika Karlovac” në postin drejtorit të shitjes me pakicë dhe shumicë. Që nga viti 1991, ka punuar në Ministrinë e Brendshme, Departamenti i Policisë Karlovac, si shef i operacioneve të përbashkëta, ku shërbeu si drejtues i burimeve financiare, kontabilitetit dhe burimeve njerëzore. Që nga viti 1996 ka punuar në Zyrën Kombëtare të Auditimit si Shef i Zyrës Rajonale të Karlovac.

Si një pjesëmarrës në luftën e pavarësisë, z. Klešić fitoi statusin e mbrojtësve kroatë dhe u dekorua me medaljet “Vetëtima” dhe “Stuhia”. Ai është i martuar me dy fëmijë.



Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (NAO)

NAO është pjesë e pushtetit qendror të kontrollit të Parlamentit (Riksdag). Ai siguron që Parlamenti të marrë një auditim të koordinuar dhe të pavarur të financave shtetërore. Kjo detyrë është unike sepse, NAO është organi i vetëm që mund të kontrollojë të gjitha financat shtetërore.

Funksioni unik

NAO auditon të gjithë zinxhirin e pushtetit ekzekutiv si në aspektin financiar, ashtu dhe në atë të performancës. Ajo është një organizatë e pavarur nga ekzekutivi, nën mbikëqyrjen e Parlamentit dhe gjithashtu e pavarur edhe nga subjektet e audituara. Për më tepër, ajo kontribuon në zhvillimin e pushtetit të kontrollit parlamentar dhe të demokracisë së vendeve të tjera, nëpërmjet detyrave ndërkombëtare.

Fushat e veprimit

NAO Suedeze ka 4 detyra kryesore

Auditimi financiar

Në një auditim vjetor financiar, NAO auditon dhe vlerëson nëse pasqyrat financiare të autoriteteve qeveritare janë të besueshme dhe të sakta, në qoftë se llogaritë janë të vërteta dhe të drejta dhe nëse drejtuesit po zbatojnë detyrat dhe rregulloret e përcaktuara. Përveç autoriteteve qeveritare, Zyra Kombëtare e Auditimit auditon edhe organizata të caktuara të tilla si Fondi i Trashëgimisë Suedeze dhe ekonominë e Familjes Mbretërore, si dhe

kompani në të cilat shteti ka në pronësi të paktën pesëdhjetë për qind. Për më tepër, NAO auditon edhe raportin vjetor të qeverisë mbi operacionet shtetërore. Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, auditon rreth 250 pasqyra financiare.

Auditimi i performancës

Në një auditim performance, NAO auditon efikasitetin e autoriteteve qeveritare. Pikënisja e këtij auditimi është, se si subjekti ka arritur qëllimet e tij dhe përshtatshmëria e organizimit, operacioneve, proceseve dhe funksioneve. Qëllimi i auditimit është të sigurohet se shteti, në lidhje me interesat e publikut të gjerë, është duke marrë rezultatet më të mira nga përpjekjet e tij. Për shembull, një temë për shqyrtim mund të jetë planifikimi dhe organizimi i investimeve rrugore dhe hekurudhore. Një faktor i përbashkët për të gjitha auditimet e performancës, është se ata janë të bazuar në treguesit e problemeve dhe vlerësimet e riskut dhe materialitetit. Kjo do të thotë se auditimi drejtohet nga operacione të cilat rrezikojnë të mos përmbushin qëllimin, pra ato nuk janë kryer me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimet dhe Bashkëpunimet Ndërkombëtare

Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë përfaqëson Suedinë në kontekste ndërkombëtare të auditimit dhe me porosi të Parlamentit, punon për zhvillimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare me SAI-t e vendeve në zhvillim. Qëllimi i përfshirjes së NAO-s në aktivitete ndërkombëtare, është të mbështesë zhvillimin e organeve të pavarura të auditimit, të kontribuojë në zhvillimin demokratik dhe të forcojë pushtetin mbikëqyrës të parlamenteve në vende të ndryshme të botës. Aktualisht, ajo është përfshirë kryesisht në projekte me Afrikën dhe Evropën jug-lindore.

Operacionet globale

Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë bashkëpunon me Institucione të tjera Supreme të Auditimit nëpër botë, ndër të tjera edhe me INTOSAI-n duke shkëmbyer vazhdimisht përvoja me SAI-t anëtare. Për shumë vite, NAO ka kryesuar një grup pune ndërkombëtar, i cili ka zhvilluar udhëzime të pranuar globalisht, mbi auditimin financiar në sektorin publik, përdorimi i të cilëve rrit cilësinë dhe besueshmërinë në auditimin publik

në mbarë botën. Një detyrë tjetër e rëndësishme e NAO-s është të përhapë informacion mbi atë çka po bën dhe ku po shkon. Kjo gjë arrihet përmes dialogut me subjektet e audituara, por edhe përmes pjesëmarrjes në debate, shpërndarjen e informacioneve për median, pjesëmarrjen në seminare dhe konferenca, si dhe në mbajtjen e marrëdhënieve të mira me aktorë të ndryshëm.

Rezultatet e auditimeve Auditimi financiar

Përfundimet e auditimeve financiare, janë rezultat i shqyrtimit të raporteve mbi pasqyrat financiare të ndërmjetme, të cilat NAO ia paraqet qeverisë dhe subjektit të audituar. NAO gjithashtu, përgatit edhe raporte verbale për autoritetet dhe ministrinë përkatëse.

Auditimet e performancës

NAO publikon rreth 30 raporte auditime performance çdo vit të cilat ja paraqet Parlamentit dhe ky i fundit qeverisë, në formë deklarate. Brenda 4 muajve nga marrja e raportit, Qeveria duhet të paraqesë një raport të vetin me masat që ka marrë nisur nga gjetjet e auditimit. Pa shqyrtimit nga Komiteti i autorizuar, Parlamenti merr vendimet.

Raportet vjetore

Çdo vit, NAO harton raportin më të rëndësishëm, të cilin e quan Raporti Vjetor i Auditorit të Përgjithshëm dhe i cili përmban auditimet financiare dhe të performancës të të gjithë vitit. Këtë raport ajo ja paraqet Parlamentit. Në raportet pasuese, NAO ndjek se çfarë ka ndodhur me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna. Në Raportin Vjetor NAO jep edhe një vlerësim të plotë nëse i ka arritur qëllimet e përcaktuara për katër fushat e saj të funksionimit.

Drejtimi i Zyrës Kombëtare Suedeze të Auditimit

NAO është një autoritet i pavarur, nën mbikëqyrjen e parlamentit, i cili në bazë të ligjeve dhe rregulloreve vendos shtrirjen dhe fokusin e aktiviteteve të auditimit. Parlamenti gjithashtu, vendos për grantet vjetore të nevojshme që NAO të ushtrojë aktivitetin e saj dhe gjithashtu shqyrton ndarjen e burimeve në lidhje me rezultatet e paraqitura. Menaxhimi i lartë i organizatës (tre auditorët e përgjithshëm) emërohen nga Parlamenti.

Audituesit e Përgjithshëm

NAO drejtohet nga tre menaxherë të përgjithshëm, të cilët vendosin se si do të ndajnë fushat e auditimit mes tyre. Pas këtij vendimi, secili Auditues i Përgjithshëm, nën fushën e tij të përgjegjësisë, vendos vetë se cilat auditime do të kryejë, mënyrën se si do të kryejë dhe çfarë përfundimesh do të nxirren. Pavarësia e tre Audituesve të Përgjithshëm mbrohet nga Kushtetuta. Ata emërohen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Parlamenti emëron një Auditues të Përgjithshëm, si përgjegjës për menaxhimin administrativ të organizatës, që ka të bëjë me zbatimin e strukturës, mbikëqyrjen e granteve vjetore dhe vendimet lidhur me raportet vjetore.

Bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit

Në korrik të vitit 2012, me kërkesë të KLSH erdhi në Shqipëri një mision vlerësues nga NAO Suedeze, i përbërë nga z. Kameran Khudur, Drejtor i Auditimit dhe Kryemenaxher Projekti, nga zj. Johanna Gardmark, drejtuese e lartë e projekteve ndërkombëtare dhe nga z. Jan-Ake Nilsson, drejtor auditimi financiar”. KLSH është në pritje të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve.



Gjykata Holandeze e Auditimit

Informacion i përgjithshëm mbi Gjykatën Holandeze të Auditimit

Pozicioni i Gjykatës: Këshilli i Lartë i Shtetit.

Si një nga Këshillat e Lartë të Shtetit, Gjykata Holandeze e Auditimit është një organ qendror qeveritar, i krijuar për të siguruar funksionimin demokratik të sistemit. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga qeveria. Këshilla të tjerë të Lartë të shtetit janë:

- Senati
- Dhoma e Përfaqësuesve
- Këshilli i Shtetit
- Avokati i Popullit

Detyrat, kompetencat dhe statuti ligjor i kësaj Gjykate, janë përcaktuar nga Kushtetuta dhe nga vendimet qeveritare, Akti i vitit 2001.

Detyrat e Gjykatës së Auditimit

Gjykata e Auditimit heton nëse të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit qendror janë fituar dhe shpenzuar si duhet dhe nëse politika e pushtetit qendror është zbatuar sipas objektivave. Kjo gjykatë shpreh opinione

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

mbi politikën qeveritare që tashmë është miratuar, por nuk shpreh opinione politike, për shembull: nuk shprehet kurrë që një ligj është i gabuar. Megjithatë Gjykata mund të bëjë të ditur nëse një ligj nuk po funksionon sipas qëllimit. Mendimi politik i takon qeverisë ose Dhomës së Përfaqësuesve.

“Klientët e NAO-s” : Qeveria dhe Dhoma e Përfaqësuesve

“Konsumatorët” kryesor të kësaj Gjykate janë Qeveria dhe Dhoma e Përfaqësuesve. Detyra e saj është të informojmë parlamentin në mënyrë që ai të vendosë nëse politikat e një ministrie janë të efektshme. Kurdo që është e mundur, gjykata i përshtat detyrat e saj me kërkesat e Parlamentit. Ashtu si edhe ministrinë, ajo merr parasysh edhe auditimet nga zyra të tjera (lokale dhe ndërkombëtare), si dhe nga akademikët kryesorë nga radhët e klientëve.

Institucion i pavarur me një mendim ekspert

Gjykata e Auditimit është një institucion i pavarur, që do të thotë se e vendos vetë se çfarë do të auditohet. Shpesh, ajo merr kërkesa për të kryer auditime edhe nga anëtarët e parlamentit, ministrat dhe sekretarët shtetërorë që kanë nevojë për një mendim ekspertësh të pavarur mbi një çështje të caktuar, por, për shkak të pavarësisë ky nuk mund të jetë një urdhër. Në praktikë, zakonisht, gjykata i respekton kërkesat e bëra nga anëtarët e parlamentit apo qeverisë, nëse e vlerësojnë të arsyeshme. Ajo i përgjigjet me interes çdo sinjalizimi nga shoqëria, publiku, ndërmarrjet apo organizatat, madje ka raste kur mund të vendosë ti përfshijë edhe ata në auditim.

Bordi dhe stafi

- Anëtarët e Bordit: detyrat individuale, përgjegjësitë e përbashkëta
- Anëtarët e jashtëzakonshëm të Bordit
- Emërimi i Bordit
- Sekretari i Përgjithshëm në krye të stafit prej 300 vetash
- Stafi i Gjykatës së Auditimit: prejardhje të ndryshme dhe të arsimuar mirë

Anëtarët e Bordit: detyra individuale, përgjegjësi e përbashkët

Bordi i Gjykatës së Auditimit përbëhet nga tre anëtarë të cilët emërohen për jetë. Këshilli punon me parimin e përgjegjësisë së përbashkët. Kjo do të

thotë, se të gjitha vendimet janë marrë nga Bordi, jo vetëm nga presidenti i saj apo nga një anëtar individual i Bordit. Megjithatë, çdo anëtar i Bordit, vepron si raportues për pjesën tjetër të Gjykatës së auditimit.

Anëtarët e jashtëzakonshëm të Bordit

Përveç tre anëtarëve, Bordi ka edhe dy anëtarë të jashtëzakonshëm që mund të thirren për të marrë pjesë në aktivitete të caktuara. Atyre mund tu kërkohet për shembull, të mbikëqyrin auditimet, të kryejnë aktivitete të jashtme apo të përfaqësojnë një anëtar të Bordit. Nëse anëtarët e jashtëzakonshëm përfaqësojnë një anëtar të Bordit, ata kanë të njëjtat kompetenca me këtë të fundit.

Emërimi i Bordit

Për çdo vend vakant në Bord, Gjykata informon menjëherë Madhërinë e tij dhe Dhomën e Përfaqësuesve. Pas një procedurë aplikimi publike, Gjykata harton një listë të gjashtë kandidatëve, të cilët janë intervistuar nga Komisioni për shpenzimet e qeverisë. Më tej, me anë të një votimi të fshehtë, Dhoma e Përfaqësuesve bën një propozim për tre kandidatë. Dhoma e Përfaqësuesve nuk është e detyruar të pranojë rekomandime nga Gjykata e Auditimit. Anëtari i ri i Bordit emërohet me dekret mbretëror për një mandat për jetë (p.sh. 70 vjet)

Sekretari i Përgjithshëm në krye të stafit prej 300 vetash

Gjykata e Auditimit përmban edhe shërbimin e Sekretarit të Përgjithshëm, Ellen van Schoten, e cila është në krye të një stafi prej 300 vetash.

Stafi i Gjykatës së Auditimit: prejardhje të ndryshme dhe të arsimuar mirë

Duke pasur parasysh çështjet tepër komplekse me të cilat ka të bëjë Gjykata e Auditimit, duhet theksuar se 80% e stafit janë të arsimuar në universitet, apo në nivele të lartë profesionale. Dhe për shkak të larmisë së punës, stafi vjen nga fusha të ndryshme studimi si: administrata publike, sociologji, kontabilitet, shkenca politike, histori, gjuhësi, drejtësi dhe ekonomi.

Misioni

Gjykata Hollandeze e Auditimit synon të auditojë dhe të përmirësojë efektivitetin, rregullsinë, efikasitetin dhe integritetin me të cilat organet shtetërore dhe shoqëruese veprojnë. Gjithashtu ajo auditon përputhshmërinë

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

e detyrimeve hollandeze sipas marrëveshjeve të nënshkruara. Si pjesë e këtij procesi, Gjykata ja kalon rezultatet e auditimeve qeverisë, parlamentit dhe përgjegjësve për organet e audituara. Si rregull, ky rezultat është i disponueshëm edhe për publikun. Ai përbëhet nga gjetjet e auditimit, opinionet dhe rekomandimet lidhur me organizimin, menaxhimin dhe politikën.

Strategjia e Gjykatës Hollandeze të Auditimit për vitin 2010 – 2015

Efektivitet dhe transparencë

Objektivi i kësaj gjykate është të auditojë dhe të përmirësojë rregullsinë, efikasitetin, efektshmërinë dhe integritetin e qeverisë qendrore dhe të institucioneve që lidhen me të. Përveç kësaj, ajo ka për detyrë të kontribuojë për një qeverisje sa më të mirë duke shkëmbyer njohuri dhe duke punuar me të tjerët brenda dhe jashtë vendit.

Çfarë bën Gjykata e Auditimit

Gjykata e Auditimit heton nëse të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë qendrore janë fituar dhe shpenzuar si duhet dhe nëse politika e qeverisë qendrore është zbatuar sipas objektivave.

- Auditimet e rregullshmërisë

Ajo ka detyrë ligjore ti raportojë ministrive çdo vit. Auditimi mbi rregullsinë kontrollon nëse ministrat popërdorin paratë etaksavenë përputhjem rregullat.

- Auditimet Performancës

Ajo heton nëse politikat e Ministrave janë të efektshme: nëse objektivat sjellin rezultatet e synuara

Institucionet mbështetëse

Shumë detyra të rëndësishme ligjore janë kryer nga institucionet që mbështeten nga qeveria. Këto institucione kanë detyra publike, por nuk janë pjesë e qeverisë qendrore. Auditimi i personave juridikë me detyra ligjore konsiston në rregullshmërinë e politikave të ministrive si dhe në mbikëqyrjen e përgjegjësive të ministrave. Gjykata e Auditimit shkëmben mësimet e nxjerra nga këto auditime në mënyrë që të ndihmojë në përmirësimin e administratës publike.

Rrjedha e fondeve të BE-së

Çdo vit, Gjykata e Auditimit heton përdorimin e fondeve të BE-së për

Gjykata e Auditimit e Mbretërisë së Hollandës

Hollandën. Ajo gjithashtu kontrollon menaxhimin e këtyre fondeve, veçanërisht subvencionet bujqësore dhe paratë që BE-ja shpenzon për eliminimin e dallimeve strukturore ekonomike dhe sociale midis dhe brenda shteteve anëtare (fondet strukturore).

Raportet informuese të BE-së

Çdo vit ajo nxjerr raportin informues të BE-së, një pasqyrë e menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së në Hollandë. Raporti gjithashtu vlerëson zhvillimet në BE dhe situatën në shtetet e tjera anëtare. Me anë të Raportit, gjykata synon të përmirësojë menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në Hollandë dhe në Bashkimin Evropian.

Deklarata e shteteve anëtare të BE-së

Në vitin 2006 qeveria vendosi të lëshojë një deklaratë vjetore kombëtare për menaxhimin dhe përdorimin e fondeve të BE-së në Hollandë. Qëllimi i tij është të përmirësojë përgjegjshmërinë dhe kontrollin e fondeve që Holanda kontribuon dhe merr nga BE. Gjykata e Auditimit shpreh edhe një opinion mbi shpalljen e një shteti anëtar të BE-së dhe raporton për këtë gjë në Dhomën e Përfaqësuesve çdo vit.

Bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit

Ekspertët e Gjykatës holandeze kanë qenë aktivë në projektin e Binjakëzimit të KLSH, me fonde të projektit CARDS gjatë vitit 2008. Për arsye subjektive nga ana e KLSH, ky bashkëpunim u ndërpre për periudhën 2009-2011. Të dyja SAI-t, si Gjykata e Auditimit e Holandës dhe KLSH kanë shprehur interes për të ripërtëritur bashkëpunimin në projekte të reja në të ardhmen e afërt.



Nga ceremonia e përfundimit të binjakëzimit të KLSH (kryetari Robert Çeku) me NAO-n e Anglisë dhe Gjykatën Holandeze të Auditimit, në vitin 2008



TRIBUNAL DE CUENTAS



Gjykata Spanjolle e Llogarive

HYRJE

Gjykata e Llogarive është një organ kushtetues i shtetit, e parashikuar nga neni 136 dhe neni 153/d i Kushtetutës Spanjolle. Ajo ka një histori të pasur dhe të vjetër, e cila nis që prej shekullit të XVI-të. Në atë periudhë ky institucion quhej Zyra më e Lartë e Kontabilitetit të Llogarive. Po në këtë periudhë kohore filloi të përdorej edhe emri Gjykata e Zyrës më të Lartë të Kontabilitetit të Llogarive. Prej vitit 1828 emërtimi i këtij institucioni ndryshoi përfundimisht duke u quajtur Gjykata e Llogarive.

Me kushtetutën e vitit 1978 emërtimi i mësipërm u adoptua përfundimisht, duke respektuar dhe ruajtur traditën historike në të cilën zhvillimi i institucionit ishte rrënjësor. Në vitin 1982 u aprovua nga parlamenti spanjoll Ligji Organik 2/1982, i cili fiksonte aspektet rregullatore të këtij institucioni. Në vitin 1988 u aprovua një tjetër Ligj Organik 7/1988, i cili vendosi përfundimisht mënyrën e funksionimit të Gjykatës së Llogarive. Pra, Gjykata e Llogarive spanjolle, zhvillon aktivitetet e saj në bazë të dispozitave kushtetuese dhe në bazë të Ligjit Organik dhe Ligjit mbi Funksionimin e saj.

Tre instrumentet ligjorë të sapo cituar e quajnë atë si organi më i lartë i ngarkuar me kontrollin e llogarive dhe menaxhimin ekonomik-financiar të shtetit dhe të sektorit publik. Gjykata ushtron funksionet e saj pa hyrë në konflikt institucional me Organet e Kontrollit të Jashtëm të Komuniteteve

Autonome. Ajo bën pjesë në sferën e fuqisë legjislativë edhe pse nuk mund të thuhet që është një organ i vetë Parlamentit Kombëtar. Gjykata është e përbërë nga dymbëdhjetë anëtarë: gjashtë të zgjedhur nga Kongresi i Deputetëve (dhoma e ulët e parlamentit bikameral spanjoll) dhe gjashtë nga Senati. Anëtarët kanë të njëjtin status të gjykatësve dhe kryejnë dy funksione, të cilat janë funksioni auditues dhe funksioni juridiksional.

Funksioni auditues është i jashtëm, i përhershëm dhe përfundimtar. Nëpërmjet tij verifikohet nëse veprimtaria ekonomik-financiare e sektorit publik është në përputhje me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit dhe ekonomicitetit. Ajo i drejton Parlamentit dhe Asambleve Legjislativë të Komuniteteve Autonome rezultatet e auditimeve të saj. Pra, Gjykata e Llogarive ushtron një kontroll të jashtëm, brenda fushëveprimit të saj, si një organ teknik.

Funksioni ku ka autoritet është thjesht përndjekja e përgjegjësive se mbajtjes së llogarive financiare, e cila u takon atyre që merren me menaxhimin e pronës dhe fondeve publike. Nëpërmjet tij Gjykata synon të arrijë dëmshpërblimin e fondeve publike të dëmtuar si pasojë e përvetësimit, e justifikimit të pasaktë, ose jo të plotë të dëmit të shkaktuar, apo për shkaqe dhe sjellje të tjera.

Organizimi

Ligji Organik mbi Funksionimin e Gjykatës i ka dhënë asaj organizimin që vijon. Ajo përbëhet nga këto organe: Presidenti, Kolegji Plenar, Komisioni Qeveritar, Seksioni i Auditimit, Seksioni i Juridiksionit, Drejtorët e Llogarive, Prokuroria dhe Sekretariati i Përgjithshëm. Gjykata ka gjithashtu organe mbështetëse si dhe organe që punojnë në të njëjtën mënyrë, të cilët janë Kontrollori, Kabineti Teknik dhe Shërbimi Ligjor i Shtetit.

1. Presidenti

Mbreti emëron Presidentin e Gjykatës, sipas propozimit të Kolegjit Plenar për një periudhë tre vjeçare. Procedura përzgjedhëse zhvillohet nëpërmjet një votimi të fshehtë nga Drejtorët e Llogarive. Në rastet kur vendi është vakant, ose në raste mungese, sëmundjeje dhe çfarëdo lloji pengese ligjore tjetër. Presidenti zëvendësohet nga Presidentët e Seksionit të Auditimit ose të Juridiksionit. Në mungesë të këtyre, nga Drejtori i Llogarive më i madh në moshë. Presidenti përfaqëson Gjykatën, thërret dhe kryeson Kolegjin Plenar dhe Komisionin Qeveritar dhe ka fuqi të ushtrojë një votë

cilësuese në raste bllokimi të organeve të mësipërm. Ai, gjithashtu, drejton personelin e Gjykatës dhe vendos mbi shpenzimet dhe kontratat. Ushtron edhe kompetenca disiplinore në raste sjelljeje të rëndë nga ana e personelit.

2. Kolegji Plenar

Kolegji Plenar është i përbërë nga 12 Drejtorët e Llogarive, një nga të cilët është Presidenti dhe Prokurori. Ai mbledhet të paktën një herë çdo muaj. Që mbledhjet të quhen të vlefshme, të paktën 2/3 e anëtarëve duhet të jenë të pranishëm. Vendimet merren me mazhorancën e të pranishmëve, duke përjashtuar këtu ato raste kur me ligj kërkohet një mazhorancë e kualifikuar. Vendimet e Kolegjit janë të fshehta. Sekretari i Përgjithshëm vepron si sekretar i Kolegjit, me të drejtë fjale por pa të drejtën e votës. Ai mban procesverbalin, i cili pasqyron rezultatin e diskutimeve dhe marrëveshjet e arritura. Ushtrimi i funksionit të auditimit i përket Kolegjit, të cilit i përket gjithashtu zgjidhja e konflikteve të kompetencave midis organeve të tjerë të Gjykatës dhe ushtrimi i funksioneve të tjera të përcaktuara nga dy ligjet organike të sipërpërmendura. Sipas Ligjit mbi Funksionimin e Gjykatës, Kolegji Plenar: miraton programin e auditimeve të çdo viti; pranon fillimin e procedurave audituese; krijon udhëzimet teknike dhe përmbajtjen e tyre; miraton raportet, mocionet dhe vërejtjet; ka autoritet mbi çështjet e përgjegjësive së llogarive financiare, etj.

1. Komisioni Qeveritar

Komisioni është i përbërë nga Presidenti, Drejtorët e Llogarive dhe Presidentë Seksionesh, të cilët zgjidhen për një periudhë prej tre vjetësh, në të njëjtën mbledhje në të cilin zgjidhet dhe Presidenti, me të njëjtën procedurë. Funksionimit të Komisionit Qeveritar i aplikohen parimet e Kolegjit Plenar në lidhje me thirrjen, përbërjen, diskutimet dhe mbajtjen e procesverbalit. I përket Komisionit, mbajtja e marrëdhënieve të përhershme me Parlamentin nëpërmjet Komisionit Parlamentar të Përbashkët; ushtrimi në lidhje me personelin dhe regjimin e punës të funksioneve që nuk i përkasin Kolegjit Plenar ose Presidentit; përdorimi i dispozitave disiplinore në raste faji të rëndë; shpërndarja e çështjeve midis seksioneve dhe funksione të tjera të caktuara nga dy ligjet organike.

2. Seksioni i Auditimit

Seksioni i auditimit përbëhet nga Presidenti i tij dhe Drejtorët e Llogarive, të cilët janë përgjegjës për departamentet sektoriale dhe territoriale.

Organizimi i seksionit të auditimit në departamente sektoriale është bërë sipas fushave të aktivitetit ekonomiko-financiar të sektorit publik. Departamentet territorialë merren me auditimin e veprimtarive ekonomiko-financiare të Komuniteteve Autonome dhe Korporatave Lokale.

3. Seksioni i Ligjshmërisë

Seksioni i ligjshmërisë përbëhet nga Presidenti i tij dhe nga Drejtorët e Llogarive, të cilët – duke qenë se veprojnë si organ gjykues i shkallës së parë ose si organ i bashkërenditur me Dhomën ose Dhomat e Gjykatës – u përket njohja e procedurave gjyqësore. Çdo Dhomë Gjykuese përbëhet nga Presidenti (që është ai i seksionit) dhe nga Drejtorët. Gjithashtu përfshihen një ose më shumë sekretarë dhe stafi i Sekretariatit në ndihmë të shërbimit të kërkuar. I përket këtij seksioni përgatitja e Shënimeve të veprimeve gjyqësore të Gjykatës gjatë vitit përkatës financiar; hartimi i propozimeve të përshtatshme të drejtuara Kolegjit Plenar; dorëzimi i drejtuar Kolegjit të ndryshimeve që duhen ndërmarrë në strukturën e seksionit po ashtu si dhe krijimi i Dhomave të reja atëherë kur e kërkon numri i çështjeve; përcaktimi i kriterëve sipas të cilëve do të shpërndahen çështjet mes Dhomave dhe mes Drejtorëve të Seksionit Jurisdiksional.

4. Drejtorët e Llogarive

Drejtorët e Llogarive zgjidhen nga Parlamenti Spanjoll. Gjashtë prej tyre zgjidhen nga Kongresi i Deputetëve dhe gjashtë nga Senati sipas një votimi me mazhorancë 3/5 në çdo Dhomë Parlamentare, për një periudhë nëntë vjeçare, mes avokatëve, audituesve të Gjykatës, ekspertëve kontabël, prokurorëve dhe gjykatësve, profesorëve universitarë dhe funksionarëve publik që u përkasin atyre organeve për të cilët kërkohet një titull universitar i lartë. Ata janë të pavarur dhe të palëvizshëm dhe u nënshtrohen të njëjtave rregulla në lidhje me pamundësinë, papajtueshmërinë dhe pengesat që i aplikohen gjykatësve dhe prokurorëve në bazë të Ligjit Organik mbi Fuqinë Gjyqësore. Përgjegjësia civile apo penale me të cilën ata mund të ndeshen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre verifikohen në Dhomën përkatëse të Gjykatës Supreme, ndërsa dënimi disiplinor caktohet në bazë të Ligjit Organik mbi Funksionimin e Gjykatës. Presidenti dhe Drejtorët e Llogarive mbajnë postin e tyre deri në mbarim të mandatit.

5. Prokuroria

Prokuroria e Gjykatës së Llogarive, e cila varet drejt se drejti nga Prokuroria e Përgjithshme e Shtetit, është e përbërë nga prokurorët dhe avokatët

tatimorë. Prokurori emërohet nga qeveria sipas mënyrës së përcaktuar nga Statuti i Prokurorisë Publike. Funkcionet e Prokurorisë së Gjykatës janë: të japi mendim me shkrim në Llogaritë e Përgjithshme, raportet, mocionet dhe vërejtjet e Gjykatës, në lidhje me përgjegjësitë kontabile që mund të rezultojnë nga këto dokumente; të dëgjohet në procedimet e auditimit të Gjykatës para aprovimit përfundimtar dhe të kërkojë miratimin e masave që mendon të nevojshme në lidhje me korrigjimin e përgjegjësive kontabile që mund të rezultojnë nga vendimet e Gjykatës; të marrë në shqyrtim të gjitha procedurat mbikëqyrëse dhe gjyqësore që janë ndjekur nga Gjykatën me qëllim sqarimin e efekteve të mundshme të përgjegjësive të kontabilitetit që mund të lindin prej tyre.

6. Sekretariati i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm mbikëqyr të gjitha ato aktivitete që lejojnë ushtrimin e duhur të kompetencave qeveritare të Presidentit, Parlamentit dhe Komisionit të Qeverisë në të gjitha çështjet që lidhen me qeverisjen e brendshme të Gjykatës së Llogarive. Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet dhe largohet lirisht nga Kolegji Plenar në bazë të propozimit të Komisionit të Qeverisë. I përkasin Sekretariatit të Përgjithshëm funksionet e mësipërme si dhe menaxhimi, përpunimi, dokumentimi dhe regjistrimi i çështjeve në kompetencë të Presidentit, Kolegjit Plenar dhe Komisionit Qeveritar. Është i organizuar në Njësi Administrative, të cilat janë të nevojshme për të adresuar menaxhimin e çfarëdo lloji çështjeje dhe menaxhimin e çështjeve të përgjithshme qeveritare dhe të personelit në shërbim të gjykatës, ekonomike dhe buxhetore, të inspektimit dhe funksionimit të buxhetit, blerjeve dhe përvetësimeve, kompjuterizimit dhe përpunimit të të dhënave.

7. Organet Mbështetëse dhe Organet e Tjera

Përveç organeve të përshkruara më sipër, ka edhe organe të tjerë të cilët ushtrojnë funksioni kontrollues. Një prej tyre është Auditori i Gjykatës i cili zgjidhet dhe shkarkohet nga kolegji plenar i këtij organi. Një tjetër është Shërbimi Ligjor i Shtetit në Gjykatën e Llogarive i cili, duke qenë një organ këshillues në shërbim të Presidentit, të organeve kolegjalë të Gjykatës dhe të Presidentëve të Seksioneve, ka një Zyrë Teknike që varet organikisht nga Presidenti.

Funksionet e Gjykatës së Llogarive

Dy funksionet nëpërmjet të cilave Gjykata zhvillon kontrollin e saj të jashtëm të veprimtarisë ekonomiko-financiare të sektorit publik janë funksioni i auditimit dhe ai juridiksional.

Funksioni i Auditimit

Neni 136 i Kushtetutës Spanjolle e quan Gjykatën si organi më i lartë i auditimit të llogarive dhe i menaxhimit ekonomik të shtetit dhe sektorit publik. Po ashtu edhe neni 2 i Ligjit Organik të Gjykatës së Llogarive e cilëson funksionin e saj auditues si të jashtëm, të përhershëm dhe përfundimtar. Ky funksion ushtrohet nga Kolegji Plenar i Gjykatës. Funksioni i auditimit konkretisht zhvillohet nëpërmjet një sërë veprimesh që Gjykata kryen ku ushtron kompetencat e saj, të cilat i janë dhënë, sipas kushtetutës dhe ligjit, për të verifikuar nëse aktiviteti ekonomiko-financiar i sektorit publik është në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ekonomicitetit dhe efikasitetit dhe në lidhje me zbatimin e programeve të të ardhurave publike dhe shpenzimeve. Aktivitetet e auditimit të Gjykatës janë përcaktuar nga objektivat që duhet të plotësohen në verifikimin e parimeve të mësipërme. Në bazë të këtyre objektivave, mund të dallohet auditimi i pajtueshmërisë, auditimi i financiar, auditimi i sistemeve dhe procedurave operative dhe të kontrollit. Kontrolli operativ i veprimtarisë ka si qëllim vlerësimin tërësor ose të pjesshëm të menaxhimit ekonomiko-financiar të organit që po auditohet, gjithmonë duke u bazuar tek zbatimi i procedurave dhe tek përputhshmëria e tyre me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

Procedurat e Auditimit

Nëpërmjet procedurave të auditimit Gjykata ushtron funksionin e saj të kontrollit mbi gjithë sektorin publik. Këto janë të përcaktuara në Titullin IV të Ligjit Organik mbi Funksionimin e Gjykatës. Nisja e funksionit të auditimit i përket Gjykatës së Llogarive, Parlamentit Spanjoll, ose Asambleve Parlamentare të Komuniteteve Autonome për çështjet që bien brenda kompetencave të tyre. Neni 32/2 i ligjit të sapa përmendur thotë që Gjykata nuk pranon asnjë kërkesë tjetër për auditim nëse nuk vjen nga institucionet e mësipërm. Ushtrimi i funksionit të auditimit kryet sipas procedurave në vijim, të cilat janë të përcaktuara në nenin 31 të Ligjit Mbi

Funksionimin e Gjykatës:

1. Shqyrtimi dhe verifikimi i Llogarive të Përgjithshme të Shtetit;
2. Shqyrtimi dhe verifikimi i Llogarive të Përgjithshme dhe të Pjesshme të agjencive dhe organeve që bëjnë pjesë në sektorin publik dhe të atyre që kanë përfituar grante, subvencionime ose garanci;
3. Shqyrtimi i të dhënave që lidhen me kontratat e përfunduara nga Administrata e Shtetit dhe nga të tjera subjekte të sektorit publik;
4. Rishikimi i statusit dhe ndryshimet e aseteve shtetërore dhe subjekteve të tjerë të sektorit publik;
5. Shqyrtimi i dosjeve për ndarjet buxhetore të jashtëzakonshme dhe suplementare, si dhe shtesat, zgjerimet, transfertat dhe ndryshime të tjera të ndarjeve fillestare buxhetore;
6. Dhe çfarëdo lloj aktiviteti tjetër i përshtatshëm për ushtrimin e këtij kontrollit.

Konkretisht, ushtrimi i funksionit të auditimit kryhet falë Programit Vjetor të Auditimeve, miratimi i të cilit bëhet në Kolegjin Plenar të Gjykatës, siç parashikohet në nenin 3 a) të Ligjit Organik mbi Funksionimin e Gjykatës. Mbas aprovimit të Programit, çdo departament ndërmerr masat e nevojshme për vënien në punë të veprimtarive që do të realizojnë këtë program. Çdo departament harton edhe një Projekt Udhëzimesh Teknike i cili duhet të miratohet nga Kolegji Plenar i Gjykatës. Mbas këtij miratimi të mëtejshëm, departamentet e Gjykatës mund të fillojnë punën e tyre audituese. Procedimet audituese të Gjykatës mbyllen atëherë kur nuk ka më asnjë evidencë ose provë për çështjet në fjalë. Gjykata, në përfundim të procedurës, harton një Projekt Raport i cili përmban rezultatet e arritura nga auditimi ashtu si edhe vrojtimet dhe rekomandimet e saj. Projekt Raporti i dërgohet Prokurorit dhe Shërbimit Ligjor të Shtetit në Gjykatën e Llogarive, të cilët brenda 30 ditëve duhet të formulojnë mendimin e tyre në lidhje me përgjegjësitë e mundshme të kontabilitetit që rrjedhin nga procedura e auditimit. Projekt Raporti i nënshtrohet sërish gjykimit të Kolegjit Plenar i cili e rishikon sërish dhe procedon me referimin në Parlament ose në Asambletë Parlamentare të Komuniteteve Autonome mbi këtë Projekt Raport. Sa i përket procesit të shqyrtimit parlamentar të procedurave të auditimit, duhet të theksohet se Komiteti i Përbashkët i Kongresit dhe Senatit për marrëdhëniet me Gjykatën e Llogarive është organi parlamentar përgjegjës për dëgjimin dhe njohjen e rezultatit të aktiviteteve të auditimit. Raporti i auditimit i miratuar nga Kolegji Plenar

i Gjykatës, pas analizës nga ana e Komisionit të Përbashkët, sipas nenit 28/2 të Ligjit mbi Funkcionimin e Gjykatës, botohet në Gazetën Zyrtare, së bashku me rezolutat në këtë drejtim që Komisioni mund të ketë miratuar. Procedura të ngjashme parlamentare dhe botime në Fletoret Zyrtare të tyre përkatëse jepen ligjërisht për raportet në lidhje me rajonet apo subjektet që varen mbi ta.

Funksioni i ligjshmërisë

Përmbajtja, Karakteristikat, Qëndrueshmëria, Konfliktet dhe Ndihma Gjyqësore

Funksioni i gjykimit kontabël është një aktivitet që ka natyrë gjyqësore dhe që konsiston në gjykimin dhe zbatimin e gjykimeve në çështjet e mbajtjes së llogarive financiare. Ajo konsiston në aplikimin e standardeve ligjore në lidhje me aktet e kontabilitetit për të dhënë një gjykim përshtatshmërie, pra nëse ka apo jo përgjegjësi menaxheri i fondeve publike. Nëse jo, atëherë ai shfajësohet, në rast të kundërt ai dënohet dhe ekzekutimi i vendimit të Gjykatës është i detyrueshëm. Juridiksioni kontabël është karakterizuar si i nevojshme, i parevokueshëm, ekskluziv, i plotë dhe ushtrohet vetëm në lidhje me deklaratën e përgjegjësisë së mbajtjes së llogarive financiare dhe aspekteve të tjera të lidhura direkt me të. Ai përputhet me ushtrimin e fuqisë disiplinore dhe të juridiksionit penal. Kur ngjarjet përbëjnë vepër penale, përgjegjësia civile përcaktohet nga juridiksioni kontabël në fushën e tij të kompetencës dhe Gjykata Ordinare që do gjykojë mbi çështjen do të transferoj Gjykatës së Llogarive informatat e nevojshme në lidhje me shumën e dëmit të shkaktuar pronës ose fondeve publike. Nuk përfshihet në juridiksionin kontabël mbi çështjet që i përkasin Gjykatës Kushtetuese dhe shkallëve të ndryshme të juridiksionit të zakonshëm. Konfliktet që mund të lindin midis organeve të juridiksionit kontabël me administratën ose me juridiksionet e tjerë zgjidhen nga Ligji Organik mbi Konfliktet Jurisdikcionale. Organet e juridiksionit kontabël mund të kërkojnë ndihmën e Gjykatësve dhe Gjykatave të çfarëdo shkalle gjatë ushtrimit të funksioneve jurisdikcionale ashtu siç është përcaktuar në Ligjin Organik të Fuqisë Gjyqësore dhe Ligjin Procedural për Bashkëpunimin Gjyqësor.

Përgjegjësia e mbajtjes së llogarive

Ai punonjës që me veprimet ose mosveprimet e tij shkakton thyerjen e Ligjit dhe një dëmtim në të ardhurat publike është i detyruar të paguaj dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar. Përgjegjësia e mbajtjes së llogarive

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

mund të jetë e drejtpërdrejtë ose ndihmëse. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë është gjithmonë e përbashkët dhe përfshin të gjitha dëmet e shkaktuara. Përgjegjësia ndihmëse i kufizohet vetëm dëmeve të shkaktuar si pasojë e veprimtarisë së një individi. Ajo dhe mund të përcaktohet në bazë të arsyeshmërisë dhe paanshmërisë. Të dy llojet e përgjegjësive i kalojnë pasardhësve të atyre që janë përgjegjës në momentin e pranimit të shprehur ose të heshtur të trashëgimisë, por sipas mundësive ekonomike të tyre.

Organet që ushtrojnë Ligjshmërinë

Organet e përgjegjësive kontabile janë Drejtoritë e Llogarive dhe Dhomat e Seksioneve të Gjykatës së Llogarive. Drejtorive të Llogarive u takon: në një seancë të vetme njohja dhe gjykimi i të dhënave mbi anulimin e obligacioneve në rastet kur nuk ka pretendime për përgjegjësi kontabile; në shkallën e parë të gjyqimit, njohja e gjykimeve mbi llogaritë, mbi procedurat e rimëkëmbjes së defiçitit mbi procedurat e tjera të anulimit të obligacioneve. Dhomat e Seksioneve të Gjykatës së Llogarive merren kryesisht me apelet që formulohen në kundërshtim të rezolutave të administratës publike në lidhje me përgjegjësinë kontabile. Se dyti, ato merren edhe me ankesat kundër rezolutave të Drejtorive të Llogarive në procedimet mbi përgjegjësinë kontabile.

Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës

Vendimet e Gjykatës së Llogarive mund të ekzekutohen *ex officio* ose nëpërmjet kërkesës së palës së interesuar nga organi gjyqësor që ka dhënë vendimin sipas mënyrës së përcaktuar nga Kodi Civil. Pasi vendimi merr formë të prerë procedohet me ndarjen e shpenzimeve gjyqësore që bëhet në përputhje me dispozitat e përmbajtura në Kodin e Procedurës Civile.



Corte dei Conti



Gjykata e Llogarive e Italisë

1. Historiku

Gjykata e Llogarive e Republikës Italiane (*Corte dei Conti*) e ka origjinën e saj nga Dhoma e Llogarive e themeluar në 1351 nga Amedeo VI i Savoies.¹ Kësaj Dhome i nënshtroheshin të gjithë ata persona fizikë ose juridikë që kishin në dorë menaxhimin e pasurisë publike në tërësinë e saj. Ajo kishte formën e një magjistrature të pavarur, e cila përmbushte funksionin e saj kontrollues në mënyrë juridiksionale² mbi mosmarrëveshjet që rridhnin midis: mbledhjes së taksave dhe pasurisë dukale; kontabilitetit të zyrtarëve publikë dhe tërheqjes së drejtpërdrejtë të taksave nga këta zyrtarë. Edhe pse origjina e kësaj Dhome është e hershme, ajo nuk është organi shtetëror më i vjetër në Evropë me të tilla funksione. Më të vjetëra akoma janë te ashtu quajturat Dhomat e Llogarive franceze³ - ose më mirë të themi *Les Chambres des Comptes de Paris* - të themeluara në 1256 nga Luigji IX.⁴ Ky organ është parardhësi i drejtpërdrejtë i

1 Në italisht ky institucion quhej *Camera dei Conti* dhe kishte kompetencë territoriale të kufizuar në Dukatin e Savoies.

2 Juridiksionale në këtë tekst do të përdoret në kuptimin latin të fjalës e cila rrjedh nga *ius dicere*. *Ius dicere* në drejtësinë romake ka dy kuptime. Në radhë të parë, nën një pamje objektive përshkuan funksionin juridiksional i cili konsiston në aplikimin e ligjeve dhe interpretimin e tyre në raste konkrete nga një person i tretë – gjykatësi – i cili është i pavarur nga antagonistët e çështjes për të cilën po gjykon ose do gjykoj. Nën një kuptim subjektiv, kjo frazë shërben për të identifikuar organet përkatëse që ushtrojnë funksionin juridiksional, pra pushteti gjyqësor.

3 Në frëngjisht ky lloj institucioni shtetëror quhej: *Les Chambres des Comptes*.

4 Ky institucion lindi si përgjigje ndaj nevojave për të kontrolluar arkëtimet dhe shpenzimet e monarkisë në një kohë kur akoma nuk ishte konsoliduar ideja e një kontrolli të mirëfilltë

Gjykatës së Llogarive Franceze të themeluar me ligjin e 16 shtatorit 1807 gjatë periudhës së Napoleonit. Më vonë, mbas okupimit francez në Italinë e veriut, rreth vitit 1577 Emanuele Filiberto i Savojës vendosi krijimin e një Dhome të re të Llogarive, e cila përfshiu dhe përqendroi funksionet e organit të mëparshëm. Me kalimin e kohës, me zhvillimin e vazhdueshëm të instituteve shtetërorë savojarde⁵ dhe me shumëfishimin e funksioneve të tyre lindi nevoja për krijimin e një organi të ngjashëm, por me një artikulum më të kompletuar të aktiviteteve kontrolluese. Për këto arsye me ligjin e 30 tetorit 1859 nr. 3706, u themelua Gjykata e re e Llogarive, e cila kishte, ndër të tjera, edhe kompetencë mbi kontrollin paraprak të llogarive shtetërore.

Menjëherë mbas bashkimit të Italisë dhe krijimit të Mbretërisë Italiane, parlamenti i shtetit të sapo formuar u angazhua në redaktimin e një projekt ligji i cili duhet të bashkonte me Gjykatën e Llogarive të vitit 1859 organet e tjerë analogë, si për shembull: Dhoma e Llogarive të Shtetit të Sardenjës me seli në Torino; Gjykata e Llogarive të Dukatit të Madh të Toskanës me seli në Firence; Dhoma e Madhe e Llogarive së Mbretërisë së dy Siçilive me seli në Napoli dhe Palermo.

Në 1862 u themelua Gjykata e Llogarive me ligjin e datës 14 gusht 1862, nr. 800 si magjistratura e parë e Italisë së bashkuar.

2. Bazat Ligjore

Në periudhën kohore që shkon nga themelimi i saj në lindjen e Republikës së Italisë bazat ligjore, funksionet dhe organizimi i përgjithshëm i Gjykatës së Llogarive mbeti pjesërisht i pandryshuar. Me miratimin e Kushtetutës së re të Republikës së Italisë në 1947 dhe hyrjen në fuqi në 1948, ky organ futet si pjesë themelore e arkitekturës institucionale. Bazat e saj ligjore, në radhë të parë, ndodhen në artikullin 100 të Kushtetutës Italiane seksioni III i titulluar: “Organet Ndihmës”. Sipas këtij artikulli Gjykata ushtron një kontroll paraprak mbi ligjshmërinë e akteve të qeverisë; një kontroll të mëvonshëm mbi menaxhimin e bilancit të shtetit; se fundi merr pjesë në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji në kontrollin e menaxhimit financiar të atyre subjekteve privatë ose shtetëror për të cilët shteti derdh kontribute të drejtpërdrejta. Gjykata raporton në parlament periodikisht mbi rezultatet e fituara nga kontrollet e ushtruara.

në këtë fushë. Gjithsesi ato kishin një juridiksion të pavarur për sa i përket kontrolleve financiare.

5 “Savojarde” në këtë tekst është mbiemër që i referohet Mbretërisë të Savoies me kryeqytet Torinon. Pra quheshin në këtë mënyrë organet shtetërore të kësaj mbretërie.

Së dyti, në bazë të artikullit 103/koma II, Titulli IV seksioni II me emrin “Rendi Juridiksional”, Gjykata ka juridiksion mbi çështjet e kontabilitetit publik dhe mbi çështjet e tjera të përkufizuara nga ligji.

Pra rrjedh se ky organ paraqet dy fytyra funksionale. Në një pamje është organ ndihmës, në kuptimin që jep ndihmën e saj organeve që kanë në dorë fuqinë legjislativë dhe administrative të shtetit duke ushtruar funksionet e saj kontrolluese të përkufizuara nga art. 100 i kushtetutës. Në pamje të dytë Gjykata e Llogarive cilësohet si organ gjykues i cili bën plotësisht dhe paralelisht pjesë në rendin gjyqësor të shtetit italian.

2.1. Neutraliteti, Autonomia dhe Pavarësia e Gjykatës së Llogarive

Në ushtrimin e funksioneve të saj, kontrolluese apo gjyqësore, Gjykata vepron si një organ neutral, autonom dhe i pavarur në marrëdhëniet e saj me pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ. Neutraliteti i Gjykatës shpaloset gjatë ushtrimit të funksioneve ndihmëse. Ajo nuk zëvendëson organet në ushtrimin e kompetencave përkatëse, por jep një vlerësim mbi aksionet e ndërmarra nga këto organe në kuadrin e administrimit të mirë të shtetit. Ndër të tjera ajo formulon mendime, përcakton masat që duhem marrë nga organet shtetërore dhe verifikon së fundi nëse organet e kontrolluara i janë pershtatur vrotjimeve të Gjykatës. Për të gjitha këto raporton në Parlament. Në këtë mënyrë ajo vepron si një organ i tretë, neutral, nga parlamenti dhe qeveria, por gjithmonë në interesin e vetë organeve shtetërore, po ashtu si edhe në interesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve taksapagues.

Autonomia edhe pavarësia e Gjykatës vihet re në faktin që ajo ka kompetencë të ushtrorë një kontroll paraprak mbi ligjshmërinë e akteve parlamentare apo ekzekutive. Në ato raste kur këto akte rezultojnë të pa ligjshme, atëherë atyre u anulohen efektet juridike. Gjithsesi ekziston mundësia që - për arsye të rëndësishme të rendit politik – qeveria të bëjë një regjistrim me rezervë të ligjit⁶ të deklaruar të paligjshëm nga Gjykata e Llogarive. Ky lloj regjistrimi duhet të ketë një kohëzgjatje të kufizuar dhe për këtë qeveria duhet të raportojë në mënyrë të menjëhershme në parlament.

Rezultatet e kontroleve të ushtruara nga Gjykata dhe gjykimet e saj në çështje të veçanta janë gjithmonë publike për te ngritur sensibilitetin dhe

6 E ashtu quajtura “*registrazione con riserva*” i lejon qeverisë të regjistrojë ligjin e aprovuar në regjistrin kombëtar të ligjeve. Në këtë mënyrë ligji bëhet efektiv dhe prodhon efekte juridike në vend. Gjithsesi ky lloj regjistrimi nuk e pengon Gjykatën në funksionin e saj kontrollues. Pra ajo do të vazhdojë ti quaj efektet e atij ligji të papërpunshme *ex post*, deri sa ky ligj të zëvendësohet.

pergjegjësine e administruesve dhe funksionarëve publikë.

Gjykata e Llogarive paraqet profile të tjerë pavarësie dhe autonomie për sa i përket mënyrës së zgjedhjes së kokave institucionale të saj si edhe në lidhje me procedurat e rekrutimit të magjistratëve kontabël, të cilët zgjidhen nëpërmjet konkurseve publikë dhe në bazë të titujve universitarë. Për shembull në bazë të ligjit 21 korrik 2000 nr. 202, Presidenti i Gjykatës së Llogarive duhet të jetë një nga magjistratët e vetë Gjykatës që ka ushtruar të paktën për tre vjet: funksionin e Presidentit të një Seksioni të Gjykatës; funksione analoge në organe kushtetuese kombëtare, ose organe të Bashkimit Europian. Emërimi i Presidentit bëhet me Dekret të Presidentit të Republikës, mbas propozimit të Kryeministrit, i cili ka marrë mendimin e Këshillit të Presidencës së Gjykatës.

Elementë të tjerë që përforcojnë karakterin e pavarur janë edhe: palëvizshmëria e magjistratëve, rëndësia themelore e mendimit të Këshillit të Presidencës në zgjedhjen e Presidentit të Gjykatës, autonomia financiare dhe organizative.

3. Struktura Funksionale dhe Organizative

Rendi aktual funksional dhe organizativ i Gjykatës së Llogarive lind si pasojë e aprovimit të Tekstit të Përgjithshëm nr. 1214/34⁷ i modifikuar dhe integruar nga ligjet nr. 161/53, nr. 1345/61, nr. 259/58.

Në bazë të ligjeve të mësipërm Gjykata e Llogarive përbëhet nga dy kategori funksionarësh. Në rradhë të parë kemi ata funksionarë që cilesohen si magjistratë. Këta janë Presidenti, Prokurori i Përgjithshëm, Presidentët e Seksioneve, Referendarët e Parë, Referendarët, Këshilltarët. Magjistratët mbajnë këtë titull në cfarëdo lloj funksioni që ata ushtrojnë, si në auditim ashtu edhe në juridiksion sepse mandati i tyre është përmbledhës i të dy funksioneve të Gjykatës.

Së dyti, kemi personelin teknik dhe administrativ numri i të cilëve në 2009 arrinte në 2487⁸ dhe që kanë detyra administrative. Në krye të aparatit administrativ të Gjykatës qëndron një magjistrat i cili quhet Sekretari i Përgjithshëm. Anëtarët e magjistraturës zgjidhen në menytrat që vijojnë. Presidenti i Gjykatës, mbas emërimit - që kemi përshkruar në paragrafin nr. 2 - ka një mandat të pa kthyeshem. Pra ai nuk mund te hiqet nga posti i tij

7 Testo Unico (T.U.) n. 1214/34 aprovuar me Dekret të Mbretit në vitin 1934 gjatë Regjimit Fashist.

8 Të dhënat shifrore janë marrë nga faqja zyrtare e internetit te Gjykatës së Llogarive.

për asnjë arsye, veçse në rastet kur mandati i tij mbaron për shkak të moshës ose kur vendos vetë të japë dorëheqjen. Me ligjin n. 45, të vitit 2004 është krijuar figura e Ndhmës Presidentit⁹. Prokurori i Përgjithshëm emërohet me Dekret të Presidentit të Republikës në baze të propozimit të Kryeministrit, i cili bazohet në emërimet e Këshillit të Presidencës së Gjykatës. Mund të bëhet Prokuror i Përgjithshëm çdo magjistrat që mban titullin President Seksioni. Me ligjin nr. 45, të vitit 2004 është shtuar figura e Ndhmës Prokurorit. Magjistratët e tjerë që kompletojnë kuadrin institucional të gjykatës rekrutohen nëpërmjet konkurseve publike. Parashikohet edhe mundësia për qeverinë që të emërojë një kuotë këshilltarësh të Gjykatës, mbasi ka kërkuar mendimin paraprak të Këshillit të Presidencës. Mbas emërimit, ata marrin të njëjtin status të magjistratëve të tjerë dhe ushtrojnë funksionet e tyre në pavarësi të plotë nga ekzekutivi. Aktualisht, Gjykata e Llogarive ka 1 President, 1 Ndhmës President, 1 Këshill të Presidencës, 1 Prokuror të Përgjithshëm, 1 Ndhmës Prokuror, 1 Sekretar të Përgjithshëm. Ka edhe 62 President Seksionesh, 310 Këshilltare, 68 Referendarë të Parë, 51 Referendarë. Për sa i përket strukturës organike, mund të themi se Gjykata është e organizuar në: organe primarë; organe qëndrorë; organe rajonalë¹⁰ ose periferikë.

Organet primarë janë Presidenti, Ndhmës Presidenti, Prokurori i Përgjithshëm, Ndhmës Prokurori, Sekretari i Përgjithshëm dhe Këshilli i Presidencës. Në veçanti ky i fundit përbëhet nga 11 anëtarë, ndër të cilët Presidenti që drejton mbledhjet e tij, Ndhmës Presidenti, Prokurori i Përgjithshëm, 4 përfaqësues të parlamentit, 4 magjistratë të zgjedhur nga magjistratët e Gjykatës. Në mbledhjet e Këshillit mund të marrin pjesë Sekretari i Përgjithshëm dhe magjistrati që është zyrtari kryesor i kabinetit të Presidencës. Organet qëndrorë dhe rajonalë janë të organizuar në seksione kontrolli, juridiksioni dhe prokure.

Seksionet e kontrollit janë qëndrorë dhe periferikë.

Seksionet qëndrorë që ushtrojnë funksione auditimi janë:

9 Në italisht, *Presidente Aggiunto*.

10 Në këtë kontekst fjala rajonalë i referohet atyre uniteteve territoriale dhe administrative që në rendin organizativ të shtetit Italian quhen “*Regioni*”. Duhet kujtuar këtu që shteti Italian në 15 vitet e fundit ka ndërmarrë një proces decentralizimi – duke modifikuar artikullin 117 të Kushtetutës – që e ka çuar vendin drejt federalizmit, ose më mirë rexhionalizmit (Spanja ka një rend organizativ të ngjashëm dhe bashkë me Italinë hyn në ato shtete që quhen “*quasi federali*” ose “*Stati Regionali*”). Fjala shqipe krahinë, nuk mund të jetë e përshtatshme në këtë kontekst sepse ka vetëm një kuptim gjeografik. Fjaqa qark, po ashtu nuk është e përshtatshme sepse është karakteristike e një vendi ku rendi organizativ është i përqëndruar, pra jo federalist.

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- Seksionet e bashkuara janë një *corpus* unitarë që mbidhet si për arsye konsultimi dhe kontrollimi. Në të dy rastet ky organ merret me gjykimet mbi çështjet primare dhe konfliktet e kompetencave.
- Seksionet qendrorë të kontrollit të ligjshmërisë së akteve qeveritare dhe administratës shtetërore (përbëhen nga 5 zyra qendrore me detyra auditimi për sa i përket Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës, Ministrisë për Aktivitetet Prodhuese, Ministrisë së Infrastrukturave, Menaxhimit të Territorit, Ministrisë që merret me shërbimet ndaj individit dhe mbrojtjen e pasurive kulturore).
- Seksioni qendror i kontrollit mbi menaxhimin e administratës shtetërore i cili përbëhet nga 5 zyra qendrore, te cituara me sipër
- Seksioni qendror i kontrollit të personave fizikë dhe juridikë për të cilët shteti derdh kontribute të drejtpërdrejta (në bazë të ligjit nr. 259/58)
- Seksioni i Autonomive Rajonale, i cili referon në parlament çdo vit mbi mbarëvajtjen e përgjithshme të financave rajonale dhe vendore duke u bazuar tek Pakti i Stabilitetit të Brendshëm dhe tek detyrimet që lindin nga pjesëmarrja e Italisë në Bashkimin Europian.
- Seksioni i kontrollit mbi çështjet komunitare dhe ndërkombëtare i cili referon çdo vit në parlament mbi menaxhimin e fondeve strukturore europiane, mbi përdorimin e financimeve nga programe të tjerë komunitarë, etj.

Seksionet periferikë me funksione kontrolluese janë:

- 21 Seksionet Rajonale të kontrollit aq sa janë edhe krahinat rajonale italiane. Ato ushtrojnë kontrollin e ligjshmërisë së akteve; kontrollin mbi menaxhimin e administratës shtetërore në rajon; verifikojnë funksionimin e mirë të kontrolleve brenda çdo administrate shtetërore me seli në rajon; ushtrojnë një kontroll të detajuar mbi menaxhimin e administratë rajonale dhe subjekteve të saj dhe referojnë për këtë në Këshillet Rajonale; ushtrojnë së fundi edhe kontroll mbi subjektet vendorë, mbi universitetet dhe institutet publike në vend.

Seksionet që ushtrojnë funksione juridiksionale janë po ashtu qendrorë dhe rajonalë.

Seksionet qendrorë janë:

- Seksionet juridiksionale qendrorë të apelit, me seli në Romë, janë 3 dhe veprojnë si gjykatë e shkallës së dytë
- Seksioni juridiksional i Rajonit të Siçilisë me seli në Palermo

- Seksionet e bashkuara juridiksionale të cilat merren me zgjidhjen e konflikteve të kompetencave midis seksioneve rajonalë dhe/ose qëndrorë.

Seksionet Rajonalë janë.

- 21 Seksione rajonalë juridiksionale dhe kanë seli në çdo kryeqytet rajoni. Përveç këtyre ka edhe një seksion rajonal për provincën autonome të Bolzanos, Prokuroria e Gjykatës së Llogarive është e organizuar në menyrën e sqaruar ne vijim. Kemi një Prokuror dhe Prokurori të Përgjithshme me seli ne Romë. Kemi po ashtu edhe një Prokurë ne Seksionin juridiksional të Rajonit të Siçilisë. Së fundi kemi Prokurat rajonale në çdo seksion rajonal juridiksional.

4. Funkzionet

Gjykata e Llogarive ka funksione kontrolluese sipas artikullit 100 të Kushtetutës Italiane, juridiksionale në çeshtjet e kontabilitetit publik dhe në çeshtje të tjera të parashikuara me ligj sipas artikullit 103.

Ajo ka gjithashtu edhe funksione: administrative në rastet kur adopton masa në lidhje me statusin ekonomik apo juridik të punonjësve të saj; konsultuese kur jep mendime qeverisë ose ministrave në lidhje me aktet e tyre normativë ose kur jep mendime në lidhje me kontabilitetin publik mbas kërkesave të rajoneve, komunave, provincave apo qyteteve.

4.1. Funksionet Kontrolluese

Funksionet kontrolluese së Gjykatë së Llogarive janë të shprehura në artikullin 100 të Kushtetutës italiane. Këto janë:

- kontrolli paraprak i ligjshmërisë së akteve të qeverisë
- kontrolli i mëvonshëm mbi menaxhimin e bilancit të shtetit
- kontrolli ekonomik – financiar me detyrë raportimin në Parlament.

Pranë këtyre janë shtuar me kalimin e kohës edhe funksione të tjera të parashikuar nga ligji, të cilat gjejnë bazë ligjshmërie në:

- art. 97 të Kushtetutës që përmban principin e ecurisë së mirë të administratës publike
- art. 81 mbi respektin e ekuilibrit të bilancit shtetëror
- art. 119 mbi nevojën për bashkërendim dhe harmonizim të financës publike.

Në përgjithësi mund të thuhet se tre llojet e kontroleve nën artikullin 100

janë ato më të rëndësishmet. Së pari, kontrolli paraprak i ligjshmërisë së akteve të qeverisë shërben për të verifikuar nëse aktet e ekzekutivit përputhen dhe respektojnë normat që përmbahen nga ligjet e shtetit në përgjithësi dhe nga ligjet financiare në veçanti. Fillimisht ky lloj kontrolli aplikohet tek të gjitha aktet e prodhuara si nga ekzekutivi dhe nga administrata publike në tërësi. Me ligjin e reformës nr. 20 të 1994 ky lloj kontrolli është kufizuar vetëm për aktet më të rëndësishëm që janë: kontratat financiare që parashikojnë shuma të mëdha; masat e marra mbas vendimeve të Këshillit të Ministrave; rregulloret; aktet me natyrë programuese; aktet me natyrë të përgjithshme dhe abstrakte si dhe ato akte që përmbajnë masa të ndërlikuara në lidhje me aktivitetet menaxhuese.

Pra nëpërmjet këtij kontrolli Gjykata vepron si organ garantues i rendit të kushtetuar duke verifikuar *ex ante* konformitetin e akteve me kushtetutën dhe ligjet. Në veçanti, nga viti 1976, Gjykata Kushtetuese Italiane i ka njohur aftësinë Gjykatës së Llogarive ti drejtohet asaj – gjatë zhvillimit të zakonshëm të procedurës kontrolluese paraprake – për të verifikuar në qoftë se ka dhunim të artikullit 81 të Kushtetutës. Në këtë rast të jashtëzakonshëm funksioni kontrollues paraprak shkrihet me atë juridiksional.

Për sa i përket kontrollit të mëvonshëm mbi menaxhimin e bilancit të shtetit, ligji nr. 20 i 1994 - duke përjashtuar një sasi të madhe aktesh nga kontrolli paraprak - i ka dhënë Gjykatës kompetencat e duhura për të ushtruar kontrollin e mëvonshëm mbi tërësinë e administratës publike qendrore, rajonale dhe vendore. Në këtë mënyrë Gjykata verifikon dhe vlerëson *ex post* nëse rezultatet e menaxhimit përputhen me objektivat programues të administratës, me efektivitetin dhe ekonomikitetin e veprimtarisë administrative.

Duhet vënë në dukje se kontrolli i mëvonshëm nuk i drejtohet vetëm normave juridike, por menaxhimit të bilancit në kuptimin më të gjerë të fjalës. Në bazë të ligjit të sapo cituar ky lloj kontrolli i aplikohet: administratës publike; të gjitha instituteve edukative dhe shkollave; ndërmarrjeve dhe administratave autonome të shtetit; rajoneve; provincave; bashkive; komuniteteve malore; instituteve universitarë; ndërmarrjeve dhe subjekteve të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar; menaxhimit jashtë bilancit dhe menaxhimit të fondeve komunitare etj.

Aspektet subjektive dhe objektive të menaxhimit që i nënshtrohen kontrollit aprovohen paraprakisht nga vetë Gjykata çdo vit për vitin që do vijojë, duke u bazuar në disa kritere si: rëndësia financiare; prania një rreziku për parregullsi; rezultatet e kontrolleve të mëparshëm; kërkesat për kontroll të drejtuara Gjykatës nga vetë administrata.

Programi vjetor i kontrolleve komunikohet nga Gjykata parapraakisht organeve parlamentare, Presidentit të Dhomës së Deputetëve dhe Senatit të Republikës, në rastin e një kontrolli në nivel qendror; Presidentit të Këshillit Rajonal në rast kontrolli rajonal; ose vetë subjekteve ndaj të cilëve do të ushtrohet kontrolli.

Së fundi, në lidhje me kontrollin ekonomik – financiar me detyra raportimi në parlament mund të themi se ka detyra ndihmëse kundrejt Parlamentit për sa i përket problemeve me natyrë financiare. Gjatë ushtrimit të këtij kontrolli Gjykata përpilon Raporte Vjetorë, Raporte katër mujorë, Raporte Specifike, Raporte në fushën e financës rajonale dhe vendore. Raporti Vjetor i shërben Gjykatës për të paraqitur rezultatet në lidhje me Barazimin e Llogarive të Përgjithshme Shtetërore duke theksuar në qoftë se Barazimi i Llogarive përputhet me kriteret e fiksuar nga Ligji Financiar Vjetor dhe nga Pakti i Stabilitetit. Pas ligjit nr.468 të 1978, Gjykata është e detyruar të bëjë raportime katër mujorë në Parlament. Në këto raporte Gjykata paraqet rezultatet e kontrolleve të saj mbi ligjet që parashikojnë shpenzime të reja të mëdha ose të ardhura të ulta, gjithmonë nën respektin e artikullin 81 të Kushtetutës. Raportet Specifike, të cilat paraqiten periodikisht para Parlamentit, trajtojnë aspekte të tjerë financiarë në sektorë të ndryshëm të administratës publike si për shembull: në sistemin universitar; në përdorimin e të ardhurave të destinuar për personelin publik; në sektorin e sistemit informatik të administratës publike etj.

Për sa i përket Raporteve në fushën financiare rajonale dhe vendore, Gjykata dialogon drejt për së drejti me organet administrative rajonale dhe vendore në mënyrë telematike të paktën një herë në vit. Ajo jep një vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë e bilancit rajonal dhe vendor duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të financave publike të vendosura nga Bashkimi Evropian, në kriteret e tjerë të vendosura nga Kushtetuta dhe ligji i shtetit.

4.2. Funksionet e ligjshmërisë

Funksionet e ligjshmërisë të Gjykatës *ex art 103* ushtrohen në fushën e kontabilitetit publik si dhe në çdo fushë të parashikuar nga ligji. Në lidhje me kontabilitetin publik ajo ka juridiksion ekskluziv, në kuptimin që ka kompetencë për të gjykuar agjentët kontabël, administratorët dhe funksionarët publik për të gjithë aspektet e mbarëvajtjes së të ardhurave publike. Hyn në kompetencën e Gjykatës gjykimet mbi përgjegjësinë administrative dhe të mbajtjes së llogarive financiare të funksionarëve

dhe administratorëve publikë për dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Gjykimi jepet mbi përgjegjësinë civile mbi pronën sepse synon të verifikojë në qoftë se, nga sjellja e funksionarit në ushtrimin e detyrave të tij, rezulton një dëm për administratën publike. Atëherë kur ky dëm është i pranishëm, Gjykata procedon me vlerësimin monetar të dëmit dhe dënon funksionarin me kompensimin të vlerës monetare të atij.¹¹ Gjykata e Llogarive ka fuqi gjykuese edhe mbi përgjegjësinë e të gjithë administratorëve, punonjësve dhe subjekteve publikë që janë të lidhur me administratën publike nëpërmjet një kontrate pune ose sepse po ushtrojnë një funksion publik të përkohshëm. Pra në këtë kategori hyjnë punëtorët e aparatit shtetëror, ministrat edhe personat që kanë funksione publike pa pasur legjitimim etj. Proçesin për verifikimin e përgjegjësisë administrative e fillon; prokurori kontabël (*pubblico ministero contabile*), që mund të jete ose Prokurori Rajonal në Seksionet e Ligjshmërisë Rajonale të Gjykatës për sa i përket shkallës së parë të gjykimit, ose Prokurori i Përgjithshëm në Seksionin e Apelit; persona të tjerë fizikë ose juridikë. Në rastet kur nuk ekziston asnjë kërkesë formale për verifikim përgjegjësie nga presona fizikë ose juridikë, prokurori kontabël është i vetmi që ka fuqinë për të nisur këtë proçes, kjo sepse nuk parashikohet me ligj mundësia për gjykatësin kontabël të proçedoj në mënyrë të pavarur.

Në këtë mënyrë fuqia për të thirrur në gjykim pjesëtarë të administratës publike në lidhje me verifikimin e përgjegjësisë i është dhënë një organi të tretë – *pubblico ministero contabile* – i cili ushtron këtë fuqi në mënyrë të pavarur nga organet e tjerë, por gjithmonë duke respektuar hierarkinë e burimeve ligjore të cilave u referohet veprimtaria e tij.

5. Marrëdhëniet me Jashtë

Gjykata e Llogarive ka marrëdhënie të shumta si me Institutet e tjerë të kontrollit jashtë shtetit (*Supreme Audit Institutions, SAI*), po ashtu edhe me organizata ndërkombëtare.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare merret me aktivitetet e Gjykatës në këtë kontekst. Ajo zëvendëson Presidentin e Gjykatës në mbledhjet ndërkombëtare në rastet kur ai nuk mund të jetë i pranishëm. Kjo zyrë

¹¹ Elementët mbi të cilët bazohet gjykatësi kontabël për vlerësimin e dëmit janë përcakuar nga Gjykata Kushtetuese Italiane në vendimin nr. 340 të 24 tetorit 2001. Ato janë: lloji i dëmit të shkaktuar, kapaciteti ekonomik i subjektit, sjellja, niveli i përgjegjësisë në administratë.

drejtohet nga një Këshilltar i cili emërohet nga Presidenti në bazë të zgjedhjes së Këshillit të Presidencës. Këshillëtari mban marrëdhëniet me SAI e vendeve të tjerë dhe me Gjykatën e Llogarive Europiane.

Veprimtaria e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare zhvillohet si vijon:

- në kontekstin ndërkombëtar ajo siguron dhe promovon bashkëpunimin e vazhdueshëm të Gjykatës në organizatat ndërkombëtare si INTOSAI – *International Organization of the Supreme Audit Institutions* - , EUROSAI – *European Organization of the Supreme Audit Institutions*; bashkëpunon me organizatat rajonale të INTOSAI-t si AFROSAI, ASOSAI, ARABOSAI, OLACEFS, CAROSAI, SPASAI; merr pjesë në kongrese, seminare dhe mbledhje të organizuara nga SAI dhe organizatat e mësipërme
- në kontekstin europian ajo mban marrëdhënie të vazhdueshme me agjentët e SAI të vendeve të tjera europiane dhe bashkëpunon në organizimin e mbledhjeve vjetore të Komitetit të Kontaktit të Presidentëve të SAI europiane; bashkëpunon me Gjykatën e Llogarive Europiane për sa i përket kontrollit të fondeve të BE-së
- në kontekstin e organizatave ndërkombëtare ajo është në raporte të vazhdueshme me organizata si NATO, Këshilli i Europës, ËEO, UN, OECD, FAO, ËFP; përgatit dokumentacionin e duhur për kontrollin e jashtëm të këtyre organizatave.

Së fundi Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare përfaqëson Gjykatën e Llogarive në bordin drejtues të EUROSAI (*Governing Board*); siguron pjesëmarrjen e Gjykatës në seksionet e punës së Komitetit mbi *Standardet e Auditimit* të INTOSAI; jep sygjerime organit të INTOSAI në lidhje me principet e kontabilitetit në sektorin publik të hartuara nga IFAC (*International Federation of Accountants*).



GJYKATA FRANCEZE E LLOGARIVE

Historiku i Gjykatës së Llogarive në Francë

Gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj, Gjykata e Llogarive franceze, pavarësisht periudhës kohore, ka pasur si moto të saj auditimin e parave publike.

Ajo është kryesisht përgjegjëse për auditimin e llogarive publike shtetërore, institucioneve publike kombëtare, ndërmarrjeve publike, sigurimeve shoqërore dhe organizatave private që u jepen fonde nga shteti ose nga publiku. Ajo e informon Parlamentin, Qeverinë dhe opinionin publik mbi rregullsinë e llogarive. Kjo gjykatë e ka qendrën në Paris, në “Palais Cambon”.

Nëse i referohemi historisë së Gjykatës së Llogarive, ne vitin 1256, nga oborri mbretëror doli një urdhëresë për krijimin e një komisioni, i cili do të informonte mbretin çdo vit për gjëndjen e llogarive. Disa vite më vonë, në vitin 1303, u krijua Dhoma e llogarive të Parisit.

Ne vitin 1467, sipas një urdhërese të Louis XI, gjykatësit e llogarive ishin të përhershëm dhe mund të zëvendësoheshin vetëm në rast vdekje, dorëheqjeje ose të dënimit për shkak të shkeljeve flagrante gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë mënyrë, gjykatësit e llogarive janë të përhershëm dhe kjo rrit shkallen e pavarësisë në punën e tyre.

Në 1807 Napoloni krijoi Gjykatën e parë të Llogarive, që ishte vazhdimësia e Dhomës së Llogarive të Parisit, duke u shprehur : «Unë dua që nëpërmjet

një mbikëqyrje aktive, të zhduket pabesia dhe përdorimi legal i fondeve të jetë i garantuar”. Kjo gjykatë ishte e centralizuar dhe unike deri në 1982 kur u krijuan Dhomat rajonale dhe territoriale nëpërmjet decentralizimit.

Organizimi

Gjykata e Llogarive përbëhet nga shtatë dhoma (organe gjyqësore) dhe secila prej tyre drejtohet nga një President. Ne përbërje të tyre ka këshilltarë, auditues, raportues dhe ekspertë. Për çdo dhomë janë caktuar fushat e përgjegjësisë. Gjykata kryesohet nga Presidenti, i cili emërohet nga Presidenti i Republikës.

Gjykata, dhomat rajonale e territoriale të llogarive (CRTC) formojnë një urdhër juridiksioni sipas të cilit Gjykata e Llogarive është gjykata më e lartë. Për aktivitetet e gjykimit, Gjykata shërben si organi i apelit për vendimet e dhëna nga CRTC-ja. Këshilli i Shtetit shërben si Gjykatë Kasacioni për Gjykatën e Llogarive dhe CRTC-në.

Të gjithë anëtarët e Gjykatës së Llogarive janë gjyqtarë me status të përhershëm, që rregullohet me dispozitat statusore të Shërbimit Publik dhe jo të gjyqësorit. Rekrutimi behet vetëm nga studentët më të mire të ENA (Ecole Nationale d’Administration). Një procedurë specifike lejon të rekrutohen disa punonjës në vit, të cilët mund të jenë edhe nga Administrata e lartë shtetërore.

Ne kuadër të misionit të saj për të çertifikuar llogaritë e Shtetit, Gjykata e Llogarive mund të rekrutojë ekspertë të jashtëm, të cilët janë në përgjithësi nga kabinetet e mëdha të auditimit ose funksione të tjera private apo publike.

Fushat e përgjegjësisë që mbulon çdo Dhomë :

- **Dhoma e 1^{re}**: Ministrinë e Financave dhe të gjitha institucionet e tjera financiare publike
- **Dhoma e 2^{te}**: Ministrinë e Mbrojtjes, të industrisë, të energjisë, të turizmit, të tregëtisë së jashtme dhe të gjithë organizmat publike që punojnë në fushen e industrise.
- **Dhoma e 3^{te}** : Ministrinë e Arësimit, të kulturës rinisë e sporteve dhe institucionet që lidhen me to
- **Dhoma e 4^t** : Ministrinë e Drejtësisë, të brëndshme, të jashtme dhe gjykatat e apelit të dhomës rajonale të llogarive
- **Dhoma 5^{te}**: Ministrinë e punës dhe të çështjeve sociale, të formimit profesional dhe të strehimit.

- **Dhoma e 6^{të}** : Ministrinë e Shëndetësisë dhe të sigurimeve shoqërore dhe organizmat që mbulojnë sigurimet shoqërore
- **Dhoma e 7^{të}** : Ministrinë e transporteve, të Menaxhimit të territorit, të bujqësisë dhe të peshkimit, të ambjentit

Misioni

Misioni i Gjykatës së llogarive është që të sigurojë rregullsinë, efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Për t'iu përgjigjur këtyre detyrave, të cilat janë preçizuar gjerësisht në nenin 47-2 të Kushtetutës, ky institucion gjykon, auditon, vlerëson dhe certifikon.

Dhomat rajonale dhe territoriale kanë kompetencë të trefishtë për autoritetet lokale dhe institucionet e tyre publike. Ato auditojnë llogaritë e shtetit, menaxhimin dhe auditimin e fondeve buxhetore. Ato gjithashtu kontribuojnë në vlerësimin e politikave publike dhe kushtet e zbatimit të tyre në nivel lokal në kontekstin e sondazheve tematike.

Dhomat rajonale dhe territoriale të llogarive, kontribuojnë në transparencën e informimit të publikut dhe në këtë mënyrë në demokracinë lokale, duke publikuar gjetjet dhe vëzhgimet e tyre, si dhe duke u përpjekur për t'i bërë ato sa më shumë të kuptueshme dhe të përçojnë mesazhe të qarta:

- Për të hedhur dritë mbi gjendjen e financave publike;
- Të formulojë rekomandime konkrete dhe reale sipas të cilave menaxherët publikë duhet të përkrahen për të ndryshuar praktikat e tyre në mënyrë më efektive dhe efektive;

Gjykata e disiplinës buxhetore dhe financiare (CDBF)

Gjykata franceze e disiplinës buxhetore dhe financiare është një juridiksion financiar, themeluar në vitin 1948.

Ndryshe nga Gjykata e Llogarive, e cila auditon “llogaritë” dhe jo kontabilistët, kjo gjykatë ka kompetenca që përafrojnë me ato të gjykatës penale.

Ajo ka kompetenca për të gjykuar veprimet e disa administratorëve publikë dhe për këtë ajo duhet të njihet me aktet e ndërmarrja prej tyre, si psh urdhrat e dhëna për shpenzime të ndryshme. Kjo gjykatë gjykon gabimet serioze (te rënda) të drejtuesve të ndërmarrjeve publike. Ajo mund të merret në disa raste shumë të kufizuara me parregullsitë e akteve të drejtuesve ekzekutivë vendorë (si psh Presidenti i Këshillit Rajonal, kryetari i bashkisë...), por CDBF nuk është përgjegjëse për akte të nënshkruara personalisht nga

ministrat, të cilat janë kompetencë e kontrollit që ushtron Parlamenti mbi qeverinë.

Ajo është e përbërë nga një numër i barabartë anëtarësh që vijnë nga Gjykata e Llogarive dhe nga Këshilli i Shtetit.

Këshilli i mbledhjes së taksave të detyrueshme (CPO)

Këshilli është përgjegjës për vlerësimin e progresit dhe të ndikimit ekonomik, social dhe buxhetor të të gjitha taksave të detyrueshme. Ai është i ngarkuar gjithashtu me dhënjen e rekomandimeve për çdo çështje në lidhje me taksat e detyrueshme.

CPO paraqet çdo vit një raport për punën e tij tek Presidenti i Republikës dhe në Parlament.

Ligji i 20 prillit 2005 thekson se qeveria pret nga CPO një “tablo të plotë të nivelit të taksave të detyrueshme, që do të thotë, nga njëra anë, taksat e mbledhura nga autoritetet shtetërore, lokale dhe institucionet publike të bashkëpunimit dhe në anën tjetër, të gjitha kontributet e detyrueshme të mbledhura në emër të institucioneve të mbrojtjes sociale.

CPO mund të ngarkohet me kërkesë të Kryeministrit ose të komisioneve të Parlamentit, përkatësisht komisioni i Financave ose ai i çështjeve sociale, për të realizuar studime në lidhje me çdo çështje brenda kompetencave të tij.

Këshilli duhet të jetë në gjendje të analizojë gjendjen dhe trendet e mbledhjes së taksave, në mënyrë që të ndihmojë qeverinë të marrë vendime të drejta në këto fusha.

Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës kryesohet nga Presidenti i Gjykatës, në mungesë të tij, drejtohet nga Dekani i Presidentëve të Dhomave. Këshilli mund të mbledhet në seancë plenare dhe seanca të zakonshme. Gjatë seancave plenare, këshilli përpara se të dërgoje për miratim raportin vjetor publik dhe raportet e parashikuara nga Ligji Organik, në fillim dorëzon projekt-raportin tek Presidenti i Gjykatës ose tek Prokurori i Përgjithshëm, në mënyrë që të kontrollohet prej tyre.

Anëtarët e Këshillit janë:

- Presidenti i Gjykatës,

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- Prokurori i Përgjithshëm që merr pjesë në takime dhe në debate dhe nuk ka të drejtën e votës,
- Presidentët e Dhomave të konsideruar si këshilltarë,
- Këshilltarët e lartë,
- Këshilltarët e lartë në detyrë të veçantë,

Seancat e zakonshme drejtohen nga Presidenti i Gjykatës. Këshilli është i përbërë nga kryetarët e Dhomave, si dhe pesë këshilltarë, të emëruar çdo vit nga Presidenti i Gjykatës. Presidentët e Dhomave rajonale ose territoriale të llogarive me gradën e këshilltarit, gjithashtu marrin pjesë gjatë këtyre seancave dhe pëse atakan në marrë-pjesë në raportin e ekzaminuar nga Presidenti. Anëtarët e tjerë të Gjykatës së Llogarive kanë të drejtën e pjesëmarrjes në Këshillin Mbikëqyrës gjatë seancave të rregullta, por pa të drejtë vote. Këshilli gjatë seancave të zakonshme shqyrton disa draft-raporte publike përveç atyre të shqyrtuara nga Këshilli gjatë seancave plenare, me përjashtim të raporteve lidhur me organizatat që marrin donacione.

Pavarësia, kolegjaliteti, kundërshtitë.

Këto rregulla dhe parime janë garancitë e paanshmërisë dhe cilësisë së punës së gjykatës së llogarive.

Pavarësia

Pavarësia e Gjykatës është bazuar në statusin e saj, që daton që nga fillimi i tij në 1807. Kjo pavarësi mbështetet gjithashtu në pavarësinë e anëtarëve të saj, gjyqtarë me mandat pa afat, me garanci ligjore të forta që nga viti 2006. Pavarësia është gjithashtu çështje kulture, mendësie dhe praktike, dhe në këtë këndvështrim, kjo pavarësi është e lidhur me eksperiencën e gjatë dhe prestigjin e kësaj gjykate.

Kolegjialiteti

Kolegjialiteti është një rregull i rëndësishëm në funksionimin e Gjykatës. Nëse auditimi është individual, vendimi është kolegjal. Gjykatësi, edhe pse udhëzon “për të ngarkuar dhe shkarkuar,” në vijim vetëm propozon për vëzhgimet e konstatuara. Vendimi i marrë në kolegjalitet, “fshin” pozicionimin personal dhe kur shpallet vendimi ruhet sekret i votës së secilit. Kolegjialiteti është kusht për legjitimitetin dhe besueshmërinë e Gjykatës.

Kundërshtitë

Natyra kundërshtuese e procedurës është një parim i përgjithshëm në çështjet gjyqësore, vendosur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ky rregull zbatohet për të gjitha procedurat e Gjykatës. Koncepti

është i thjeshtë, por është kompleks në zbatim dhe ka evoluar me kalimin e viteve për shkak të reformave të ndërmarra. Një ekuilibër është kërkuar gjithmonë në mes të nevojës për të njohur këndvështrimin e “audituarit” dhe nevojës për të realizuar auditimin në një afat të arsyeshëm. Gjykata, për të qenë e dobishme, duhet të jetë në gjendje të shprehet qartë dhe pa vonesa të gjata.

Auditimi i llogarive të shtetit

Deri në vitin 2008, procedura para Gjykatës së Llogarive ishte sekrete, e shkruar dhe objektive, duke ruajtur parimin e kundërshtisë : kur konstatohej një shkelje, Gjykata nxirrte aktin për një pezullim të përkohshëm, duke i lënë personit dy muaj kohë për të siguruar dokumente shtesë mbështetëse ose për të paguar shumën që mungonte, vendimi përfundimtar mund të dilte vetëm pas kësaj periudhe.

Në 2008, ligji ndryshoi këtë procedurë sepse audienat ishin publike dhe vendimi ishte përfundimtar.

Kontabilistët kontrollohen për zbatimin e detyrave të tyre dhe kur rezulton që ata kanë operuar sipas rregullave, gjykata akordon “shkarkimin nga detyrimet”. Në të kundërt, nëse gjykata gjen gabime si në pasqyrimin e të ardhurave ose të shpenzimeve, atëherë ajo e deklaron kontabilistin në gabim dhe ky i fundit duhet të paguajë dëmin e shkaktuar nga të ardhurat e tij personale.

Çdo dhomë kontrollon sipas fushës që mbulon një here në vit llogaritë e shtetit. Institucionet shtetërore respektive në rrethe gjykohen nga 26 Dhomat rajonale. Ekziston mundësia e apelimit të vendimit.

Auditimi i menaxhimit

Gjykata nuk ka kompetenca për të gjykuar zyrtarët që janë në drejtim (urdhëruesit), por ajo mund të auditojë mënyrën e tyre të menaxhimit përmes dokumentacionit që u japin kontabilistët. Mbështetur në ligj, që nga viti 1982, mund të auditojnë saktësinë dhe ligjshmërinë e vendimeve të tyre, nëpërmjet një raporti vlerësimi. Ky auditim është jo-juridik dhe nuk mund të çojë në një vendim kundër zyrtarit, por mund të venë në dukje vëzhgimet e konstatuara tek drejtuesit e tyre ose i referojnë mangësitë e konstatuara në Gjykatën e disiplinës buxhetore dhe financiare.

Auditimi dhe menaxhimi i shërbimeve publike

Në auditimin e ndërmarrjeve publike nuk jepen gjykime por raporte të

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

veçanta ose opinione. Përveç ligjshmërisë ose rregullsisë së operacioneve financiare, analizohet efektiviteti i administratës apo organizmit që auditohet, me qëllimin e vetëm, mirë përdorimin e fondeve publike.

Një herë në vit, Gjykata përgatit një raport publik për Parlamentin dhe për Presidentin e Republikës, i cili botohet në Fletoren Zyrtare. Raporti vjetor publik është i ndarë tani në disa botime që dalin në periudha të ndryshme : një raport të përgjithshëm dhe raporte të veçanta për një temë të vetme.

Në zbatim të kushtetutës, Gjykata e llogarive ka edhe një mision tjetër, atë të asistencës së parlamentit nëpërmjet një raporti vjetor në lidhje me ecurinë e ekonomisë kombëtare dhe orientimin e financave publike.

Çertifikimi i llogarive të shtetit

Në zbatim të ligjit, Gjykatës i është dhënë edhe detyra e certifikimit të llogarive të Shtetit. Viti i parë kontabël që i është nënshtruar këtij rregulli është 2006. Ky mision i ri e vendos Gjykatën në zemër të reformës së financave të shtetit.

Gjykata duhet të mbajë qëndrimin e saj mbi llogaritë vjetore të publikuara nga Ministria e Financave, sipas rregullave dhe parimeve të kontabilitetit të shtetit francez : rregullsia, sinqeriteti, në kuptimin e një “foto” reale të rezultateve të një viti, si edhe për gjendjen financiare dhe asetet e shtetit në fund të vitit.

Asistencë për Parlamentin

Sipas Kushtetutës (mbështetur në aktin e datës 23 korrik 2008), Gjykata ndihmon Parlamentin në auditimin e aksioneve të qeverisë sepse parlamenti ka misionin e vlerësimit të politikave publike.

Për të kontribuar në kryerjen e kësaj detyre, Gjykata prodhon raporte hulumtuese me kërkesën e Senatit dhe të Asamblesë Kombëtare në lidhje me auditimin e politikave publike. Ky veprim është pjesë e një bashkëpunimi midis Gjykatës dhe legjislativit në kontekstin e auditimit në rritje të shpenzimeve publike dhe vlerësimit të performancës së politikave publike.

Në organigramën e gjykatës së llogarive një vend të rëndësishëm zënë : Prokurori i Përgjithshëm dhe Sekretariati i përgjithshëm

Prokuroria është e përbërë nga prokurori i përgjithshëm, i cili asistohet nga avokatët e përgjithshëm. Prokuroria e përgjithshme është e ngarkuar

të kujdeset për zbatimin e ligjeve dhe të ndihmojë Gjykatën në qartësimin e çështjeve të ndryshme. Prokuroria duhet të ndjekë dhe të bashkëpunojë për zbatimin e vendimeve të nxjerra nga gjykata. Prokuroria tradicionalisht ka qenë një nyje lidhëse midis gjykatës dhe autoriteteve të ndryshme shtetërore.

Prokuroria është projektuar për të ndihmuar gjykatën, të analizoje dhe të konkludojë mbi parregullsitë e raportuesve dhe të masave të marra gjatë auditimit të tyre dhe mund të prononcohet mbi rëndësinë relative të parashtrimeve të tyre.

Prokurori i Përgjithshëm mbikëqyr punën e Gjykatës, në lidhje me subjektet që kjo e fundit duhet të kontrollojë ose të gjykojë. Me iniciativën e tij, Prokurori i Përgjithshëm, garant i financave publike, mund të kërkojë Gjykatës për të hapur një procedurë ose rishikojë një vendim. Ajo gjithashtu mund të apelojë kundër vendimeve të dhomave rajonale të llogarive dhe gjykimeve të Gjykatës së Kasacionit duke kërkuar një verifikim të dytë.

Ajo gjithashtu monitoron ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës dhe në përgjithësi, është përgjegjëse për monitorimin e progresit të punës së saj.

Prokurori i Përgjithshëm gjithashtu luan një rol të veçantë në lidhje me dhomat rajonale dhe territoriale sepse ai duhet të sigurojë funksionimin e mirë të këtyre të fundit, nëpërmjet prezencës së prokurorit financiar që ai i zgjedh vet.

Sekretariati i Përgjithshëm (strukturat mbështetëse)

Është përgjegjës për funksionet mbështetëse për kontrollin dhe menaxhimin administrativ. Stafi mbështetës i Gjykatës së Llogarive është i ndarë në struktura të ndryshme (drejtori, zyra, etj) disa të lidhura direkt me Sekretariatën e Përgjithshëm, të tjerë nën autoritetin e një Shefi shërbimi. Ky staf administrativ i shërben Gjykatës, prokurorit të përgjithshëm dhe dhomave rajonale dhe territoriale.

Sekretariati i Përgjithshëm dhe shërbimet administrative

Presidenti i parë ka nën autoritetin e tij, sekretarin e përgjithshëm dhe dy zëvendësit e tij, të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës dhe që kanë gjithashtu pozicione drejtuese në një nga shërbimet administrative. Ndër shërbimet administrative, disa janë të lidhura direkt me Sekretariatën e Përgjithshëm, të tjerët nën autoritetin e një shefi shërbimesh.

Shërbimet administrative të lidhura direkt me Sekretariatit e Përgjithshëm

- Drejtoria e komunikimit
- Shërbimi i raportit publik dhe i programeve
- Drejtoria e marrëdhënjeve me jashtë, auditit të jashtëm dhe frankofonisë
- Rregjistri i Gjykatës së Llogarive
- Shërbimi juridik

Shërbimet administrative nën autoritetin e një drejtori të përgjithshëm shërbimesh

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Trajnimeve
- Drejtoria e Financës dhe e Auditimit
- Drejtoria e IT
- Drejtoria e Logjistikës
- Drejtoria e protokollit dhe arkivës



Gjykata Austriake e Auditimit

Gjykata Austriake e Auditimit është një organ federal i cili shpalo aktivitetin e tij auditues në nivel shtetëror, në nivelin e njësisve territoriale administrative të federuara (pra lander-at) dhe në nivel bashkiak.

- Sipas nenit 121/koma I të Kushtetutës Austriake:

“Gjykata e Llogarive ka si detyrë të kontrollojë menaxhimin financiar të federatës, të landeve, të bashkësive komunale, të komunave dhe të subjekteve të tjerë juridikë të përcaktuar në ligj.”

Gjykata verifikon nëse fondet shtetërore janë administruar në mënyrë korrekte. Përfshihen në këto fonde të gjitha kontributet shtetërore kundrejt organeve publike, po ashtu si edhe kontributet shtetërore të shpenzuar nga institucionet private. Pra, ky është një sistem kontrolli i cili bazohet në principin e njëtrajtshmërisë së institucioneve publike dhe private.

Gjykata vepron si organ auditues në emër të përfaqësuesve të zgjedhur nga qytetarët e vendit, brenda kornizës kushtetuese e cila përcakton edhe pavarësinë e saj nga pushteti ekzekutiv.

- Neni 122 i Kushtetutës specifikon se:

“Gjykata e Llogarive i nënshtrohet drejtpërsëdrejti Këshillit Kombëtar (Parlamentit Federal). Në çështjet e llogarive federale si edhe ato të përfaqësuesve ligjorë të kategorive të cilat hyjnë në aktivitetet ekzekutive të federatës, ajo vepron si një organ i Këshillit Kombëtar: në çështjet e llogarive provinciale si edhe në kontabilitetin e përfaqësuesve ligjorë të kategorive të cilat hyjnë në aktivitetet ekzekutive të Lander-ave, ajo

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

vepron si organ i Këshillit Provincialë të interesuar.”

Pika II e të njëjtit nen, deklaron pavarësinë e saj kundrejt fuqisë ekzekutive federale dhe provinciale. Ajo i nënshtrohet vetëm dispozitave ligjore.

Gjatë ushtrimit të funksionit të saj auditues ajo verifikon në qoftë se buxhetet - federalë apo provinciale - po shpenzohen ose janë shpenzuar duke respektuar parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

Respektimi i parimeve të mësipërme integrohet nga praktika e auditimit publik i cili është një prej kollonave kushtetuese të një sistemi parlamentar demokratik.

Si një organ auditues i një shteti federal, Gjykata është përgjegjëse për auditimin e të gjithë sektorëve publikë në të gjitha nivelet institucionale.

Ajo kryen veprimtarinë e saj në mënyrë objektive, të pavarur, profesionale dhe të paanshme. Gjykata ndjek po ashtu edhe udhëzimet ndërkombëtare për auditim (si për shembull Udhëzimet e Auditimit të INTOSAI –t) dhe është e angazhuar në zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Historiku

Austria ka një histori të hershme në lidhje me auditimin. Vetë Perandresha Maria Theresa Hasburg, me një letër të 23 Dhjetorit të 1761, krijoi Dhomën për Auditim (Rechen Cammer), paraardhësja e Gjykatës së Llogarive të sotshme. Krijimi i këtij organi të ri në atë kohë shërbente për të vënë në dukje sëmundjet që infektonin sistemin financiar të vendit. Dhoma për Auditim i kushtonte një vëmendje të veçantë problematikave në lidhje me shpenzimet e shtetit. Sot, Gjykata e Llogarive ka akoma më shumë funksione dhe detyrime ndërkombëtare.

Pavarësia

Bashkë me profesionalizmin e organikut të brendshëm dhe atë metodologjik, pavarësia e auditimit të jashtëm publik garanton një raportim harmonik, të besueshëm dhe objektiv mbi rezultatet e auditimeve të kryera. Pra pavarësia nuk është vetëm jetësore për garantimin e transparencën së administratës shtetërore, por edhe një trajtë themelore që siguron një zbatim të qëndrueshëm dhe efektiv të funksioneve kontrolluese të parlamentit. Në këtë mënyrë fuqizohet akoma më shumë besimi i opinionit publik në institucionet shtetërore.

Deklarata e Limës u kërkon SAI-ve të kenë pavarësi organizative, funksionale dhe financiare të përkufizuar në kushtetutë dhe të kenë fuqi audituese të pakufishme mbi të gjitha burimet financiare publike. Kërkesat

e mëtejshme të Deklaratës janë: liri konsultimi nga ana e audituesve të të gjitha dokumenteve të rëndësishëm; numër personeli të mjaftueshëm; aftësi teknike për të audituar organizatat në të cilat ka pjesëmarrje publike; autoritet për të audituar institucione që marrin grante shtetërore dhe të drejtën për të paraqitur raporte parlamentit dhe opinionit publik; së fundmi të kenë një mekanizëm përndjekës efektiv (folloë – up mechanism).

Kërkesat e mësipërme mbi pavarësinë e SAI-ve janë përsëritur edhe në Deklaratën e Meksikës, e cila u miratua në Takimin e INCOSAI të vitit 2007 në Mexico City. Në këtë deklaratë u përcaktuan 8 pilastra në të cilët bazohet pavarësia e Institucioneve më të Lartë të Auditimit. Konkretisht 8 pilastrat e Deklaratës së Meksikës përcaktojnë çfarë gjendet mes pavarësisë së çdo SAI dhe çfarë është e nevojshme për të arritur atë.

Pozita e Presidentit

Kryetar i Gjykatës Austriake të Llogarive është Presidenti, i cili emërohet nga Këshilli Kombëtar me propozim të Komisionit Kryesor për një periudhë dymbëdhjetë vjeçare pa të drejtë ri-zgjedhjeje. Në raste paaftësie të përhershme ose të përkohshme të Presidentit, ai përfaqësohet nga zyrtari më i lartë në hierarki. Në ushtrimin e detyrave të tij, Presidenti i Gjykatës renditet në të njëjtën kategori të anëtarëve të tjerë të qeverisë federale.

Presidenti ka të drejtë të marrë pjesë në diskutimet: mbi raportet e Gjykatës; mbi deklaratat financiare federale; mbi pjesën përkatëse të Ligjit Financiar Federal ne seancën plenare të Këshillit Kombëtar po ashtu dhe në komisionet dhe nën-komisionet përkatës; së fundi, ai ka të drejtën e fjalës në situatat e sapo përshkuara.

Funksionet e Veçanta

Gjykata ka për detyrë ushtrimin e funksioneve të përkufizuara në kushtetutë, të cilat janë tregues të besimit të veçantë në të si institucion i pavarur dhe i paanshëm.

Këto funksione janë:

- Hartimi i Deklaratave Financiare Federale;
- Rishqyrtimi i projekt-ligjeve dhe rregulloreve, gjatë të cilit Gjykata i jep rëndësi të veçantë shmangies së shpenzimeve indirekte dhe realizueshmërisë ekonomike të zbatimit;
- Hartimi (çdo dy vjet) i një Raporti të Ardhurash mbi prurjet mesatare dhe përfitimet e pensioneve të kompanive dhe institucioneve shtetërore;

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- Publikimi – në përputhje me Ligjin mbi Kufizimin e të Ardhurave - i një koeficienti përshtatshmërie për pagesat e përfaqësuesve të sektorit publik;
- Paraqitja e një Raporti të Ardhurash mbi prurjet mesatare të popullsisë totale dhe publikimi i tij sipas seksionit 8 paragrafëve 1-8 të Ligjit mbi Kufizimin e Pagesave;
- Zbulimi nëpërmjet Presidentit të Gjykatës i çdo rritjeje të jashtëzakonshme në pasurinë e anëtarëve të qeverisë federale dhe të lander-ave: të sekretarëve të Presidentit të Këshillit Kombëtar ose të sekretarëve të Presidentëve në parlamentet e lander-ave në baze të Ligjit mbi Papajtueshmërinë;
- Publikimi i një Deklarate publike – në bazë të kërkesës së një partie politike – mbi korrektesën e një kontributi të përfituar. Ligji mbi Partitë Politike i detyron ato ti paraqesin Presidentit të Gjykatës çdo vit një listë kontributesh nga të cilët kanë përfituar;
- Bashkëpunimi në redaktimin e Deklaratës mbi Borxhin Financiar;
- Krijimi i opinioneve të kualifikuara për një Grup Ndërmjetësimi, në bazë të Paktit të Stabilitetit Austriak, i cili duhet të ilustrojë në qoftë se dhe në çfarë mase kriteret e stabilitetit nuk janë respektuar nga shteti, landerat ose bashkitë.

Organizimi

Kryetar i Gjykatës Austriake të Llogarive është Presidenti. Gjykata ka një organizim monokratik, sipas të cilit puna dhe efektiviteti i saj hyjnë në sferën e përgjegjësisë vendim-marrëse të Presidentit.

Duke filluar nga data 1 shtator 2010, Gjykata ka një strukturë organizative të re që i përgjigjet më mirë pozicionimit të saj në asketin institucional dhe objektivave strategjikë të saj.

Gjykata është tani e organizuar në 5 seksione dhe në 35 departamente auditimi të specializuar në fusha të ndryshme të performancës. Për të përkrahur zhvillimin e metodave të auditimit mbi tema specifike dhe të ndërthurura, fusha të ndryshme auditimi janë integruar dhe përqendruar në një seksion.

Misioni – Strategjia – Kodi Etik

Strategjia

Strategjia e Gjykatës Austriake të Llogarive bazohet në deklaratën e misionit të saj e cila reflekton pozicionin e saj aktual dhe orientimin

strategjik për sa i përket tërësisë së aktiviteteve të saj. Përfshihen në të tregues të rëndësishëm, të cilët masin të gjithë objektivat strategjike dhe vlerësojnë shërbimet dhe efektivitetin e Gjykatës.

Gjykata Austriake e Llogarive si një Institucion Federal i Shtetit dhe i Lander-ave

Si institucion federal i shtetit dhe i Lander-ave, Gjykata është përgjegjëse për auditimin e gjithë sektorit publik në të gjitha nivelet e qeverisjes: vepron si një organ i Këshillit Kombëtar dhe si një organ i parlamenteve të Lander-ave (dhe Këshillit Bashkiak të Vjenës).

Ndërthurja e financave publike federale, të lander-ave dhe bashkive me përgjegjësinë buxhetore, në përgjithësi kërkon një trajtim gjithëpërfshirës së çështjes si në nivel kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar. Për tu bërë ballë këtyre sfidave, Gjykata ka zhvilluar një strategji të përbashkët si për Lander-at dhe për bashkitë.

Kodi Etik

Si institucioni më i lartë i auditimit, Gjykata ka për detyrë të sigurojë që fondet publike të përdoren sipas parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit dhe në përputhje me ligjin. Prandaj ajo jep një kontribut të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimit të tij. Mbi bazën e vlerave dhe parimeve të punës së sotme të punonjësve të Gjykatës, Kodi Etik shërben si një pikë referimi dhe udhëzim në aktivitetet e përditshme.

Bazat Ligjore

Aktivitetet, funksionet, organizimi dhe pozita e Gjykatës Austriake të Llogarive, janë të përcaktuara në Kapitullin VI të Ligjit Kushtetues Federal (Kushtetuta). Informacione të mëtejshme ndodhen në ligjet e Lander-ave dhe në Ligjin mbi Gjykatën Austriake të Llogarive. Rregullat procedurale të Këshillit Kombëtar dhe të parlamenteve të Lander-ave qeverisin pjesëmarrjen strategjike të Gjykatës në takimet e komisioneve dhe në seancat plenare.

Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian i drejtohet drejtpërsëdrejti auditimit të fondeve komunitare dhe kooperimit me Gjykatën Evropiane të Auditimit.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Detyrat e veçanta të Gjykatës Austriake përcaktohen edhe nga ligje të tjerë. Ligjet që vijojnë kanë një rëndësi të veçantë për punën e Gjykatës: Ligji mbi Kufizimin e të Ardhurave; Ligji mbi Partitë Politike; Ligjit mbi Papajtueshmërinë; Ligji dhe Rregullorja Staffing.

Në rastet kur ka divergjenca opinionesh midis Gjykatës dhe një subjekti juridik në lidhje me kompetencat dhe të drejtat përkatëse, Gjykata mund ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe ti kërkojë asaj zgjidhjen e çështjes. Kjo procedurë është detajuar në Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese.

Zhvillim i Mëtejshëm i Parimeve Ligjore

Gjykata është e angazhuar në kryerjen e aktiviteteve të auditimit në të gjitha fushat e administratës publike dhe ekonomisë shtetërore. Në kuadrin e reformës shtetërore dhe kushtetuese ajo vë në punë metodat që vijojnë:

- Auditim i të gjitha autoriteteve bashkiake
- Auditim i të gjitha sipërmarrjeve në të cilat sektori publik ka të paktën 25% të aksioneve
- Përfshin edhe financimin e drejtpërdrejtë nga BE

Mandati dhe Përfitimet

Gjykata kryen auditime në nivel federal, të lander-ave dhe të bashkive sipas parimit të pavarësisë, siç është përkufizuar në kushtetutë. Ajo verifikon nëse fondet në dispozicion po përdoren me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet. Detyrat kryesore janë ato të shërbimeve të auditimit dhe të konsultimit.

Fushat në të cilat Gjykata mund të auditojë janë përcaktuar nga Kushtetua dhe nga Ligji mbi Gjykatën Austriake të Llogarive i vitit 1948. Për më tepër, Gjykata auditon edhe mbi çështjet financiare:

- Të shtetit, të lander-ave. të bashkësive bashkiake, të bashkive dhe subjekteve të tjerë juridikë të përkufizuar në ligji;
- Të fondacioneve, фондеве, dhe organeve që administrohen nga institucione federale, provinciale, bashkiake ose nga individë që janë vetë pjesëtarë të një institucioni të çfarëdo niveli;
- Të organizatave në të cilat shteti, një land ose bashki (me të paktën 10'000 banorë) zotëron të paktën 50% *share, stock* ose *capital neto*; ose të organizatave që drejtohen nga shteti, nga një land ose bashki vetëm ose bashkë me palët e tjera kontraktuese, ose që kanë

de facto kontrollin mbi të;

- Të fondeve të sigurimeve shoqërore dhe organeve statusore profesionale.
- Ajo merr përsipër edhe kryerjen e disa detyrave të veçanta shumë të rëndësishme, si për shembull hartimi i Deklaratës Financiare Federale, i Deklaratës mbi Borxhin Financiar, rishqyrtimi i projekt–ligjeve dhe rregulloreve, funksionet që rrjedhin nga Ligji mbi Papërpuethshmërinë, nga Ligji mbi Kufizimin e të Ardhurave dhe nga Ligji mbi Partitë Politike. Të rëndësishme janë edhe funksionet që i referohen Raportit mbi Prurjet Mesatare dhe Pensionet e Vjetërsisë të Paguara nga Agjencitë dhe Organet Qeveritare Federale; krijimi i opinionëve të kualifikuara për një grup ndërmjetësimi, në bazë të Paktit të Stabilitetit Austriak 2008.

Në arenën ndërkombëtare Gjykatës i është besuar Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t që nga viti 1968.

Në këtë kontekst Gjykata është një institucion që rrit në mënyrë domethënëse besimin e qytetarëve tek demokracia dhe tek institucionet e saj. Pra ajo arrin të krijojë transparencën e duhur në përdorimin e fondeve publike dhe të kontribuojë kështu në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetin në arenën publike. Në këtë mënyrë Gjykata i shton konsiderueshëm vlerat e saj si institucion auditimi, po ashtu si edhe prodhon nëpërmjet aktivitetit të saj përfitime për shoqërinë në tërësinë e saj.

Auditimi

Aktivitetet thelbësorë të Gjykatës së Llogarive janë shërbimet audituese dhe këshilluese. Auditimi është – strategjikisht – fusha më e rëndësishme e performancës për Gjykatën, i cili hedh edhe bazat për një ushtrim efikas të funksionit këshillues.

Gjykata ndërmerr auditime *ex post*, të cilat i lejojnë asaj të auditoj edhe hapat e kryera gjatë një projekti të papërfunduar, si për shembull auditimi *ex post* i planifikimit të një projekti, realizimi i të cilit ka një shtrirje kohore relativisht të gjatë.

Gjatë procedimit auditues, çështja e kontrollit është në pararojë dhe për këtë arsye, Gjykata angazhohet – mbi baza besimi dhe partneriteti të qëndrueshëm me organizatat që po i nënshtrohen procedimit auditues – që rekomandimet dhe përfundimet e saj të jenë sa më të pranueshme dhe të realizueshme. Pra ky aktivitet i Gjykatës – që nuk ka karakter ndëshkues

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- duhet të ofrojë përfitime organizatave që auditohen dhe të inkurajojë kështu ndryshimet e dëshiruara.

Për këto arsye Gjykatë konsideron veçanërisht mënyrat e kursimit ose mundësitë dhe avantazhet konkurruese, nëpërmjet të cilave organizatat mund të arrijnë realizimin e objektivave të tyre në mënyrë ekonomike, kosto-efektive dhe të përshtatshme.

Aktiviteti auditues i Gjykatës diferencohet sipas tipit të auditimit, mënyrën se si procedimi auditues nisët dhe nga forma e auditimit. Gjatë procedimit auditues, të drejtat specifike të organizatës e cila po auditohet dhe menaxhimi i cilësisë qëndrojnë në një konsideratë të veçantë për Gjykatën. Auditimet janë zakonisht afat mesëm, ose afat gjatë në lidhje me tema të posaçme, ndërsa zbatimi i aktiviteteve audituese është afat shkurtër, hapat e të cilit vendosen në një Program Auditues të Vitit.

Për sa i përket zgjedhjes së tematikave mbi të cilat do të hapen procedime auditimi duhet vënë në dukje rëndësia e disa kriterëve bazë, të cilët janë:

- Rëndësia financiare
- Interesi i veçantë publik i temës
- Efektet parandaluese që mund të prodhoj auditimi në një fushë të posaçme.

Për shkak të ndërthurjes dhe koklavitjes së buxheteve shtetërorë, Gjykata auditon institucionet publike dhe subjektet juridikë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe gjithashtu bashkëpunon në këtë proces me institucione të tjerë auditimi.

Fushat e Aktivitetit të Gjykatës

Gjykata përqendron punën e saj në të gjitha fushat e administrimit dhe merr vendime në lidhje me auditimin e tyre duke u bazuar në rrezikun për shkelje, arritjen e efektivitetit, rëndësinë financiare, ndryshimet e mundshme, temat më të rëndësishme për interesin publik, efektet e mundshme parandaluese dhe avantazhet që rrjedhin nga këto. Në ushtrimin e aktivitetit të saj ajo përdor të gjitha kompetencat që rrjedhin nga natyra e saj si organ federal, i lander-ave dhe bashkiak duke audituar në ato tema për të cilat institucionet e tjerë të auditimit, ose nuk kanë kompetenca auditimi, ose nuk janë në gjendje të auditojnë me të njëjtin efikasitet dhe efektivitet.

Auditimet e Gjykatës përfshijnë edhe të gjitha zonat e aktivitetit politik në përgjithësi, si për shembull, ligjet, puna, mirëqenia sociale, shëndetësia, familja, arsimi, aktivitetet kërkimore, financa dhe ekonomia, infrastruktura.

Fusha strategjike auditimi për Gjykatën janë bizneset në përgjithësi dhe ekonomia (ekuilibri makro ekonomik), reforma administrative e shtetit dhe mbrojtja e mjedisit (ajri, uji, toka, zhurmat). Çdo vit shtohet numri i temave të cilat përfshihen në procedimin planifikues të auditimit. Në vitin 2010 Gjykata u përqendrua në temën: "Krijimi i Transparencës gjatë Ushtrimit të Funkcioneve Publike". Në këtë temë u përfshinë totalisht 14 programe auditimi në planifikimin auditues të vitit.

Llojet e Auditimit

Në arenën ndërkombëtare, auditimi i performancës dhe auditimi financiar konsiderohen të ndryshëm. Praktikisht, ekziston një ndërthurje e tipave. (cfr. International Standards of Supreme Audit Institutions ISSAI 100 no. 39ff)

Programi Auditues

Gjykata e Llogarive Austriake me iniciativën e saj të lire krijon një program vjetor auditimi i cili aprovohet nga Gjykata në pavarësi të plotë për sa i përket tipit, temave dhe metodologjisë së auditimeve që do ndërmerren. Gjykata pra mesatarisht kryen rreth 100 auditime në vit në çdo nivel të administratës federale apo vendore. Seleksionimi i auditimeve bëhet në përputhje me fushat strategjike të auditimit vjetor duke i dhenë rëndësi të veçantë ndryshimeve të rëndësishme financiare, temave me aktuale, interesit publik në disa tema, arritjes së një impakti parandalues dhe përfitimet që burojnë nga ky. Pra iniciativa e lirë e Gjykatës në përzgjedhjen e temave për auditim është pilastri qendror i pavarësisë së saj nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ.

Përveç kësaj, Gjykata ka gjithashtu një mandat kushtetues i cili e lejon atë të kryej auditime mbi disa aktivitete të veçanta (*Special Audits*) mbi bazën e:

- Një rezolute të Këshillit Kombëtar (Neni 126b/paragrafi 4B I Kushtetutës) ose të një parlamenti të një lander-i (Neni 127 Paragrafi 7B Idem):
- Një kërkesë të një anëtari të Këshillit Kombëtar ose të një parlament lander-i (Neni 126b/paragrafi 4B I Kushtetutës):
- Një kërkesë të arsyeshme të qeverisë federale ose të një lander-i (Neni 126b/paragrafi 4B i Kushtetutës):
- Një kërkesë të një ministri federal (Neni 126b/paragrafi 4B I Kushtetutës).

Këto lutje ose kërkesa për të kryer auditime të veçanta (si më sipër) janë shenjë e besimit të thellë mbi korrektesën e veprimtarisë së Gjykatës që është krijuar në opinionin publik. Gjithashtu, këto kërkesa bëhen në respekt të karakterit të pavarur të institucionit në fjalë. Kjo gjë vërtetohet edhe nga fakti se kushtetuta, në nenet e sapo përmendur, parashikon një listë të kufizuar organesh të autorizuar për të bërë kërkesa për të tilla auditime. Pra iniciativa e lirë e Gjykatës është kryesore në këtë kontekst.

Iniciativa e lirë që gëzon Gjykata në zgjedhjen e fushave të auditimit nuk e bën atë një organ të pavarur dhe autoritar. Përkundrazi, ajo i vë një vlerë të veçantë sugjerimeve të shumta për auditim që i vijnë nga deputetët, partitë politike, grupet e interesit, përfaqësuesit e organeve të audituar dhe nga qytetarët e thjeshtë. Në këtë mënyrë Gjykata krijon prioritete të qarta mbi aktivitetet audituese që do të kryej në të ardhmen edhe pse shpesh, për shkak të mungesës së fondeve, ajo nuk është në gjendje të përmbush brenda një kohe të shkurtër të gjitha kërkesat që i vijnë.

Procedura e Auditimit

Me përjashtim të disa llojeve të auditimit, (*“ECA support audits” and “audits of legal professional representative bodies - chambers*), auditimi zhvillohet gjithmonë duke ndjekur një procedurë të përbërë nga 7 hapa, të cilat Gjykata i ka krijuar me kalimin e kohës në mënyrë të pavarur dhe duke u bazuar tek ekspertiza e fituar, duke u bazuar po ashtu edhe tek standardet ndërkombëtare të INTOSAI – t. Pavarësia kushtetuese që gëzon Gjykata i lejon asaj të krijoj programin e saj auditues në mënyrë autonome; i lejon gjithashtu liri në zgjedhjen e formës që raporti mbi auditimin e kryer do të marrë konkretisht.

Përveç kësaj Gjykata bashkëpunon me institucionet e auditimit të landerave dhe institucionin e auditimit të qytetit të Vienës nëpërmjet Rrjetit Auditues të Përbashkët.

Po ashtu edhe bashkëpunimi me subjektet e audituara është një parim themelor i punës së Gjykatës. Ajo respekton arritjet e subjekteve të audituara dhe këndvështrimet e tyre. Kritikën që u drejtohen organeve të audituar bazohen mbi të dhënat dhe faktet e mbledhura, ashtu si edhe mbi argumentime ligjore të shëndosha. Subjektet e audituar janë të lirë të shprehin këndvështrimin e tyre mbi problemet e zbuluara nga Gjykata, mbi vendimet e marra si pasojë e auditimit në vend dhe mbi rezultatet përfundimtare në deklaratën e procedimit auditues.

Për sa i përket përmbajtjes, auditimi përfshin një *spectrum* shumë të gjerë

të aktiviteteve publike, duke filluar nga ato më të thjeshtat, deri tek ato më të hollësishmet. Ato shtrihen duke filluar nga funksionet për të cilat shteti vepron si organ sovran dhe i pavarur deri tek çështjet e rëndësishme të jetës politike dhe financiare aktuale, për të vazhduar me ato problematika që drejt së drejti influencojnë jetën e qytetarëve.

Përfundimet mbi auditimin mund mos të komunikohen ose të publikohen brenda një afati të caktuar ose në ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Çdo informacion i mbledhur nga Gjykata gjatë procedimit auditues (si për shembull bashkëbisedimet, ose dokumentet elektronike dhe në letër) trajtohet me fshehtësinë e duhur. Në këtë mënyrë Gjykata krijon bazat e qëndrueshme për një marrëdhënie bazuar mbi besimin e organeve të audituar tek ajo, si një faktor kryesor për suksesin e veprimitarisë së vetë Gjykatës. Ruhen nga Gjykata edhe sekretet operative dhe të biznesit.

Kriteret e Auditimit

Kriteret e Auditimit të Gjykatës janë parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit mbi bazën e rregullsisë dhe ligjshmërisë (Neni 126b/paragrafi 5B I Kushtetutës). Pra ajo verifikon nëse financat e subjekteve shtetërorë të audituar i përmbushin këto parime dhe nëse punojnë mbi sugjerimet se si të kryejnë punën e tyre në mënyrë sa më ekonomike, efikase dhe efektive.

Pikënisja është korrektesa matematike e financave publike. Së dyti, auditimi duhet të kryet në përputhje me rregulloret aktuale dhe me parimin e ligjshmërisë (Artikulli 18 paragrafi 1B I Kushtetutës), i cili përcakton se administrimi publik në Austri mund të ushtrohet vetëm në përputhje me ligjin. Së fundi, kriteri i ekonomicitetit i referohet minimizimit të shpenzimeve, ndërsa kriteri i efikasitetit i referohet gjetjes së ekuilibrit më të mire midis shpenzimeve dhe prurjeve. Kriteri i efektivitetit i referohet optimizimit të detyrave që mund të realizohen.

Pra këto kriteret i referohen ruajtjes së një buxheti-objektiv, në mënyrë që Gjykata të mund të zbatojë një kontroll tërësor efikas mbi administratën publike dhe aktivitetet e saj: buxheti në dispozicion duhet përdorur në mënyrë të tillë që masat e marra për të arritur objektivat të sjellin përfitimin më të lartë që mund të arrihet.

Për shkak të reformës buxhetore, parime të rinj do marrin rol qendrorë në aktivitetet audituese të Gjykatës në të ardhmen.

Rrjeti Auditues

Auditimi është efektiv vetëm nëse të gjithë subjektet e përfshirë në këtë fushë punojnë bashkë si partner në një rrjet komunikimi të vazhdueshëm. Ndarja e pushteteve në një shtet funksionon në bazë të parimit të peshave dhe kundërpeshave (*'checks and balances'*). Kjo implikon që realisht nuk ka ndarje absolute të pushteteve, por një kontroll reciprok të funksioneve të shtetit. Koncepti abstrakt i auditimit mund të shpërbëhet në shumë aspekte. Së bashku me auditimin, kompetenca e të cilit i përket Gjykatës, ka edhe auditim ligjor që i përket kompetencës së gjykatave të drejtësisë. Si pjesë e sistemit kushtetues, Gjykata është një institucion auditimi financiar parlamentar i jashtëm që vepron *ex post*, por në kohën e duhur. Pra parlamenti është rojtari i auditimit dhe Gjykata merr rolin e saj nga burimi parlamentar. Kështu që Gjykata ndihmon në mënyrë transparente organet përfaqësues në çdo nivel qeverisjeje. Duke qenë një organ federal, i lander-ave dhe bashkive, ajo përdor rolin e saj në ndjekjen e parimit të unitetit dhe harmonisë së auditimit, duke përdorur metoda pune krahasuese midis gjithë subjekteve që auditohen.

Parimi Bazë i Unitetit dhe Harmonisë së Auditimit

Parimi Bazë i Unitetit dhe Harmonisë së Auditimit është afirmuar në praktikën audituese të Gjykatës Austriake që prej vitit 1929 për shkak të arkitekturës federale të shtetit dhe përgjegjësisë buxhetore në çdo nivel qeverisjeje që rrjedh nga kjo. Zhvillimi i mëtejshëm i këtij parimi ka shkaktuar një rritje të përgjegjësisë buxhetore – në sfondin e integritetit evropian – dhe një rritje të marrëdhënieve financiare midis gjithë niveleve të qeverisjes. Këta kanë rezultuar më vonë në një ndërvarësi të koklavitur të lëvizjeve financiare, e cila është zhvilluar paralelisht me zhvillimin dhe ndryshimin e kushtetutës federale.

Përgjegjësia për rregullsi të përgjithshme të buxhetit e kërkuar nga *membership*-i në BE, ekuilibri makro-ekonomik i kërkuar nga kushtetuta federale dhe kriteret e konvergencës së Paktit të Stabilitetit, vënë në dukje nevojën për një auditim publik të njëtrajtshëm. Gjykata Austriake, për shkak të pozicionit të veçantë që zë në arkitekturën federale, është në gjendje të përdorë një metodë ndërthurëse. Pra ajo, brenda kornizës së një teme mbi të cilën po auditon, mund të kryejë auditime horizontale (krahasime midis dy ose më shumë lander-ave), ose auditime vertikale (krahasime vertikale) dhe me rezultatet e arritura i drejtohet të tre niveleve

administrative shtetërore nëpërmjet rekomandimeve të saj duke siguruar kështu unitetin dhe harmoninë e procedurës.

Lufta kundër Korrupsionit

Suksesi më i mirë në luftën kundër korrupsionit arrihet kur çdokush që punon ne organet shtetërorë, në organet auditues, në organet hetues apo në organet legjislativ vepron si bashkëpunues me të tjerët. Një punë e ndërthurur dhe tërësore në këtë fushë garanton një përdorim më të mirë të fondeve shtetërorë. Bashkëpunimi i të gjithëve në rrjetin ndërthurës – gjithmonë duke respektuar pavarësinë dhe fuqinë specifike – ndihmon në mbylljen e boshllëqeve. Pra eliminimi i këtyre mangësive gjatë procedurës audituese duhet të jetë shqetësimi më i madh i të gjithë organeve shtetërore: ligj-bërëse dhe ligj-zbatuese.

Në veçanti Gjykata lufton korrupsionin nëpërmjet funksioneve audituese dhe këshilluese. Gjykata kontribuon konkretisht kur ajo vë në dukje me rekomandimet e saj mangësitë, zbulon parregullsitë dhe parandalon zhvillime të mëtejshëm të padëshirueshëm, duke arritur kështu nivele të larta transparence. Mbi këto baza, organet e audituara dhe organet ligj-bërës janë në gjendje të reagojnë në përputhje me rekomandimet, duke adoptuar masa efektive. Raportet audituese publikohen mbasi i janë nënshtruar këqyrjes së Këshillit Kombëtar ose organit reprezentativ përkatës në mënyrë që impakti i tyre parandalues të forcohet.

Për këto arsye Gjykata ka publikuar gjithashtu një seri kodesh praktike të cilët duhet të ndihmojnë parandalimin e zhvillimeve të padëshiruara dhe përsëritjen e gabimeve.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar Gjykata është aktive në INTOSAI dhe luan një rol kryesor në luftën parandaluese kundër korrupsionit. Në vitin 2009, u takuan në Vjenë përfaqësuesit më të lartë të organizatave ndërkombëtare dhe diskutuan gjatë simpoziumit të 20-të UN/INTOSAI për “ INTOSAI – Partner Aktiv në Rrjetin Anti-Korrupsion Ndërkombëtar: Duke Siguruar Transparencë për të Promovuar Siguri Shoqërore dhe Ulje të Varfërisë”.

Roli aktiv i Gjykatës në hapësirën ndërkombëtare shoqëruar me aktivitetin e saj rekomandues e bën atë një institucion që realisht arrin nivele të larta transparence dhe parandalimi.

□ KLSH po përpiqet që në vitin 2013 të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me këtë SAI të konsoliduar europian.



Gjykata Greke e Auditimit

Në Greqi, Gjykata e Llogarive është njëkohësisht organ administrativ (një nga tre organet më të mëdha të Administratës Publike) dhe Gjykatë e Lartë Auditimi, me një status juridik të veçantë. Në këtë këndvështrim, roli i saj është i dyfishtë.

Dhoma e Llogarive përmban:

- këshillin
- auditimin
- gjyqësorin

Kompetencat

Sipas nenit 98 të Kushtetutës, kompetencat e Gjykatës së Auditimit kryesisht kanë të bëjnë me auditimin e shpenzimeve të agjencive shtetërore dhe lokale, subjektet që i nënshtrohen kontrollit me ligje të veçanta, kontratat me vlerë të madhe financiare të bëra nga shteti ose persona juridik nën përgjegjësinë e shtetit. Gjithashtu, ajo auditon llogaritë e zyrtarëve publikë dhe agjencitë e Qeverisjes Vendore, siguron mendim ekspert mbi ligjet për pensionet, duke paraqitur në Kuvend një raport mbi pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin e shtetit, si dhe rastet që lidhen me llogaritë publike dhe të nëpunësve civilë ose shërbimit ushtarak.

Histori

Dhoma e Llogarive u krijua menjëherë pas pavarësisë së Greqisë në 1833. Ajo është themeluar në bazë të modelit francez “Cour des Comptes”.

Organizimi

Dhoma e Llogarive përfshin:

- Presidentin,
- 8 zëvendës-presidentë,
- 26 Këshilltarë Gjyqësor,
- 44 Gjyqtarë të rangut të dytë
- 50 Gjyqtarë raportues
- Komisioneri i Përgjithshëm para H.C.A.
- Komisioneri i Shtetit
- 3 zëvendës të Komisionerëve të Shtetit

Në bazë të Kushtetutës, të gjithë kanë statusin e gjyqtarit. Në postet e gjyqtarëve raportues, emërohen vetëm të diplomuarit nga Shkolla Kombëtare e Gjyqtarëve. Kryetari dhe zëvendës-kryetarët e Dhomës zgjidhen nga anëtarët e Kabinetit.

Kompetencat

Kompetencat Këshilluese (konsultative)

Kompetenca Këshilluese (konsultative) ushtrohen nga:

- Përgjigje këshilluese, bashkangjitur çdo fature, të cilat rregullojnë pensionet e dhëna nga shteti. Me anë të dispozitave ligjore, kompetencat e saj mund të shtrihen edhe më gjerë.
- Përgjigje këshilluese mbi çështje të ndryshme, kur kërkohet nga Ministrat

Kompetencat e Auditimit

- Dorëzimi në Parlament i raportit vjetor në lidhje me bilancin e shtetit.
- Auditimi i shpenzimeve të shtetit ose të subjekteve publike.
- Mbikëqyrja e nëpunësve civilë, të cilët janë detyruar të japin llogari.
- Mbikëqyrja e të ardhurave publike.
- Auditimi dhe kontrolli i ligjshmërisë së procedurave të prokurimeve dhe punëve publike, vlera e të cilave tejkalon një shumë të caktuar parash.

Juridiksioni

Dhoma operon si Gjykatë e Lartë Administrative, ku vendimet gjyqësore janë përfundimtare dhe të pakthyeshme. Rastet që gjykohen në një seancë plenare janë si më më poshtë:

- Mosmarrëveshjet në lidhje me auditimin e nëpunësve civilë, të cilët janë të detyruar të japin llogari
- Çështjet gjyqësore mbi pensionet, me përjashtim të pensioneve të gjyqtarëve, në bazë të Komisionit Kushtetues, të shqyrtuar në amendimin e vitit 2001
- Mosmarrëveshjet rreth përgjegjësisë së nëpunësve civilë për çdo dëm shkaktuar shtetit ose njërive publike me anë të mashtrimit ose të neglizhencës.

Procedurat

Palët ose ministrat përkatës mund të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme ligjore:

- Padi kundër veprave penale të personelit, duke përfshirë veprat e grupeve të auditimit.
- Korigjimi i vendimeve të gabuara të Departamenteve të Dhomës, të cilat janë gjykuar nga një seancë plenare.

Kuadri Ligjor

- Një nga institucionet më të vjetra të shtetit bashkëkohor grek.
- Mandati i saj përcaktohet nga Kushtetuta.
- 1887: Kontrolli parandalues i shpenzimeve shtetërore iu caktua HCA-së.
- Që atëherë: legjisllacioni në lidhje me punën e HCA-së është plotësuar nga disa dekrete.
- 1969: Ligji për kontabilizimin publik.
- 1972: Kontrolli gjyqësor i fondeve publike.
- 1975: Kompetencat e HCA-së të fituara nga Kushtetuta.
- 1980: Dekreti, që mbulon të drejtat e Gjykatës dhe konsolidimin e dispozitave të mëparshme.
- 1981: Dekreti për procedurat e Gjykatës.

Që atëherë, janë votuar rreth 90 nene, duke bërë modifikime të vogla.

Marrëdhëniet me Gjykatën Evropiane të Audituesve

Neni 248 (ish-neni 188C) i KE-së. Traktati përbën bazën ligjore për bashkëpunimin midis HCA dhe E.C.A.

Parimet themelore që drejtojnë këtë bashkëpunim:

- Parimi i pavarësisë në veprimtarinë e secilit institucion.
- Parimi i profesionalizmit në vendim-marrjen e H.C.A.
- Parimet në përputhje me kërkesat e nenit 10 (neni 5) të KE-së.
- Parimi i përputhshmërisë me sa parashikohet në nenet 246, 247 dhe 248 të KE-së.
- Nuk ka kufizim ligjor në lidhje me format e mundshme të bashkëpunimit (interpretimi i kombinuar i neneve 10 dhe 248 të Traktatit të KE-së).

□ Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit i Shqipërisë gjatë vitit 2012 ka kërkuar intensifikimin e marrëdhënieve dhe gjatë 2013 KLSH shpreson të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me këtë SAI fqinj.



Institucioni Shtetëror i Auditimit i Malit të Zi

Parlamenti i Republikës së Malit të Zi, në seancën e 21 Prillit 2004 miratoi Ligjin për Institucionin Shtetëror të Auditimit (Fletore Zyrtare e Republikës së Malit të Zi, № 28/2004), i cili përcakton krijimin e Institucionit Shtetëror të Auditimit të Republikës së Malit të Zi si institucion i jashtëm, i pavarur, profesional dhe kontrollues i paanshëm i shpenzimeve buxhetore dhe i menaxhimit të pronës shtetërore në Mal të Zi.

Institucioni Shtetëror i Auditimit është një organ i pavarur dhe autonom që funksionon në përputhje me udhëzimet e Deklaratës së Limës, e miratuar në tetor të vitit 1977 në Konferencën e IX-të të INTOSAI-t në Lima (Peru), si një dokument kryesor ndërkombëtar për pozicionin, organizimin ligjor dhe aktivitetet e auditimit të sektorit publik.

Procedura e auditimit duhet të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare INTOSAI-t të miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit anëtarë të INTOSAI-t janë të detyruar të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të udhëzimeve të Deklaratës së Limës.

Institucioni Shtetëror i Auditimit është një organ suprem i kontrollit të buxhetit dhe pronës shtetërore, të njësisive të qeverisjes vendore, fondeve, Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe të gjitha subjekteve të tjera ligjore që shteti ka në pronësinë e tij.

Institucioni përcakton në mënyrë të pavarur subjektet e auditimit, përmbajtjen, vëllimin dhe llojin i auditimit. Një herë në vit, Institucioni është i detyruar të kontrollojë bilancin vjetor të buxhetit të Republikës së Malit të Zi.

Institucioni Shtetëror i Auditimit kontrollon rregullsinë, mbarëvajtjen,

efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve buxhetore dhe menaxhimin e pronës shtetërore. Institucioni njofton Parlamentin e Republikës së Malit të Zi në lidhje me rezultatet e auditivit, duke paraqitur një raport vjetor. Raporti vjetor duhet të paraqitet në Parlament në fund të tetorit.

Në korrik të vitit 2004, Parlamenti i Republikës së Malit të Zi ka emëruar Presidentin dhe anëtarët e Senatit të Institucionit Shtetëror të Auditimit, duke krijuar të gjitha kushtet formale dhe ligjore për vënien në punë të Institucionit.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E INSTITUCIONIT

Institucioni duhet të shqyrtojë rregullshmërinë, efektivitetin, dhe eficiencën e veprimtarive të entit publik që auditon.

Auditimi i rregullshmërisë përfshin mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së veprimtarisë me rregullat dhe standardet e përgjithshme për grumbullimin e të ardhurave publike, financimin e shpenzimeve, përdorimin dhe menaxhimin e pronës, përmbushjen e angazhimeve, mbajtjen e llogarive, dokumentimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe pronësinë dhe menaxhimin e aktiviteteve ekonomike. Auditimi i efektivitetit duhet të shqyrtojë masën e arritjes së qëllimeve të planifikuara. Auditimi i eficiencës duhet të shqyrtojë nëse qëllimet e planifikuara janë arritur me investime minimale të fondeve.

Kur miratohet buxheti dhe pasqyrat financiare të buxhetit në Republikën e Malit të Zi, Institucioni i dorëzon Kuvendit pasqyrën ose përmbledhjen mbi gjetjet në buxhetin e shtetit dhe gjendjen e pasurisë, duke theksuar shkaqet dhe pasojat e çdo gabimi dhe parregullsie dhe duke propozuar masa për eliminimin e tyre.

Në përputhje me nenin 5 të ligjit themelues, Institucioni duhet të kontrollojë dokumentet dhe aktivitetet e subjektit nën auditim, të cilat kanë ose mund të kenë efekt financiar në:

- 1) të ardhurat dhe shpenzimet;
- 2) në pronën ose pasurinë shtetërore;
- 3) në nivelin e borxhit, dhënien e garancive dhe super-garancive;
- 4) Përdorimin eficient të fondeve që i vihen në dispozicion subjekteve nën auditim.

Fushëveprimi, Koha dhe Metoda e Auditimit

Institucioni duhet të jetë i pavarur për vendim-marrjen në lidhje me subjektet që do të auditohen, lëndën, fushëveprimin, qëllimin, llojin e

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

auditimit, kohën dhe metodën e auditimit, përveç parashikimit ndryshe nga ligji themelues. Një herë në vit Institucioni është i detyruar të kryejë auditimin e Pasqyrave Financiare të Buxhetit të Republikës. Plani vjetor i auditimit duhet të miratohet në 10 janar të vitit aktual. Institucioni duhet të fillojë procedurën e auditimit duke e informuar subjektin që do të auditohet për objektin, qëllimin, llojin dhe kohën e auditimit. Institucioni duhet të rezervojë të drejtën për të filluar auditimin pa njoftim paraprak. Institucioni duhet të informojë subjektin e audituar mbi përfundimin e auditimit.

Raporti i Auditimit

Raporti i auditimit duhet t'i dorëzohet subjektit të audituar dhe nëse është e përshtatshme, ti dorëzohet autoriteteve të tjera, kur Institucioni e konsideron të nevojshme.

Subjekti i audituar ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në lidhje me raportin e auditimit, brenda afatit kohor të përcaktuar nga Institucioni. Institucioni mund të raportojë në Kuvend ose në Qeveri, para se subjekti i audituar të ketë shprehur mendimin e tij, në rastet kur dorëzimi i vonuar i raportit mund të shkaktojë dëme, ose kur rezultatet janë zbuluar para kohe për publikun, ose nëse subjekti i audituar nuk ka shprehur mendimin e tij brenda afatit të duhur. Dëmi, referuar në paragrafin 3 të nenit 15 të ligjit themelues, është përcaktuar si humbje financiare për pronën shtetërore ose parandalimin e rritjes së saj.

Institucioni duhet të raportojë në Parlament dhe Qeveri:

- 1) duke paraqitur Raportin Vjetor;
- 2) duke paraqitur raporte të veçanta;
- 3) duke i dhënë këshilla të bazuara në gjetjet e fituara me anë të auditimit.

Raporti Vjetor mund të paraqesë konkluzionet mbi gjetjet e mëparshme dhe rekomandime për vitet e ardhshme fiskale. Ai duhet të dorëzohet në Parlament dhe Qeveri deri në fund të Tetorit.

ORGANIZIMI DHE ORGANET E INSTITUCIONIT

Institucioni organizohet në sektorë. Departamentet organizohen si pjesë e një sektori. Një shërbim i veçantë organizohet për kryerjen e detyrave administrative dhe sigurimin e mbështetjes.

Institucioni ka një Senat dhe Bordin e Auditimit. Senati ka pesë anëtarë. Një Anëtar nga Senati duhet të jetë Drejtuesi i një sektori.

Emërimi i Anëtarëve të Senatit dhe Presidentit

Anëtarët e Senatit emërohen dhe pezullohen nga detyra nga Parlamenti, në bazë të rekomandimeve të organit kompetent të punës së tij.

Parlamenti emëron Presidentin e Senatit nga radhët e anëtarëve të Senatit për një periudhë nëntë vjeçare. I njëjti person nuk mund të riemërohet dy herë.

Një anëtar i Senatit nuk mund të jetë anëtar i Parlamentit, apo të mbajë një detyrë tjetër publike, ose të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër profesional. Një anëtar i Senatit nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi të një partie politike.

Senati vendos me shumicën e votave të të gjithë Anëtarëve të Senatit.

Senati duhet:

- 1) të miratojë Raportin vjetor dhe raportet e veçanta;
- 2) të miratojë planin vjetor të auditimit;
- 3) të marrë vendime në rastet kur asnjë vendim nuk mund të merret në përputhje me nenin 44, paragrafi 3 të ligjit themelues;
- 4) të miratojë udhëzimet për metodën e punës (standardet e auditimit);
- 5) të shqyrtojë, me kërkesë të Bordit të Auditimit, vendim-marrjen e mëparshme të Senatit dhe vendimet e miratuara nga Bordi Auditimit;
- 6) të miratojë Rregulloren e Punës së Institucionit.

Financimi

Fondet për aktivitetet e Institucionit duhet të sigurohen nga buxheti i Republikës. Kërkesa për ndarjen e fondeve buxhetore për Institucionin do të paraqitet nga organi i punës së Parlamentit, i ngarkuar me veprimtarin financiare, me kërkesë të Institucionit.

□ Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit i Shqipërisë gjatë vitit 2012 ka kërkuar intensifikimin e marrëdhënieve dhe gjatë 2013 KLSH shpreson të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me këtë SAI fqinj.



Zyra e Auditimit të Shtetit të Maqedonisë

Statusi i SAO-s

Organet e para të kontrollit të qeverisë janë krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë gjithë këtyre viteve ajo ka pësuar shumë reforma, derisa Zyra e Kontrollit të Shtetit u shndërrua në Institucionin më të Lartë të Auditimit. SAO është themeluar në vitin 1997 nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në bazë të Ligjit të Auditimit Shtetëror (SAL). Deri në qershor të vitit 2006, SAO ka pësuar katër amendime.

Dy amendimet e fundit, përfshijnë dispozita që lidhen me mandatin e auditimit mbi subjektet e sektorit publik, kriteret e planifikimit të auditimit, publikimin e rezultateve të auditimit, shpërblimet, stafin, politikat etj.

SAO ka nisur të funksionojë në fillim të vitit 1999, me nëntë punonjës nga Departamenti i Auditimit në ish Zyrën e Operacioneve të Pagesave. Zyra e Auditimit të Shtetit drejtohet nga Audituesi i Përgjithshëm i Shtetit dhe zëvendësi i tij, të cilët zgjidhen nga Parlamenti për një periudhë prej 10 vjetësh.

Fushat e auditimit

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- Buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore;
- Buxhetet e fondeve;
- Përdoruesit e fondeve të buxhetit dhe shpenzimet e tyre;
- Ndërmarrjet shtetërore;

- Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë;
 - Personat juridikë, në të cilën shteti është aksioneri kryesor;
 - Partitë politike që financohen nga Buxheti;
 - Agjencitë dhe institucionet e tjera të përcaktuara me ligj;
 - Institucione të tjera, të cilët financohen nga fondet publike
 - Përfituesit e fondeve të BE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare.
- Auditimi i Shtetit, në aspektin ligjor, ka të bëjë me:
- Shqyrtimin e dokumenteve, letrave dhe raporteve gjatë kontrolleve dhe auditimeve të brendshme
 - Shqyrtimin e procedurave financiare dhe të kontabilitetit, si dhe të dhënave elektronike dhe sistemeve të informacionit, për të vlerësuar vërtetësinë e pasqyrave financiare dhe përputhshmërinë me standardet e kontabilitetit;
 - Shqyrtimin e transaksioneve financiare të përcaktuara si shpenzime qeveritare, nëse janë në respekt të shpenzimeve të përcaktuara në ligj;
 - Vlerësimin nëse fondet janë shpenzuar ekonomikisht, në mënyrë efikase dhe efektive (auditimi performancës).

Qëllimi i Auditimit

Kryerja e auditimeve përcaktohet në programin vjetor të SAO-s. Subjektet e mëposhtme janë të detyrueshme të auditohen, të paktën një here në vit.

- Buxhetet (buxheti i RM, buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore dhe fondeve);
- Shfrytëzuesit e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
- Buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore;
- Ndërmarrjet shtetërore të themeluara nga Republika e Maqedonisë
- Partitë politike të cilat financohen nga buxheti;

Subjektet e audituara që përfshihen në Programin Vjetor të SAO-s, përzgjidhen në bazë të kritereve të caktuara të tilla si madhësia, shumata e fondeve publike të mbledhura, risqet e menaxhimit, ose me kërkesë të Parlamentit. Numri i përgjithshëm i njësisve ekonomike, të cilat i nënshtrohen auditimit në të gjitha nivelet, është rreth 2000.

Kuadri i metodologjisë

SAO kryen auditime financiare (rregullsinë) dhe të performancës. Auditimi i qeverisë kryhet në përputhje me dispozitat e SAO-s, standardet e INTOSAI-t dhe IFAC-it, Kodin e Etikës së INTOSAI-t, si dhe me legjislacionin në

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

fuqi të Republikës së Maqedonisë. SAO ka krijuar Manualin e Auditimit Financiar dhe të Performancës, të cilat janë vazhdimisht në zhvillim, duke marrë parasysh praktikat më të mira të komuniteteve ndërkombëtare.

Publikimet

SAO paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi auditimet e kryera dhe funksionimin e saj për vitin e kaluar, jo më vonë se data 30 shtator. Ky raport përfshin informacione mbi zbatimin e rekomandimeve, mbi dobësitë sistematike të identifikuara në kontrollet e brendshme, si dhe raste të korrupsionit raportuar nga Komisioni shtetëror Anti-Korrupsion.

Në raport paraqiten edhe raportet e auditimit për zbatimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, buxhetet e ministrive, si dhe fondet dhe ndërmarrjet shtetërore të përcaktuara me ligj. Raportet e auditimit që përmbajnë konstatime për parregullsi të mëdha mund të paraqiten në Parlament edhe para paraqitjes së Raportit Vjetor. Këto raporte vjetore, SAO i publikon edhe në faqen e tij të internetit. Gjithashtu, SAO publikon edhe buletin e tij, i cili u publikua për herë të parë në dhjetor 2005. Audituesi i Përgjithshëm i Shtetit informon publikun mbi rezultatet e auditimit sipas rrethanave.

Financimi

Veprimtaria e SAO-s financohet nga:

- Buxheti i Shtetit, (për përdoruesit e buxhetit dhe përfituesit e fondeve të BE-së dhe fondet e tjera ndërkombëtare)
- Tarifat nga subjektet e audituara, në përputhje me Tarifat e SAO, miratuar nga Parlamenti.

Struktura

SAO përbëhet nga 11 njësi organizative dhe aktualisht ka 79 të punësuar. Qëllimi i tij është të arrij në 125 të punësuar, të cilët do të sigurojnë performancë optimale në aktivitetin e tij.

Anëtarësimi

Zyra e Auditimit të Shtetit është anëtare e:

- INTOSAI-t që nga data 29 Mars 2001;
- EUROSAI-t që nga data 31 Maj 2002,

Zyra e Auditimit e Shtetit të Maqedonisë

- Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit (ËGEA), që nga Tetori 2002
- Grupi i Punës për TI, që nga Dhjetori 2005.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë është duke punuar për të realizuar së shpejti një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e Auditimit të Shtetit të Maqedonisë.



Zyra e Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës

Objektivat

Të sigurojë, me anë të auditimeve, opinione të pavarura për ekzekutimin e buxhetit dhe të pasqyrave financiare, si dhe përdorimin dhe menaxhimin e burimeve dhe pronave shtetërore nga institucionet e B&H.

Zyra njofton institucionet përkatëse dhe opinionin e gjerë publik, mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve, me anë të publikimeve të raporteve të auditimit.

Zyra është një organizatë jo-politike dhe nuk mund të mbështesë ose të bashkëpunojë me ndonjë parti politike.

Kuadri Ligjor

Ligji për institucionet e auditimit të Bosnjës dhe Hercegovinës

I. Dispozita të Përgjithshme

Neni 3

1. Qëllimi kryesor i zyrës së auditimit është që të sigurojë mendime të pavarura mbi ekzekutimin e buxhetit dhe raportet financiare, si dhe përdorimin dhe menaxhimin e burimeve dhe pronës shtetërore nga Këshilli i Ministrave.
2. Zyra e Auditimit informon publikun dhe institucionet përgjegjëse për gjetjet dhe rekomandimet nga publikimin në kohë i raporteve të auditimit dhe me forma të tjera të informimit, nëse këto janë të rëndësishme.
3. Zyra e Auditimit, është organizatë jopolitike dhe nuk mbështet apo krijon lidhje me asnjë parti politike.

Neni 11

(Korniza e Auditimit)

8. Sipas dispozitave të këtij ligji, kompetencat e Zyrës së Auditimit zbatohen në të gjitha institucionet publike të Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë:
 - (a) Parlamentin
 - (b) Presidencën
 - (c) Këshillin e Ministrave dhe institucionet e financuara nga qeveria
 - (d) fondet ekstra-buxhetore që mund të parashikohen nga ligji

9. Kompetencat zbatohen si në vijim:
 - (a) Fondet në formën e një kredie ose të një granti, të cilat sigurohen nga agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare për një projekt të caktuar apo institucion në Bosnjë dhe Hercegovinë.
 - (b) Fondet e siguruara nga buxheti për çdo institucion, organizate apo organ tjetër
 - (c) Çdo njësi, në të cilën shteti zotëron më shumë se 50 për qind të aksioneve.
 - (d) Të gjitha aktivitetet financiare, administrative, programet dhe projektet e menaxhuara nga një ose disa institucione publike, duke përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e pronave, privatizimit dhe koncesionet

Neni 20

(Zyra e Auditimit)

1. Zyra e Auditimit, është institucion më i lartë për auditimet e institucioneve publike të Bosnje dhe Hercegovinës, me seli në Sarajevë.
2. Zyra e auditimit mund të vendosë të ngrejë zyra rajonale kur këto janë të nevojshme për stabilitetin ekonomik të tyre.
3. Zyra për Auditim përbëhet nga: Audituesi i Përgjithshëm, deputetët, personeli i auditimit dhe nëpunësit e zyrës.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar i Zyrës së Auditimit të Institucioneve të

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Bosnjës& Hercegovinës praktikohet nëpërmjet:

- 1) Anëtarësimi në bashkëpunime ndërkombëtare profesionale dhe aktivitetet brenda këtyre shoqatave. Zyra e Auditimit ka qenë anëtare e INTOSAI –t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) qe nga viti 2001 dhe e EUROSAI-t (Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit) që nga viti 2002. Zyra merr pjesë në aktivitetet e këtyre organizatave (kongrese, programe trajnimi, aktivitetet kërkimore,etj), të cilat synojnë përmirësimin e praktikave të auditimit në sektorin publik dhe nxitjen e koordinimit midis institucioneve shtetërore të auditimit;
- 2) Zyra e Auditimit zhvillon bashkëpunime të suksesshme dypalëshe me SAI-t e tjerë në formën e seminareve të përbashkëta, vizitave, shkëmbimeve, përvojave, aftësive dhe informacionit.
- 3) Një aspekt shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar të Zyrës së Auditimit është bashkëpunimi me Gjykatën Europiane të Audituesëve (ECA). Zyra e Auditimit të institucioneve të B&H, së bashku me SAI-t e Shqipërisë, Malit të Zi, Kroacisë, Maqedonisë dhe Turqisë, ka përfaqësuesit e saj në Komitetin e Oficerëve dhe rrjetin e vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale të BE-së dhe merr pjesë në mënyrë aktive në grupet e tyre të punës.
- 4) Përveç bashkëpunimit me SAI-t e tjera dhe organizatat profesionale, Zyra e Auditimit krijon dhe mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e tjera ndërkombëtare të tilla si: Banka Botërore, USAID, SIGMA, GRECO, etj.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë do të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi gjatë vitit 2013 me këtë SAI të rajonit.



Gjykata Rumune e Llogarive

Misioni, Vizioni, Vlerat dhe Objektivat Strategjike

Misioni i Gjykatës së Llogarive është të kryejë funksion kontrollues mbi shtetin, si dhe mbi krijimin, përdorimin dhe menaxhimin e burimeve të sektorit publik. Kjo gjykatë i raporton Parlamentit dhe autoriteteve publike gjetjet nga aktiviteti i saj, në mënyrë që të sigurojë ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Gjykata e llogarive promovon, llogaridhënien, korrektësinë dhe praktikën më të mira në operacionet që përfshijnë fondet publike, duke siguruar shërbime cilësore në fushën e kontrollit dhe të auditimit të jashtëm publik. Kjo gjë bëhet për të marrë dhe dhënë informacione reale dhe objektive mbi ligjshmërinë, efikasitetin dhe transparencën në përdorimin e fondeve publike dhe atyre nga jashtë. Kjo gjykatë ka përmirësuar vazhdimisht kontrollin dhe mekanizmat e auditimit të jashtëm, si dhe raportet që harton, për të mbështetur Parlamentin në kryerjen e kompetencave dhe detyrave kushtetuese. Gjykata e Llogarive është angazhuar për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit në fushën e shpenzimeve të fondeve publike dhe për të promovuar një nivel të lartë profesional në mënyrë që auditimi i jashtëm publik në Rumani të jetë në përputhje me praktikën evropiane dhe ndërkombëtare.

Vizioni i Gjykatës së Llogarive mbështet një kontroll të shëndoshë, të besueshëm dhe të efektshëm të sistemit të auditimit, si dhe rrit ndikimin social. Gjykata rumune e llogarive është një nga institucionet themelore të shtetit që gëzon pavarësinë financiare, operacionale dhe organizative, në përputhje me rekomandimet e Deklaratës së Limës. Aktiviteti i saj kryhet në mënyrë autonome, me anë të procedurave publike të auditimit të jashtëm, të përcaktuara sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit. Ashtu si

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

institucionet e ngjashme të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Gjykata e Llogarive ka një rol kyç në promovimin dhe përgjegjësinë në përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike, duke përfshirë edhe ato që ndahen nga BE-ja dhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare në Rumani, si dhe luftën kundër korrupsionit. Kjo gjykatë është e përkushtuar për të eliminuar gabimet dhe parregullsitë dhe për të përmirësuar menaxhimin e parave publike.

Vlerat që nxit kjo gjykatë kanë të bëjnë me respektimin e Kushtetutës dhe të ligjit, pavarësinë, objektivitetin, profesionalizmin, llogaridhënien, integritetin, transparencën, paanshmërinë dhe efektivitetin.

Objektivat strategjike janë:

- zbatimi i rregullave në fushën ekonomike, financiare dhe ligjore
- identifikimi i gabimeve të mundshme ose parregullsi në hartimin e pasqyrave financiare, në menaxhimin e saktë dhe të shëndoshë të përdorimit të fondeve publike, si dhe zbatimi i masave për eliminimin e tyre.
- zhvillimi i auditimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe me direktivat evropiane për zbatimin e tyre
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të Gjykatës së Llogarive rumune si një institucion i pavarur, profesional dhe i besueshëm për kontrollin e fondeve publike, auditimin e jashtëm dhe mbrojtjen e interesave financiare të shtetit rumun dhe të Komunitetit Evropian.

Baza Ligjore

Kushtetuta e Rumanisë

Neni 140

Gjykata e Llogarive

- (1) Gjykata e Llogarive kryen kontrollin e krijimit, menaxhimit dhe përdorimit të burimeve shtetërore dhe publike në sektorin financiar. Në përputhje me ligjin, veprimtaria e Gjykatës së Llogarive duhet të përcaktohet nga gjykatat e specializuara.
- (2) Gjykata e Llogarive paraqet në Parlament, çdo vit, një raport mbi auditimin e menaxhimit dhe zbatimin të buxhetit të shtetit, duke identifikuar parregullsitë e konstatuara
- (3) Me kërkesë të Dhomës së Deputetëve ose të Senatit, Gjykata

shqyrton menaxhimin e burimeve publike dhe raporton për to.

- (4) Këshilltarët e Gjykatës së Llogarive emërohen nga Kuvendi për një periudhë nëntë-vjeçare, e cila nuk mund të zgjatet ose të rinovohet. Anëtarët e Gjykatës së Llogarive janë të pavarur në ushtrimin e mandateve të tyre dhe të pazëvendësueshëm në të gjithë kohëzgjatjen e hetimit.
- (5) Gjykata e Llogarive rinovohet nga një e treta e këshilltarëve të emëruar nga Kuvendi, çdo tre vjet, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin organik të Gjykatës.
- (6) Anëtarët e Gjykatës së Llogarive revokohen nga Kuvendi, në rastet e përcaktuara me ligj.



Institucioni i Auditimit të Shtetit të Serbisë (SAI)

Institucioni më i Lartë i Auditimit është autoriteti më i lartë për auditimin e fondeve publike në Republikën e Serbisë. Ai u krijua në vitin 2005, në bazë të Ligjit mbi Institucionin e Kontrollit të Shtetit. Ky institucion është një organ i pavarur shtetëror.

Institucioni është përgjegjës në Asamblenë Kombëtare të Republikës së Serbisë për kryerjen e veprimtarive që rrjedhin nga kompetencat e tij.

Ky institucion ushtron aktivitete që rrjedhin nga kompetenca e tij në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Serbisë, Ligjin mbi Institucionin e Auditimit të Shtetit dhe Rregulloren e Punës së Institucionit të Kontrollit të Shtetit.

Institucioni duhet të ketë Rregulla Procedurale, të cilat, në bazë të Ligjit, përcaktojnë në hollësi mënyrën dhe procedurën për kryerjen e aktiviteteve që rrjedhin nga kompetencat e institucionit, mënyrën për të siguruar funksionimin transparent, procesin e vendimmarrjes dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e institucionit.

Ky institucion ka një President, një Zëvendës President, Këshillin, Departamente Auditimi dhe Departamente për Shërbimet Ndihmëse. Departamentet e Auditimit drejtohen nga Audituesit më të Lartë të Shtetit. Aktivitetet audituese kryejnë nga audituesit e shtetit (revizori shtetëror dhe audituesi i certifikuar shtetërorë).

Mënyra dhe shtrirja e aktiviteteve brenda departamenteve të institucionit, si dhe organizimi i brendshëm dhe klasifikimi i punëve, përcaktohen me hollësi në Rregulloren dhe Organizimin e Brendshëm, të miratuara nga Këshilli me propozim të Presidentit të Institucionit .

Kodi i Etikës i këtij institucioni, përcakton me hollësi parimet etike, rregullat e pranuar të sjelljes në përgjithësi dhe standardet profesionale që zyrtarët shtetërorë, audituesit dhe punonjësit e tjerë duhet t'i përmbahen. Rregullat e Kodit zbatohen edhe për ekspertë të jashtëm, të angazhuar në këtë institucion, gjatë kryerjes së aktiviteteve që rrjedhin nga kompetencat e tij. Audituesit shtetërorë dhe punonjësit e tjerë, janë të detyruar të respektojnë dhe të zbatojnë në mënyrë rigoroze Ligjin mbi Institucionin e Auditimit të Shtetit, si dhe Kodin etik dhe standardet e miratuara të INTOSAI-t.

Kompetencat

Institucioni i Auditimit të Shtetit, si autoriteti më i lartë i auditimit të fondeve publike, kryen këto aktivitete brenda kompetencave të tij:

1. Planifikon dhe kryen auditime në përputhje me Ligjin për Institucionin e Auditimit të Shtetit;
2. Miraton akte nënligjore dhe rregullore të tjera për qëllime të zbatimit të Ligjit
3. Dorëzon raporte në Asambleenë Kombëtare të Republikës së Serbisë dhe kuvendet e autoriteteve lokale;
4. Formulon qëndrime dhe mendime, si dhe forma të tjera të opinionëve publike në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e dispozitave të veçanta të Ligjit mbi Institucionin e Auditimit të Shtetit;
5. Nëse është e nevojshme dhe në përputhje me kapacitetet e saj, i ofron ndihmë profesionale Kuvendit, Qeverisë dhe autoriteteve të tjera shtetërore për projekte të rëndësishme, pa cënuar pavarësinë e institucionit;
6. Mund të japë këshilla për përfituesit e fondeve publike;
7. Mund të japë sugjerime për draft propozimet e ligjeve dhe rregulloreve të tjera, si dhe për çështjet në fushën e financave publike;
8. Mund të nxjerrë rekomandime për ndryshime në ligjet e aplikueshme, bazuar në informacionin e marrë gjatë auditimit
9. Miraton dhe publikon standardet e auditimit në lidhje me fondet publike, manuale auditimi dhe dokumentet e tjera të ekspertëve, të rëndësishme për zhvillimin e profesionit të auditimit;
10. Përcakton programet e trajnimit dhe nxit marrjen e titullit “auditues shtetëror i certifikuar”, organizon provime për marrjen e certifikimeve

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

shtetërore të ndryshme dhe mban regjistrin e personave që kanë fituar këta tituj;

11. Përcakton kriteret dhe kryen njohjen e titujve të ekspertëve, me kompetenca që institucioni ka fituar jashtë vendit;

12. Bashkëpunon me audituesit ndërkombëtarë dhe organizatat në fushën e kontabilitetit dhe auditimit të sektorit publik;

13. Vepron në çështje të tjera të përcaktuara në Ligjin mbi Institucionin e Auditimit të Shtetit.

Organizimi dhe Përbërja

Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Institucionin e Auditimit të Shtetit dhe Rregullores së Brendshme, ky institucion duhet të ketë: një Presidentin, Nënkrjetarin, Këshillin, departamentet e auditimit dhe shërbimet ndihmëse të departamenteve.

Këshilli është organi më i lartë i institucionit dhe organizohet në formë kolegjiale me pesë anëtarë, përkatësisht Presidenti, Nënkrjetari dhe tre anëtarë të cilët konsiderohen zyrtarë të institucionit. Këshilli merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, në seanca që kryesohen nga Kryetari i Këshillit apo zëvendësi i tij. Rregullat procedurale për funksionimin e Këshillit, përcaktojnë në hollësi çështjet lidhur me operacionet e Këshillit. Kryetari i Këshillit është në të njëjtën kohë edhe Kryetari i Institucionit, si dhe kryen edhe funksionin e Auditorit të Përgjithshëm. Ky Institucion ka në përbërje edhe Audituesit e Lartë Shtetëror, të cilët janë zyrtarët që menaxhojnë departamentet e auditimit. Institucioni i Auditimit të Shtetit duhet të ketë një sekretar, i cili është një zyrtar i Institucionit dhe menaxhon departamentin e shërbimeve mbështetëse.

Anëtarësimet

1. Institucioni i Auditimit të Shtetit të Serbisë ka fituar anëtarësinë e plotë në INTOSAI në Nëntor 2008.
2. Ai ka fituar anëtarësinë e plotë në EUROSAI më 23 Qershor 2009.
3. Është anëtare e Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe kandidatë potenciale e BE-së, në Gusht të vitit 2010.
4. Raporti i parë i auditimit financiar për deklaratën vjetore të llogarive të Buxhetit të Republikës së Serbisë, u dorëzua në Asambleshë Kombëtare të Republikës së Serbisë më 27 Nëntor 2009.

5. Raporti vjetor për vitin financiar buxhetit 2010 të Republikës së Serbisë, u dorëzua në Asamblenë Kombëtare të Republikës së Serbisë më 16 Dhjetor 2009.



Zyra Kombëtare e Auditimit e Bullgarisë

Informacion i përgjithshëm

Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon traditat buxhetore të kontrollit të Dhomës së Lartë të Kontrollit, e cila është themeluar me ligj në 1880 dhe ka funksionuar deri në vitin 1947.

Neni 91 i Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë thekson si më poshtë:

(1) Asambleja Kombëtare e ka themeluar Zyrën Kombëtare të Kontrollit Financiar për të mbikëqyrur zbatimin e buxhetit.

(2) Organizimi, kompetencat dhe procedurat me të cilat Zyra Kombëtare e Auditimit të Brendshëm duhet të veprojnë, themelohen me ligj.

Sipas Nenit të ri për Zyrën e Auditimit Kombëtar të miratuar në dhjetor të vitit 2010, NAO përbëhet nga një president dhe dy nënkryetarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare.

NAO ushtron kontroll mbi zbatimin e buxhetit, në fondet e tjera publike dhe ato të aktiviteteve, në përputhje me nenin e NAO-s dhe standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit.

Detyra kryesore e Zyrës së Auditimit Kombëtar është të kontrollojë besueshmërinë dhe vërtetësinë e deklaratave financiare të buxhetit të financuara nga organizatat, ligjshmërine, eficienten, efikasitetin dhe ekonomikitetin e menaxhimit të fondeve publike dhe aktiviteteve, si dhe për t'i siguruar Asamblesë Kombëtare informacion të besueshëm.

Zyra Kombëtare e Auditimit është e pavarur në kryerjen e veprimtarive së saj dhe i raporton ato drejtpërdrejt në Asambleshë Kombëtare.

Operacionet e Zyrës së Auditimit Kombëtare janë kryer në bazë të parimeve të mëposhtme:
- Selia e OAG-së ndodhet në Oslo, ndërkohë që rreth 100 anëtarë të stafit kanë zyrat e tyre në 17 vende të tjera të Norvegjisë
- OAG është themeluar në vitin 1816



Rolet dhe detyrat

- Auditimi i llogarive të pushtetit qendror (auditimi financiar);
- Auditimi i llogarive të ministrive dhe agjencive të ndryshme qeveritare (auditimi financiar);
- Hetim sistematik i ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit (auditimi i performancës);
- Të monitorohet menaxhimi i interesave të pronave shtetërore (kontrolli i korporatave);
- Të japë udhëzime për administrimin e qeverisë në çështje lidhur me llogaritë dhe ekonominë, duke përfshirë edhe promovimin e parandalimit të defekteve dhe mangësive në të ardhmen;
- Të raportojë rezultatet e auditimeve dhe monitorimeve tek Parlamenti.

Nëpërmjet kontrolleve të saj, OAG kontribuon në parandalimin dhe zbulimin e parregullsisve dhe gabimeve. Me marrëveshje të veçanta, OAG mund të ndërmarrë edhe monitorime dhe auditime ndërkombëtare.

Parlamenti mund të udhëzojë OAG-në për të ndërmarrë hetime të veçanta. Detyrat e OAG-së janë përcaktuar në nenin 75 të Kushtetutës, në ligjin mbi Audituesin e Përgjithshëm dhe në rregulloret e tij shoqëruese.

Zyra e Audituesit të Përgjithshëm si një agjenci e monitorimit në shoqërinë norvegjeze

Norvegjia ka formë qeverisjeje parlamentare, ku qeveria është e varur nga Parlamenti. Parlamenti mban pushtetin legjislativ, ndërsa qeveria pushtetin ekzekutiv.

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

OAG varet nga Parlamenti dhe monitoron përputhshmërinë e aktiviteteve të qeverisë me vendimet e Parlamentit. OAG është organi më i rëndësishëm monitorues i jashtëm i Parlamentit. Parlamenti mund të emërojë një auditues të jashtëm për të kontrolluar OAG-në.

Qëllimi i auditimit dhe monitorimit të OAG-së

Llogaritë e pushtetit qendror

Agjencitë qeveritare

Fondet e qeverisë dhe të agjencive me kompetenca të veçanta

Kompani të organizuara sipas legjislacioneve të veçanta

Ndërmarrjet shëndetsore shtetërore

Kompanitë pjesërisht shtetërore me përgjegjësi të kufizuara

Publikime

Publikimet më të rëndësishme të OAG-së janë “Raportet” 1 dhe 3, të cilët ofrojnë informacione mbi rezultatet e auditimit për Parlamentin dhe publikun në përgjithësi. Rezultatet e auditimit mund të gjenden të përmbledhura edhe në raportin vjetor, të përkthyer në gjuhën angleze.



Raportet Administrative

Raportet administrative janë auditime performance, ku gjetjet e auditimit janë më pak serioze dhe nuk i adresohen Parlamentit. Ato i dërgohen Komitetit të Përhershëm për shqyrtim dhe ministrive përkatëse apo organeve kushtetuese për dijeni.

Raportet vjetore

Çdo vit, OAG publikon një raport vjetor në dokumentin 2, i cili është një përmbledhje e aktiviteteve të saj. Raporti përmban një përmbledhje të shkurtër të Dokumentit 1 dhe 3, një pasqyrë të aktiviteteve ndërkombëtare gjatë vitit të mëparshëm, si dhe një përmbledhje statistikash. Ky raport publikohet edhe në anglisht.

Revista e brendshme

“Observajsonsposten” është revista e brendshme e OAG-së, e cila publikohet 6 herë në vit. Kryesisht revista përmban të dhëna për auditimet dhe OAG-në.

RIGSREVISIONEN



Agjencia Kombëtare e Auditimit të Danimarkës (Rigsrevisionen)

Rigsrevisionen është themeluar më 1 janar 1976 përmes bashkimit të dy departamenteve të auditimit, duke ju përmbajtur ligjit mbi “Audituesin e Përgjithshëm” të vitit 1975.

Në vitin 1991, varësia e Rigsrevisionen u transferua nga Ministria e Çështjeve Ekonomike tek Parlamenti (Folketing). Projekt-ligji për ndryshimet mbi “Audituesin e Përgjithshëm” u hartua nga PAC, Prezantuar nga Kryesia e Kuvendit dhe miratuar në mënyrë unanime nga Folketing. Sot, Rigsrevisionen është një institucion i pavarur nën autoritetin e Parlamentit. Audituesi i Përgjithshëm emërohet nga Kryetari i parlamentit, me rekomandimin e PAC, përcaktuar në ligjin mbi “Audituesin e Përgjithshëm”, seksioni 1.

Rigsrevisionen është një institucion publik. Detyra e tij parësore është të auditojë llogaritë dhe të shqyrtojë nëse fondet shtetërore administrohen në përputhje me vendimet e Parlamentit.

Rigsrevisionen është një organizatë që i raporton Parlamentit, megjithatë, i pavarur në kryerjen e detyrave të tij. Ai është i paanshëm dhe objektiv në qëndrimin gjatë kryerjes së auditimeve.

Rigsrevisionen kryesohet nga një Auditues i Përgjithshëm, i cili bashkëpunon me Komitetin e Llogarive Publike. Ky i fundit, sipas Kushtetutës, mbikëqyr kontrollin e auditimit në administratën publike. Ai qëndron mbi Audituesin e Përgjithshëm për të ndihmuar Rigsrevisionen në shqyrtimin e llogarive të saj dhe për të kryer ekzaminimet e kërkuara nga ky Komitet.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Rigsrevisionen ka një staf prej rreth 270 individësh nga disiplina të ndryshme, të cilët reflektojnë gamën e gjerë të detyrave që kryen ky institucion.

Rigsrevisionen i bën publike rezultatet e aktivitetit të saj edhe në faqen kryesore të internetit.

Aktiviteti

Rigsrevisionen punon me sipas planeve strategjike katër-vjeçare. Strategjia për periudhën 2012-2015 reflekton dy zhvillime kryesore:

1. Të Sigurojë se fondet publike shpenzohen dhe menaxhohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Kjo është bërë një çështje gjithnjë e më e rëndësishëm në kushtet e krizës financiare. Subjektet e audituara duhet të dokumentojnë se ato ofrojnë shërbime të nivelit të lartë dhe efikas për qytetarët dhe bizneset. Këto shërbime duhet të ofrohen në përputhje me buxhetin e përcaktuar dhe në përputhje me objektivat administrative dhe politike. Funksionet themelore të njësive të kontabilitetit duhet të lehtësojnë kontrollin e buxhetit. Gjithashtu organet e qeverisë duhet të jenë në gjendje të ndajnë në mënyrë shumë të saktë shpenzimet për aktivitetet e tyre.
2. Administrata publike, në vitet e fundit, ka qenë subjekt i një politike të shtrënguar të shpenzimeve dhe të dhënat tregojnë se presioni ekonomik në sektorin publik do të rritet në vijim. Në periudha të vështira ekonomike, Rigsrevisionen kontribuon duke siguruar se kontrolli i saj krijon vlerë për qytetarët.

Rigsrevisionen ka përcaktuar një mision të ri dhe objektiva strategjike për periudhën 2012 – 2015, për të ndihmuar në arritjen e efektit të dëshiruar në aktivitetet e saj.

MISIONI

Auditimet shtetërore të Rigsrevisionen janë përgjegjëse për zhvillimin e administratës në mënyrë që të krijojë vlera për qytetarët.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- kontribuon për menaxhimin efektiv financiar dhe raportimin konçiz të rezultateve
- nxit cilësinë, efektivitetin, efikasitetin dhe ekonominë në administrim
- mbledh dhe komunikon informacione në të gjithë sektorët, duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin e administratës si dhe të auditimit në sektorin publik.

Vlerat

Puna e Rigsrevisionen e ka pikënisjen nga një sërë vlerash. Përcaktimi i vlerave të organizatës ka qenë një projekt i përbashkët për të gjithë stafin. Vlerat sigurojnë që Rigsrevisionen, në procesin e plotësimit të objektivave, të demonstrojë vlerësimin dhe kredibilitetin dhe të jetë i fokusuar në një mjedis të karakterizuar nga një kulturë pune tërheqëse.

Roli Social i Rigsrevisionen

Kontrolli i pavarur

Rigsrevisionen është organ i pavarur i kontrollit të qeverisë, i cili kontribuon për të inkurajuar një administrim efikas dhe ligjor.

Integriteti

Rigsrevisionen ruan integritetin e tij duke qëndruar i pavarur dhe duke ushtruar kompetencat e tij.

Në fokus

Rigsrevisionen dëshiron të sjellë ndryshime pozitive, duke siguruar vlerë për shtetin dhe qytetarët.

Bashkëpunimi

Rigsrevisionen përqendrohet në shkëmbimin e informacioneve dhe njohurive brenda dhe jasht vendit

Punë tërheqëse

Rigsrevisionen synon të ofrojë mundësi për zhvillimin personal dhe profesional.

Fleksibiliteti

Rigsrevisionen vlerëson fleksibilitetin dhe transparencën, dhe kërkon të krijojë një ambient pune të karakterizuar nga siguria dhe besimi reciprok.

Objektivat e performancës në vitin 2012

kontribuon për menaxhimin efektiv financiar dhe raportimin konçiz të rezultateve

- të kryejë auditime vjetore në të gjitha subjektet qeveritare dhe të japë opinione mbi auditimin për 100 subjekte
- të zhvillojë standardet për auditimin e menaxhimit financiar.
- të zhvillojë modele auditimi më të zgjeruara.

Nxitja e cilësisë, efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në administrim

- Cilësia teknike e aktiviteteteve është vlerësuar “e kënaqshme” nga vlerësuesit e jashtëm.
- Cilësia e gjuhës së përdorur në studimet e kryera, është vlerësuar “e kënaqshme” nga vlerësuesit e jashtëm.
- 90% e të gjithë rasteve të raportimeve duhet të mbyllen brenda tre vjetësh, veprimi i ndërmarrë nga ministri në këtë hapësirë kohore duhet të konsiderohet i kënaqshëm nga ana e auditorit të përgjithshëm
- 75% e studimeve paraprake duhet të jenë të paktën në një nga tre zonat e fokusit, pra efektiviteti, efikasiteti dhe ekonomiciteti i menaxhimit financiar.

Mbledhja dhe komunikimi i njohurive në të gjithë sektorët, duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin e administratës si dhe të auditimit në sektorin publik.

- Dërgon të paktën tre raporte të ndërthurura mes departamenteve, tek Komitetit i Llogarive Publike.
- Raporti mbi auditimin e llogarive të shtetit për vitin 2011 duhet të referohet të paktën një prej tre auditimeve të ndërthurura mes departamenteve.
- Jep kontributin për të marrë pjesë në të paktën 10 ngjarje të rëndësishme të administratës dhe audituesve të tjerë të sektorit publik.



Zyra Kombëtare e Auditimit e Finlandës

Zyra Kombëtare e Auditimit ka qenë historikisht organi më i rëndësishëm monitorues financiar në Finlandë. Ai është institucioni më i vjetër shtetëror finlandez, përgjegjës për auditimin dhe menaxhimin financiar të ekonomisë shtetërore.

Zyra Kombëtare e Auditimit është Institucioni më i Lartë i Auditimit të Finlandës dhe i raporton drejtpërdrejt Kuvendit. Ajo auditon financat e shtetit dhe menaxhon asetet në mënyrë që të sigurojë që fondet publike janë shpenzuar në mënyrë sa më ekonomike dhe në përputhje me legjislacionin. Së bashku me administratën, Zyra Kombëtare e Auditimit punon për të zhvilluar një menaxhim të shëndoshë financiar dhe për të siguruar përdorimin e drejtë dhe efektiv të fondeve publike. Si një ekspert i pavarur, ai mbështet Kuvendin, Qeverinë dhe administratën shtetërore në vendimmarrje.

Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO)

Zyra Kombëtare e Auditimit të Finlandës është organ ekspert i pavarur dhe neutral. Detyra e saj është të kontrollojë ligjshmërinë dhe drejtësinë e menaxhimit financiar dhe në përputhje me buxhetin e shtetit. Zyra Kombëtare e Auditimit informon Parlamentin, Qeverinë dhe nivelet e tjera të administratës mbi menaxhimin financiar të shtetit, dhe të aktiviteteve administrative.

KLSH - EUROSAT dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Zyra Kombëtare e Auditimit mbron interesat e qytetarëve dhe taksapaguesve, me anë të auditimit të të ardhurave shtetërore, përdorimit të fondeve publike, si dhe menaxhimit të pronës shtetërore. Me anë të auditimit, ajo nxit ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në administratën shtetërore, që lidhen me kontrollin e menaxhimit financiar. NAO ka të drejtë të marrë të gjithë informacionin që i nevojitet nga subjekti i audituar, për kryerjen e detyrave të tij. Autoritetet shtetërore dhe ndërmarrjet e biznesit, duhet të raportojnë menjëherë, çdo rast shpërdorimi të fondeve në Zyrën Kombëtare të Auditimit. NAO i raporton organeve përkatëse parregullsitë dhe mbikëqyr nëse mangësitë e vërejtura janë korrigjuar.

Organizimi

Zyra Kombëtare e Auditimit drejtohet nga Audituesi i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Parlamenti për një periudhë prej gjashtë vjetësh. Audituesi i Përgjithshëm është Dr Tuomas Pöysti.

Zyra Kombëtare e Auditimit përfshin auditimin financiar, auditimin e performancës dhe menaxhimin e njësive ekzekutive, të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e auditimit dhe raportimin në Parlament. Ajo përfshin gjithashtu edhe njësitë e Administrimit dhe Informacionit.

NAO ka një staf prej rreth 150 punonjësish me seli qendrore në Helsinki dhe me degë në Turku dhe Oulu. Statusi, detyrat dhe aktivitetet e NAO-s, përshkruhen në nenin 90 të Kushtetutës së Finlandës dhe në akte të tjera të caktuara.

Kuadri Ligjor

Ligji mbi Zyrën Kombëtare të Auditimit (miratuar në Helsinki, më 14 Korrik 2000)

Pozita dhe detyrat

Ka një organ të pavarur të Kontrollit të Shtetit, i cili lidhet me Parlamentin. Detyra e Zyrës së Auditimit është të sigurojë ligjshmërinë dhe efektivitetin e menaxhimit financiar të shtetit si dhe pajtueshmërinë me buxhetin. Detyrat e NAO-s nuk përfshijë auditimin e menaxhimit financiar të Parlamentit, të fondeve për të cilat Kuvendi është përgjegjës, të Bankës së Finlandës apo institucioneve të sigurimeve shoqërore.

E drejta e NAO-s për të mbikëqyrur transferimin e fondeve nga Finlanda drejt BE-së, përcaktohet me ligje të veçanta

Të drejtat e auditimit

Zyra e Auditimit të shtetit ka të drejtë të auditojë:

1. autoritetet shtetërore, agjencitë, ndërmarrjet e biznesit, grupet e biznesit dhe fondet shtetërore
2. kompanitë në të cilat shteti ka interesa dhe kompanitë e tjera të përmendura në nenin 19, veçanërisht kur përcaktohet se janë përdorur pronësia dhe aksionet e shtetit
3. komunat, federatat komunale, fondacionet dhe organizatat e tjera, personat juridik dhe personat privat, të cilët kanë marrë fonde ose mbështetje apo përfitime ekonomike nga shteti. Audituesit përcaktojnë nëse informacionet mbi dhënien e fondeve janë të sakta dhe nëse këto fonde janë përdorur për qëllimet e duhura.
4. organizatat dhe subjektet e tjera ligjore, të cilat kanë marrë leje nga shteti për të prokuruar fonde, për ti përdorur ose shpërndarë për një qëllim të veçantë
5. institucionet e kreditimit ose organizata të tjera që kujdesen për transaksionet financiare të shtetit, ose përdorin dhe menaxhojnë fondet dhe pronat shtetërore
6. fonde të tjera për të cilat shteti është përgjegjës.

Parashikimet e paragrafit 1 pika 3, lidhur me përfituesit e mbështetjes shtetërore, janë gjithashtu të zbatueshme edhe për ndërmjetësit dhe palët të cilët kanë transferuar fondet. Audituesit nuk mund të ushtrojnë kompetencat e tyre për fondet e marra nga persona privatë, për qëllime personale

Raportimi në Parlament

NAO duhet të paraqesë në Parlament një raport mbi veprimtarinë e tij, çdo vit deri në fund të shtatorit, si dhe raporte të tjera të veçanta sipas nevojës. Me anë të raporteve, ka të drejtë të marrë informacione edhe Komisioni Parlamentar.

Audituesi i Përgjithshëm

Aktivitetet e Zyrës së Auditimit drejtohen nga Audituesi i Përgjithshëm, i cili është përgjegjës për të gjitha çështjet, përveç atyre që janë përgjegjësi e Bordit, ose për çështje për të cilat në ligj përcaktohet ndryshe.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Audituesi i Përgjithshëm zgjidhet nga Parlamenti. Dispozita të mëtejshme në lidhje me zgjedhjet, përfshihen në procedurën e Parlamentit (40/2000). Mandati i Audituesit të Përgjithshëm zgjat 6 vjet dhe vazhdon deri në momentin që fillon mandati i Audituesit të ardhshëm. Audituesi i zgjedhur do të lirohet nga çdo detyrë e mëparshme, gjatë ushtrimit të detyrës si auditues i përgjithshëm.

Audituesi i Përgjithshëm vendos se si të paraqesë çështjet për të cilat ai është përgjegjës.

Bordi Këshillues

Në strukturën e saj, NAO ka edhe një Bord Këshillues. Detyrat e këtij Bordi janë të ruajë dhe të zhvillojë lidhjet e NAO-s me partnerët, të ndërmarrë iniciativa për zhvillimin e auditimeve dhe të monitorojë efektivitetin në marrëdhëniet me partnerët. Bordi e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të tij.

NAO mund të emërojë si anëtarë të Bordit, përfaqësues nga partnerët kyç të bashkëpunimit ose ekspertë të administrimit financiar publik, për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.

Raportimi i abuzimeve

Pavarësisht nga rregullat e konfidencialitetit, çdo autoritet shtetëror, agjenci apo ndërmarrje biznesi, duhet të raportojë menjëherë në Zyrën e Kontrollit të Shtetit, për çdo shpërdorim të fondeve ose pronave që ajo menaxhon ose për të cilat është përgjegjës.

Ligji mbi të drejtën e Zyrës së Auditimit për të audituar transfertat të caktuara mes Finlandës dhe Komunitetit Evropian (17 Mars 1995/353).

Qëllimi i aplikimit

Ky ligj zbatohet për transfertat e kredive mes Finlandës dhe Komunitetit Evropian dhe auditon përdorimin e tyre. Sipas këtij Ligji, transfertat e kreditit do të thotë pagesa ose llogaritë e detyrimeve të shtetit, komunave, shoqërive finlandeze, shoqërive që operojnë në Finlandë, të famullive, fondacioneve, ndërmarrjeve dhe individëve ndaj Komunitetit Evropian, si dhe të subvencioneve, kredive, financimeve të tjera, letrave me vlerë, ose forma të tjera të subvencionimit, të drejtuara në Finlandë nga Komuniteti Evropian.

Parashikimet e paragrafit 1, në lidhje me transferimin e kredive nga

Komuniteti Evropian, janë gjithashtu të zbatueshme edhe për ndërmjetësit dhe palët të cilët kanë transferuar fondet.

Kompetencat

Zyra e Auditimit të Shtetit ka të drejtë të auditojë transferimin e kredive sipas referencave në paragrafin 1, si dhe kontrollin në masën e duhur të financave dhe operacioneve të ndërmjetësuesit, dhuruesit, marrësit dhe ndërmjetësit që paguan transferimin, apo të personit të cilit marrësi i ka transferuar burimet që ka marrë.

NAO ka të drejtë të auditojë transferimet e kredive të përmendura në paragrafin 1 dhe përgjegjësit për pagesën. Personat e audituar duhet të ndihmojnë audituesit gjatë kryerjes së detyrës. NAO mund të zgjedhë të përfshijë në auditim edhe këshilltarë ekspertë.

Qasja në informacione

Subjektet e audituara duhet ti sigurojnë NAO-s të gjithë informacionin dhe dokumentet e kërkuara, pa cenuar dispozitat e veçanta mbi fshehtësinë e çështjeve. NAO duhet të ketë akses në të gjitha informacionet dhe dokumentet e subjekteve të audituara, si dhe në shkresat që kanë lidhje me operacionet e saj.

Dorëzimi i informacioneve sekrete (21 Maj 1999/653)

Pavarësisht detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë, siç përshkruhet në Ligjin mbi Publikimin e Aktiviteteve Zyrtare (621/1999), informacioni i siguruar gjatë kryerjes së auditimit, që ka lidhje me gjendjen ekonomike, biznesin, apo sekretin shtetëror, mund të trajtohet nga policia dhe autoritete të tjera si prokuroria dhe gjykatat në mënyrë që të hetohet një krim dhe madje edhe nga organet e KE-së, nëse e kërkon legjislacioni.

Rregullorja e Punës

Rregullorja e punës udhëheq organizimin, departamentet, njësitë dhe detyrat e tyre, si dhe menaxhimin dhe përgatitjen e çështjeve për vendimmarrje.

Rregullorja e punës gjithashtu rregullon lëshimin dhe përgatitjen e udhëzimeve dhe urdhrave që kanë të bëjnë me auditimin, me bordin e gjobave dhe sanksioneve dhe vendosjen e tyre, me bordin e cilësisë dhe këshillin shkencor, me bashkëpunimin mes zyrtarëve dhe personelit, si dhe me postet dhe kualifikimet.



Zyra e lartë e Auditimit të Republikës Çeke

Statusi dhe kompetencat

Një nga kushtet e domosdoshme për funksionimin e mirë të një shteti modern demokratik, është ekzistenca e një sistemi kontrolli të pavarur. Në Republikën Çeke, ky funksion kryhet nga Zyra e Lartë e Auditimit (SAO), konceptimi i të cilit është bazuar në përvojën e auditimit të institucioneve të ngjashme në Evropë.

Ekzistenca e SAO-s ka qenë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës Çeke dhe në kontrast me të kaluarën, mandati i tij është konceptuar në mënyrë krejtësisht të re. SAO është i pavarur, si nga pushteti legjislativ (Parlamenti) ashtu dhe nga pushteti ekzekutiv (qeveria). Ndikimet politike në punën e tij janë eliminuar në shkallë maksimale. SAO paraqet një nga elementet specifike të demokracisë parlamentare.

Kushtetuta e Republikës Çeke, përveç pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe elementeve të tjera kushtetues, përcakton statusin e SAO si një organ i pavarur, me dispozitat që:

- kontrollon administrimin e pronës shtetërore,
- Presidenti dhe Nënkryetari emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Dhomës së Deputetëve për një afat prej nëntë vjetësh,

- statusi, kompetencat dhe struktura organizative përcaktohen me ligj.

Këto parime pasqyrohen në Ligjin nr. 166 për Zyrën e Lartë të Auditimit (më tej vetëm “Akti”), i cili erdhi në fuqi që nga data 1 Korrik 1993.

Në bazë të këtij ligji, aktiviteti i SAO-s ka të bëjë me menaxhimin e pronës shtetërore dhe burimeve financiare të grumbulluara në bazë të ligjit, p.sh. për shëndetin dhe sigurimet shoqërore. Ajo gjithashtu auditon të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, p.sh. pagesa e taksave nga të gjithë personat përgjegjës, si dhe llogaritjen saktë dhe mbledhjen e tyre nga ana e autoriteteve përkatëse.

Për të siguruar shkallën më të lartë të objektivitetit në shqyrtimin e çështjeve të kontrolluara dhe në vendimmarrje, SAO udhëhiqet nga parimi i kolektivitetit. Për këtë arsye, vendimet për planifikimin dhe rezultatet e aktivitetit të auditimit të SAO janë marrë nga organet e saj kolektive: në përputhje me rëndësinë dhe natyrën e auditimeve, ose nga 17-anëtarët e bordit apo tre të pestat e anëtarëve të Senatit. Bordi përbëhet nga Presidenti, Nënkrystari dhe 15 anëtarë të Zyrës. Anëtarët e zyrës zgjidhen nga Dhoma e Deputetëve të Parlamentit të Republikës Çeke. Mandati i tyre zgjat vazhdimisht derisa ata të arrijnë moshën 65 vjeç dhe statusi i tyre është i krahasueshëm me statusin e anëtarëve të parlamentit.

Pavarësia institucionale e SAO plotësohet nga pavarësia financiare e saj, e përcaktuar nga Dhoma e Deputetëve dhe buxheti i shtetit.

Konceptimi i SAO-s plotëson parimet themelore dhe rekomandimet e Deklaratës së Limës të INTOSAI-t. “Udhëzimet dhe rregullat e Auditimit” është krijuar si një dokument bazë që përmbledh parimet e veprimtarisë së auditimit të pavarur; ky dokument u miratua në Kongresin e IX të INTOSAI-t në Lima, Peru, në vitin 1977. Gjithashtu në “Deklaratën e Pavarësisë së Meksikë” 30 vjet më vonë, Kongresi XIX i INTOSAI (2007, Meksikë) përcaktoi kërkesat për pavarësinë së SAI-ve, në terma më të detajuara dhe u identifikuan tetë shtyllat kryesore për pavarësinë e auditimit të jashtëm të qeverisë.

Struktura organizative

Aktivitetet e Senatit dhe Dhomës së SAO-s, udhëhiqen nga Bordi.

Organet drejtuese të SAO-s janë: Presidenti, Zëvendës Presidenti, Bordi, Senati dhe Dhoma e Debatit. Sipas strukturës organizative, SAO përbëhet nga disa seksione. Drejtori i Përgjithshëm, krerët e seksioneve, si dhe drejtorët dhe shefat e departamenteve dhe sekretariateve.

Bordi i SAO

Bordi përbëhet nga kryetari dhe zëvendës-kryetari, si dhe nga anëtarët e Bordit. Karakteri dhe veprimet e tij, përcaktohen në nenin 166 të vitit 1993.

Presidenti

Kreu i Zyrës së Lartë të Auditimit, Presidenti, vepron në emër të SAO-s, kryeson takimet e autoriteteve dhe koordinon aktivitetet e SAO-s.

Zëvendës-presidenti

Zëvendëson të gjitha kompetencat plenare të kryetarit kur ky i fundit mungon dhe në disa raste të veçanta, me autorizimin e presidentit jep llogari për vendimet e marra gjatë periudhës së zëvendësimit.

Anëtarët e Bordit

Një anëtar i Bordit të SAO-s kontrollon operacionet e auditimit dhe harton raportet, si dhe merr pjesë në aktivitetet e bordit dhe në senat. Ashtu si dhe presidenti apo zëvendës-presidenti, anëtarët parashtrojnë opinione për organizimin e planit të auditimit. Gjithashtu, ata mund të propozojnë edhe procedura disiplinore.

Aktiviteti i auditimit

Fushat kryesore të aktiviteteve të auditimit

Misioni kryesor i SAO-s është t'u sigurojë institucioneve kushtetuese dhe qytetarëve informacione të besueshme dhe kompetente për administrimin e burimeve të tatimpaguesve, të burimeve të grumbulluara në bazë të ligjit dhe të pronës shtetërore.

SAO shqyrton nëse zyrat shtetërore dhe subjektet e tjera që menaxhojnë pronën e shtetit dhe burimet që ju besohen atyre, po kryejnë këto detyra në mënyrë efektive dhe ekonomike, si dhe në përputhje me rregullat ligjore. Bazuar në rezultatet e veprimtarisë së saj të auditimit, SAO përgatit dhe dorëzon në Dhomën e Deputetëve, sipas datave të përcaktuara, raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit. Veç kësaj, SAO përgatit me kërkesë të Dhomës së Deputetëve, komentet dhe opinionet mbi rregulloret e propozuara nga qeveria dhe ministrat dhe veçanërisht ato në lidhje me buxhetin, kontabilizimin, statistikën, auditimet, taksat dhe inspektimin e aktiviteteve.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar ndihmon Institucionet Supreme të Auditimit

të rrisin cilësinë e punës së tyre në fushën e auditimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore, fondeve dhe buxhetit të shtetit dhe ndihmave financiare të dhënë nga jashtë. Zyra e Lartë e Kontrollit (SAO) njeh rëndësinë e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve ndër-institucionale dhe vazhdimisht mban marrëdhënie profesionale me institucione të auditimit supreme nga e gjithë bota, si nëpërmjet anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe, ashtu edhe nëpërmjet bashkëpunimeve direkte.

Objektivat e SAO në fushën e çështjeve ndërkombëtare janë:

- të familjarizohet me metodat e auditimit dhe praktikat më të mira të zhvilluara dhe të përdorura nga institucionet e tjera ndërkombëtare;
- të zhvillojë metodologji dhe të shkëmbejë përvojën me institucionet e tjera ndërkombëtare;
- të mbështetë shkëmbimin e informacionit mbi auditimin e sektorit publik dhe institucioneve ndërkombëtare;
- të edukojë audituesit e saj dhe të mbështesë punonjësit e përhershëm nëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjes në seminare ndërkombëtare, dhe konferenca;
- të zhvillojë marrëdhëniet me institucionet dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të marrë pjesë në auditimet e koordinuara;
- të forcojë reputacionin e saj ndërkombëtar.



Zyra e Lartë e Auditimit e Republikës Sllovaqe

Zyra e Lartë e Auditimit e Republikës Sllovaqe është themeluar në 1 Prill 1993. Kushtetuta Sllovaqe e vitit 1992 e konfirmoi Zyrën e Lartë të Auditimit si organ i pavarur i auditimit të jashtëm. Akti i vitit 1993, fuqizon Zyrën për të kontrolluar se si janë llogaritur dhe mbledhur taksat dhe burimet e tjera të të ardhurave, të tilla si detyrimet doganore dhe gjobat dhe si janë menaxhuar shpenzimet e fondeve publike. Zyra i kryen auditimet në respekt të statutit ligjor, ekonomikiteti, efikasiteti dhe përputhshmëria Zyra e Lartë e Auditimit të Republikës Sllovaqe kryen misionin e saj shtetëror të pavarur dhe aktivitetet e saj të auditimit, në përputhje me Kushtetutën e Republikës Sllovaqe dhe Aktin për Zyrën së Lartë të Auditimit.

Vizioni

Zhvillimi i Zyrës së Lartë të Auditimit të Republikës Sllovaqe si një organizatë e pavarur dhe një institucion fleksibël i cili mbështet përdorimin optimal të burimeve publike dhe në mënyrë të konsiderueshme kontribuon në përdorimin efektiv të financave publike në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe Republikës Sllovaqe.

Misioni

Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të aktiviteteve audituese të pavarura si dhe përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm nëpërmjet organeve, punonjësve dhe rrjeteve të zyrave rajonale të shpërndarë në mënyrë optimale në mbështetje të ndërsjellë dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera të auditimit. Gjithashtu kontributi në transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë, administratës publike dhe vetëqeverisjes territoriale, duke rezultuar në menaxhimin sa më të mirë të pronës dhe mjeteve publike.

Vlerat Kryesore

Lehtësimi i menaxhimit të shëndoshë dhe efektiv të pronës dhe mjeteve publike si dhe informimi i Këshillit Kombëtar të Republikës Sllovaqe dhe subjekteve të interesuara duke përfshirë publikun e gjerë, mbi gjetjet e konstatuara gjatë kryerjes së auditimit;

Forcimi i pozitës brenda strukturave të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t dhe zgjerimi i mëtejshëm dypalësh dhe shumëpalësh nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera të Kontrollit të Lartë (më poshtë “SAI”) në Evropë dhe në botë;

Përshtatja dhe zbatimi i standarteve të INTOSAI-t, duke iu përmbajtur edhe kushteve të Republikës Sllovaqe;

Kryerja e auditimeve të pavarura me cilësi të lartë ekonomike, efikase dhe efektive;

Përmirësimi i performancës dhe përgjegjësi të audituesve dhe punonjësve të tjerë, nëpërmjet motivimit, zhvillimit të tyre personal dhe profesional, forcimit të krenarisë dhe besnikërisë për punën e tyre si dhe nëpërmjet përmirësimit të mjedisit të punës.

Statusi Ligjor

Zyra është themeluar sipas neneve 60 - 63 të Kushtetutës së Republikës së Sllovakisë. Zyra është themeluar dhe vepron sipas ligjit (Ligji i Këshillit Kombëtar të Republikës Sllovaqe Nr. 39/1993). Zyrat qendrore ndodhen në Bratislavë, ndërsa 8 zyrat rajonale ndodhen në Banska, Bisticë, Bratislavë, Koscicë, Nitra, Presov, Trençín, Tërnavë dhe Zhilina. Zyra është organ buxhetor.

Autoriteti dhe kompetencat

Zyra e Lartë e Auditimit të Republikës Sllovaqe është një autoritet shtetëror i cili është i pavarur gjatë kryerjes së aktivitetit të auditimit dhe është i lidhur vetëm me ligjin. Kompetencat, standardet themelore të auditimit,

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

të drejtat dhe detyrimet e saj janë vendosur në Aktin mbi Zyrën e Lartë të Auditimit të Republikës Sllovaqe. Zyra e kryen veprimtarinë e saj të auditimit në përputhje me Planin e Aktiviteteve të Auditimit, që zakonisht miratohet për një vit kalendarik. Me kërkesë të Bankës Kombëtare të Sllovakisë, kjo zyrë merr pjesë edhe në procesin e auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare të kësaj banke.

Struktura organizative

Zyra e Lartë e Auditimit përbëhet nga Presidenti dhe dy zëvendës Presidentë. Zyra udhëhiqet nga Presidenti si një autoritet statutor. Presidenti mund të zëvendësohet nga dy zv/presidentët e zgjedhur. Këta tre anëtarë zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Republikës Sllovaqe me votim të fshehtë për një mandat 7 vjeçar, por jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Edhe me përfundimin e mandatit, Presidenti mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Presidentit të ri. Zyra e Lartë e Auditimit i përmbush detyrat me anë të njësisë organizative të saj të përfaqësuar nga departamente, zyra rajonale, personeli dhe sekretariate.



Zyra Kombëtare e Auditimit e Maltës

Funksionet dhe kompetencat e Audituesit të Përgjithshëm dhe roli i NAO-s, përcaktohen me nenin 108 të Kushtetutës së Maltës dhe Aktin e vitit 1997 të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Kushtetuta dhe Ligji fuqizojnë Audituesin e Përgjithshëm, të auditojë llogaritë e të gjithë departamenteve dhe zyra të qeverisë së Maltës, si dhe çdo subjekt publik apo organe të tjera që merren me administrimin, mbajtjen apo përdorimin e fondeve të qeverisë malteze. Gjithashtu, ligji parashikon auditimin e performancës për këto njësi, si dhe për çdo kompani apo subjekt tjetër në të cilin qeveria zotëron më shumë se 50% të aksioneve.

Kompetencat e auditimit të NAO-s:

Në nivel qendror: NAO ka autoritetin të auditojë llogaritë e të gjithë departamenteve dhe zyra të pushtetit qendror dhe të shqyrtojë nëse ata i kanë përdorur fondet dhe burimet në dispozicion të tyre në mënyrë efektive, efikase, dhe ekonomikisht.

Në nivel lokal: Auditimi i Pushtetit Lokal është përfshirë edhe brenda mandatit të Audituesit të Përgjithshëm siç përshkruhet edhe në legjislacionin që rregullon Pushtetin Lokal.

Organet publike: Mandati përfshin edhe auditimin e autoriteteve publike dhe korporatave, si dhe çdo subjekt publik apo organe të tjera që merren me administrimin, mbajtjen apo përdorimin e fondeve të qeverisë malteze dhe në të cilat qeveria zotëron më shumë se 50% të aksioneve.

Subjekte private: NAO ka kompetenca të hetojë edhe ndihmat që qeveria merr nga organizata jo-qeveritare.

Vizioni

Të sigurojë shërbime profesionale për parlamentin, qeverinë dhe taksapaguesit dhe të jetë agjent i ndryshimeve për arritjen e përsosmërisë në sektorin publik.

Misioni

Të ndihmojë në promovimin e pronës, përgjegjshmërisë dhe praktikat më të mira në operacionet qeveritare.

Mandati i Audituesit të Përgjithshëm

Sipas nenit 108 të Kushtetutës, mandati i auditimit kërkon auditime të plota vjetore financiare dhe të përputhshmërisë për të gjitha organet qeveritare dhe subjektet e tjera publike. Mandati i auditimit ka për qëllim të ofrojë një opinion të përgjithshëm nëse transaksionet financiare dhe kontabël të qeverisë janë kryer si duhet.

Ligji mbi NAO-n dhe Audituesin e Përgjithshëm, si dhe urdhri nr.120 mbi Dhomën e Përfaqësuesve, e zgjeron mandatin e auditimit edhe në mbulimin e kompetencave këshilluese dhe hetimore të pavarura, në shqyrtimin e ndonjë çështje financiare në lidhje me përdorimin e fondeve publike, si dhe vlerësimet e performancës për përdorimin e fondeve publike. Këto auditime kryhen me iniciativën e NAO-s, me kërkesë të Parlamentit ose të Ministrit të Financave.

Ligji mbi Këshillat Lokalë vendosi gjithashtu obligime dhe përgjegjësi të veçanta për Audituesit e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Kontrollit, në lidhje me emërimin e audituesve të Këshillave Lokale dhe punën e tyre.

Kushtetuta e Maltës

Neni 108.

- (1) Do të ketë një Auditues të Përgjithshëm, zyra e të cilit do të jetë një zyrë publike që do të ketë funksionet siç parashikohet në dispozitat e mëposhtme të këtij neni.
- (2) Audituesi i Përgjithshëm do të jetë një zyrtar i Dhomës së Përfaqësuesve dhe do të emërohet nga Presidenti. Ai vepron në përputhje me rezolutën e Dhomës së Përfaqësuesve të mbështetur nga votat e jo më pak se dy

të tretat e të gjithë anëtarëve të Dhomës: me kusht që kur një person i cili nuk është anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve është zgjedhur të jetë Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, ai nuk do të trajtohet si një anëtar i Dhomës për qëllim të krijimit të shumicës së kërkuar nga ky nën-artikull.

- (3) (a) Në varësi të dispozitave të pikës (4) të këtij neni, Audituesi i përgjithshëm do të mbajë postin për një periudhë prej pesë vjetësh nga data e emërimit të tij dhe do të ketë të drejtë të riemërohet për një periudhë të mëtejshme prej pesë vjetësh.

Ligji për Audituesin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit
Të përcaktojë detyrat e Audituesve të Përgjithshëm dhe mënyrën se si ata do të raportojnë në parlament, të sigurojë mënyrën e ndarjes së fondeve dhe mënyrën e auditimit dhe raportimit të tyre në Zyrën Kombëtare të Auditimit si dhe çështje të tjera të rëndësishme, ndihmëse apo plotësuese.



Zyra e Auditimit të Qipros

Audituesi i Përgjithshëm është Kryetari dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm është Zëvendës Kryetari i Zyrës së Auditimit. Zyra e Auditimit të Republikës është një zyrë e pavarur dhe nuk varet nga asnjë Ministri. Audituesi i Përgjithshëm dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm emërohen nga Presidenti i Republikës.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Audituesi i Përgjithshëm, i ndihmuar nga Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm, është përgjegjës për auditimin, në emër të Republikës, i të gjitha pagesave dhe arkëtimeve, për kontrollin dhe inspektimin e të gjitha llogarive, pasuritë e tjera të administruara dhe detyrimet e shkaktuara nga ose nën autoritetin e Republikës. Për këtë arsye, Audituesi i Përgjithshëm ka të drejtë të inspektojë dhe të kontrollojë të gjitha librat përkatëse, arkivat, deklaratat dhe vendet ku janë mbajtur pasuritë e mësipërme.

Gjithashtu, Audituesi i Përgjithshëm zbaton çdo pushtet tjetër, kryen punë të tjera ose përgjegjësi të parashikuara apo të përcaktuara për atë me ligj. Përveç kësaj, në vijim të auditimit të llogarive të qeverisë, Audituesi i Përgjithshëm është përgjegjës, në përputhje me dispozitat e ligjeve të veçanta ose masat administrative, për auditimin e organeve statutore, fondet e veçanta, autoritetet lokale dhe organizatat e tjera publike.

Në përputhje me Ligjin 113 (I) të vitit 2002 (sigurimi i provave dhe informacionit për Audituesin e Përgjithshëm) Audituesi i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë prova dhe informacione nga të audituarit në çfarëdo formë dhe çdo person që refuzon të japë informacionin e kërkuar, që i jep dëshmi të rreme ose të pasakta ose nxit ndonjë person të mbajë të fshehura provat dhe informacionin duke kryer një vepër penale dhe dënohet, nëse

shpallet fajtor, me një gjobë prej 1000 £ dhe / ose burgim deri në një vit. Gjithashtu sipas këtij ligji Audituesi i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë nga çdo person, fizik ose juridik, i cili merr një subvencion shtetëror, garanci ose hua për të siguruar të gjitha provat e nevojshme lidhur me lëvrimin e fondeve.

Kompetencat dhe detyrat e Audituesit të Përgjithshëm ushtrohen prej tij personalisht apo nga nëpunësit e tij, të cilët veprojnë në përputhje me udhëzimet e tij.

Vizioni

Të kontribuojë në menaxhimin efektiv dhe efikas të fondeve publike.

Misioni

Të promovojë standardet më të larta në menaxhimin e sektorit publik financiar dhe atë të raportimit, përgjegjshmërinë dhe vlerat për parandë.

Vlerat

Pavarësia, Objektiviteti, Profesionalizmi, Besueshmëria

Kuadri Ligjor

Kompetencat dhe detyrat e Audituesit të Përgjithshëm janë përcaktuar në Kushtetutën e Republikës. Në bazë të kësaj dhe legjislacionit tjetër përkatës, Audituesi i Përgjithshëm është përgjegjës për auditimin e llogarive të qeverisë qendrore, të organeve statutore, të autoriteteve lokale, të fondeve të veçanta dhe të agjencive të tjera. Audituesi i Përgjithshëm ka gjithashtu autoritetin për të kërkuar dëshmi ose informacion nga përfituesit e granteve, garancive ose kredive nga fondet publike në mënyrë që të konstatojnë se si ata janë përdorur.

- Kushtetuta
- Ligji statutor
- Komunat
- Autoritetet lokale
- Sigurimi i provave dhe informatave për Audituesit e Përgjithshëm

Kushtetuta

Pjesa 6, Kapitulli 2 – Audituesi i Përgjithshëm dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm

Neni 115

1. Presidenti dhe Zëvendës Presidenti i Republikës emërojnë të dy bashkërisht personat e duhur për të qenë njëri Audituesi i Përgjithshëm dhe të tjetri të jetë Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm: Me kusht që Audituesi i Përgjithshëm dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm nuk i përkasin të njëjtit komunitet.
2. Audituesi i Përgjithshëm do të jetë Kryetari dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm do të jetë Zëvendës Kryetari i Zyrës së Auditimit të Republikës, e cila do të jetë një zyrë e pavarur dhe nuk varet nga asnjë ministri.
3. Audituesi i Përgjithshëm dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm janë anëtarë të shërbimit të përhershëm publik të Republikës dhe nuk mund të dalin në pension ose largohen nga detyra, përveç arsyeve si dhe në të njëjtën mënyrë si gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Neni 116

1. Audituesi i Përgjithshëm i ndihmuar nga Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm, në emër të Republikës, kontrollin të gjitha arkëtimet dhe auditon dhe inspekton të gjitha llogaritë e parave dhe pasurive të tjera të administruara, si dhe detyrimet e shkaktuara nga ose nën autoritetin e Republikës dhe për këtë qëllim ai do të ketë të drejtën e aksesit në të gjitha librat, shënimet në lidhje me llogaritë e tilla dhe në vendet ku mbahen asetet e tilla.
2. Audituesi i Përgjithshëm, i cili ndihmohet nga Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm, duhet të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe të kryej të gjitha funksionet dhe detyrat që i janë dhënë ose përcaktuar me ligj.
3. Kompetencat, funksionet dhe detyrat e Audituesit të Përgjithshëm janë të parashikuara në këtë kapitull mund të ushtrohen nga ai personalisht ose nga nëpunës që veprojnë nën dhe në përputhje me udhëzimet e tij.
4. Audituesi i Përgjithshëm duhet t'i paraqesë Presidentit dhe Zëvendës Presidentit të Republikës çdo vit një raport mbi ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tij, që përcaktohen në këtë Kapitull.

Neni 117

1. Audituesi i Përgjithshëm do të ketë kompetenca të tilla dhe do të kryejë funksione të tilla dhe detyra që zakonisht i përkasin zyrës së tij dhe gjithashtu duhet që në përputhje me drejtimit e Audituesit të Përgjithshëm, të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe të kryej të gjitha funksionet dhe detyrat e dhëna nga ai në bazë të dispozitave kushtetuese

ose me ligj.

2. Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm duhet të veprojë në vend të Audituesit të Përgjithshëm në rast të mungesës së tij apo paaftësisë së tij të përkohshëm për të kryer detyrat e tij.



Izrael – Kontrolli i Shtetit dhe Avokati i Popullit

Kontrolli i Shtetit në Izrael fokusohet në shqyrtimin e aktiviteteve të autoritetit ekzekutiv, nëse ato janë kryer në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit, efektivitetit dhe integritetit moral. Funkzioni i Kontrollit të Shtetit është përcaktuar në ligjin bazë mbi Kontrollorin shtetëror. Rezultatet e auditimit sillen në vëmendjen e organeve të audituara për reagimin e tyre dhe në mënyrë që të mundësojë përmirësim në menaxhim. Raportet më pas dorëzohen në Knesset (parlamenti i Izraelit) dhe publikohen. Vlerësimi i auditit të Kontrollorit të Shtetit është i pavarur dhe ai i përgjigjet vetëm Knesset-it.

Parimet e Kontrollit të Shtetit

Kontrolli i Shtetit është një nga faktorët themelorë të demokracisë. Audituesi shtetëror është pjesë e sistemit të kontrolleve dhe balancave në një shtet demokratik. Statusi i tij në kuadër të sistemit të qeverisjes është një nga masat për forcimin e demokracisë.

Kontrolli i autoritetit ekzekutiv ka shprehjen e tij në parimin, që zyrtarët publikë në një shtet demokratik janë administratorët e besuar dhe shërbyesit e publikut dhe jo të mjeshtreve të tyre. Ky është një faktor i rëndësishëm në rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës publike. Shumica e vendeve të botës kanë një institucion shtetëror të pavarur të auditimit, funksioni i të cilit është të auditojë administratën e qeverisë, atë të organeve të tjera publike dhe të vlerësojë aktivitetet e tyre. Institucioni shtetëror i auditimi në Izrael është Zyra e Kontrollit të Shtetit. Që në fillim, shteti i Izraelit njohu rëndësinë e kontrollit të shtetit. Në vitin 1949

ishte miratuar Ligji për Kontrollorin e Shteti, duke krijuar kështu Zyrën e Kontrollit të Shtetit, një nga institucionet e para që duhet themeluar në një shtet.

Ligji për Kontrollorin e Shtetit të Izraelit ofron një bazë të fortë për një kontroll sa më të detajuar të shtetit. Ky ligj i jep një gamë të gjerë funksionesh kontrollorëve në drejtim të dy kategorive të organeve që i nënshtrohen kontrollit të shtetit dhe gjithë përfshirjes së auditimit. Ky ligj themelor, një nga një seri ligjesh themelore, përcakton statusin kushtetues të Kontrollit të Shtetit dhe në veçanti pohon pavarësinë e tij. Kneset-i e zgjedh Kontrollorin e Shtetit në një votim të fshehtë për një mandat shtatë-vjeçar. Në kryerjen e funksioneve të tij, ai raporton vetëm për Kneset-in dhe nuk varet nga qeveria. Është Kontrollori Shtetëror që vendos për subjektet që do të auditohen, përveç rasteve kur kërkohet nga Kneset-i, nga Komisioni i Kneset-it për Punët e Auditimit të Shtetit ose të Qeverisë. Buxheti i Zyrës së Kontrollit Shtetërorë përcaktohet nga komiteti i financave i Kneset-it me propozimin e Kontrollit të Shtetit dhe me miratim në mënyrë të veçantë nga Buxheti i Shtetit. Kontrollori e dorëzon raportin mbi zbatimin e buxhetit të Zyrës së Kontrollit Shtetërorë në Komisionin e Kneset-it për Punët e Auditimit të Shtetit. Kontrollori është i pavarur në shkarkimin dhe emërimin e punonjësve të zyrës së tij.

Funksionet e Kontrollit të Shtetit

- A. Ligjshmëria dhe rregullsia - Kontrolli mbi ligjshmërinë e një veprimi të ndërmarrë nga një zyrtar publik, një person që ushtron autoritetin apo shpenzon fondet publike është projektuar për të shqyrtuar nëse ky veprim është brenda autoritetit të tij ligjor për të ndërmarrë veprimin në fjalë, shqyrtimin e rregullshmërisë së veprimit të ndërmarrë ose shpenzimeve. Kjo është projektuar për të shqyrtuar përputhshmërinë me ligjet, rregulloret, procedurat dhe normat e duhura të sjelljes.
- B. Ekonomiciteti, Efienca dhe Efektiviteti - Auditimi i ekonomisë ka të bëjë kryesisht me burimet e investuara në një aktivitet të veçantë; auditimi i efikasitetit ekzaminon marrëdhëniet mes burimeve dhe rezultateve ndërsa auditimi i efektivitetit ka të bëjë me rezultatet e arritura dhe se qëllimet e aktivitetit janë përmbushur vërtetë.
- C. Integriteti Moral - Kontrolli i Shtetit në Izrael ka të bëjë edhe me shqyrtimin e zbatimit të normave dhe rregullave të sjelljes të nëpunësve publikë, si në rastet ku veprimet janë ndërmarrë edhe pse ka pasur konflikte të interesit, ka pasur anshmëri ose abuzime

me pozitën ose autoritetin. Në zonat ku normat e sjelljes nuk janë të përcaktuara në ligje, me procedura të shkruara ose nga precedentët gjyqësor, Kontrollori Shtetëror duhet të përcaktojë normën e duhur në mënyrë që të parandalojë vendimet dhe veprimet e pahijshme. Normat kanë më shumë forcë detyruese se ligjet ose rregulloret. Ndonjëherë, pas rezultateve të auditimit, kontrollori mund të bëjë një rekomandim duke marrë parasysh një ndryshim në legjislacion.

Qëllimi i Auditimit

Organi drejtues i Dhomës së Kontrollit është Këshilli, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë: kryetari, zëvendës kryetari dhe pesë anëtarë të Këshillit. Zëvendës Kryetari i Dhomës së Kontrollit dhe pesë anëtarët e Këshillit, emërohen nga presidenti i Republikës së Armenisë, me propozim të Kryetarit të Dhomës së Kontrollit për një mandat gjashtë-vjeçar, me përjashtim të mandatit të anëtarëve të parë të Këshillit. Këshilli i Dhomës së Kontrollit (COC) diskuton dhe miraton draftin e projekteve të veprimtarisë vjetore. Gjithashtu ajo diskuton dhe miraton vendimet për zbatimin e kontrollit, konkluzionet e raporteve të qeverisë dhe Bankës Qendrore, mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe privatizimeve të subjekteve, si dhe raportet aktuale dhe vjetore mbi ankesat administrative të COC-së.

Historiku i COC-së

Duke ndjekur parimin e pavarësisë, është e nevojshme krijimi i një sistemi shtetëror financiar dhe ekonomik, i aftë për të mbështetur përfitimet e shtetit dhe shoqërisë në kushtet e një ekonomie liberale. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme edhe krijimi i një kuadri të ri ligjor për të përcaktuar parimet dhe qasjet financiare të kontrollit. Për këtë arsye, më 29 Maj 1996, u themelua Dhoma e Kontrollit të Republikës Armene, një sistem i ri i kontrollit financiar shtetëror. Disa nga objektivat kryesore që ju dhan këtij institucioni ishin: të ushtrohet një kontroll i plotë dhe profesional mbi shpenzimin efektiv të të ardhurave dhe fondeve publike, të sigurohet

transparencë në përdorimin e tyre, si dhe të analizojë raportet e paraqitura. Dhoma e Kontrollit u formua nga Asambleja Kombëtare dhe ishte nën përgjegjësinë e organit legjislativ të vendit. Dhoma i paraqet Asamblesë Kombëtare referencat e saj gjashtëmujore, raportet e progresit të kontrollit, si dhe planet vjetore të aktiviteteve, duke i bërë në këtë mënyrë, publike studimet e saj. Parimet e veprimtarisë së Dhomës së Kontrollit, ishin ato të pavarësisë, kolegjalitetit dhe publicitetit.

Si rezultat i ndryshimeve kushtetuese, u ngrit edhe nevoja për të ndryshuar ligjin mbi Dhomën e Kontrollit. Më 25 dhjetor 2006, Asambleja Kombëtare miratoi një ligj të ri, i cili u ratifikua më 9 qershor 2007, dhe hyri në fuqi dhjetë ditë pas ardhjes në fuqi të nenit 83.4 të kushtetutës, pra më 5 nëntor, 2007.

Mbi bazën e kërkesave të reja ligjore, u bënë edhe ndryshimet strukturore: u bë riformimi i Departamenteve sipas parimeve të degëve dhe të rotacionit, gjithashtu u ndanë ato ekzistueset dhe u krijuan të reja, si psh departamenti i kontrollit të brendshëm.

Veçoritë e Ligjit të ri

Miratimi i ligjit të ri për COC-në erdhi si pasojë e ndryshimeve në kushtetutë. Ligji është hartuar në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, me klauzolat e deklaratës së Lima-s “Udhëzime për rregullat e Auditimit”, si dhe me praktikën e auditimeve ndërkombëtare. Ndryshe nga ligji i mëparshëm, kjo dallohet nga qasjet e mëposhtme.

Dhoma aktuale e Kontrollit është shumë më e pavarur, e ndarë nga Kuvendi dhe me një status të ri. Kryetari i Dhomës së Kontrollit emërohet nga Asambleja Kombëtare me propozim të Presidentit, për një mandat gjashtë-vjeçar, ndryshe nga kryetarët e mëparshëm të cilët propozoheshin nga Kryetari i Kuvendit dhe miratoheshin nga Kuvendi.

Sipas ligjit të ri, Kryetari i Dhomës së Kontrollit nuk mund të zgjidhet për dy mandate radhazi. Asambleja Kombëtare diskuton raportin vjetor të përbërë nga rezultatet e kontrollit të ndërmarrë nga Dhoma e Kontrollit, por pa dhënien e një vendimi. Në ligjin e mëparshëm, nëse raportet nuk miratoheshin, Kuvendi mund të jepte mosbesimin ndaj Kryetarit të Dhomës.

Dhoma e kontrollit mund të ndërmarrë plane kontrolli edhe jashtë planit vjetor të aktiviteteve të miratuara nga Këshilli. Dhoma e kontrollit i kryen detyrat e saj nëpërmjet vëzhgimeve, analizave, kontrolleve të ndërthurura, si dhe nëpërmjet auditimeve financiare, të përputhshmërisë dhe mjedisore.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Në ligjin e ri janë zgjeruar dhe qartësuar kompetencat e Dhomës së Kontrollit. Me anë të procedurave të ndryshme, Dhoma e Kontrollit mund të ushtrojë kontroll mbi hyrjet dhe daljet e buxhetit të shtetit, të komunitetit dhe të sigurimeve shoqërore. Tani e tutje, Dhoma e Kontrollit do të ketë kufizim kohor në drejtim të zbatimit të kontrollit. Pra, periudha për të ushtruar kontroll do të jetë jo më shumë se 24 ditë pune, e cila mund të zgjatet gjatë auditimit, me jo më shumë se 12 ditë pune, në bazë të vendimit të Këshillit të Kontrollit të Dhomës. Ndërsa periudha për kontrolle të ndërthurura do të jetë jo më shumë se 12 ditë pune, që mund të zgjatet me jo më shumë se 6 ditë pune në bazë të urdhërit të Kryetarit të Dhomës së Kontrollit.

Megjithatë, ligji i ri për COC-në, ka vend për përmirësime. Sipas specialistëve, nuk duhet të ketë pengesa gjatë punës së COC-së. Në këtë drejtim, COC po punon për reformat legjislative.



Dhoma e Kontrollit e Gjeorgjisë

Dhoma e Kontrollit e Gjeorgjisë (CCG) është Institucioni më i Lartë i Auditimit të Gjeorgjisë. Pavarësia institucionale, financiare dhe funksionale e saj, garantohet me ligj. Roli i CCG-së, është të promovojë ligjshmërinë, efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve publike, si dhe përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

Parimet kryesore të aktivitetit të CCG-së janë:

- Paanshmëria
- Pavarësia
- Transparenca
- Profesionalizmi

Dhoma e Kontrollit të Gjeorgjisë është institucioni kryesor, i cili siguron përgjegjshmëri dhe transparencë në institucionet publike. Në vitin 1991, Gjeorgjia fitoi statusin e Republikës së pavarur dhe Komiteti Kombëtar i Kontrollit të atëhershëm pushoi së ekzistuari. Dhoma e sotme e Kontrollit është pasuesi ligjor i Institucionit të Kontrollit Shtetëror të Republikës Demokratike të Gjeorgjisë në vitet 1918-1921.

CCG është anëtare e INTOSAI-t që nga viti 1992, anëtare e EUROSAI-t që nga viti 1993 dhe anëtare e ASOSAI nga viti 2004. Në vitin 1993, Parlamenti i Gjeorgjisë miratoi Ligjin “ mbi Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë”.

Kushtetuta e vitit 1995, e përcaktoi Dhomën e Kontrollit si Institucionin më të Lartë të Auditimit. Në vitin 1997, Parlamenti miratoi një ligj të ri

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

“mbi Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë”.

Dhoma e Kontrollit të Gjeorgjisë, është institucioni më i lartë i kontrollit shtetëror financiar dhe ekonomik. Ai mbikëqyr shpenzimet, përdorimin e fondeve publike dhe vlera të tjera materiale shtetërore, mbron pasuritë kombëtare dhe pronën shtetërore, si dhe kontrollon dhe analizon ligjshmërinë, vendosmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve shtetërore.

CCG-ja është e pavarur në aktivitetet e saj dhe i raporton vetëm Parlamentit. CCG i kryen aktivitetet e saj të auditimit bazuar në parimet e mëposhtme: pavarësia, paanshmëria, transparenca dhe profesionalizmi. Ajo njeh standardet e pranuar ndërkombëtarisht të SAI-ve dhe bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare të auditimit, për të promovuar marrëdhëniet e partneritetit dhe shkëmbimin e njohurive.

Në dhjetor të vitit 2008, Parlamenti i Gjeorgjisë, miratoi një tjetër ligj të ri “për Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë”

Kuadri Ligjor

Kushtetuta e Gjeorgjisë

Dhoma e Kontrollit është Institucioni më i Lartë i Auditimit të Gjeorgjisë, themeluar në bazë të Kushtetutës së Gjeorgjisë. Kompetencat, statusi dhe pavarësia e saj, përcaktohen dhe garantohen me nenin 97 të Kushtetutës së Gjeorgjisë.

Kushtetuta e Gjeorgjisë miratuar më 24 gusht 1995

Neni 97

1. Dhoma e Kontrollit të Gjeorgjisë mbikëqyr përdorimin dhe shpenzimin e fondeve shtetërore dhe vlerave të tjera materiale. Gjithashtu, ajo është e autorizuar të shqyrtojë veprimtarinë e organeve të tjera shtetërore të kontrollit fiskal dhe ekonomik dhe të paraqesë propozime për përmirësimin e legjislacionit tatimor në Parlament.
2. Dhoma e Kontrollit është e pavarur në veprimtarinë e saj dhe i raporton vetëm Parlamentit. Kryetari i Dhomës së Kontrollit zgjidhet nga Parlamenti për një mandat prej pesë vjetësh. Ai duhet të zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Parlamentit, nga lista e miratuar nga Presidenti. Arsyet dhe procedurat e shkarkimit të tij përcaktohen nga Kushtetuta dhe ligji.
3. Dhoma e Kontrollit, paraqet një raport në Kuvend lidhur me shpenzimet e qeverisë, dy herë në vit, ndërsa për zbatimin e

- Buxhetit, raporti paraqitet një herë në vit.
4. Aktiviteti, kompetencat, organizimi dhe garantimi i pavarësisë së Dhomës së Kontrollit, përcaktohen me ligj.
 5. Organet e tjera të kontrollit shtetëror do të ngrihen, vetëm nëse përcaktohet në ligj

Ligji mbi Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë

Më 26 dhjetor 2008, Parlamenti i Gjeorgjisë miratoi Ligjin “Për Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë”, i cili në përputhje me Kushtetutën e Gjeorgjisë, përcakton statusin, kompetencat, aktivitetin, marrëveshjet dhe garanton pavarësinë e institucionit. Ky ligj u miratua më 28 janar 2009 dhe ndryshoi rrënjësisht rolin e Dhomës së Kontrollit të Gjeorgjisë.

“Në datat 17-18 Shtator 2012 në Tbilisi, Gjeorgji u zhvillua Konferenca e VII-të e organizatave EUROSAT dhe OLACEFS, me temë “Roli i institucioneve supreme të auditimit në mirëqeverisjen e sektorit publik“. Në këtë konferencë mori pjesë një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kryesuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, së

bashku me auditueset znj. Luljeta Nano dhe znj. Keida Muça. Pjesëmarrës të kësaj konference ishin përfaqësues të 38 vendeve (delegacione të kryesura nga Presidentët e organizatave supreme të auditimit) anëtarë të EUROSAT (organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Europës) dhe OLACEFS (Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve)”.



Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj
17-18 Shtator 2012, Tbilisi, Gjeorgji



Komiteti i Kontrollit të Shtetit të Bjellorusisë

Në përputhje me ligjin e Republikës së Bjellorusisë, Komisioni i Kontrollit të Shtetit përbëhet nga Kryetari dhe katër zëvendës kryetarë. Bazuar në nenin 9 të Ligjit të Republikës së Bjellorusisë, Nr 142-3, datë 1 korrik 2010 mbi "Komitetin e Kontrollit të Shtetit të Republikës së Bjellorusisë dhe zyrave të saj vendorë", Komiteti i Kontrollit të shtetit dhe zyrat e tij vendore, i raportojnë Kryetarit.

Qëllimet

Në bazë të rregullores së dekretuar nga Presidenti më 27 Nëntor 2008 me numër 647, detyrat kryesore të Komitetit janë:

- Të mbrojnë interesat e shtetit nga kundërvajtjet e paligjshme ekonomike dhe të garantojnë sigurinë ekonomike të Republikës së Bjellorusisë;
- Të shqyrtojnë përmbushjen e udhëzimeve të Presidentit të Republikës së Bjellorusisë, nën kompetencat e Komitetit të Kontrollit të Shtetit, në përputhje me ligjet dhe vendimet e Presidentit të Republikës së Bjellorusisë;
- Të ushtrojnë kontrollin në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike dhe të pronave shtetërore, nga organizatat dhe sipërmarrësit individualë
- Të ushtrojnë kontroll mbi aktivitetin e Presidentit, Parlamentit, Qeverisë dhe organeve të tjera që kanë marrëdhënie me pronën shtetërore, marrëdhënie ekonomike, financiare, si dhe çështje të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet e Presidentit të Republikës

së Bjellorusisë;

- Të marrë masa për zbulimin e shkeljeve sistematike të ligjit dhe tendencave negative ekonomike në sferën sociale
- Të kryejë detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet e Presidentit të Republikës.

Bazat ligjore të funksionimit

- Për Komitetin e Kontrollit të Shtetit dhe organet e saj rajonale - ligji i Republikës së Bjellorusisë Nr. 142-3, datë 1 Korrik 2010;
- Për përmirësimin e aktivitetit të kontrollit - dekreti i Presidentit nr. 510, datë 16 Tetor 2009;
- Për disa çështje të veprimtarisë së organeve të Kontrollit të Shtetit - dekreti i Presidentit, nr 647, datë 27 Nëntor 2008.
- Për Organet e Hetimit Financiar – ligji nr 414-3, datë 16 Korrik 2008.
- Për Departamentin e Monitorimit Financiar – dekreti i Presidentit nr. 408, datë 14 Shtator 2003.
- Për Masat Shtesë për Rregulloren e Marrëdhënieve Ekonomike - dekreti i Presidentit nr. 40, datë 16 Janar, 2002.
- Për disa masa për përmirësimin e kontrollit të shtetit – dekreti i Presidentit nr. 617, datë 2 Nëntor 2001.

Aktiviteti

- Kontrolli mbi shpenzimet e buxhetit të shtetit dhe përdorimit të pronës shtetërore.
- Siguria ekonomike e vendit.
- Kontrolli mbi përmbushjen e udhëzimeve të dhëna nga Kryetari i Shtetit.
- Kontrolli parandalues dhe parandalimi i shkeljeve.
- Trajtimi i peticioneve dhe pritja e qytetarëve.
- Parandalimi dhe eliminimi i krimeve ekonomike.
- Zbulimi i shkeljeve sistematike të ligjit dhe tendencave negative ekonomike.
- Marrja e masave për parandalimin e pastrimit të parave, kontrolli mbi respektimin e rregullave të auditimit.
- Kontrolli mbi zbatimin e legjislacionit mbi auditimin.
- Hetimi Financiar dhe Departamenti i Monitorimit.

Funksionet dhe objektivat e Departamentit të Monitorimit dhe Hetimit Financiar

Funksionet e Departamentit të Monitorimit dhe Hetimit Financiar janë të përcaktuara në Rregulloren për Departamentin e Monitorimit dhe Hetimit Financiar, të miratuar nga Dekreti Presidential Nr 87, datë 11 Shkurt 2009. Objektivat kryesorë janë zbulimi, parandalimi dhe eliminimi i krimeve ekonomike, duke përfshirë edhe korrupsionin. Kjo gjë arrihet nëpërmjet hetimeve paraprake, marrjeve në pyetje, procedurave përkatëse administrative brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, si dhe duke kryer detyra të tjera të përcaktuara në legjislacion. Departamenti kryen inspektive, aktivitete kërkimore, hetime paraprake dhe marrje në pyetje, si dhe marrjen e masave për parandalimin e krimeve dhe shkeljeve administrative.

Qëllimet

Në përputhje me Ligjin e Republikës së Bjellorusisë «mbi organet e hetimit financiar të Komitetit të Kontrollit Shtetëror të Republikës së Bjellorusisë», detyrat kryesore të këtyre organeve janë si më poshtë:

- të mbrojnë interesat publike dhe shtetërore nga veprat penale dhe kundërvajtjet, në sferën ekonomike,
- të ruaj sigurinë ekonomike të Republikës së Bjellorusisë,
- të mbrojnë të drejtat dhe interesat ligjore të qytetarëve të Republikës së Bjellorusisë, shtetasve të huaj dhe organizatave, në sferën ekonomike,
- të parandalojë, zbulojë dhe eliminojë krimet ekonomike dhe kundërvajtjet administrative, duke përfshirë korrupsionin,
- të kryejë hetime paraprake dhe të ndërmarrë procedurat përkatëse administrative brenda fushëveprimit të kompetencave të tij,
- të kryej detyra të tjera të përcaktuara në legjislacion.

Komiteti i Kontrollit, anëtar i organizatave ndërkombëtare

Që nga viti 2001, Komiteti i Kontrollit Shtetëror, ka qenë anëtar i Organizatës Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Në vitin 2002 ai u bashkua me Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Komiteti është gjithashtu anëtar i këshillit të krerëve të institucioneve supreme të auditimit të CIS.

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, lejon Komitetin të jetë një

Komiteti i Kontrollit i Bjellorusisë

anëtar me të drejta të plota në bashkësinë ndërkombëtare të auditimit, gjithashtu i jep një mundësi për të studiuar, analizuar dhe të miratuar praktikat më të mira ndërkombëtare. Veç kësaj, me qëllim shkëmbimin e ekspertizës dhe organizimin e auditimeve të përbashkëta, Komiteti ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi, me institucionet e auditimit të Lituaniës, Ukrainës, Ruisë, Moldavisë, Kinës, Polonisë, Armenisë, Kazakistanit, Koresë , Vietnamit, Letonisë, dhe Azerbajxhanit.



Dhoma e Llogarive e Azerbajxhanit

Krijimi dhe zhvillimi i Dhomës së Llogarive

Dekada e fundit e shekullit të 20 ishte periudhë e ndryshimeve në krijimin e fondacioneve politike dhe ekonomike në Republikën e Azerbajxhanit. Rënia e parimeve të vjetra të ekonomisë Sovjetike, formimi i një sistemi ekonomik të ri dhe më efektiv dhe ngritja e shoqërisë moderne civile, ishin një domosdoshmëri. Zhvillimi progresiv dhe i suksesshëm i Azerbajxhanit, kërkonte edhe zhvillimin dhe përmirësimin e kontrollit shtetëror në të gjitha sferat me rëndësi, veçanërisht në fushën e financave dhe ekonomisë. Kështu, ndryshimet themelore ekonomike, krijuan nevojën e krijimit të një sistemi kontrolli financiar të bazuar në parimet e reja të unifikuara dhe që të mbulojë të gjitha aspektet e jetës ekonomike. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se sisteme të tilla financiare duhet të mbështeten normalisht në kontrollin e jashtëm shtetëror, i cili i raporton pushtetit legjislativ dhe nuk varet nga asnjë kontroll i brendshëm (kontrolli financiar i kryer nga organet ekzekutive përkatëse për zbatimin efektiv të pushtetit të tyre në publik) ose autoritete ekzekutive. Ky kontroll i jashtëm i gjendjes financiare, i cili është i pavarur nga menaxhuesit e burimeve financiare të shtetit dhe mban përgjegjësi para ligjit dhe publikut, është pranuar si një mjet themelor për respektimin e legjislacionit financiar dhe disiplinën në vend.

Kuadri ligjor

Dhoma e Llogarive është organ krejtësisht i ri për Republikën e Azerbajxhanit. Statusi ligjor i këtij institucioni bazohet në Kushtetutën e

Republikës së Azerbajxhanit (neni 92) dhe është pasqyruar edhe në Ligjin e Republikës së Azerbajxhanit “mbi Dhomën e Llogarive”, miratuar në vitin 1999. Në këtë ligj janë bërë edhe ndryshime dhe amendime të rëndësishme, për ta sjellë atë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sipas mandatit statusor, Dhoma e Llogarive është një organ i përhershëm i buxhetit të shtetit, i cili i raporton parlamentit (Milli Majlis) mbi kontrollin financiar të ushtruara. Dhoma e Llogarive ka pavarësi organizative dhe funksionale. Duke qenë një organizëm demokratik, Dhoma e Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit, e ndërton punën e saj mbi parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, objektivitetit, të kolegjalitetit, publicitetit dhe drejtësisë. Ajo i paraqet raportet e aktivitetit në parlament dhe është përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të specifikuar nga legjislati.

Sipas legjislatit në fuqi, Dhoma e Llogarive përbëhet nga Kryetari, zëvendëskryetari dhe 7 auditorë, mandati i të cilëve është nga 7 vjet. Pavarësia e aktiviteteve profesionale të Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe Audituesëve të Dhomës së Llogarive është e garantuar nga shteti. Në bazë të ligjit, aktivitetet organizative, logjistike, informative, financiare dhe ekonomike, kryhen nga stafi i Dhomës së Llogarive, i cili udhëhiqet nga Kryetari i Dhomës së Llogarive. Struktura, rregullat e punës dhe numri i stafit përcaktohet në vlerësimin e shpenzimeve nga Dhoma e Llogarive.

Aktivitetet dhe Procesi i Auditimit

Sipas Ligjit të Republikës së Azerbajxhanit “për Dhomën e Llogarive”, miratuar më 2 korrik 1999, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vitet e fundit, Dhoma kryen funksionet e mëposhtme:

- jep mendim për draftin e Buxhetit të Shtetit dhe fondet shtetërore shitesë;
- mbikëqyr vëllimin, strukturën, si dhe ekzekutimin në kohë të të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve ekstra-buxhetore;
- jep mendim për raportin vjetor mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet;
- analizon nëse financimi i buxhetit është kryer sipas parashikimeve, bën propozime për eliminimin e devijimeve të zbuluara dhe përmirësimin e procesit dhe ja paraqet ato parlamentit;
- mbikëqyr administrimin e pronës shtetërore dhe të parave të gjeneruara nga privatizimi i tyre;

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

- kryen ekzaminimin financiar të projektligjeve që lidhen me buxhetin e shtetit dhe fondeve ekstra, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të miratuara nga parlamenti, me udhëzim të parlamentit dhe komiteteve të tij;
- merr dhe analizon informacione nga Banka Qendrore e Azerbajxhanit, nga banka të tjera të autorizuara dhe nga institucione të kredive në lidhje me rrjedhën e financave të Buxhetit të Shtetit dhe të fondeve ekstra, si dhe jep propozimet përkatëse për parlamentin;
- informon parlamentin për gjetjet gjatë auditimit;
- punon në bashkëpunim me organet e tjera të kontrollit shtetëror.

Bashkëpunimet Ndërkombëtare

Në fillimet e veprimtarisë së saj, Dhoma e Llogarive vendosi kontaktet e para me organet shtetërore dhe subjektet që kryejnë kontrollin shtetëror financiar dhe buxhetor. Ajo u bë anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe përmbush detyrat e saj në fushën e bashkëpunimit dypalësh me institucione të ngjashme homologe. Dhoma e Llogarive është pranuar në organizata ndërkombëtare të ndryshme, të tilla si INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit), ASOSAI (Organizata Aziatike e Institucioneve Supreme të Auditimit) dhe ECOSAI (Kontrolli i Institucioneve Supreme të Shteteve Anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik) në vitin 2002.

Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe ka për qëllim të organizojë dhe të kryejë kontrole të jashtme të veprimtarive financiare shtetërore, për të përmirësuar trajnimin profesional dhe aftësitë e stafit të auditimit, të kryejë aktivitete të auditimit të përbashkëta, hulumtime, seminare, konferenca dhe takime, si dhe shkëmbimin e informacioneve dhe dokumenteve përkatës për të kryer auditime të përbashkëta veçanërisht kur marrëdhëniet dypalëshe tregtare dhe ekonomike janë në rritje. Hartimi dhe zbatimi i planeve të punës së Dhomës, ka për qëllim të kryejë funksionet dhe detyrat e specifikuar në Ligjin e Republikës së Azerbajxhanit «Për Dhomën e Llogarive» dhe me statutin e saj dhe i konsideron të ndryshme llojet e auditimit dhe punën analitike për krijimin e mekanizmit të nevojshme të kontrollit mbi përdorimin e fondeve shtetërore. Planet e punës përfshijnë mendime dhe informacione për hartimin e aktiviteteve funksionale të Dhomës dhe zgjidhjen e çështjeve mbi rregullshmërinë, metodologjinë dhe ligjin. Në planin e punës përfshihen gjithashtu edhe çështjet e aktiviteteve ndërkombëtare dhe të logjistikës.



Kontrolli i Lartë i Shtetit i Republikës së Shqipërisë

Kryetarët e KLSH



Lac Gera

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1925-1927



Llambi Aleks

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1927



Kol Thaçi

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1928-1930

Histori

Më 1925, Asambleja Kombëtare e Shqipërisë miratoi të parin Statut Themeltar të Shtetit Shqiptar (Kushtetuta). Për kohën e vet, ky dokument ishte një arritje e madhe historike që sanksionoi tiparet kryesore të shtetit dhe të institucioneve të tij legjitime. Në këtë kushtetutë, përcaktohet edhe institucioni që ngarkohet me kontrollin shtetëror të financave publike, Dhoma e Deputetëve.

Në Gusht 1946 bëhet riorganizimi tërësor i organeve të kontrollit, si në formë edhe në përmbajtje. Me ligj të veçantë të Kuvendit Popullor krijohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit.

Më 1966 suprimohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit. Ky organ riorganizohet në formën e një Inspektimi Shtetëror. Këtë formë ai e ruajti deri në vitin 1987.

Në vitin 1987, me dekret të veçantë, rikrijohet Komisioni i Kontrollit të



Lame Kareco

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1930-1931

Shtetit. Ky institucion vazhdoi të veprojë deri në fund të vitit 1991. Më 1992, me ligj të veçantë, krijohet institucioni suprem i kontrollit të shtetit. Ky institucion u emërtua Shërbimi i Kontrollit të Shtetit.



Delegacioni i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, i kryesuar nga Kryetari z. Blerim Çela, në Kongresin e INCOSAI Washington, D.C., tetor 1992



Eqerem Libohova

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1931-1932

Në Dhjetor 1997, për të përsosur bazën ligjore e institucionale të Kontrollit Shtetëror, me ndihmën e SIGMAS, u miratua nga Parlamenti ligji nr. 8270, datë 23.10.1997 "Mbi Kontrollin e Lartë të Shtetit". Ky ligj, pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nëntor 1998, u pasurua në muajin prill 2000 me disa amendime plotësuese.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë

Institucioni merr emrin ” Kontrolli i Lartë i Shtetit ” (KLSH).

“Në nëndor 2012 KLSH ka depozituar në Kuvend draft-amendamente të ligjit të tij organik që modernizojnë institucionin drejt standardeve INTOSAI. Më datën 16 nëndor 2012, drejtori në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Bashkimin Evropian, z. Robert Gielisse me shkresën Nr. 1354284 konfirmon se draft-amendamentet e ligjit organik të KLSH “...mund të konsiderohen në përputhje të plotë me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI, duke përfshirë Deklaratat e Limës dhe të Meksikos”.



Xhafer Ypi

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1933-1937



Rrok Gera

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1937-1939



Izedin Beshiri

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1943-1944



Kiço Kasapi

Kryetar i Këshillit Kontrollues
1945-1946



Pandi Kristo

Kryetar i Kontrollit të Përgjithshëm
të Shtetit, 1946

Funksionimi dhe detyrat

KLSH është institucion i pavarur i auditivit të jashtëm publik në Republikën e Shqipërisë. Pozicioni kushtetues i KLSH përcaktohet në ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, pjesa 14, nenet 162-165.

Funksionet dhe detyrat e KLSH janë përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin organik nr. 8270, datë 23.12.1997, plotësuar me amendimet përkatëse me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.



Shefqet Peçi

Kryetar i Kontrollit të Përgjithshëm të Shtetit, 1946-1947



Spiro Koleka

Kryetar i Kontrollit të Përgjithshëm të Shtetit, 1949-1950



Manush Myftiu

Kryetar i Komisionit të të Kontrollit të Shtetit, 1950-1952; 1989-1990



Osman Murati

Kryetar i Inspektimit të Shtetit 1978-1982



Stefan Papagjoni

Kryetar i Inspektimit të Shtetit 1982-1986

Në organizimin e drejtimit, KLSH i referohet rregullave e udhëzuesve organikë të brendshëm që veprojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar. Parimet bazë të drejtimit (organizimit) rrjedhin nga Deklarata e Limës dhe ajo e Meksikos, nga standardet e tjera të auditimit të INTOSAI-t dhe udhëzuesit evropianë të zbatimit. KLSH është anëtar i INTOSAI dhe EUROSAI që nga viti 1993.

Në aspektin e bazës rregullative të KLSH janë miratuar dhe janë objekt përditësimi të vazhdueshëm disa akte nënligjore mjaft të rëndësishme, si: Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të KLSH; Standardet e Kontrollit të KLSH, bazuar në standardet ndërkombëtare të kontrollit (INTOSAI); Kodi Etik i KLSH etj.

Pavarësia e institucionit është e garantuar me pozicionin kushtetues dhe ligjin organik të KLSH, duke filluar nga pavarësia e Kryetarit, pavarësia financiare, imuniteti i Kryetarit, pavarësia organizative dhe funksionale.

Kryetari i KLSH zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë



Enver Halili

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit, 1987-1989



Simon Stefani

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit, 1990



Ali Kaza

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit, Dhjetor 1990



Bujar Kolaneci

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit, Janar-Shkurt 1991

Republikës dhe qendron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. KLSH ka për objektiv auditimin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, miradministrimin financiar dhe auditimin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare. Gjithashtu, komunikimin dhe dhënien e informacionit autoriteteve publike dhe publikut në përgjithësi, nëpërmjet publikimit të raporteve të paanshme.

Mandati i auditimit

KLSH ka për detyrë të auditojë:

- Veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- Përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor;
- Veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve apo të aksioneve ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantoohen nga shteti;
- Përdorimin e fondeve që iu janë dhënë nga buxheti i shtetit partive politike dhe shoqatave;
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll-revizionit të brendshëm shtetëror, përfshirë auditin e brendshëm;
- Subjekte të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.



Zydi Pepa

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit, 22.02.1991-15.06.1991



Alfred Karamuç

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit, 16.06.1991-11.12.1991



Ylli Memisha

Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit
1991-1992



Blerim Çela

Kryetar i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit
1992-1997

KLSH ka të drejtë të bëjë propozime për përmirësimin e legjislacionit në fushat brenda detyrave të tij, madje kur gjatë auditimit konstaton akte ligjore ose nënligjore në kundërshtim me ligjet bazë, mund të kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e tyre nga organet që i kanë nxjerrë; ndërkohë që për shkeljet financiare me dëm ekonomik, KLSH kërkon kompensimin e vlerave të humbura. Për rastet kur shkeljet financiare me dëm ekonomik, përbëjnë vepër penale, ndaj personave përgjegjës bëhet kallzim në organet e prokurorisë, duke i dërguar dhe materialet përkatëse.

Raportimi

KLSH paraqet çdo vit në Kuvend:

- Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
- Mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, para se të miratohet nga Kuvendi;
- Raportin për Veprimtarisë Vjetore të KLSH.

Reformimi

KLSH po reformohet thellësisht duke kaluar nga tipi i punës i ngjashëm me inspektimin në auditime moderne të përputhshmërisë, auditim financiar dhe auditim të performancës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë

Institucioni ka marrëdhënie korrekte me institucionin e Presidentit të Republikës dhe Qeverinë Shqiptare.



Mustafa Kërçuku
Kryetar i Kontrollit të Lartë
të Shtetit
1997-2004



Kryeministri, Prof. Dr. Sali Berisha dhe
Kryetari i KLSH, Dr. Bujar Leskaj,
Tiranë, 19 janar 2012.



Robert Çeku
Kryetar i Kontrollit të Lartë
të Shtetit
2004-2011



Ish-Presidenti i Republikës, z. Bamir Topi
dhe Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj,
Tiranë, 2 shkurt 2012



Bujar Leskaj
Kryetar i Kontrollit të Lartë
të Shtetit
23 Dhjetor 2011 e në vazhdim



Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani dhe
Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj, Tiranë,
29 tetor 2012



Në pritjen e organizuar nga Presidenti për 100 Vjetorin e Pavarësisë, në Pallatin e Brigadave (nga e majta në të djathtë Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës z. Lars Lage Olofsson, z. Hiqmet Cavit Erdogan, Antar i Lartë i Dhomës së Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Kryetari i KLSH z. Bujar Leskaj, z. Igor Šoltes President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, z. Ivan Klešić, Auditor i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë) Tiranë, 28 nëntor 2012

Institucioni ka gjashtëfishuar këtë vit numrin e ditëve të trajnimit për auditues, në krahasim me një vit më parë, duke rritur ndjeshëm kapacitetet audituese dhe duke thelluar luftën kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij. Numri i kallëzimeve penale gjatë vitit 2012 është një herë e gjysmë më i lartë nga kallëzimet penale të këtyre tre viteve të fundit (2009, 2010 dhe 2011) të marra së bashku.

KLSH po e lufton korrupsionin në sistem, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera shtetërore, institucioni ka nënshkruar marrëveshje si me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm,



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm përfaqësuar nga Prokurorja e Përgjithshme znj. Ina Rama dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj Tiranë 28 qershor 2012

me Ministrinë e Financave,



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave përfaqësuar nga Ministri Dr. Ridvan Bode dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari Dr. Bujar Leskaj Tiranë, 8 maj 2012

me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive,



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis ILDKP përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm z. Adriatik Llalla, dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj Tiranë, 2 shkurt 2012

me Autoritetin e Konkurrencës



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Autoritetit të Konkurrencës përfaqësuar nga Kryetar Prof.Dr. Lindita Milo (Lati) dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari Dr. Bujar Leskaj
Tiranë, 23 mars 2012

me lëvizjen Alternativa Civile,



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis O.J.F. Alternativa Civile përfaqësuar nga z. Mentor Kikia dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, Tiranë, 23 prill 2012

dhe me organizatat më aktive të shoqërisë civile dhe përkatësisht me:

Transparency International në Shqipëri,



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis O.J.F. Transparency International Shqipëri përfaqësuar nga Drejtori z. Lutfi Dervishi dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj
Tiranë, 23 prill 2012

me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë”,



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë përfaqësuar nga Drejtori z. Sami Neza dhe KLSH përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, Tiranë, 23 prill 2012

me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për

Demokraci dhe Ndërmjetësim

dhe me Lëvizjen Evropiane Shqipëri.



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Institutit të Studimeve Bashkëkohore përfaqësuar nga Drejtori z. Artan Hoxha dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, Tiranë, 23 prill 2012



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Lëvizjes Europiane Shqiptare, përfaqësuar nga Drejtori z. Gledis Gjipali dhe KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, Tiranë, 23 prill 2012

Gjatë dhjetorit 2012 KLSH do të nënshkruajë marrëveshje me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, me Agjencinë e Prokurimeve Publike dhe me Avokatin e Popullit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

KLSH është bërë anëtar i INTOSAI në vitin 1984. Në formë deri diku të ngjashme me atë që është sot KLSH, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit (SHKSH), organi më i lartë i auditimit ekonomik e financiar shtetëror u krijua me Ligjin nr. 7597, datë 31.08.1992.

Në Qershor të vitit 1993, një delegacion i SHKSH, i kryesuar nga Kryetari z. Blerim Çela mori pjesë në Kongresin e II-të të EUROSAI në Stokholm të Suedisë, ndërsa në maj 1996 KLSH mori pjesë në Kongresin e III-të të EUROSAI, mbajtur në Pragë, Çeki.

Në tremujorin e katërt të vitit 1997, me ndihmën e ekspertëve të Programit SIGMA të BE-së dhe OECD-së u përgatit një projektligj i ri, i cili u miratua nga Parlamenti me datën 23.12.1997, duke bërë ndryshimin e emrit të SHKSH-së në Kontrollin i Lartë i Shtetit (KLSH), si dhe duke sanksionuar pavarësinë e institucionit.



Në foto: z. Jan Piter Lingen (ECA), z. Nick Treen (SIGMA), Kryetari i KLSH-së z. Mustafa Kërçuku gjatë dhënies së konkluzioneve të Seminarit mbi kontrollin e sistemeve IT Tiranë, 13 qershor 2003



Në foto: presidentët e SAI-ve të vendeve të Europës Qendrore e Lindore z. Mustafa Kërçuku Kryetar i KLSH-së (i pari radha e dytë majtas) Riga Letoni, prill 2004

Në periudhën 1999-2008, delegacione të KLSH-së të kryesuar nga Kryetari morën pjesë në të gjithë kongreset e EUROSAT-t, duke filluar nga Kongresi i IV i EUROSAT-t në Paris në vitin 1999, në Kongresin e V-të të EUROSAT të zhvilluar në Moskë, Rusi në vitin 2002 e me rradhë në Kongresin e VI-të në Bon të Gjermanisë në vitin 2005 dhe në Kongresin e VII-të në Krakov të Polonisë më 2008.

Në vitin 2006 KLSH, drejtuar nga z. Robert Çeku ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën e Llogarive të Federatës Ruse Në kuadër të Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit të vendit tonë me BE në muajin janar të vitit 2007 filloi zbatimin e **Projektit të Binjakëzimit** të KLSH-së me NAO-n e Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjykatën e Auditimit të Holandës dhe që përfundoi në shtator 2008, me këta komponentë:



Vizita zyrtare e Gjykatës së Llogarive të Turqisë në KLSH Në foto: z. Mehmet Damar Presidentit të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Drejtori për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, z. Bademli Kryetari i KLSH z. Robert Çeku, Drejtoresha e Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Evis Pustina, Tiranë, prill 2007

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

1. Reforma Institucionale,
2. Reforma e Burimeve Njerëzore,
3. Reforma Ligjore,
4. Komunikimet.

Pas një periudhe pauze 3 vjeçare, gjatë vitit 2012 KLSH ka vendosur raporte intensive bashkëpunimi me INTOSAI, EUROSAI, duke marrë pjesë rregullisht dhe aktivisht në konferencat e tyre rajonale, si dhe me institucionet homologe.

Gjatë vitit 2012 KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa SAI të tjera dhe përkatësisht me Zyrën e Auditimit Suprem të Polonisë (NIK), me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, me Gjykatën e Llogarive të Turqisë, me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe me Institutin Shtetëror të Auditimit të Kroacisë.

Kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e tjera homologe, KLSH gjatë vitit 2012 ka arritur të dërgojë auditues të tij jashtë shtetit për trajnim një numër të barabartë me atë të audituesve që institucioni ka dërguar jashtë shtetit gjatë shtatë viteve të fundit (2004-2011) të marra



Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj në zyrën e tij me Përfaqësuesen e Përhershme të Bankës Botërore në Shqipëri, Znj. Kseniya Lvovsky
Tiranë, mars 2012



Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë dhe Kryetari i KLSH në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes, maj 2012, Varshavë Poloni

së bashku. Si rezultat edhe i kësaj, numri i ditëve të trajnimit në vit për auditues gjatë 2012 është i barabartë me trefishin e numrit të ditëve të trajnimit në vit për dy vitet e fundit (2010, 2011) të marra së bashku.

KLSH gjatë vitit 2012 ka marrë pjesë aktive në evenimente ndërkombëtare, si në Konferencën e EUROSAI-OLACEFS zhvilluar në Tbilisi, Gjeorgji, në aktivitetet e 150 Vjetorit të themelimit të

Gjykatës së Llogarive të Turqisë në Ankara në maj 2012, Konferenca Antikorrupsion Poloni, dhjetor 2012, takime dhe seminare të rrjeteve rajonale dhe të grupeve tematike të EUROSAT në Pragë, Budapest, Romë, Qipro, etj.

Institucioni është në pritje të marrëveshjeve të bashkëpunimit me NAO-n britanike, me Gjykatën e Auditimit të Landit Bavarez, me Gjykatën e Auditimit të Austrisë ndërsa në rajon me SAI-t e Bullgarisë, Greqisë, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi.

KLSH ka rritur ndjeshëm gjatë vitit 2012 bashkëpunimin me SIGMA, duke siguruar, krahas asistencës për draft-amendimet e ligjit të tij organik, një program të gjerë trajnimi të audituesve të tij për auditimin e performancës, auditimin financiar, të përputhshmërisë, auditimin e teknologjisë së informacionit, etj. Ky program do të vijojë intensiv gjatë gjithë vitit 2013.



Ambasadori i delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri z. Ettore Sequi me Kryetarin e KLSH në një takim pune, Tiranë, nëntor 2012

Institucioni ka intensifikuar gjatë 2012-ës marrëdhëniet me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Bashkimit Evropian, duke siguruar një mbështetje thelbësore teknike për draft-amendimet e ligjit të tij, kulmuar me tryezat e punës të zhvilluara në Tiranë në nëntor 2012, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Njesisë së DG-Budget, z. Robert Gielisse.



Tryezë pune me shoqërinë civile për draft amendimet e ligjit të KLSH me pjesëmarrjen e z. Robert Gielisse nga DG-BUDGET, Tiranë, nëntor 2012

KLSH ka zgjeruar po ashtu kontaktet dhe shkëmbimin e informacionit me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, duke aplikuar në shkurt 2012 për një projekt binjakëzimi dhe duke e siguruar këtë projekt me vlerë 2.11 milionë euro, në kuadër të fondeve IPA 2012.

KLSH - EUROSAI dhe Institucionet Supreme Europiane të Auditimit

Para Monumentit të Pavarësisë me rastin e festimeve të 100-Vjetorit (nga e djathta Dr. Bujar Leskaj, Dr. Igor Šoltes, President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë dhe z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës), Vlorë, 28 nëntor 2012.



Me delegacionet e institucioneve të larta të auditimit të ardhura me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë, në zyrën e Kryetarit të KLSH z. Bujar Leskaj. (Dr. Igor Šoltes President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, Lidija Pernar Asistente e Auditorit të Përgjithshëm të Kroacisë, z. Lars Lage Olofsson Auditues i Përgjithshëm i Kosovës, z. Hiqmet Cavit Erdogan Anëtar i Lartë i Dhomës së Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Attila Caglar Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë i Gjykatës së Llogarive të Turqisë dhe Sami Suzer Auditues i Lartë i Gjykatës së Llogarive të Turqisë). Tiranë, 29 nëntor 2012

seria: botime KLSH- 07/2012

ISBN: 978-9928-159-04-5



Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: klsh@klsh.org.al